

# NARRA TIVAT E PËR BASH KËTA

*Përkrahja e pajtimit përmes  
tejkalimit të hendeqeve të  
narrativave ndarëse*





# NARRATIVAT E PËRBASHKËTA

*Përkrahja e pajtimit përmes tejkalimit të  
hendeqeve të narrativave ndarëse*

Ky libër është krijuar si pjesë e projektit i cili është zbatuar gjatë programit të *fellowship* të Aleancës për Dialog Historik dhe Përgjegjshmëri të Institutit për Studimin e të Drejtave të Njeriut në Universitetin Columbia në Qytetin e Nju Jorkut, SH.B.A., dhe është zbatuar nga Rjeti Rajonal i Nismës së të Rinjëve për të Drejtat e Njeriut në bashkëpunim me PAX for Peace nga Holanda dhe me mbështetjen e Fondacionit Robert Bosch nga Gjermania, Fondacioni Mott nga Sh.B.A., Komisioni Europian dhe Ambasadës së Republikës Franceze në Zagreb, Kroaci. Projekti e ka fitin çmimin e Republikës Franceze për të Drejtat e Njeriut *Liberté - Egalité - Fraternité* për vitin 2019 të.

AHDA

Adviser for  
Historical Dialogue  
and Accountability

COLUMBIA UNIVERSITY  
**ISHR**  
Institute for the Study of  
Human Rights

YHR

PAX

Robert  
Bosch  
Stiftung

**M** CHARLES STEWART  
MOTT FOUNDATION



AMBASSADE  
DE FRANCE  
EN CROATIE

U.S. BREAK THEM DID MY

A large sheet of paper covered with numerous small, rectangular pieces of paper, each containing handwritten text. The pieces are scattered across the page, some overlapping, and are held in place by two circular fasteners on the right side. The handwriting is in cursive and appears to be a collection of notes or a story. The paper is aged and yellowed, and the overall scene suggests a creative or investigative process.



# NARRATIVAT E PËRBASHKËTA

---

## *Përkrahja e pajtimit përmes tejkalimit të hendeqeve të narrativave ndarëse*


Ky libër është krijuar si pjesë e projektit i cili është zbatuar gjatë programit të *fellowship* të Aleancës për Dialog Historik dhe Përgjegjshmëri të Institutit për Studimin e të Drejtave të Njeriut në Universitetin Columbia në Qytetin e Nju Jorkut, SH.B.A., dhe është zbatuar nga Rrjeti Rajonal i Nismës së të Rinjëve për të Drejtat e Njeriut në bashkëpunim me PAX for Peace nga Hollanda dhe me mbështetjen e Fondacionit Robert Bosch nga Gjermania, Fondacioni Mott nga Sh.B.A., Komisioni European dhe Ambasadës së Republikës Franceze në Zagreb, Kroaci. Projekti e ka fitin çmimin e Republikës Franceze për të Drejtat e Njeriut *Liberté - Egalité - Fraternité* për vitin 2019 të.

AHDA

Alliance for  
Historical Dialogue  
and Accountability



Robert  
Bosch  
Stiftung

 CHARLES STEWART  
MOTT FOUNDATION®



  
AMBASSADE  
DE FRANCE  
EN CROATIE  
*Liberté  
Egalité  
Fraternité*

# IMPRESSUM

Autor i projektit	Mario Mažić	
Redaktorë të librit	Maja Nenadović, Mario Mažić	
Këshilluese	Marijana Toma	
Publikuesi	Youth Initiative for Human Rights - Croatia	
Për publikuesin	Morana Starčević, Nikola Puharić	
Autorër	Amar Bralić, Ante Pereza, Bojan Lazić, Diana Morina, Dino Buljat, Dora Pavković, Dušan Čvorović, Edvin Medunjanin, Engjell Hamiti, Era Çollaku, Filip Vulović, Irena Femic, Ivana Brajdić, Jasmina Hasanović, Lana Lugonja, Lejla Burgić, Ljiljana Jokić, Maja Žilić, Mario Mrkić, Marko Lončar, Milica Striković, Nadira Ćurulija, Nevena Petković, Nikica Torbica, Nikola Kandić, Samir Čomaga, Sara Pavlović, Stefan Štrbac, Tina Glazer, Valentina Perušina, Vasilisa Milošević, Viktorija Stanković, Zoran Dabetić	
Bashkëpunëtorët	Andjela Milojević, Bruno Viduka, Denis Suljaković, Dragana Mrđen, Fatlind Azizi, Filip Mitrović, Gloria Gudelj, Ilir Hajraj, Ivana Jovanović, Josip Humjan, Josipa Grgurić, Juraj Neralić, Lana Nanovski, Maja Vranić, Marina Milanović, Marko Milikić, Merima Čokić, Mihailo Mitić, Milena Medojević, Milica Stankić, Naim Talić, Nina Vukoslavčević, Oliver Pecirep, Tamara Milanović, Željko Jovanović	
Përkthimi	Bashkim Fazliu	
Përpunimi grafik	Petar Novak	

# PËRMBAJTJA



011	›	Prolog
019	:	Hyrje
025	"	Skena kulturore u viteve 90-të në Jugosllavinë e dikurshme
059	1	Bosnja dhe Hercegovina – Kroacia
093	2	Bosnja dhe Hercegovina – Mali i Zi
109	3	Bosnja dhe Hercegovina – Serbia
145	4	Kroacia – Serbia
173	5	Kroacia – Mali i Zi
225	6	Kosova – Serbia
263	x	Protestat kundër luftës
299	?	Përshtypjet e pjesëmarrësve
317	!	Përfundim
325	...	Epilogu
329	⌋	Metoda e përdorimit të Narrativave të Përbashkëta







# PROLOG

WOR  
Maja

011



# PROLOG




—  
011  
—









Ky tregim është krijuar për një kohë të gjatë. Deri në vitin 2012, Nisna Rinore për të Drejtat e Njeriut dhe organizatat të tjera që punojnë për të promovuar pajtimin në rajon kanë përfshirë tashmë mijëra të rinj në programe takimi dhe bashkëpunimi. Këto vizita nga një vend në tjetrin u kanë mundësuar pjesëmarrësve të sfidojnë disa nga pikëpamjet dominuese të mjedisit të tyre kombëtar (ose etnik), duke u ekspozuar ndaj atyre përvojat e të cilëve nga e kaluara e afërt janë të ndryshme; të cilët ndonjëherë festojnë diçka që kanë mësuar të dënojnë në komunitetet e tyre, ose madje përkujtojnë atë që të tjerët festojnë. Ideja e këtyre shkëmbimeve është t'u ofrojnë të rinjve një pasqyrë për një temë - një ngjarje historike - nga një perspektivë të ndryshme nga e tyre, duke besuar se kjo do të inkurajojë një 'dialog të brendshëm' midis besimeve të ngulitura thellë dhe njohurive nga kjo përvojë e re. Të tilla ishin reagimet që merrnim shpesh: pjesëmarrësit kanë thënë që vizitat nganjëherë i kanë shtyrë të ndërlidhin atë që u është treguar sistematikisht (nga udhëheqësit e tyre kombëtarë, edukatorët ose familjet) me ato që kanë parë dhe mësuar gjatë vizitës.



E gjithë ideja e projektit 'Narrativat e Përbashkëta' ishte që ky dialog i brendshëm të nxirrej jashtë.

Pjesa më e madhe e konceptit është zhvilluar gjatë qëndrimit tim në programin Dialogu Historik dhe Përgjegjësia (AHDA) në Institutin e Studimit të të Drejtave të Njeriut në Universitetin Columbia gjatë vitit 2012. Drejtori i Institutit dhe mentori im, prof. Elazar Barkan dhe drejtuesja i programit AHDA në atë kohë, Ariella Lang, do të mbledhnin seminare ku kemi diskutuar dhe debatuar mbi atë se çfarë përbën dialogun historik, nëse mund ta përcaktojmë atë nga rezultatet dhe ndikimi i tij, ose më mirë nga procesi i tij.

Këto biseda dhe këshilla nga Elazari, Ariella dhe kolegë të tjerë, veçanërisht Sandra Orlović dhe Murat Celikkan, si dhe shembujt nga të cilët kam mësuar (disa prej tyre dukeshin si suksese dhe disa si dështime) më çuan në përfundimin vijues: dialogu historik nuk është një koncept si, le të themi, drejtësia - të cilin kemi mësuar ta funksionalizojmë dhe institucionalizojmë me kalimin e kohës. Nuk mund ta dallojmë as për nga 'rezultatet' - nuk mund të vëzhgojmë narrativen e së kaluarës në një shoqëri dhe thjesht të konkludojmë se është rezultat i dialogut historik. Sigurisht që mund të jetë, por është gjithashtu e mundur që të imponohet, të ruhet përmes një forme detyrimi. Ose mund të mos jetë asgjë nga këto, por gjithsesi nuk është rezultat i një dialogu të hapur, real, gjithëpërfshirës. Dialogu historik duket të jetë më i pranishëm në shoqëritë ku ka mosmarrëveshje ose këndvështrime të ndryshme për të kaluarën e tyre. Dialogu duket se lulëzon në veçanti në shoqëritë që mund të shkëmbejnë hapur, lirshëm dhe në mënyrë të sigurt perspektivat dhe pikëpamjet e ndryshme mbi të kaluarën; ku nuk duhet guxim të mendosh dhe të shprehësh mendime. Ku, mbi të gjitha, perspektiva e shumicës nuk i detyron të tjerët të heshtin, por përfshihet në një ndërveprim që të gjithë të mund ta dëgjojnë.

Edhe pse në hapësirën e ish-Jugosllavisë ka shumë versione të historisë dhe megjithëse ekziston ndërveprimi i rregullt ndërmjet tyre, kryesisht përmes mosmarrëveshjeve dypalëshe, më duket se këto ndërveprime nuk plotësojnë kriteret minimale për dialog historik. A mund të përfshihemi në dialog nëse të dy palët u japin përparësi ndjenjave dhe mitologjisë së tyre në krahasim me faktet? Nëse 'kush na thotë' është më e rëndësishme nga ajo që na thuhet? Nëse në të vërtetë nuk e dëgjojmë njëri-tjetrin, por gjithsecili bërtet të veten pa ndonjë ndikim në perspektivën e tjetrit?

Elazari do të sugjeronte që dialogu historik mund të jetë një situatë ku nuk pajtohemi, por ku mosmarrëveshja është racionale, në vend që besimet tona të jenë të rrënjosura në identitet. Ndonjëherë ai gjithashtu pyeste nëse dialogu mbaron ndonjëherë apo është një proces i hapur përjetësisht. Edhe sot, nuk jam në gjendje, përmes hulumtimeve ose eksperimentimeve të të menduarit, të gjej ose imagjinoj një ndërprerje jo-totalitare të dialogut historik. Ne mund të argumentojmë se ka ngjarje nga e kaluara që janë dokumentuar në mënyrë të detajuar saqë kuptimi i tyre është pothuajse universal dhe prandaj nuk janë të rrethuara nga ndonjë dialog. Por unë do ta sfidoja këtë pikëpamje. Kushdo që dëshiron të kuptojë tmerret e Holokaustit



ka mënyra dhe burime të panumërta për të edukuar veten në lidhje me të. Megjithatë, deri më sot, ka zëra të vazhdueshëm, dhe jo vetëm marginalë, që e mohojnë ose e vënë në dyshim me forcë atë.

Pikërisht kjo e kuptuar e dialogut historik si një proces e ka dhënë idenë për këtë projekt. Dialogu historik vë në dyshim mitologjinë nacionaliste, shtypjen e të menduarit kritik dhe vënien në pikëpyetje përmes arsytimit racional. E vë në dyshim kur nga të rinjtë pritet që vetëm të konsumojnë narrativat pa ekspozimin më të vogël ndaj kundër-narrativave, historive të atyre që kanë parë diçka nga një perspektivë ndryshe nga e tyre. Suprimohet kur duhet guximi qytetar që fare të dëgjohet, e lëre më të gjindet mirëkuptim për 'tjetrin'. Megjithatë, kjo kryesisht u përcillet brezave të rinj në këtë cep të botës. Kjo duket të jetë arsyeja pse arsimi është akoma i ndarë etnikisht në pjesën më të madhe të rajonit.

Secili proces ka nevojë për hapësirën e vet. Projekti 'E Kaluara e Vazhduar: Narrativat e Përbashkëta' është konceptuar si hapësirë për dialog historik; hapësirë ku të rinjtë janë të gatshëm të marrin pjesë në vënien në pikëpyetje të perspektivës së të tjerëve derisa e vënë në pikëpyetje edhe të tyren edhe mund ta bëjnë këtë lirshëm dhe përmes bashkëpunimit. Është konceptuar si kontribut në ndërtimin e infrastruktures për dialog.

Sidoqoftë, ky nuk ishte motivimi fillestar për këtë projekt. Motivimi erdhi nga një histori shumë personale, e imja. Në vitin 2008, kam vizituar rajonin për të mësuar se çfarë bëjnë degët e Nismës së të Rinjëve për të Drejtat e Njeriut në shoqëritë e tyre. Kur isha në Beograd, Serbi, isha ulur në zyre me një hapësirë të hapur dhe Tanja Mrkalj ishte ulur në një tavolinë ngjitur me timen. Kemi biseduar dhe e kam përmendur që jam nga Petrinja në Kroaci. Ajo më pyeti "Ku në Petrinja?". Petrinja është një qytet që shumë njerëz në Kroaci nuk dinë ta tregojnë në hartë, kështu që u befasova kur ajo më pyeti për detaje të mëtejshme. Ajo pa habinë time dhe tha "Edhe unë jam nga Petrinja". "Nuk mund të jesh", thashë, pasi ishim në moshë relativisht të ngjashme dhe isha i sigurt se do ta njihja, të paktën ndonjëherë do ta shihja në qytet nëse do të ishte kështu. "Jemi arratisur gjatë 'Stuhisë' (Oluja) në vitin 1995", vazhdoi ajo. Ishte hera e parë që kisha biseduar me dikë 'nga ana tjetër' e megjithatë kaq afër. Më vonë mësova se gjyshi im kishte qenë mik me anëtarët e moshuar të familjes së Tanjës.

Ajo bisedë më ka ndryshuar. E ka frymëzuar një pjesë të madhe të punës sime që nga ajo kohë. Ky projekt ishte një përpjekje për t'u dhënë të rinjve të tjerë në rajon një përvojë kaq të vlefshme, transformuese.

Në vitin 2019, morëm lajmin se projekti do të vlerësohet me Çmimin Kombëtar të Republikës Franceze për të Drejtat e Njeriut. Për ta Pranuar atë, Maja Žilić, njëra nga pjesëmarrëset në projekt dhe unë udhëtuaam për në Paris, Francë. Prindërit e Majës gjithashtu u arratisën nga Petrinja në Operacionin 'Stuhia', së bashku me Tanjën dhe shumë të tjerë.

Kjo është arsyeja pse në fjalimin tim kam thënë: "Në verën e vitit 1995, një vit para lindjes së Majës, prindërit e saj u larguan nga Kroacia sepse u dëbuan në një operacion ushtarak që më lejoi mua dhe familjes time të ktheheshim në shtëpi pas pesë vitesh si refugjatë. Nëse nuk do të kishte pasur luftë, nëse askush nga ne nuk do të ishte detyruar të ikte ose të ishim të ekspozuar ndaj dhunës, unë dhe Maja do të ishim rritur në të njëjtin qytet. Mamaja e saj dhe e imja janë të së njëjtës moshë. Ajo është e të njëjtës moshë me kushërirën time. Vëllau i Majës është një vit më i ri se unë. Ne ndoshta do të luanim së bashku, do të shkonim në shkollë së bashku, do të fshiheshim dhe do të pinim verë të lirë së bashku në argjinaturët e Petrinjčicas... Tregimet tona janë të ndryshme. Historitë tona mund të na etiketojnë si armiq. Por sot, Maja, unë dhe kolegët tanë qëndrojmë së bashku, të bashkuar në luftë të përbashkët për një të ardhme më të ndershme se e kaluara jonë".

E vetmja mënyrë se si mund ta lëmë logjikën e luftës pas nesh është duke u bashkuar në të kuptuarit se asnjë nga përvojat tona, asnjë histori e jona nuk mund të tregojë të gjithë tregimin e asaj që ka ndodhur. Secili prej nesh mban një pjesë të së vërtetës në të kaluarën tonë, secila prej tyre është e vlefshme dhe secila prej tyre duhet të ketë një vend në një shoqëri të hapur dhe të bazuar në mirëkuptim.

*Mario Mažić*



HYRJE



019




many others.


This is why I said the following in my speech there: “Back in the summer of 1995, a year before Maja was born, her parents fled Croatia as they were expelled in the military action that allowed me and my family to go back home after five years as refugees. If there was no war, if none of us were forced to flee or were exposed to violence, Maja and I would have grown up in the same town. Her mom and my mom are the same age. She is the same age as my cousin. Maja’s brother is one year younger than I am. We probably would have played together, gone to school together, hid to drink cheap wine at the Petrinjčica riverbank together... Our stories are different. Our histories might label us enemies. But today, Maja and I, and all our colleagues are standing together, as one, united in a common struggle for a future fairer than our past.”

The only way we can put the logic of war behind us is by coming together in understanding that none of our experiences, none of our histories can tell the full story of what happened. Each of us holds a fragment of truth in our past, each of them is worthy, and each of them should have a place in a society that is open and founded on understanding.

*Mario Mažić*



# HYRJE









Qëllimi kryesor i 'Narrativave të Përbashkët' është mbështetja e pajtimit dhe përfshirja e të rinjve në procesin e dialogut me qëllim të parandalimit të përsëritjes së dhunës në ish-Jugosllavi. Kjo është bërë përmes një qasje të krijuar së bashku me pjesëmarrësit ku mbi 150 të rinj nga 5 vende të rajonit (Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Kosova, Mali i Zi dhe Serbia) janë takuar dhe përfshinë në dialog në grupe dypalëshe.

021

Projekti ka filluar në mars 2018 me një konferencë rajonale të quajtur 'Sillni Historinë Tuaj'. Siç sugjeron vetë emri, kjo është një hapësirë ku të rinjtë inkurajohen të ndajnë këndvështrimin mbi historinë e fundit të rajonit me të cilën janë rritur, të cilën e kanë mësuar në shkollë. Ka qenë e rëndësishme të njëhej fakti i ndryshimeve të thella në narrativa që nga fillimi dhe të krijohej një mjedis në të cilin pjesëmarrësit kanë ndier se mund të ndajnë lirisht pikëpamjet e tyre, pavarësisht nga distanca ose afërsia e narrativave dhe perspektivave të të tjerëve. Pjesëmarrësit në konferencë janë organizuar në 6 grupe bilaterale (Bosnja dhe Hercegovina - Kroacia, Bosnja dhe Hercegovina - Serbia, Kroacia - Serbia, Bosnja dhe Hercegovina - Mali i Zi, Kroacia - Mali i Zi, Kosova - Serbia). Secili prej grupeve përbëhej nga mbi 20 të rinj (10 nga secili vend) të cilët kanë marrë pjesë në dy vizita studimore në vendet ku kanë mësuar për temë të zgjedhur nga historia e re. Temat dhe vendet për vizita janë zgjedhur nga pjesëmarrësit të cilët gjithashtu kanë krijuar orare të vizitave. Fillimisht, temat supozohej të kishin të bënin vetëm me çështje të vëna në dyshim përmes mohimit dhe relativizimit kryesisht mbi baza etnike dhe kombëtare (p.sh. krimet në Ahmići dhe Trusina, rrethimi i Sarajevës, gjenocidi në Srebrenicë, beteja për Vukovar, sulmi ndaj Dubrovnikut, operacioni 'Stuhia', krimet e luftës në Kosovë, etj.), por pjesëmarrësit kanë insistuar që të shtohen temat me një ton pozitiv - kështu që janë shtuar temat e protestave

kundër luftës dhe skena kulturore e luftës në rajon. Para se të fillonin përpjekjen për të shkruar rrëfimet e përbashkëta, pjesëmarrësit kanë shkruajtur rrëfime për tema të zgjedhura për të treguar atë që ata mendojnë se përfaqëson më së miri narrativën dominuese për çështjen e dhënë në komunitetin e tyre, mjedisin e tyre.

Pas vizitave pjesëmarrësit kanë punuar në hulumtim dhe janë përfshinë në dialog ku kanë punuar në narrativa të përbashkëta mbi temat e dhëna. Atyre iu është kërkuar të përpiqen të zhvillojnë narrativa të bazuara mbi fakte, të respektojnë dinjitetin e viktimave dhe të jenë të përmbledhur. U është kërkuar që lirisht të shkruajnë narrativa të veçanta nëse kanë menduar ai i përbashkëti nuk ka pasqyruar pikëpamjet e tyre. Një ekip i vogël pjesëmarrësish (ata që kanë koordinuar grupet bilaterale) janë takuan edhe një herë për të ndërlidhur, rregulluar dhe përfunduar narrativat.

Narrativat e tyre bazohen në kërkim të përgjegjshëm, humanist të të kuptuarit të dhimbjes së atyre që ne jemi mësuar t'i përjetojmë si 'të tjerë'. Prandaj, ato kanë aftësinë të na afrojnë jo vetëm duke na afruar të gjithëve me 'të vërtetën', por edhe duke na afruar me njerëzimin tonë të përbashkët, atë që e ndajmë pavarësisht nga të gjitha dallimet që jemi mësuar t'i shohim si jashtëzakonisht të rëndësishme.

—  
022  
—

Në fund, doli se ky projekt nuk merret vetëm me narrativat e diskutueshme dhe të ndryshme. Merret gjithashtu me avokim kundër arsimit të ndarë të cilin vazhdojmë ta shohim në të gjithë rajonin, gjë që justifikohet nga ideja se diçka është natyrshëm e 'ndryshme' në mes të të rinjve për shkak të identitetit të tyre të ndryshëm. Prandaj, ky projekt është kundër idesë se dialogu është i padëshiruar ose i pamundur. Kundër botëkuptimit që historia (mësimi i historisë) është diçka që u diktohet studentëve ta pranojnë në mënyrë joselektive. Është kundër mohimit dhe refuzimit të njohjes së perspektivës së viktimave. Përfaqëson refuzim të manipulimit dhe refuzim të urrejtjes.

*Maja Nenadović & Mario Mažić*



# SKENA KULTURORE U VITEVE 90-TË NË JUGOSLLAVINË E DIKURSHME


---



025







wartime cultural scene across the region were added as well. Before engaging in an attempt to write shared narratives, the participants wrote narratives on the selected topics in a way that they feel best presents the dominant narrative on the issue in their community, their surroundings.

After the visits, the participants worked on research and engaged in dialogue where they were working on shared narratives about the topics. They were asked to try and develop narratives that are fact-based, respectful of humanity of victims, and concise. They were invited to freely write a dissenting narrative, if they felt that the shared one did not reflect their views. A smaller team of participants (those who co-ordinated bilateral groups) met at a writers' retreat to tie together, edit and finalize the narratives.

These narratives are based in a responsible, humanist pursuit of understanding the pain of those we were taught to see as 'other'. Thus, they have the ability to bring us together not only by bringing us all closer to 'the truth', but also by bringing us closer to our common humanity, to what we share despite all the differences we were taught to consider utterly important.

This process, in the end, turned out not to be about contested and differing narratives alone. It is also about advocating against segregated education that we continue to see across the region, justified by the notion of something being innately 'different' between young people because of their different identities. It is against the notion that dialogue is unwanted, or impossible. It is against the notion that history (education) is something that is dictated to students to non-selectively accept. It is against the denial and the refusal to acknowledge the perspective of victims. It is a rejection of manipulation and a rejection of hatred.

*Maja Nenadović and Mario Mažić*

# SKENA KULTURORE U VITEVE 90-TË NË JUGOSLLAVINË E DIKURSHME

---



—  
025  
—







***Skena kulturore:  
fushë betejë pa plumba apo hapësirë  
e përpjekjes për liri në vitet nëntëdhjetë?***



Megjithëse lufta zakonisht perceptohet, dhe mbahet mend, si çështje politike dhe konfliktet në histori në përgjithësi janë analizuar për nga shkaqet politike dhe pasojat e tyre, është e rëndësishme të kuptohet që veprimet aq të rëndësishme dhe të mëdha kolektive si luftërat lënë gjurmë të thella mbi shoqëritë dhe individët që i përbëjnë ato. Lufta gjithmonë ka depërtuar në poret më të ngushta të shoqërisë, duke ndryshuar jetën, duke çuar në ndryshim të identiteteve kombëtare dhe duke ndikuar kështu në format kulturore dhe dinamikën e grupeve që do të merrnin pjesë në të.

Pjesëmarrësit e këtij projekti ka njohur rëndësinë e asaj që të flasin jo vetëm për luftën, por edhe për implikimet më të gjera sociale të luftës, të lëshohen në analizën e ndikimeve që kishte lufta në kulturën e bashkësive, jeta e të cilave është definuar në mënyrë të konsiderueshme nga lufta. Kjo analizë është veçanërisht e vlefshme sepse paraqet një përpjekje të të rinjve për të kuptuar se sa thellësisht lufta ka përcaktuar ato fusha të veprimtarisë njerëzore që ne ndryshe i lëmë pas dore kur flasim për luftë. Ajo është një produkt i besimit se produkti kulturor është një model specifik i ruajtjes së dinamikës sociale dhe, si pasojë, përmban leksione mbi atë se si shoqëria përcaktohet ndaj luftës, shkaqeve të saj, protagonistëve dhe viktimave në një kohë kur ajo që ne shohim sot si histori ishte përditshmëri. Shkurt, kultura e një shoqërie lufte është një dritare mbi proceset e saj të brendshme - etike, emocionale dhe politike.

Skena kulturore në të gjitha vendet e rajonit ka qenë një hapësirë për të shprehur pikëpamjet si për ashtu edhe kundër luftës. Në kohë lufte, kultura pushon të jetë thjesht mënyrë e kalimit të kohës dhe një shfaqje fisnike e mendjes njerëzore, por bëhet gjithashtu një armë e fuqishme e politikës dhe propagandës shtetërore. Përdoret për të

shprehur qëndrime kundër luftës, por edhe për të forcuar vetëdijen kombëtare, për të rritur moralin dhe për të inkurajuar veprimet në përputhje me ideologjitë politike.

Përmes një seri esesh, në këtë kapitull do të fitoni njohuri për zhvillimet kulturore në secilin prej vendeve të rajonit gjatë luftërave të viteve nëntëdhjetë. Ky kapitull është specifik sepse përshkruan ndarjen e narrativave brenda vetë vendeve të rajonit, ndërsa kapitujt e tjerë përqendrohen në ndarjen e narrativave midis shteteve të rajonit në konflikt.

Në kapitullin e skenës kulturore në Bosnje dhe Hercegovinë gjatë luftës, do të keni mundësi të lexoni për këmbënguljen dhe guximin e artistëve dhe muzikantëve që kanë organizuar dhe marrë pjesë në një seri ngjarjesh kulturore pavarësisht rrethimit brutal të Sarajevës; në eseun për Kroacinë do të lexoni për shtypjen dhe censurimin e artistëve dhe gazetarëve që guxuan të kritikojnë hapur elitën qeverisëse në vitet 1990; eseu për skenën në Kosovë zbulon një botë të aktivitetit të fshehur kulturor në kafene dhe galeri gjatë viteve tetëdhjetë dhe nëntëdhjetë, gjatë shtypjes së regjimit jugosllav nga Serbia; eseu për Malin e Zi tregon disa nga muzikantët dhe artistët më në zë që ndikuan në skenën kulturore të këtij vendi në vitet nëntëdhjetë; në fund, eseu për Serbinë paraqet ndikimet kulturore pro dhe kundër luftës që ishin në konflikt me njëra-tjetrën në vitet nëntëdhjetë.



## **Mund të na merrni gjithçka tjetër përveç inatit: Skena kulturore e BiH gjatë luftës**

---

“Skena muzikore në luftë ishte një burim idesh fantastike dhe energjie, të cilat na mbanin, si të rinj në atë kohë, relativisht normal. Koncertet në Obalë dhe Slogë ishin një lloj shpëtimi nga lufta dhe tmerrri në një botë normale të klubeve dhe të daljeve në mbrëmje.”

*Enes Zlatar, frontmen i grupit Sikter*

Lufta si fenomen përfshin jo vetëm sakrifikimin e njerëzve, por edhe rrëzimin e sistemit të vlerave, ngritjen e nacionalizmit, shkatërrimin e territoreve, zhdukjen e institucioneve, por edhe humbjen e identitetit. Identiteti i një kombi ose shteti reflektohet kryesisht në skenën kulturore të një hapësire të caktuar. Gjendja e luftës shkatërron ciklet normale të jetës, kështu që as kultura nuk është immune ndaj kësaj. Është e vështirë të flitet për skenë kulturore në kushte të tilla, dhe duhet të përqendrohemi mirë për të gjetur ato zëra të vetmuar të cilët ishin të gatshëm të kundërshtonin tendencat mbizotëruese nacionaliste, të ngrisinin zërin kundër shovinizmit dhe histerisë së luftës.

Ajo që karakterizon gjendjen e luftës kudo në botë, dhe gjatë luftës ndaj kësaj nuk ka mbetur immune as Bosnja dhe Hercegovina, është propaganda e luftës. Përgatitjet për luftë nuk konsistojnë vetëm në armatimin e ushtrive të palëve në konflikt, por shpesh, para vetë konflikteve, civilët - ushtarët e ardhshëm – duhet të përgatiten mendërisht. Ndikimi i propagandës së luftës ka qenë i jashtëzakonshëm në këtë luftë, por megjithëse do të përmendet në disa raste, ky tregim do të përqendrohet në shembujt më të famshëm pozitivë të ngjarjeve dhe lëvizjeve kulturore, të cilat, për fat të keq, nuk marrin aq vëmendje sa duhet, sipas parimit të vjetër - pse të përqendrohemi në gjera pozitive, kur mund të jemi negativë?

Në Bosnjë dhe Hercegovinë, si dhe në vendet tjera të ish-Jugosllavisë, kultura ishte e vetmja reze shprese për një të ardhme më të mirë; fija e shpëtimit, e cila ka shpëtuar njerëzit nga humnera që do t'i tërhiqte



ata në çmenduri të plotë. Kështu, kur flasim për skenën kulturore të BiH gjatë viteve të luftës, ajo nuk mund të izolohet nga Jugosllavia, veçanërisht në fushën e muzikës.

Qysh nga koha e shtetit të mëparshëm, janë vendosur standarde të caktuara për sa i përket numrit të kopjeve të albumeve, si dhe shijes së audiencës. Megjithë kufizimet nga ana e shtetit, këngëtarët neo-folk kishin kopje disa herë më të shumta dhe industria e muzikës mbështetej mbi to. Njëkohësisht rock and rolli, megjithëse komercialisht jo-fitimprurës, është imponuar nga shteti si muzikë europiane urbane. Në fillim të luftës, shteti u tërhoq nga roli i diktatorit të politikës publikuese dhe mund të themi se rock and rolli gjatë luftës, zhduket pothuajse plotësisht. Ajo që tërheq masat dhe çfarë është mainstream i ri janë këngët me motive kombëtare: këngë me motive nga Kosova në elementet e muzikës popullore serbe, fillimi i lëshimit të albumeve me ilahi dhe kaside (ish-interpretuesit e sevdahit) dhe paraqitje të ngjashme. Për dallim nga RF e Jugosllavisë dhe Kroacia, në të cilat ekziston një proces paradoksal i mbylljes së jashtme dhe hapjes së brendshme të skenës muzikore (d.m.th. njerëzit nuk udhëtojnë, por vlerat kulturore perëndimore vijnë në këto vende përmes dance-it në Serbi dhe tekno-popit në Kroaci), BiH mbetet immune ndaj ndikimit perëndimor në muzikë. Përderisa krijohen këngë nacionaliste në BiH dhe Kroaci, Beogradi bëhet qendra e tekno skenës së Europës Lindore. Tendencat perëndimore ndikojnë në skenën popullore të deriatëhershme, duke çuar në formimin e një muzike që ne e njohim si turbo folk. Është thjesht e jashtëzakonshme çfarë “futet” nën këtë etiketim gjatë kësaj periudhe, që nga folku luftëtar i Gexhas, Vëllezërve Bajiq dhe Baja Mali Kninxha, përmes grupeve dance deri tek realizimet tekno-folk si të Ivan Gavriloviqit. Ajo që pengon zhvillimin më të rëndësishëm të skenës muzikore në BiH gjatë luftës është mungesa e kanaleve të mjaftueshme televizive. Sarajeva – kryeqyteti i rock and rollit të para luftës në Jugosllavi – reziston ndaj ndikimeve të vendeve fqinje kurse realizimet e rralla muzikore që shfaqen gjatë kësaj periudhe vazhdojnë trendet e paraluftës ose bëhen në stilin pop.

TNdikimi i tendencave të paraluftës është i dukshëm edhe në këngët që në ato vite kanë përfaqësuar BiH në garën më të madhe muzikore - Eurovizion. Për herë të parë, BiH performon në Eurovizion në

vitin 1993 me këngën “E gjithë dhimbja e botës” (“Sva bol svijeta”) interpretuar nga Fazla, pastaj në vitin 1994 me këngën “Qëndro pranë

meje” (“Ostani kraj mene”) të realizuar nga Alma dhe Dejan, dhe në 1995 me këngën “Shekulli njëzet e një” (“Dvadeset prvi vijek”) të interpretuar nga Davorin Popović. Nga tre këngët e përmendura, shembulli më domethënës i një revolte ishte kënga “E gjithë dhimbja e botës”, e cila i referohej të gjitha dhimbjeve gjatë luftës. Për shkak të luftës, performanca e Fazlës në Dublin mund të përcillej nga shumë pak qytetarë të BiH.

Megjithëse BiH nuk ka qenë kurrë një komunitet i njohur për ushqimin e kulturës së muzikës klasike, shembulli më pozitiv i revoltës gjatë luftës është Vedran Smajlović. Në fakt, Vedran Smajlović është një muzikant nga Bosnja dhe Hercegovina, i njohur si “Violonçelisti i Sarajevës”. Gjatë rrethimit të Sarajevës, Smajlović ka luajtur “Adiagio në G Minor” të Albinonit në ndërtesat e shkatërruara dhe gjithashtu ka luajtur në funerale – shpesh nën kërcënimin e snajperëve. Ky akt i njerëzisë në luftë ka frymëzuar shumë muzikantë dhe performanca e tij e kompozimit të Albionit është përmendur edhe në librin “A Story Like the Wind” (“Një tregim si era”).<sup>1</sup>

Gjatë luftës në BiH, teatri nuk ka pushuar së funksionuari. Gjatë kohës së luftës janë dhënë premiera të shumë shfaqjeve, duke përfshirë “Duke pritur Godonë” nga S. Beckett, “Alkestisin” nga Euripidi, “Mbreti Yby” nga A. Zhari, “Hamletmakina” nga H. Müller, “Përralla e Sarajevës” nga G. Shimić, “Alfabeti” F. Duraković etj. Teatri Rinor ka organizuar në galerinë e tij një ekspozitë më 6 prill 2004 me titull “Teatri nën rrethim”, në të cilën janë paraqitur fotografi të shfaqjeve të krijuara gjatë luftës 1992-1995 në BiH. Janë treguar 13 fotografi nga shfaqjet e Teatrit të Luftës të Sarajevës (SARTR), Teatrit Kamertal 55, Teatrit Rinor Sarajevë, Teatrit Kombëtar të Sarajevës, si dhe shfaqjeve të realizuara në Festivalin Ndërkombëtar të Teatrit MESS.

Një nga informacionet më të rëndësishme që lidhen me veprimtarinë teatrore gjatë luftës vjen nga libri “Teatri në Sarajevë gjatë Luftës 1992-1995” nga Nihad Kreshevlaković dhe Davor Diklić.<sup>2</sup> Njëri nga dy autorët e librit, Nihad Kreshevlaković, shprehet se në Sarajevë, në tre vite lufte, pati 3.102 ngjarje kulturore, 48 koncerte të Orkestrës Filharmonike të Sarajevës, 263 libra të botuar, 177 ekspozita arti, 156 dokumentarë dhe 182 premiera teatrore, mbi 2.000 shfaqje të dhëna. Diklić, nga ana tjetër, thotë se motra e tij, Jasna Diklić, një heroinë e aktrimit në BiH, i ka thënë atij se më parë do të vdiste sesa të mbijetojë përsëri luftën – por shton se ajo ishte pjesa më e bukur e jetës së saj, pikërisht për shkak të ndikimit të madh që kishte kultura tek njerëzit.



Kur gjithçka rreth jush është e zezë, edhe një rreze e vogël dritë shkëlqen si diell.

Prodhimi dhe shfaqjet e filmave, nga ana tjetër, kishin një histori ndryshe. Filmi me titull “Vitet e gomarit” (“Magareće godine”) u përfundua në vitin 1991, por për shkak të shpërthimit të luftës, editimi u përfundua në Paris, dhe filmi u shfaq për herë të parë gjatë rrethimit të Sarajevës në gusht 1994. Gjatë luftës, pjesëmarrja në shfaqjet e filmit ishte shumë e ulët - deri më 25 tetor 1995, kur u mbajt Festivali i Parë i Filmit në Sarajevë. Një numër i pabesueshëm prej 15,000 vetash erdhën për të parë shfaqjet e 37 filmave nga 15 vende të ndryshme. Që atëherë, Festivali i Filmit në Sarajevë është rritur në popullaritet dhe tani konsiderohet një nga festivalet më të rëndësishëm të filmit në Europë.

Kur mendojmë për letërsi, mund të themi se libri më i rëndësishëm “i luftës” ishte “Ditari i Zllatas” (“Zlatin dnevnik”) nga Zllata Filipović. Gjatë luftës, Zllata ishte një vajzë që kishte shkruar një ditar, duke iu drejtuar Mimas. Zllata e kaloi periudhën e luftës në Sarajevë, dhe këtë libër e ka shkruar gjatë luftës, nga shtatori 1991 deri në tetor 1993. Përmes këtij libri ne mund të shohim pafajësinë e një fëmije, e cila thjesht dëshiron të mbijetojë fëmijërinë e saj - asgjë më pak, as më shumë. Vetë ditari rrëfen ngjarjet e luftës përmes syve të një vajze të vogël, me përshkrime të thjeshta që të prekin në zemër. Një nga fjalitë më të famshme të ditarit ishin “NDALONI TË SHTËNAT” dhe “PAQE, PAQE, PAQE”, shkruar pas vdekjes së të dashurve të Zllatës. Në parathënien e librit, reportuesja Janine di Giovanni e ka quajtur Zllatën Anna Frank e Sarajevës, që këtij tregimi i sjellë rëndësi më të madhe. Në fund të rrethimit më të gjatë të një qyteti të shekullit të 20-të, në Sarajevë vritet Nirvana Zelković, fëmija i fundit që është vrarë në Sarajevën e rrethuar. Tre muaj para vdekjes ajo ka mbajtur ditar, mbi bazën e të cilit gazetari gjerman Peter Münch ka shkruar romanin “Era e blirit”.

Sa i përket qyteteve tjera, gjatë luftës, shfaqën shtëpi të reja botuese dhe “hiper-prodhim” të botimeve të luftës. Tuzlla del si qendër e letërsisë viteve të luftës gjatë të 90-ave, gjatë së cilës kohë është arritur një rekord për numrin e përdoruesve të shërbimeve bibliotekare, por edhe hapja e Qendrës Kulturore Boshnjake (BKC) në Tuzëll. E gjithë periudha e luftës në Banja Llukë, Mostar dhe Tuzëll mund të quhet një periudhë e ngjarjeve kulturore të rastësishme. Përkatesisht, nuk bëhej fjalë për aktivitete të organizuara dhe të planifikuara për një



kohë të gjatë, por për ngjarje ad hoc të lidhura me individë pa ndonjë mbështetje nga institucionet.

Individët kanë bërë hapa prej njëqind mijesh, ndryshuar jetën e civilëve të zakonshëm e dhe kanë lënë një vulë rezistence për brezat e ardhshëm. Këto shenja të rezistencës ishin shpesh të çmendura, të papritura, filma epikë mund të bëhen për to. Një nga ngjarjet më të paharrueshme ndodhi në vitin 1993 të luftës kur u organizua gara e Miss Sarajevës së Rrethuar, në të cilin titullin e më të bukurës e ka fituar Inela Nogiç. Miss Sarajeva e Rrethuar u bë simbol i rezistencës së kryeqytetit të Bosnjës dhe Hercegovinës. Në garën për Miss, vajzat i thanë botës “Don't let them kill us” ose “Mos lejoni që të na vrasin”. Kjo ngjarje ishte frymëzim për Bonno Vox për të realizuar këngën “Miss Sarajevo”, të cilën e interpretoi për herë të parë me Luciano Pavarottin. Pavarotti në BiH do të mbetet i kujtuar për një seri koncertesh humanitare kushtuar Sarajevës dhe Bosnje-Hercegovinës, por edhe për ndihmën në periudhën e pasluftës. Pavarotti, Brian Eno, anëtarët e U2 dhe artistë të tjerë ndihmuan në themelimin e Qendrës Muzikore Pavarotti në Mostar. Një shembull i ngjashëm i ndihmës për ringjalljen e institucioneve kulturore në BiH pas luftës është krijimi i Muzeut të Artit Bashkëkohor Ars Aevi në Sarajevë, i cili ka një koleksion prej mbi 1.600 veprash, duke përfshirë veprat nga Pablo Picasso, Michelangelo Pistoletta, Jannis Kounellis, Joseph Beuys, Marina Abramoviç dhe Joseph Kosuth. Plani i ndërtesës së re të këtij muzeu u bë nga arkitekti i famshëm italian Renzo Piano.

Ajo që ka shënuar skenën kulturore pas luftës në BiH është lulëzimi i industrisë së filmit, pavarësisht mungesës së ndihmës nga shteti. Filmat me tema lufte janë xhiruar pas vitit 2000, kur tensionet e krijuara nga lufta kanë rënë. Është e rëndësishme të përmendim filmin *Toka e Askujt (Ničija zemlja)*, i cili e ka fituar çmimin Oscar në kategorinë e Filmit më të Mirë të Jashtëm në vitin 2002, dhe filmat: *Digjët Zjarrë, Rruga e Halimes, Vera në Luginën e Artë, Grbavica (Gori vatra, Halimin put, Ljeto u Zlatnoj dolini, Grbavica)*. Regjisorët vendas i qasen temës së luftës në një mënyrë të re, kryesisht përmes dënimit të luftës si një dukuri, dhe Nexhad Ibrahimoviç, në artikullin e tij, “Midis Kombit dhe Krijimit: Filmi Artistik i Bosnjës dhe Hercegovinës 1995 – 2008”, duke u shprehur për fituesin e Oskarit “Toka e Askujt” thotë se është e vështirë të gjesh një dënim më ilustrues të luftës në kinemanë botërore.<sup>3</sup> Filmat në BH emocionalisht, butësisht, pa patetikë, por me një dozë satire dhe ironie përcjellin të gjitha tmerret dhe çnjerëzimet e luftës dhe pakuptimësinë e saj.

Për dallim prej viteve të para të paqes, BiH është sot një destinacion i dëshirueshëm për turistët vendas dhe të huaj. Për shumicën e turistëve, asociimi i parë i BiH-së është lufta, dhe nuk është për t'u habitur që disa nga vendet e vuajtjeve janë disa nga destinacionet më të njohura turistike (Bashkia, Stari Most, Tuneli i Shpëtimi, Kompleksi Memorial i Potoçarit). Në Janar 2017 në Sarajevë u hap Muzeu i Fëmijërisë së Luftës, duke paraqitur një koleksion të sendeve personale, historive, dëshmive audio dhe video, fotografive, letrave, vizatimeve dhe dokumenteve të tjera që evokojnë përvojën unike të rritjes në luftë. Ky muze është fitues Çmimit Muzeal të Këshillit të Europës për vitin 2018.

Lufta e viteve 1990 në Kroaci ka lënë shenjë në skenën kulturore në shumë mënyra. Ndryshimi historik që ndodhi në fillim të viteve 1990 ndikoi në ndryshimet sociale dhe botëkuptimore që çuan gjithashtu në rikonceptimin e fushës kulturore. Gjuha, letërsia, muzika, media janë vënë në shërbim të theksimit të vlerave të shtetit komb dhe luftës për pavarësi. Shumë punëtorë kulturorë në këtë periudhë historike punuan shumë për të promovuar vlera pozitive shoqërore, ndërsa në të njëjtën kohë kishte raste të parandalimit të aktiviteteve progresive kulturore nga institucionet shtetërore, si dhe raste të veprimeve regresive ndaj trashëgimisë kulturore të Jugosllavisë.

Përveç shkatërrimit tashmë të njohur të monumenteve antifashiste në të gjithë Kroacinë<sup>4</sup>, politika u kthye edhe tek librat, duke u kapur shpejt për shkatërrimin e librave të padëshirueshëm nga bibliotekat dhe institucionet. Siç e dimë nga raste të ngjashme në histori, librat që deklarohen të padëshirueshëm zakonisht nuk janë libra të rrezikshëm për njerëzit, por libra të rrezikshëm për agjendën politike të atyre që i deklarojnë të padëshirueshëm. Kështu, në Kroaci në vitet 1990-të, me pretekstin e fshirjes të librave të vjetër, u shkatërruan rreth 2.800 libra me tema jugosllave, socialiste dhe antifashiste, libra të shtypur në alfabet çirilik dhe libra nga autorë jugosllavë si Vladimir Nazor dhe Dubravka Ugrešić. Vetëm një grup i vogël mediash, Feral Tribune, Novi list dhe Tjednik, guxuan të shkruanin fare për problemin, ndërsa publiku i gjerë qëndroi i heshtur. Heqja e librave u krye në mënyra të ndryshme. Rasti më i famshëm i tillë dhe një nga të paktët që mori ndonjë trajtim mediatik, ndodhi në Korçullë në vitin 1997, kur rreth pesëqind tituj u hodhën në kontejnerë në bregun e detit. Çështja bëri jehonë në media falë Milan Kangrgas, një intelektual i cili vetë i dhuroi shumë tituj bibliotekës në Korçullë dhe më pas shkroi një dënim të ashpër të botuar në “Feral Tribune”. Si rezultat, Feral dhe Kangrga



është dashut të kalonin nëpër proces gjyqësor për shpifje.<sup>5</sup>

Një shembull i qëndrimit të punonjësve kulturorë kroatë ndaj pikëpamjeve të kundërta është skandali i madh mediatik që u zhvillua në fillim të viteve 1990-të, në kohën e Kongresit Botëror të Qendrave PEN në Rio de Janeiro, i njohur në mënyrë kolokviale si “rasti i Shtrigave të Rios”, një linçim publik drejtuar kundër pesë shkrimtareve kroate të botëkuptimeve feministe dhe kryesisht të majta. Dubravka Ugrešić, Vesna Kesić, Slavenka Drakulić, Jelena Lovrić dhe Rada Iveković janë akuzuar për lobim kundër kongresit të ardhshëm të PEN në Dubrovnik më 5 dhjetor 1992. Vjesnik, Slobodna Dalmacija dhe Večernji list botojnë artikuj me përmbajtje të ngjashme në të cilat një autor anonim boton akuza dhe pretendime që shkrimtarët veprojnë me egoizëm kundër shtetit kroat. Në Večernji list, teksti është nënshkruar nga Branka Kamenski, ndërsa autori i dy botimeve të tjera është vetë kryetari i Qendrës PEN Kroate - Slobodan Prosperov Novak. Ndoshta artikulli më kontravers në një seri artikujsh dënues kundër këtyre shkrimtareve u botua në 11 dhjetor 1992 nën titullin “Feministet kroate përdhunojnë Kroacinë”. Ekipi hulumtues i nënshkruar kolektivisht në Globus në këtë artikull akuzoi pesë shkrimtarët për fshehjen e përdhunimeve të grave myslimane dhe kroatëve në Bosnje, sikur përpiqeshin t'i barazonin me agresorin. Skandali merr përmasa ndërkombëtare kur PEN-ët gjermane, japoneze dhe amerikane anulojnë pjesëmarrjen e tyre në kongres.

Kongresi përfundimisht u realizua, pa praninë e pesë ‘shtrigave’ tona, për të cilat disa delegatë u hidhëruan, dhe i gjithë skandali u diskutua në Kongres, por çështja e lirisë së mediave u përmend vetëm në kontekstin e skandalit dhe përfundimi i vetëm nga ky debat ishte se shkrimi i Globusit ishte problematik, por edhe që një media private nuk është pasqyrë e lirisë së medias në të gjithë vendin. Sigurisht, ‘shtrigat’ nuk janë harruar as pas kongresit, por diskursi që shoqëron skandalin nuk është më aq i ashpër, dhe shfaqen artikuj që vërtet analizojnë imazhin shovinist/patriarkal të grave në shoqërinë tonë. Megjithë reagimin, shoqëria jonë vazhdon të nënvlerësojë gratë në sferën kulturore, duke harruar njëkohësisht ekzistencën e shkrimtarëve dhe shkrimtareve nga vendet fqinje.

Nga ana tjetër, jashtë qarqeve akademike, skena muzikore e mirenjohur gjatë Luftës Atdhetare ishte pjesë kryesore e ngritjes së moralit dhe ndërgjegjësimit kombëtar në të dy anët e vijës së frontit. Paralelisht me pushkët dhe tanket, zhvillohej një luftë në frontit tjetër;

muzikor apo kulturor. Ajo që më herët ishte një mjet relaksimi, argëtimi bëhet një armë e fuqishme politike. Në Kroaci në vitet nëntëdhjetë, muzikantët popullorë bëjnë muzikë për të ndihmuar luftëtarët në fushën e betejës dhe për të ngritur moralin e të gjithë kombit, ose për të kërkuar ndihmë ndërkombëtare dhe për të rritur ndërgjegjësimin e bashkësisë ndërkombëtare për luftën në Kroaci.

Në kohën e rritjes eksponenciale të grupeve të tilla si Nirvana dhe Cranberries, në Kroaci mbizotëron muzika me temë atdhetare, kryesisht me qëllim për të rritur ndërgjegjësimin dhe moralin kombëtar. Përveç inkurajimit të luftëtarëve dhe ngritjes së ndjenjës së unitetit kombëtar, muzika ka luajtur një rol në thirrjet për ndihmë ndërkombëtare. Kënga “Stop the war in Croatia”, nga Tomislav Ivčić u dëgjua në radiot jashtë vendit. Diaspora kroate dha një kontribut të madh në të gjithë këtë. Mërgimtarët kroatë në mbarë botën janë përpjekur të tërheqin vëmendjen për tmerret që ndodhën në atdheun e tyre. Në Kroaci, edhe rockerët janë bashkuar në lëvizjen për të mbrojtur atdheun dhe për të ngritur unitetin kombëtar. Ikona e rokut kroat Davor Gobac ka kënduar këngën “Kroacia duhet të fitojë” (“Hrvatska mora pobijediti”) me grupin e tij Psihomodo Pop. Disa vjet më parë, ai deklaroi se nuk ishte krenar për këngën, se ishte kundër luftërave dhe dhunës etnike, por siç e thotë ai, të tilla ishin kohërat. “Atdheu im” (“Moja Domovina”), një këngë e Band Aidit Kroat, praktikisht të gjithë autorët kroatë nga ajo kohë është edhe sot e njohur. Një këngë plot emocione, e cila promovon paqen dhe një të ardhme më të mirë është ngulitur në zemrat e të gjithë kroatëve gjatë atyre viteve të luftës. Kënga “Bjeri takave” (“Lupi petama”) nga Prljavo kazalište ishte më e afërta me realitetin, aq patriotike sa ishte realiste, grupi përshkruan më së miri situatën në shoqëri në këtë hit të vitit 1993 - kombi ishte i ngopur me luftë dhe vdekjen që e goditi. Kënga për përfundimin e luftës, për dashurinë për familjen dhe miqtë, për të varfërit, u pranua me të dy duart nga publiku. Sot, ky hit mbetet një nga këngët më të bukura patriotike kroate.<sup>6</sup>

Përveç muzikës që kërkonte të inkurajonte popullsinë ose të kërkonte ndihmë ndërkombëtare, gjatë luftës vepruan muzikantë që në këngët e tyre promovuan nacionalizmin radikal, urrejtjen dhe përjashtimin. Përfaqësuesi më i famshëm i kësaj lloji forme muzikore është Marko Perković Thompson. Shpesh i ndërlidhur me nacionalizmin ekstrem dhe në disa raste fashizmin, Thompson, me hitin e tij “*Batalioni i Çavogllavës*” (“Bojna Čavoglave”), ka ngjallur zemërimin dhe mllefën e qytetarëve kroatë. Ndikimi i kësaj kënge në moralin e



mbrojtësve kroatë është i padyshimtë, por për fat të keq, shumë fjalë të këtij hiti patriotik janë të dyshimta. Kënga, për fat të keq, fillon me një përshëndetje *Za dom spremni* (Të Gatshtëm për Atdhe), një përshëndetje që, përveç që ka përfaqësuar ushtarët e njësisë të Forcave Kroate të Mbrojtjes (Hrvatske obrambene snage - HOS), ka një domethënie historike. E përdorur nga Shteti i Pavarur Fashist i Kroacisë gjatë Luftës së Dytë Botërore, përshëndetja ka një kuptim negativ historik, është në kundërshtim me Kushtetutën dhe Ligjet e Republikës së Kroacisë dhe si e tillë është padyshim e padobishme për përdorim publik.

Përveç vigjiljeve dhe hiteve patriotike, vitet nëntëdhjetë sollën në Kroaci zhanre të tjera muzikore. Viteve nëntëdhjetë në të gjithë Europën ishin vitet e skenës underground techno dhe me iniciativën e disa të rinjëve në Kroaci, kjo rrymë e muzikës elektronike u soll edhe tek ne. Under city rave 93' është një ngjarje që ndryshoi skenën e klabinut në Kroaci. Gjatë luftës, ndërsa bëheshin përpjekjet e mëdha ushtarake për çlirimin e territorit të okupuar, në Zagreb u organizua një nga partyt më të mëdhenj gjatë luftës. Rreth tre mijë njerëz u mbledhën në Tunelin Grič për të treguar fytyrën tjetër të Kroacisë. Tuneli që shkon nga Mesnička në Rrugën Radićeva, që vetëm një vit më parë, ishte vendstrehim nga sulmet ajrore të Forcave Ajrore të APJ-së ndaj kryeqytetit kroat, është kthyer në vend grumbullimi për të rinjtë. Falë organizatorëve të zellshëm, përfshirë disa dhjetëra të huaj, Undercity rave mbetet në kujtesë si party më legjendare në historinë e skenës së klabinut kroat, dhe falë MTV-së, skenat e saj u panë anembanë botës. Edhe pse njerëzit telefonuan masivisht policinë për shkak të zhurmës së pakontrolluar, falë përpjekjeve të organizatorëve, policia nuk ndërhyri. Kjo ishte një mundësi ideale për të promovuar Kroacinë. Kështu, rinia kroate tregoi një fytyrë tjetër, dëshirën për të vazhduar një jetë normale pavarësisht tmerreve të luftës.

Më 20 nëntor 1996, Këshilli për Telekomunikacion vendosi të revokojë koncesionin e Radios 101. 'Njëqind e njëshi' popullor ishte një nga disa media të pavarura që nuk kishin frikë të shprehin mendimet kritike ndaj qeverisë së atëhershme, për të cilën ishte një sekret publik që transmetonte vetëm lajme të përzgjedhura, shkelte fair-playin në komunikim dhe mbyste liritë mediatike dhe civile. HDZ, e cila ishte në pushtet në atë kohë, e udhëhequr nga Franjo Tuđman, nuk mund të duronte Radion 101, e cila kritikonte qeverinë çdo ditë dhe bënte shaka për qeverisjen e partisë, reklama spirituoze dhe këngë 'dhuruar atyre në pushtet'. Këshilli i Telekomunikacionit, sipas udhëzimeve



të pushtetit, ka votuar për shfuqizimin e koncesionit, kurse kjo ka nxitur një ortek komentesh sapo është bërë i ditur lajmi. Thirrjet dhe mesazhet e mbështetjes vinin nga e gjithë Kroacia (megjithëse vetë Radio 101 nuk transmetonte në të gjithë vendin, apo edhe tërë Zagrebin), fakset dhe telegrafet e kanë mbushur sallën editoriale. Tregimi gjithashtu është përhapur edhe në skenën ndërkombëtare kur Departamenti i Shtetit i Sh.B.A-së e ka dënuar vendimin për revokimin e koncesionit. Në pasditen e 21 nëntorit, qytetarët e Zagrebit organizuan një miting kundër censurimit të mediave dhe në mbështetje të Radios 101. Policia ka lejuar mbajtjen e protestave kryesisht pasi nuk pritej pjesëmarrje e madhe, por në fund në protestë u mbledhën 100.000 qytetarë, dhe kjo deri më sot është protesta më e madhe që nga pavarësimi i Kroacisë. Reagimi nga autoritetet nuk mungoj dhe protesta u karakterizua si protestë kundër autoriteteve dhe dëshirë për t'u rikthyer në 'epokën e errët të komunizmit'. Koncesioni i transmetimit Radios 101 i'u kthye në fillim të vitit 1997 pas një vendimi të qeverisë sipas së cilit ishin përmbushur kushtet për një konkurs të ri, duke theksuar që protestat kundër autoriteteve nuk ishin të dëshirueshme.

E vërteta është se protesta për 'njëqind e njëshim' ishte gjithçka, por jo e padëshirueshme. Bashkimi i njerëzve që nuk janë parë kurrë më parë ka treguar që përmes kulturës dhe mediave mund të arrihet tek autoritetet, se zëri i njerëzve nuk mund të heshtet. Atë mbrëmje njerëzit morën vendim dhe ai u ekzekutua, siç duhet të ishte në demokraci të vërtetë. Autoritetet u dogjën duke u përpjekur të privojnë njerëzit nga zëri i tyre. Pas protestës, u ngritën pyetje për kompetencën dhe qëllimet e qeverisë së atëhershme, që sigurisht që është një situatë pozitive. Nga kjo ngjarje mësuam se njerëzit përcaktojnë kulturën dhe përpjekjet e autoriteteve për të shkelur kulturën dhe vetëvendosjen përmes kulturës pothuajse në mënyrë të pashmangshme hasin në rezistencë, sepse kultura në thelb i përket njerëzve.



## ***Jeta e fshehur kulturore e Kosovës gjatë viteve '90: Midis frikës dhe guximit***

---

Për një dekadë të tërë, nga fundi i viteve tetëdhjetë e deri në fund të viteve nëntëdhjetë, arti dhe kultura u zhdukën plotësisht nga skena publike e Kosovës. Ngjashëm me çdo aspekt tjetër të jetës në Kosovë, aktivitetet kulturore dhe shprehja e artit në çfarëdo forme ishin 'ndaluar' nga regjimi serb. Galeria Kombëtare e Arteve ka refuzuar të gjitha ekspozitat nga studentë shqiptarë të Kosovës dhe të gjitha institucionet tjetra kulturore janë mbyllur. Të refuzuar nga çdo institucion që i formësoi artistikisht gjatë fëmijërisë, adoleshencës dhe viteve profesionale, artistët shqiptarë të Kosovës nuk kishin asnjë platformë për të shprehur artin e tyre. "Në vitet '90, Serbia hoqi autonominë e Kosovës dhe mbylli ose kontrolloi institucionet arsimore dhe kulturore. Në këto rrethana, u krijua sistemi paralel i arsimit dhe veprimtarisë politike dhe për këtë arsye edhe kultura kontribuoi në rezistencën kundër shtypjes dhe mbajtjen gjallë të ndjenjave të dinjitetit dhe krijimtarisë kombëtare. Fakulteti i Arteve në Prishtinë punonte në shtëpi private ndërsa ekspozitat mbaheshin në kafene dhe restorante".<sup>7</sup>

Galeritë e kafeneve ishin bërë hapësira e vetme ku artistët mblidheshin dhe shprehnin rezistencën e tyre përmes artit. Një nga galeritë më të vizituara dhe më të famshme të asaj kohe ishte Han. "Arti ishte mjeti i tyre i vetëm për t'i rezistuar dhunës dhe shtypjes që kishin kapluar Kosovën për shumë vite".<sup>8</sup> Hani u bë një platformë për studentët e rinj për të hapur ekspozitat e tyre të para, diskutimet në panel, takimet midis aktivistëve dhe shumë aktivitete të tjera kulturore. Me pak fjalë, galeritë e kafeneve u bënë hapësira alternative që duhej të përdorte çdo artist në vend të hapësirave publike që dikur ishin shtëpia e tyre artistike. Sidoqoftë, rezistenca artistike që përfaqësoi Hani nuk u mirëprit nga policia serbe. Pronarët dhe klientët ndiqeshin nga policia serbe gjatë gjithë kohës.<sup>9</sup> Nuk zgjati shumë derisa policia serbe dogji



kafenenë së bashku me rreth 2.000 vepra arti.

Shumë gra e kanë mbështetur kauzën duke ofruar hapësirat e tyre personale dhe duke investuar të ardhmen e tyre në art dhe zhvillim kulturor, edhe pse shtypja po rritej çdo minutë e më shumë. Siç kujton Zake Prelvukaj, në vitin 1997 ishte e pamundur që artistët të krijonin “art të lumtur”. Këngëtarët nuk mund të këndonin këngë të lumtura, piktorët nuk mund të pikturonin “piktura të lumtura”. “Doja të vizatoja një lule, por përkundrazi vizatova një trup të vdekur, sepse kjo ishte ajo që ishte në mendjen time. Njerëzit vdisnin çdo ditë. Gratë dhe fëmijët keqtrajtoheshin. Nuk mund të isha indiferente. Unë nuk mund të krijoja, duke injoruar rrethanat përreth meje...arti i artistëve u ndikua nga situata aktuale dhe ata e përdorën këtë art si një shprehje të revoltës kundër kësaj situatë. Arti i viteve ‘90 ishte art i rezistencës.” - kujton ajo.<sup>10</sup>

Për më tepër, përmes performaseve artistike, ekspozitave, librave, shfaqjeve dhe shumë formave të tjera artistike, artistët shqiptarë të Kosovës filluan të tregojnë realitetin me të cilin njerëzit përballeshin në të gjithë Kosovën për shkak të regjimit serb. Ky aktivizëm jo vetëm që i mbajti gjallë shpresat e njerëzve, por gjithashtu shërbeu si një burim informacioni për bashkësinë ndërkombëtare, për të kuptuar situatën aktuale në Kosovë. Ajo që u konsiderua si ngjarja kulturore më befasuese dhe gjithashtu provokuese nga ana serbe, ishte ekspozita “Përtej”, e mbajtur në Qendrën për Dekontaminim Kulturor në Beograd në vitin 1997. Ekspozita e Sokol Beqirit, Mehmet Behlulit dhe dy artistëve të tjerë, shkaktoi reagime ekstreme nga të gjitha palët. Ngjarja kontraverse u pa me sy të ndryshëm nga organizatorët e saj. “Gjatë periudhës midis vitit 1989 dhe 1991, institucionet arsimore dhe kulturore në Kosovë (galeritë, Akademia e Arteve, etj.) u “pastruan” nga shqiptarët. Arti kosovar është marginalizuar dhe detyruar të jetojë një jetë paralele jashtë shtëpive të tij të ligjshme. Arti i rezistencës, megjithëse i cilësisë së ndryshme, do t’i jepte një goditje përfundimtare akademizmit... Projekti “Përtej” ishte iniciuar me mision të thyerjes së kufijve dhe tabuve që parandalojnë komunikimin normal artistik dhe ndërpersonal. Ky është, mbi të gjitha, një projekt artistik, por që megjithatë ka implikime të tjera, njëri prej tyre është politik. Edhe pse ne nuk i shohim ato si të parëndësishme dhe nuk heqim dorë nga aspektet provokuese të projektit, ne kërkojmë heshtjen dhe injorimin e objektivizmit dhe implikimet e supozuara inartistike të projektit, në mënyrë që të krijojmë komunikim ndërmjet Kosovës dhe Beogradit, përmes gjuhës universale të artit dhe shqetësimeve

shpirtërore, që kapërcejnë realitetin e tronditur, të helmuar dhe ksenofobik të Ballkanit. Ne e kemi emëruar projektin “Përtej”. Ky titull nuk është i një karakteri programatik. Ai vetëm shënon situatën e limitit të artistëve që do të dëshironin të ishin përtej realitetit të vrazhdë”.<sup>11</sup>

Në korrik të vitit 1990, stacioni i vetem televiziv publik, Radio Televizioni i Prishtinës, ndaloj transmetimin pasi punonjësit shqiptarë u larguan nga pozitat e tyre dhe punonjësit serbë morën nën kontroll televizionin. Kjo solli tek një bllokim gati të plotë informativ në vend. Shqiptarët në Kosovë kishin mbetur vetëm me disa burime informacioni. Njëri prej tyre ishte gazeta “Koha”. Gazeta fillimisht botohej si revistë javore “Koha”, e cila u publikuar nga viti 1992 deri në 1994, duke u bërë revista kryesore javore në Kosovë. Ekipi fillestar përfshinte një gjeneratë të re të krijesuve të mendimeve si Ylber Hysa, Baton Haxhiu, Dukagjin Gorani, Eqrem Basha, Shkelzen Maliqi, etj. Gazeta me të njëjtin emër u botua për herë të parë në vitin 1997.

Një tjetër burim informacioni dhe të ashtuquajturat “riprodhime kulturore” ishin kasetat VHS të shitura në videoklube si pothuajse mënyra e vetme për të marrë një copë të Shqipërisë ose programeve të orientuara nga perëndimi. Pak vite më vonë, TV satelitore u përdorën gjerësisht gjatë viteve '90 si përpjekje për t'u ndjerë më afër botës. Ato ende konsiderohen si ikona të asaj kohe kur aksesit në lajme, muzikë, shfaqje ishte i kufizuar. Përkundër faktit se tani ato nuk përdoren më, turistët që vizitojnë Prishtinën ende e gjejnë numrin e madh të antenave satelitore të mbetura si një relikut interesant i së kaluarës.

Situata e tensionuar politike u reflektua edhe në muzikë që dëshmoi një ndryshim të madh në krahasim me “vitet e arta të Jugosllavisë”. Muzika rock e përfaqësuar nga bende të famshme në dekadat e kaluara si “Gjurmët”, “Telex” ose “403” ndryshoi në mënyrë drastike. U shfaqën grupe të reja, megjithatë temat në kompozimet muzikore ishin krejtësisht të ndryshme. Gjatë viteve '90 në Kosovë, ekzistuan tre zhanre kryesore muzikore, të cilat në thelb kishin një gjë të përbashkët - revoltën ndaj sistemit të portretizuar në vargje. Këngët patriotike u përdorën si një mjet për të mobilizuar qytetarët dhe ato u shndërruan në himne të asaj epoke. Muzika pop dhe hip-hop si zhanre të reja u prekën gjithashtu nga situata politike. Për shembull, këngëtarja Adelina Ismaili krijoi shumë këngë që flisnin për të drejtat e fëmijëve dhe jetën e adoleshentëve gjatë regjimit serb. Ajo ishte një nga këngëtarët e para në Kosovë që arriti të prekë tema që të tjerët në



moshën e saj dhe as më të vjetër nuk mundën. Në një moshë shumë të re, 11 vjeçe, në vitin 1990 intervistat e saj për jetën e vështirë gjatë regjimit serb u censuruan. Në vitin 1995, kënga e saj “Do të krijoj ushtrinë time me Ibrahim Rugovën” u bë një hit absolut për shkak të mesazhit të fortë dhe guximit që Adelina duhej të fliste hapur për një ushtri në një kohë shtypjeje dhe tensioni. Lirika e kësaj kënge thekson rëndësinë e formimit të një ushtrie me të cilën do të çlirohej Kosova. Unikkatil AKA Rebeli ishte një nga artistët e parë të repit shqiptar. Ai filloi të reponte në fillim të viteve 1990-të, kryesisht kundër qeverisë serbe. Gjatë këtyre viteve artistët shqiptarë të Kosovës përdorën mediat në Shqipëri si një platformë ku përfaqësuan me muzikën e tyre. Artistët e famshëm nga Kosova filluan të marrin pjesë për herë të parë në “Festivalin e Këngës”, të organizuar çdo vit nga transmetuesi publik i Shqipërisë pasi që nuk kishte asnjë platformë tjetër ku të mund të promovonin veten dhe muzikën e tyre. Kjo ishte gjithashtu sfiduese për shkak të dallimeve kulturore dhe kohës së shkurtër nga mbyllja e kapitullit të gjatë pesë dekada të socializmit në Shqipëri.

Teatri gjithashtu u prek nga situata e tensionuar. “Teatri Kombëtar i Kosovës u themelua në vitin 1945 në Prizren, qyteti më i lidhur në Kosovë me jetën kulturore. Pas gjashtë muajsh u zhvendos në Prishtinë. Gjatë viteve në vijim, aktorët performuan si në shqip ashtu edhe në serbisht derisa politika të drejtohej rrugës së Sllobodan Millosheviqit”.<sup>12</sup> “Shfaqja e parë e teatrit është krijuar kryesisht nga artistë amatorë dhe idealistë të talentuar dhe entuziastë të cilën kishin asistencën e artistëve profesionistë të teatrove tjera të ish-Jugosllavisë. “Deri në vitin 1989 ka pasur mbi 400 premiera me mbi 10.000 shfaqje në teatër të cilat u ndoqën nga mbi 3.2 milion spektatorë. Repertori i këtij teatri ishte ndërtuar mbi tekste të shumë dramaturgjistëve kombëtarë, global dhe ish-Jugosllav. Këto shfaqje teatrore, të cilat u prezantuan në festivale të ndryshme me karakter kombëtar dhe ndërkombëtar në ish-Jugosllavi, u vlerësuan shumë nga kritikët e kohës dhe u nderuan me çmime të ndryshme artistike”.<sup>13</sup>

Në vitin 1990, regjimi i Sllobodan Milosheviqit e vendosi teatrin nën një administratë të dhunshme duke dëbuar artistët shqiptarë nga teatri dhe duke e vënë atë nën kontroll totalitar, ashtu si sektorët e tjerë në sferën publike. Me këtë veprim, epoka e artë e teatrit në Kosovë mbaroj përfundimisht. Gjatë kësaj periudhe, në një sistem paralel arsimor universitar të krijuar kundër regjimit totalitar, u krijuan shumë shtëpi shkolla nga grupe artistike, të cilat tashmë ishin pjesë e këtij ansambli teatral profesional. Në mesin e viteve '90, ekzistuan



edhe OJQ ndërkombëtare në Kosovë që ofruan kurse falas të baletit dhe aktiviteteve tjera kulturore kryesisht për fëmijë, si një mënyrë për të mbajtur jetën kulturore gjallë gjatë viteve të vështira të regjimit totalitar dhe të shtypjes. Pas përfundimit të luftës në vitin 1999, teatri u riemërua si “Teatri Kombëtar”, për t’u përshtatur me rrethanat e reja politike. Që nga viti 1999, drama serbe, e cila dikur ishte një nga institucionet kryesore të teatrit, është joaktive, pasi artistët serbë u larguan nga Prishtina. Që nga viti 2008, drama serbe ka vepruar në Mitrovicë dhe në zonat tjera serbe në Kosovë. Nga viti 2014, drama serbe e Teatrit Kombëtar vendoset në Graçanicë.

Skena kulturore në vitet 90-të në Kosovë u zhvillua dhe u forcua midis frikës dhe guximit me nevojën për të shfrytëzuar artin si një mjet për të mobilizuar njerëzit politikisht kundër sistemit dhe për ta ruajtur artin në çdo formë të mundshme. Artistët e asaj epoke arritën të sigurojnë informacion për njerëzit në Kosovë, të ndajnë shpresën përmes artit dhe të dëshmojnë edhe një herë që nuk ka një mjet në botë për të ndaluar ngritjen e kulturës. Rëndësia e punës dhe kontributit të komunitetit të artistëve njihet edhe sot si art i rezistencës dhe vlerësohet për mesazhin që ka transmetuar gjatë dekadës më të vështirë të Kosovës. Historia kolektive e Kosovës numëron shumë më tepër ngjarje, ekspozita, koncerte, poema, libra, këngë dhe produkte të tjera të kulturës nga ajo periudhë kohore që kanë mbijetuar në nëntokë edhe përkundër regjimit vetëm për të përhapur mesazhin e paqes dhe mbarimit të luftës.



## ***Skena kulturore në Mal të Zi në vitet '90***

---

Si edhe në shtetet e tjera të ish-RSFJ-së, skena kulturore e Malit të Zi në vitet 80-të dhe 90-të la gjurmë të pashlyeshme në të gjitha ngjarjet gjatë luftës. Kontributi që ajo ka dhënë mund të shihet në aspekt pozitiv dhe negativ. Derisa një pjesë e skenës kulturore të RSFJ-së nxiste nacionalizmin dhe luftën dhe mbështeste publikisht politikanët që çuan në luftë, ekziston edhe një tjetër për të cilin flitet më pak edhe tani edhe atëherë, një që kërkoi të përhapë mesazhe paqeje, arsyeje dhe uniteti.

047

Shumë sociologë e lidhin shfaqjen e turbofolkut me primitivizimin e skenës kulturore, dhe rrjedhimisht të shoqërisë. Në fund të viteve 80-të, si në Serbi, ashtu edhe në Mal të Zi, turbo folku mori epërsi dhe pushtoi majat e tabelave muzikore, dhe kështu u bë një skenar i domosdoshëm në disko dhe klube të cilat i frekuentonin të rinjtë. Kjo mënyrë argëtimi kthehet në një trend, një modë, një “mënyrë jetese” e ndjekur nga përdorimi i drogës, drejtimi më shpejtësi i makinave të shtrenjta, mosrespektimi i ligjit, popullarizimi i krimit dhe mafies si qëllime pozitive për të ndjekur. Në një atmosferë të tillë, është e lehtë të krijosh një qëndrim jokritik ndaj luftës, dhe është e lehtë të frymëzosh pasione të ulëta në formën e nacionalizmit ekstrem.

Politikanët dhe zyrtarët e atëhershëm kanë dominuar estradën dhe pikëpamjet dhe mendimet e tyre ndikuan në formimin e qëndrimeve të publikut. Artistët janë të marginalizuar, zërat e tyre vështirë të dëgjohen, dhe shumë prej tyre janë të afërt me autoritetet dhe përdoren për qëllime politike. Njerëzit janë bombarduar vazhdimisht me propagandë lufte që synon të inkurajojë burrat, të rinjtë dhe të moshuarit, të rekrutohen ushtarakisht, dhe ata që i kanë rezistuar asaj propagande kanë pësuar dënim dhe turpërim nga shoqëria. Lahuta ishte pjesë integrale e pajisjeve ushtarake në atë mënyrë që



ajo përdorej për të nxitur ushtarët për të luftuar, mbrojtur nderin dhe traditat e luftës në Mal të Zi.

Është e rëndësishme të përmendim këtu intelektualët, artistët dhe grupet muzikore që kanë qenë këmbëngulëse për të shprehur rezistencën dhe bërë thirrje për paqe dhe sens të shëndoshë. Midis tyre është padyshim Antonie Pušić, e njohur më mirë si Rambo Amadeus, i cili përmes teksteve të tij satirike kritikoi njeriun e zakonshëm, marrëzinë e tij dhe absurditetin e veprave të tij. Ai është një kritik i shkëlqyeshëm i kapitalizmit neoliberal dhe puna e tij dallohet përmes kritikave të nacionalizmit. “Nacionalizmi është një temë për ata deri në 300 euro në muaj. Atyre u shërbehet ai tregim. Kur paga tejkalon 500 euro, atëherë fillon biseda për rroba dhe kafene. Kur tejkalon 1.000, atëherë tema kryesore është ushqimi i shëndetshëm, pushimi veror dhe dimror, dhe kur rritet në më shumë se 3.000 euro, atëherë çdo llafazani pushon. Njerëzit pastaj flasin për motin dhe dashurinë”.<sup>14</sup>

Ai gjithashtu dihet se ka ndërprerë koncertin e Bebi Dol me një rast dhe ka shprehur pakënaqësinë për bombardimin e Dubrovnikut dhe ka thanë se nuk do të argëtojë elitën. “Mirëmbërëma, unë u detyrova të ndërpresë të mrekullueshmen Bebi Dol sepse programi televiziv shkon deri në nëntë e tridhjetë live. Kam dy minuta për t'ju drejtuar kombit. Derisa ne bëjmë muzikë, bombat po bien mbi Dubrovnik dhe Tuzëll. Ne nuk do të argëtojmë elektoratin. Ju qi\*fsha nënën”, ka thënë Rambo Amadeus, duke hedhur mikrofonin në mënyrë demonstrative nga skena.<sup>15</sup>

Perper është një grup muzikor malazez nga Cetinja i themeluar në vitin 1991 dhe është një nga grupet më të njohura në Mal të Zi. Emri Perper rrjedh nga emri i monedhës së vjetër malazeze të përdorur gjatë pavarësisë së Malit të Zi. Performanca e parë e rëndësishme e grupit ishte në një shfaqje televizive ku u prezantua kënga “Paqja si stina e pestë” (“Mir kao peto godišnje doba”) në vitin 1991, që ishte një këngë kundër luftës. Monteniggers, hiphopistët malazezë gjithashtu së bashku me Perper luftuar me krijimtarinë e tyre kundër shkatërrimin kulturor. Shumë intelektualë që arritën të hyjnë në hapësirën publike në atë kohë, në masën maksimale të helmuar nga nacionalizmi, tentuan të ndalojnë njerëzit dhe autoritetet e Malit të Zi nga sulmet mbi civilët dhe veprimet e turpshme gjatë luftërave të viteve 1990.

## ***Skena kulturore në Serbi***

### ***– “Turbo folku më detyroi”*** <sup>16</sup>

---

Nga fundi i viteve 1980-të, në skenën muzikore të RSFJ-së u shfaqën këngë që kryesisht për temë kishin fuqizimin e idesë jugosllave si dhe thirrjet për paqe dhe unitet, e cila ishte një lloj përgjigje ndaj asaj që në të vërtetë po ndodhte. Përderisa nacionalizmi dhe dëshira për ndarje u rrit në republika, yjet më të mëdhenj jugosllavë kënduan për bukurinë dhe larminë e Jugosllavisë (Lepa Brena – “Jugosllavja” - “Jugoslovenka”, 1989), një vendi për të gjithë ne (EKV – “Ky vend është për të gjithë” - “Ovo je zemlja za nas”, 1987), magjinë e rock and rollit jugosllav (Električni orgazam – “Luan rock’n’roll” - “Igra rock’n’roll”, 1988).

Megjithëse shumë i kanë ndjerë ngjarjet e ardhshme dhe kanë patur frikë nga to, ata menduan se me vargjet e tyre mund të ndalonin fjalët e politikanëve, se mund të zgjonin Jugosllavinë që shkatërrohej dhe të ftonin për bashkim me shembull personal. Në favor të kësaj flasin edhe koncertet e paqes të organizuara në tërë Jugosllavinë, siç është Koncerti i famshëm i Paqes Yutel më 28 korrik 1991, në Zetër të Sarajevës. Ky koncert paraqet një nga përpjekjet e fundit kolektive për t'i dhënë fund luftës që tashmë kishte filluar në Slloveni dhe Kroaci. Përveç aktivistëve të paqes, shkrimtarëve, aktorëve, gazetarëve, në koncert shfaqen Bajaga, Hari Varešanović, Muharem Serbezovski, Davorin Popović, Milan Mladenović dhe shumë jugosllavë të tjerë, disa prej të cilëve më vonë, si Dino Merlin, ndryshuan qëndrimin e tyre karshi luftës. Koncerti i unitetit dhe energjisë së Jugosllavisë nuk pati një jehonë të madhe, pasi u transmetua vetëm në BiH dhe Maqedoni, ndërsa republikat e tjera bojkotuan transmetimin. Ky skenar i trajtimit të muzikantëve pacifistë do të përsëritet më vonë. Sidoqoftë, koncerti mbeti si një shënim i atomeve të fundit të bashkimit të popullit dhe dëshirës së tij që përmes artit të luftohet politika.



Paralelisht me procesin e përdorimit të muzikës për qëllime paqeje, pati edhe një proces të kundërt. Roku i gjithëpranishëm jugosllav deri në ato momente u zëvendësua me këngë kuazi-patriotike, popullore. Performues të tillë si Baja Mali Knindža (Këngët: “Ndaloni pasha dhe ustasha”, “Kthehu dukë”, “Kur isha i vogël”, “Nuk të dua Ali”, “Komunistë” - “Stan'te paše i Ustaše”, “Vrati se vojvodo”, “Kad sam bio mali”, “Ne volim te Alija”, “Komunjare”) u dëgjuan edhe në Serbi dhe në bazë të opusit të tyre qytetarët serbë nxorrën përfundime në lidhje me konfliktin, për shembull, në Bosnjë. Krahastij, më të spikaturit ishin Lepi Miča (“Muslimanë më mirë të mos jeni” - “Muslimani bolje da vas nema”, “Republika Srpska”), Roki Vulović (“Bombarduesi i zi” dhe “Crni bombarder”) dhe Miro Semberac (“Të gjitha xhamitë shkojnë në ajër” - “Sve džamije u oblake lete”). Këngët e tyre u përdorën kryesisht si motiv për ushtarët dhe motivim për të rinjtë në Serbi që të angazhohen vullnetarisht në konflikt për të mbrojtur serbët dhe serbizmin. Të mbështetur nga politikanët dhe/ose të shtyrë drejtpërdrejt nga veprimet e tyre, këto këngë synonin zgjimin e patriotizmit, por shumë shpesh shovinizmit, duke e lartësuar historinë para krijimit të Jugosllavisë dhe krijimin e një baze mbështetëse për luftë. Pozita specifike e Serbisë gjatë luftërave, inflacioni dhe sanksionet, të cilat parandaluan pothuajse çdo depërtim të tendencave perëndimore, gjithashtu favorizuan përdorimin e të gjitha formave të artit, jo vetëm të muzikës, për qëllime lufte. Në këto rrethana, njerëzit shpesh i drejtoheshin artit të vetëm të disponueshëm, atij popullor, si një rrugëdalje nga jeta e përditshme, kështu që përdorimi i kulturës popullore për qëllime propagande u justifikua më tej.

Ajo që mbetet e vërtetë është se gjatë viteve nëntëdhjetë u zhvilluan zhanre të reja të muzikës popullore në Serbi - turbo folk dhe dance – dhe kthimi tek muzika popullore. Nëse ndryshimet në skenën kulturore dhe muzikore janë kryer nga autoritetet ose reflektojnë kërkesën e tregut dhe ndarjen e shoqërisë serbe në urbane dhe rurale, nuk ka pajtim midis teoricienëve socialë që janë marrë me këtë fenomen.

Një nga shtyllat kryesore të unitetit kulturor jugosllav – muzika – u shemb si vetë shteti. Muzika ka hasur në kufij. Artistët që janë parë vetëm përmes veprave të tyre deri atëherë, papritur gjykohen sipas vendlindjes, origjinës dhe kombësisë, mbështetjes ndaj regjimit. Janë të rrallë ata që kanë mbetur imun ndaj këtyre ndarjeve dhe i kanë qëndruar besnik fisnikërisë së artit të tyre. Një shembull i tillë është Lepa Brena (Fahreta Jahić-Živojinović), një ish-simbol i unitetit



Jugosllav, e cila u ndalua në 1991 në disa frekuenca sepse kishte një emër të papërshtatshëm.<sup>17</sup>

Një koncert kundër luftës i grupit – lëvizjes Rimtutituki, të përbërë nga anëtarët e Partibrejkers, Električni Orgazam dhe EKV (Cane, Anton, Borko, Gile, Čavke, Jovec, Švaba dhe Milan) u mbajt në Beograd në pranverën e vitit 1992. Pa leje për të performuar publikisht dhe të vetëdijshëm që koncerti dhe mesazhi i tyre nuk do të transmetohej në media (me përjashtim të Radios B92, i cili mbështeti iniciativën dhe lëshimin e këngës), tetë muzikantët qarkulluan nëpër Beograd në një kamion të hapur dhe promovuan këngën “Dëgjo këtu!” Mesazhi kryesor “Paqe, vëlla, paqe” dhe vargjet tërheqëse të tilla si, “Je shumë i ri për të përfunduar në flladë” u drejtuan kryesisht kundër luftës së ardhshme në Bosnje dhe mobilizimit për APJ. Koncerti i dytë, “Mos u mbështetni tek ne”, u mbajt në Sheshin e Republikës nën sloganin e S.O.S Paqe ose mos llogarisni në ne, me lejen e autoriteteve rreth 50,000 njerëz morën pjesë në koncert. Rock muzikantët gjithashtu morën pjesë në një seri protestash dhe koncertesh të tjera kundër luftës, përfshirë atë të përkushtuar granatimeve të Dubrovnikut, “Le të ndalojmë urrejtjen për t'i dhënë fund luftës”. Në këtë koncert është kënduar edhe kënga “Unë nuk dua kundër shokut tim” (“Ja neću protiv druga svog”), të cilën në origjinal e këndojnë Rade Šerbedžija dhe Svetlana Ceca Ražnatović (asokohe Veličković), e cila është një rast shumë interesant, pasi kjo këngëtare turbo folk ka ndryshuar dukshëm angazhimin e saj fillestar muzikor kundër luftës në vitet vijuese. Në vitin 1995, Svetlana Veličković u fejuua me Željko Ražnatović Arkanin, drejtuesin e njësisë paraushtarake “Garda Vullnetare Serbe” (“Tigrat e Arkanit”, “Arkanistët”), e cila ka marrë pjesë në kryerjen e krimeve të luftës në territorin e Kroacisë dhe Bosnje-Hercegovinës. Pasi u martua me Arkanin, karriera e Cecës mori një ngjitse marramendëse, duke e bërë atë një nga yjet më të mëdhenj në Serbi (“Nëna serbe”). Një shembull që tregon se sa i madh ishte ndikimi i estradës dhe ai mediatik në errësirën informative, është popullariteti i dashurisë së Arkanit dhe Cecës. Ata u shpallën çifti më i madh “serb” i shekullit XX, dhe për dashurinë e tyre u krijuan emisione të ndryshme kurse dasma e tyre u publikuar në videokaseta të prodhuara nga PGP RTS (produksioni i televizionit publik). Videoja nga dasma e tyre ishte videoja më e kërkuar e periudhës.

Në drejtim të kundërt ka shkuar Đorđe Balašević. Balašević, duke kuptuar se politika po shkonte në drejtim të luftës vëllavrasëse, këndoi të famshmen, “Vetëm të mos ketë luftë” (“Samo da rata ne bude”). Në

stilin e tij, në këngën “Sloboda-ne” (Liria-jo) ka kritizuar sistemin, kurse me këngën “Shko qiju APJ” (“Odjebi JNA”) dhe më vonë “Rekrutuesi” (“Regrutska”) dha respekt për të rinjtë e mobilizuar. Ajo për çfarë këndoi ai e tregoj edhe përmes shembullit personal duke kritikuar regjimin në transmetimet e tij në Radio-TV, duke refuzuar mobilizimin dhe aktivizuar si Ambasadori i Vullnetit të Mirë i Komësariatit të Lartë të OKB-së për Refugjatët. Këngët e tij janë ndaluar në televizionin dhe radion shtetërore. Balašević ka shkruar dhe kënduar për shkatërrimin e Vukovarit në këngën e tij “Njeriu me hënë në sytë e tij” (“Čovek s mesecom u očima”) në vitin 1993 dhe më vonë ia kushtoi atë të gjitha qyteteve të shkatërruara në botë. Momčilo Bajagić Bajaga dhe Milan Mladenović ishin gjithashtu aktivë në promovimin e paqes dhe shpesh në koncertet e tyre u bënë homazh viktimave.

Ekziston besimi që në Serbi kishte një rezistencë të madhe ndaj propagandës së luftës, që është reflektuar përmes protestave masive kundër luftës, shmangies së rekrutimit dhe dezertimit nga lufta. Edhe pse kishte iniciativa të ngjashme dhe kundërshtim muzikor ndaj regjimit në pjesë të tjera të ish-RSFJ-së, kënga nuk e ndaloi luftën, por e promovoi atë në Serbi si një veprim patriotik ose e fshehu atë që të mos shihet.

Me përjashtim të rock muzikantëve të deklaruar jugosllav, në Serbi ka zakonisht pak këngë anti-luftë nga zhanre popullore dhe promovim të pacifizmit nga muzikantët. Refuzimi për të transmetuar përmbajtje muzikore kundër luftës në mediat shtetërore la hapësirë për këta muzikantë që të transmetojnë mesazhet e tyre direkt në koncerte. Edhe pse nuk mund të themi se kishte pak interes për ta, ajo kishte shtrirje të kufizuar, veçanërisht në vitet kryesore të luftës. Muzika në Serbi u pushtua shpejt nga këngë për një jetë më të mirë, para, popullaritet – lajtmotivet e zhanreve të reja – të cilat hodhën heronjtë e rinj – mafian - në skenë. Në këtë periudhë ka një rritje të muzikës dance, rave dhe trans – Đogani fantastico, Funky G, B3, Doktor Igy, Ivan Gavrilović. Party-të rave u mbajtën kryesisht në vende sekrete, dhe “dizellashët” (atlete Air-max, xhupa të futur në xhinse, tuta fluoeshente, syze “të shpejta”, zingjir të trashë ari – vetëm disa nga simbolet e këtij stili të veshjes) janë si një kategori e krijuar pikërisht në këtë periudhë. Ata u përzien me valën e kompozimit patriotik, duke krijuar një sistem të ri vlerash të shtrembëruara. DJ-ët bëhen shumë të popullarizuar në këtë periudhë – një nga imazhet që shënuan luftërat në BiH është fotografia e Ron Havivit që tregon Srđan Golubovićin a.k.a. DJ Max, i cili ishte anëtar i Tigrave të Arkanit, duke goditur me shqelm në kokë Tifa



Šabanovićin e vdekur në rrugë në Bijelina.

Fillimisht, skena serbe e hip hopit kryesisht bazohej në tema urbane, rinore, me disa ekskursionë në kritika ndaj regjimit, të përziera me një dozë nacionalizmi dhe dëshirë për revolucion. As grupet punk dhe as grupet e reja të rockut nuk shkuan përtej kësaj. Është fakt që skena muzikore në vitet 90-tëv në Serbi ndryshoi në mënyrë dramatike si rezultat i luftërave në ish-Jugosllavi, pra ndryshimeve të mëdha që përmbytën shtetin dhe shoqërinë. Me popullarizimin e nacionalizmit dhe ndryshimin e ideologjisë politike në Serbi, ndodh një ndryshim i plotë i skenës muzikore. Muzika popullore është në qendër të ngjarjeve kulturore, megjithëse në një formë pak më të modifikuar sesa ajo origjinale. Maintream në Serbi bëhet ajo që ne njohim sot si muzikë turbo folk dhe dance. Margjinalizimi i rock and rollit në Serbi dhe ndryshimi i paradigmes në skenën muzikore nuk mund të mos shihet nga një perspektivë më e gjerë e asaj që ndodhi në atë periudhë. Regjimi politik i Millosheviqit në fillim të viteve 90-të pati një ndikim të fuqishëm dhe shtypës në jetën e përditshme të qytetarëve. Mungesa e lirisë së fjalës si dhe presioni ndaj gazetarëve dhe mediave ndikuan drejtpërdrejt në prezantimin e përmbajtjes kulturore në media dhe diskursin publik.

053

Bota e estradës së figurave publike fiton akterët e saj të rinj. Ka gjithnjë e më shumë hapësirë në media për përmbajtje tabloidësh. Fokusi i publikut është te këngëtarët dhe këngëtares të cilët në punën e tyre mbështesin dhe promovojnë nacionalizmin, shovinizmin, atdhetarizmin dhe partinë kryesore të atëhershme politike. Po krijohej një mini univers i ri që raporton më shumë për thashetheme nga jeta e tyre të atëhershme se sa nga muzika.

Gjatë kësaj periudhe, figurat më të spikatura përveç politikanëve ishin kriminelët serbë, disa prej tyre kriminelë lufte, të cilët në atë kohë (dhe tani) mbanin titujt e heronjve më të mëdhenj serbë. Ata ishin të njohur dhe të pranishëm në estradë, u shfaqën në emisione televizive dhe për disa prej tyre u krijuan filma. Në atë kohë, Serbia, dhe veçanërisht Beogradi, ishin skena të inflacionit, paligjshmërisë dhe sundimit të grupeve kriminale.

Mund të konkludojmë se gjendja e shoqërisë dhe ndryshimet politike kanë ndikuar drejtpërdrejt në skenën kulturore në Serbi. Muzika dhe estrada u përdorën për të larguar vëmendjen e qytetarëve nga problemet aktuale për të ndikuar në vetëdijen dhe mendimin e tyre.



Sa i fuqishëm ishte ky ndikim tregon fakti që edhe sot, njëzet vjet më vonë, ende mund të vërehet prania e konsiderueshme e artistëve dhe artisteve të estradës në publik, dhe mungesa e plotë e informacionit të vërteta për atë që po ndodhte në të vërtetë në territorin e ish-Jugosllavisë.





### ■ **Mund të na merrni gjithçka tjetër përveç inatit: Skena kulturore e BiH gjatë luftës**

1 Lewis, Gill. 2017. *A Story like the Wind*. Oxford University Press, Oxford.

2 Diklić, Davor. 2004. *Teatri në Sarajevën e luftës 1992 – 1995*. Teatri kamertal - Most art. Sarajevë - Zemun.

3 Skenderagić, Mirza. *Danis Tanović: Regjisor në kohën e duhur në vend të duhur*.

• <https://web.archive.org/web/20200208111458/http://www.filmofil.ba/danis-tanovic-reditelj-u-pravo-vrijeme-napravom-mjestu/>  
(Arkivuar më 08.02.2020.)

### ■ **Kultura në shërbim të politikës kroate**

4 Në periudhën 1990 - 2000, më shumë se tre mijë monumente antifashiste u shkatërruan, shumë prej të cilave, përveç ideologjike, kishin edhe vlera të jashtëzakonshme artistike. Metodat e shkatërrimit varionin nga shpërthimi tek riciklimi i hekurit nga i cili u ndërtuan monumentet. Disa shembuj të monumenteve të shkatërruara janë monumenti i Stjepan Filipovićit në Opuzen dhe Monumenti i Fitores në Kamensko. Bakotin, Jerko. *Sramna epizoda povijesti*. Zagreb.

• <https://web.archive.org/web/20200208111631/https://www.dw.com/hr/sramna-epizoda-povijesti/a-16041768>  
(Arkivuar më 08.02.2020.)

5 Piteša, Adriana. *Lešaja: Devedesetih smo uništili 2,8 mil. „nepočudnih” knjiga*. Zagreb.

• <https://www.jutarnji.hr/kultura/knjizevnost/lesaja-devedesetih-smo-unistili-28-mil.-%E2%80%98nepocudnih%E2%80%99-knjiga/1540434/>  
(Qasur më 08.02.2020.)

6 Dokumentari “Më e zëshme se armët” nga autori fitues i çmimeve Miroslav Sikavica u publikua për të gjitha këto këngë dhe domethënien e tyre, dhe në kryeveprën e tij ai u dha fjalën shumë yjeve kroate. Josipa Lisac, Zrinko Tutić dhe Jasenko Houra janë vetëm disa nga pjesëmarrësit në këtë projekt.

## ■ Jeta e fshehur kulturore e Kosovës gjatë viteve '90: Midis frikës dhe guximit

7 Maliqi, Shkëlzen. *Modernization in Kosovo's Visual Arts*. Prishtine.

• <https://web.archive.org/web/20200208112453/https://kosovotwopointzero.com/modernization-in-kosovos-visualarts/>  
(Arkivuar më 08.02.2020)

8 Farnsworth, Nicole, 2008. *History is Herstory Too: The History of Women in Civil Society in Kosovo, 1980-2004*. Kosova Gender Studies Center. Prishtine., pp. 391.

9 Farnsworth, Nicole, 2008. *History is Herstory Too: The History of Women in Civil Society in Kosovo, 1980-2004*. Kosova Gender Studies Center. Prishtine. p. 119.

10 Farnsworth, Nicole, 2008. *History is Herstory Too: The History of Women in Civil Society in Kosovo, 1980-2004*. Kosova Gender Studies Center. Prishtine. p. 119. Intervista me Zake Prelvukaj.

11 Maliqi, Shkëlzen. 2017. *Case Study: Përtej*. K2.0 - Center for Cultural Decontamination. Prishtine – Belgrade. Foreword.

12 Osmani, Shengjyl. *Reviving Glory of Kosovo's National Theatre*.

• <https://web.archive.org/web/20200208112652/https://balkaninsight.com/2010/03/29/reviving-glory-of-kosovo-snational-theatre/>  
(Arkivuar më 08.02.2020)

13 Teatri Kombëtar i Kosovës. *Historiku*.

• <http://www.teatrikombetar.info/al/perne/1/>

## ■ Skena kulturore në Mal të Zi në vitet '90

14 N1 Hrvatska. *Rambo: Nacionalizam se servira onima s platom od 300 evra*. Zagreb.

• <https://web.archive.org/web/20200208113222/http://rs.n1info.com/Showbiz/a118563/Rambo-Amadeus-o-plati-inacionalizmu.html>  
(Arkivuar më 08.02.2020.)

15 CDM portal. *Kako je Rambo prekinuo nastup Bebi Dol*. Podgorica.

• <https://web.archive.org/web/20200208113345/https://m.cdm.me/zabava/muzika-film-tv/trenutak-kada-je-ramboamadeus-prekinuo-nastup-bebi-dol/>  
(Arkivuar më 08.02.2020.)

## ■ Skena kulturore në Serbi – “Turbo folku më detyroi”

16 Emri i këngës të reperes serbe Mimi Mercedes.

17 Blic. *Bila sam zabranjena od 1991. do 1996. Lepa Brena progovorila o NAJTEŽIM životnim trenucima*. Beograd.

• <https://web.archive.org/web/20200208113832/https://www.blic.rs/zabava/vesti/bila-sam-zabranjena-od-1991-do-1996-godine-lepa-brena-progovorila-o-najtezim-zivotnim/8g7p349>  
(Arkivuar më 08.02.2020.)



# BOSNJA DHE HERCEGOVINA / KROACIA

# 1

BeH / KRO / Mostar / 25–28 korrik

059

## ■ Jeta e fshehur kulturore e Kosovës gjatë viteve '90: Midis frikës dhe guximit

7 Maliqi, Shkëlzen. *Modernization in Kosovo's Visual Arts*. Prishtine.

• <https://web.archive.org/web/20200208112453/https://kosovotwopointzero.com/modernization-in-kosovos-visualarts/>  
(Arkivuar më 08.02.2020)

8 Farnsworth, Nicole, 2008. *History is Herstory Too: The History of Women in Civil Society in Kosovo, 1980-2004*. Kosova Gender Studies Center. Prishtine., pp. 391.

9 Farnsworth, Nicole, 2008. *History is Herstory Too: The History of Women in Civil Society in Kosovo, 1980-2004*. Kosova Gender Studies Center. Prishtine. p. 119.

10 Farnsworth, Nicole, 2008. *History is Herstory Too: The History of Women in Civil Society in Kosovo, 1980-2004*. Kosova Gender Studies Center. Prishtine. p. 119. Intervista me Zake Prelvukaj.

11 Maliqi, Shkëlzen. 2017. *Case Study: Përtej*. K2.o - Center for Cultural Decontamination. Prishtine – Belgrade. Foreword.

12 Osmani, Shengjyl. *Reviving Glory of Kosovo's National Theatre*.

• <https://web.archive.org/web/20200208112652/https://balkaninsight.com/2010/03/29/reviving-glory-of-kosovo-s-national-theatre/>  
(Arkivuar më 08.02.2020)

13 Teatri Kombëtar i Kosovës. *Historiku*.

• <http://www.teatrikombetar.info/al/perne/1/>

## ■ Skena kulturore në Mal të Zi në vitet '90

14 N1 Hrvatska. *Rambo: Nacionalizam se servira onima s platom od 300 evra*. Zagreb.

• <https://web.archive.org/web/20200208113222/http://rs.nainfo.com/Showbiz/a118563/Rambo-Amadeus-o-plati-inacionalizmu.html>  
(Arkivuar më 08.02.2020.)

15 CDM portal. *Kako je Rambo prekinuo nastup Bebi Dol*. Podgorica.

• <https://web.archive.org/web/20200208113345/https://m.cdm.me/zabava/muzika-film-tv/trenutak-kada-je-ramboamadeus-prekinuo-nastup-bebi-dol/>  
(Arkivuar më 08.02.2020.)

## ■ Skena kulturore në Serbi – “Turbo folku më detyroi”

16 Emri i këngës të reperes serbe Mimi Mercedes.

17 Blic. *Bila sam zabranjena od 1991. do 1996. Lepa Brena progovorila o NAJTEŽIM životnim trenucima*. Beograd.

• <https://web.archive.org/web/20200208113832/https://www.blic.rs/zabava/vesti/bila-sam-zabranjena-od-1991-do-1996-godine-lepa-brena-progovorila-o-najtezim-zivotnim/8g7p349>  
(Arkivuar më 08.02.2020.)

# BOSNJA DHE HERCEGOVINA / KROACIA

---

1



—  
059  
—







Marrëdhëniet midis Bosnje-Hercegovinës dhe Kroacisë gjatë viteve nëntëdhjetë, por edhe në vitet e pas luftës, ishin objekt studimi nga grupi Fqinjët (Komšije/Susjedi/Neighbours). Emri i grupit ishte i lehtë për tu gjetur. Përkatësisht, fjala fqinj përdoret shumë shpesh kur bëhet fjalë për këto dy vende: nuk është e pazakontë që mediat të flasin për marrëdhënie të fqinjësisë së mirë dhe këto janë vendet që kanë kufirin tokësor më të gjatë nga të gjitha republikat e ish-Jugosllavisë.

061

Edhe pse shpesh në baza ditore politike, marrëdhëniet midis këtyre dy vendeve duken jo aq të mira fqinjësore, komunikimi i vazhdueshëm i popullatës tregon se kjo nuk ndikon në jetën e njerëzve të zakonshëm. Në fakt, ekziston një listë e gjatë e problemeve që rëndojnë marrëdhëniet midis Sarajevës dhe Zagrebit: kufiri ndërshtetëror i paspecifikuar, ndërtimi i Urës Pelješac, pjesëmarrja e ekzagjeruar e qytetarëve të Bosnjës dhe Hercegovinës në frontet e huaja, pikëpamjet e ndryshme të pjesëmarrjes së luftëtarëve nga vendet arabe në luftën në BiH, pengesat tregtare për produktet bujqësore nga Bosnja dhe Hercegovina dhe kështu me radhë. Edhe pse Sarajeva zyrtarisht është shpesh kundër “ndërrhyrjes” të Zagrebit në çështjet politike në BiH, duhet të theksohet se Republika e Kroacisë përmes Marrëveshjes së Paqes në Dejton është obliguar që të respektoj sovranitetin, integritetin territorial dhe pavarësinë politike të BiH.

Sidoqoftë, fakti që bëhet fjalë për tema që kanë rëndësi parësisht për politikanët dhe më pas për mediat, tregohet nga atmosfera që mbizotëronte në këtë grup gjatë vizitave, si dhe gjatë punës në shkrimin e narrativave. Duke filluar me formulimin e temave që do të jenë objekt i hulumtimit tonë, përmes komunikimit të ndërsjellë, deri tek mundësia që të gjithë të shprehin pikëpamjet e tyre për çështje që mund të karakterizohen si të diskutueshme. Hapësira e

ish-Jugosllavisë, si dhe pjesa tjetër e kontinentit europian, nuk është imune ndaj asaj që historia të shkruhet dhe të lexohet ndryshe. Heronj ose viktimë, këto janë imazhet bardh e zi që popujt kanë për veten e tyre, dhe megjithëse çdo komb në themele fsheh kufoma, ata preferojnë të shikojnë në themelet e dikujt tjetër. Pra, historia ka sjellë kombe të ndryshme në të njëjtat vende, por kujtimet – ajo që ka ndodhë atje – shpesh nuk kanë shumë të përbashkëta. Por është e rëndësishme të pranojmë që ekzistojnë interpretime të ndryshme të historisë së përbashkët.

Meqenëse në Bosnjë dhe Hercegovinë, një vend me tre popuj konstituiv (boshnjakët, serbët, kroatët) ka disa narrativa kontradiktore në lidhje me këto tema, narrativat aktuale të paraqitura në këtë kapitull kryesisht do të lidhen me interpretime kundërtëdhënëse të ngjarjeve të veçanta brenda konfliktit kroato-boshnjak në luftën e BiH. Duke e izoluar këtë konflikt nga e gjithë rrjedha e luftës në Bosnje dhe Hercegovinë, mbetemi të privuar nga narrativi mbizotërues serb i marrëdhënieve midis Republikës së Kroacisë dhe Bosnje-Hercegovinës gjatë ngjarjeve të viteve nëntëdhjetë. Kështu, në kapitujt që lidhen me rrëfimet e Bosnjës dhe Hercegovinës, do të keni mundësinë të lexoni një përmbledhje të ngjarjeve të caktuara nga këndvështrimi boshnjak.

—  
062  
—

Gjithashtu mbetet disi e paqartë nëse po flasim për narrativën mbizotëruese pan-kroate? Apo në lidhje me ngjarjet në BiH gjatë viteve nëntëdhjetë ka dallime midis qëndrimeve të Zagrebit zyrtar dhe publikut të Republikës së Kroacisë në krahasim me pikëpamjet e komunitetit kroat brenda Bosnjës dhe Hercegovinës?

Me zgjedhjen e vendeve për vizitë (Mostar, Sarajevë), i gjithë studimi i marrëdhënieve midis dy vendeve u transferua në lindje të lumit Una dhe kryesisht në konfliktin boshnjako-kroat. Besojmë që do të ishte interesante të vizitojmë edhe disa vende që nuk ishin skena të vetë konflikteve për të dëgjuar mendimet e njerëzve që nuk ishin të përfshirë direkt në vetë konflikte. Sidoqoftë, gjatë vizitave kemi pasur mundësi të vizitojmë vendet ku ndodhën ngjarje të rëndësishme gjatë viteve nëntëdhjetë, të dëgjojmë mendimin e popullatës lokale për atë që ka ndodhur atje dhe të dëgjojmë më shumë rreth mënyrës se si interpretohen këto ngjarje sot, 25 vjet pas përfundimit të konfliktit.

Ajo që ka lënë një përshtypje të fortë tek ne si grup është perspektiva e popullatës lokale drejt së ardhmes, duke theksuar rëndësinë e të folurit për të kaluarën. Ishte gjithashtu shumë interesante të



shkruheshin vetë narrativat. Përkatësisht, ajo që i dha të kuptuarit tonë të informacionit një kënd tjetër të vëzhgimit nuk ishte vendi nga kemi ardhur. Ky ishte para së gjithash profesioni që kemi. Pikërisht kjo larmi fushash akademike ka treguar se sa e ndërlikuar është çështja e hulumtimit të narrativëve për një qasje ndërdisiplinore në shkrimin e këtyre kapitujve.



—  
064  
—



## **Formimi i HZHB dhe organizimi ushtarak i kroatëve në BiH: Narrativa kroate**

---

### ***Luftimi për mbijetesë***

Konflikti kroato-serb, nga fillimi i viteve nëntëdhjetë, shpejt u shtri në territorin e Republikës së atëhershme Socialiste të Bosnjës dhe Hercegovinës (në tekstin e mëtejme SR BiH, që nga prilli 1992 Republika BiH). Politika serbomadhe e Slobodan Milosheviqit dhe përfaqësuesve serbë të Bosnjës gjithashtu ka nënkuptuar agresion dhe okupim të territorit të SR BiH, e cila, deri në vitin 1992, kishte shmangur pjesëmarrjen në konfliktet në ish-Jugosllavi. Qysh në vitin 1991, popullsia serbe në BiH u organizua në një bashkësi komunash dhe në fund të atij viti u shpall Republika Serbe e Bosnjës dhe Hercegovinës (më vonë Republika Srpska). Si përgjigje ndaj politikave të tilla të serbëve të Bosnjës, kroatët në BiH gjithashtu organizohen në një bashkësi të komunave të quajtur Komuniteti Kroat i Herceg-Bosnjes (në tekstin e mëtejme HZ HB), e cila u krijua në 18 nëntor 1991<sup>18</sup> në Grude, kryeqyteti origjinal (më vonë kryeqyteti transferohet në Mostar).

Qëllimi fillestar i krijimit të një komuniteti të tillë ishte mbrojtja e popullit kroat në BiH, si dhe mbrojtja e territorit të Bosnje-Hercegovinës dhe integritetit të tij nga agresioni i pashmangshëm i Armatës Popullore Jugosllave dhe njësisë paramilitare serbe në BiH. President i parë i HZ HB u zgjodh Mate Boban (1991-1994), një politikan kroat dhe anëtar i HDZ BiH, i cili ishte një nga themeluesit e Këshillit Kroat të Mbrojtjes në prill 1992 (në tekstin e mëtejme HVO), pasi përpos në aspektin politik, mbrojtja kundër agresionit serb duhej të organizohej edhe në planin ushtarak.<sup>19</sup> Boshnjakët luftonin me kroatët në radhët e njësisë ushtarake kroate në fillim të luftës në Bosnje dhe Hercegovinë, kurse organizimi ushtarak i popullit kroat në Bosnje dhe Hercegovinë në aspektin organizativ është shfaqur vetëm me 15 prill 1992 dhe është quajtur Armata e Republikës së Bosnjes dhe Hercegovinës (Armija BiH), kurse në të vërtetë është jetësuar shumë më vonë.



Përveç HVO, si ushtri e ligjshme e HZ HB-së, Forcat Kroate të Mbrojtjes (HOS) u krijuan si një forcë paramilitare e Partisë Kroate të së Drejtës të Bosnjës dhe Hercegovinës (HSP BiH) në 1991, e cila përpos në BiH ka luftuar edhe në Kroaci. Emblema e HOS përbëhej nga stema kroate në një sfond të zi me mbishkrimin “Za dom spremni” (“Të gatshëm për ardhe”) dhe emërtimin Batalioni IX. “Rafael vitez Boban” (sipas Gjeneralit të Shtetit të Pavarur të Kroacisë - NDH, i cili u krijua në 1941) kujton shenjat dhe simbolikën e lëvizjes Ustashe nga Lufta e Dytë Botërore.

Themelimi i HZ HB dhe njërive paraushtarake në territorin e BiH me siguri nuk mund të mos kalonte pa shqetësime të muslimanëve-boshnjakëve, të cilët përveç nga idea e Serbisë së Madhe, tani kishin frikë nga rikthimi i aspiratave të Kroacisë së Madhe (kujtojmë se territori i BiH ishte përfshirë gjatë Luftës së Dytë Botërore në NDH). Ne nuk i shohim rrënjët e aspiratave të tilla, sepse që në fillimi, populli kroat bëri përpjekje të mëdha për tu mbrojtur nga agresori serb – duke luftuar së bashku në Asamblenë e SR BiH dhe duke votuar në referendum në mars të vitit 1992.

Kroatët kishin frikë të arsyeshme se do të shndërroheshin në pakicë kombëtare në Jugosllavinë e cunguar dhe veprimi në aspektin organizativ dhe ushtarak ishte një hap shumë i qartë. Konflikti i armatosur midis palës kroate dhe boshnjake shpërtheu përfundimisht në verën e vitit 1992, i përcjellë nga përleshje të përgjakshme dhe krime të rënda nga të dy palët, me viktima civile, dhe u shënuar nga shkatërrimi i trashëgimisë kulturore siç është Ura e Vjetër në Mostar, e cila u rrënuar në nëntor 1993.

Si rezultat i konfliktit boshnjako-kroat dhe mosbesimit të ndërsjellë, krijimi i Republikës Kroate të Herceg-Bosna doli si vazhdim i ekzistencës së HZHB, me qëllim të organizimit më të madh të kroatëve në BiH. Edhe pse u arrit armëpushimi midis palës kroate dhe boshnjake në vitin 1994 kur u formua Federata e BiH, Republika Kroate Herceg-Bosna mbeti zyrtarisht në ekzistencë deri në vitin 1996.

Si rezultat i konfliktit boshnjako-kroat dhe mosbesimit të ndërsjellë, krijimi i Republikës Kroate Herceg-Bosna doli si vazhdim i ekzistencës së HZ HB, me qëllim të organizimit më të madh të kroatëve në BiH. Edhe pse u arrit armëpushimi midis palës kroate dhe boshnjake në vitin 1994 kur u formua Federata e BiH, Republika Kroate Herceg-Bosna mbeti zyrtarisht në ekzistencë deri në vitin 1996.

Polemika të shumta ende sot lidhen me Republikën Kroate të Herceg-Bosnjës dhe Forcat e Armatosura Kroate, kryesisht për shkak të flirtimit të përmendur me ideologjinë ustashe dhe konotacioneve<sup>20</sup> separatiste që themelimi i organizatave të tilla në territorin e BiH vetvetiu krijon. Sidoqoftë, polemika të tilla sot përdoren kryesisht për qëllime politike dhe për grindje politike, pasi një narrativë e qartë ende nuk është përcaktuar, siç mund të shihet nga përjashtimi i këtyre temave nga librat shkollorë të historisë (Kroaci), në të cilat përmendet vetëm ekzistenca e konfliktit boshnjako-kroat të viteve nëntëdhjetë.







# **Formimi i HZHB dhe organizimi ushtarak i kroatëve në BiH: Narrativa e Bosnje-Hercegovines**

---

## ***BiH e (pa)ndashme***

Rrjedha e luftës në Bosnje dhe Hercegovinë është përcaktuar kryesisht nga marrëdhëniet boshnjako-kroate brenda kësaj lufte. Në zgjedhjet parlamentare të vitit 1990, fitorja në Asambleenë e SR BiH arrihet nga partitë etnike dhe rrëzohen komunistët nga pushteti. Me fillimin e luftës në Slloveni dhe Kroaci, boshnjakët rrezikuan të mbeten pjesë e një shteti ku do të zbatoheshin doktrinat e politikës serbomadhe dhe do të vireshin në nivel të pakicës kombëtare.

069

Agresorët çetnikë përdorën territorin e BiH si një trampolinë për operacionet ushtarake dhe ndihmën për serbët në Kroaci dhe paralajmëruan dhe filluan mobilizimin e detyruar. Parlamenti i Bosnjës dhe Hercegovinës, në përgjigje të rrjedhës së ngjarjeve, miratoi më 15 tetor 1991, një Akt për riafirmimin e sovranitetit të Republikës së Bosnjës dhe Hercegovinës. Me atë akt, u vendos që të tërhiqeshin përfaqësuesit e BiH nga puna e organeve federale derisa të arrihet marrëveshja midis të gjitha republikave që përbëjnë Jugosllavinë. Duke mbrojtur shtetësinë shumëvjeçare të Bosnjës, qytetarët e BiH zgjodhën pavarësinë në referendumin e 29 shkurtit dhe 1 marsit, pavarësisht kundërshtimit të nacionalistëve serbomëdhenj.

Frika nga agresioni serbomadh kundër Bosnjes dhe Hercegovinës, i gjen boshnjakët dhe kroatët si partnerë në luftën kundër këtyre aspiratave. Edhe pse në pamje të parë krahas boshnjakëve në dëshirën për pavarësi, HDZ BiH e ka shpallur HZ Posavina në Bosanski Brod më 12 nëntor 1991 dhe HZ HB u shpall në Grude më 18 nëntor 1991.<sup>21</sup>

Fillimi i krijimit të Komunitetit u bë në maj 1991, kur në takimin në Busovača, popullatës kroate të Bosnjës Qendrore, si dhe komunave të Hercegovinës, u rekomandua të bashkoheshin në Komunitetin Rajonal Kroat të Bosnjes dhe Hercegovinës.

Krijimi i komuniteteve kroate, që kujtonin rajonet autonome serbe, ishte një surprizë e madhe për boshnjakët, të cilët kroatët i panë si partnerë kundër agresionit serbomadh. Meqenëse të drejtat kushtetuese të serbëve dhe kroatëve në BiH nuk u komprometuan dhe pjesëmarrja e tyre në pushtetin shtetëror ishte proporcionale, krijimi i bashkësive etnike ishte një përpjekje antikushtetuese për ndarjen e shtetit dhe aneksimin e territoreve nga shtetet fqinje, sipas planeve dhe hartave të udhëheqjes politike të Serbisë dhe Kroacisë.

Përgjigja ndaj krijimit antikushtetues të njërive të reja territoriale politike në Republikën e BiH ishte një përpjekje e autoriteteve shtetërore për të ruajtur paqen me çdo kusht. Krahës qytetarëve besnikë, kishte edhe rryma që punonin intensivisht në shkatërrimin e vendit. Ndërsa një pjesë e HDZ BiH punoi për të stabilizuar vendin, pjesa tjetër bëri lëvizje që kontribuan në destabilizimin e shtetit.<sup>22</sup>

Krijimi i organeve parashtetërore kroate u shoqërua me zhvillime të ngjashme në plan ushtarak, që në masë të madhe përcaktoi rrjedhën e luftës në Bosnje, veçanërisht marrëdhëniet boshnjako-kroate gjatë dhe pas luftës. Shkaqet e një politike të tillë të kroatëve të BiH duhen kërkuar edhe në raportin e Zagrebit zyrtar dhe Tudmanit ndaj BiH, i cili në takimet e tij me përfaqësuesit e kroatëve e ka minuar shtetësinë e BiH dhe ka bërë thirrje për kufijtë e Kroacisë së Banovinës.<sup>23</sup>

Pasi theu forcat çetnike gjatë operacionit Agimi i Qershorit (Lipanska zora)<sup>24</sup>, Mate Boban vuri sistemin e qeverisjes vendore kroate, sistemin shkollor kroat dhe “kroatishtja” u bë “gjuhë zyrtare”. HDZ e shndërroi HZHB në një tërësi njëpartiake, etnike të popullit kroat, që është e definuar edhe në emërtimin e saj.

Duhet të theksohet që ka ekzistuar një dallim i rëndësishëm në aspiratat e HVO dhe HOS në luftën në BiH. HOS në Hercegovinë u drejtua nga Blaž Kraljević, një atdhetar i padiskutueshëm, i cili mbronte pandashmërinë e Republikës së Bosnje dhe Hercegovinës, dhe supozohet se ishte likuiduar nga udhëheqja e shtetit kroat, pasi parandalonte synimet për të krijuar një bashkësi të pavarur kroate në BiH, e cila më pas do të aneksohej nga Republika e Kroacisë.<sup>25</sup>

Gjatë operacioneve të saj, HVO shpesh ka bashkëpunuar me okupatorin çetnik dhe ka punuar për të dobësuar Bosnjen dhe Hercegovinën, gjë që u theksua veçanërisht në territorin e Sarajevës së rrethuar. Edhe pse është formuar si formacion paramilitar, asaj i është

dhënë status i barabartë në dëshirën për mbrojtje dhe pavarësi të BiH.

Ajo që dhemb veçanërisht është fakti që viktimat kanë qenë të pabarabarta për kaq shumë vjet. Viktimat dhe luftëtarët kroatë vazhdimisht “vlejnë” shumëfish dhe financohen me gjithë zemër nga paratë e Republikës së Kroacisë, që është një tregues tjetër se Kroacia ishte pjesëmarrëse në agresionin kundër BiH dhe se anëtarët e HVO nuk punonin në mbrojtjen, por në copëzimin e BiH. Përkatësisht, përveç financimit nga Federata e Bosnjes dhe Hercegovinës në sistemin e mbrojtjes pensionale dhe aftësive të kufizuara në të cilën ndodhen luftëtarët dhe/ose familjet e të varrëve. Në të njëjtën kohë, marrin pagesa mujore nga buxheti i Republikës së Kroacisë.





## **Formimi i HZHB dhe organizimi ushtarak i kroatëve në BiH: Narrativa e përbashkët**

---

### *Nga aleati deri tek armiku dhe sërish aleatë*

073

Pas themelimit të partisë HDZ BiH dhe katër muaj para shpalljes së pavarësisë së Bosnjes dhe Hercegovinës, me vendim të 18 nëntorit 1991, HDZ BiH themeloi HZ HB në territorin e Bosnje-Hercegovinës përëndimore dhe qendrore me seli në Mostar si një tërësi politike, kulturore, ekonomike dhe territoriale. Këtij komuniteti do t'i bashkohen më vonë pjesë të Bosanska Posavina me shumicë kroate, kurse Gjykata Kushtetuese e BiH do të kontestoj ekzistencën e këtij komuniteti përmes vendimit të 14 shtatorit 1992. Në vitin 1993, HZ HB ndryshon emrin në Republikën Kroate Herceg-Bosna (HR HB). Dhomat Gjyqësore të GJNDJ në çështjet Blaškić (IT-95-14), Kordić dhe Čerkez (IT-95-14 / 2) dhe Naletilić dhe Martinović (IT-98-34) përcaktuan se udhëheqjet politike të HZ HB (HR HB) dhe Republika e Kroacisë kishin si objektiv politik ndarjen e këtij territori nga Bosnja dhe Hercegovina dhe aneksimin e tij nga Republika e Kroacisë me qëllim që të arrihej unifikimi i popullit kroat në një shtet të vetëm që synonte kufijtë e Banovinës së vitit 1939.

HVO u krijua në vitin 1992 si organ suprem i mbrojtjes dhe më vonë si organ administrativ dhe ekzekutiv i HZ HB. Me marrëveshjen për miqësi dhe bashkëpunim midis BiH dhe Kroacisë të nënshkruar midis Presidentit Franjo Tugjman dhe Alija Izetbegović në të njëjtin vit, HVO u bë pjesë e Armatës së BiH.<sup>26/27</sup>

Në të njëjtën kohë, bashkësia ndërkombëtare ka kërkuar zgjidhje politike për konfliktet që po shtriheshin në Bosnje dhe Hercegovinë. Bisedimet e përfaqësuesve të tre popujve në Bosnje dhe Hercegovinë me ndërmjetësuesit ndërkombëtarë rezultuan në Planin e Paqes Vance-Owen (2 janar 1993), sipas së cilit BiH do të ishte një shtet unitar i decentralizuar me 10 provinca, secila me një qeveri lokale të kryesuar nga përfaqësues të komunitetit shumicë. Kroatët e Bosnjes

me këtë plan morrën provincat 3, 8 dhe 10 dhe përfaqësuesit e tyre pranuan plotësisht zgjidhjen e propozuar nga plani në fjalë, ndërsa palët boshnjake dhe serbe nuk e pranuan atë. Ky plan i paqes përshpejtoi procesin e mosmarrëveshjeve midis Kroacisë dhe BiH që u përshkallëzua në konflikt në vitin 1993. Në disa gjykime, Dhomat Gjyqësore të ICTY kanë konkluduar se<sup>28</sup>, pavarësisht kundërshtimit nga muslimanët boshnjakë, udhëheqjet politike të Republikës së Kroacisë dhe HZ HB janë përpjekur ta zbatojnë këtë plan me forcë. Sipas planit Vance-Owen, të gjitha njësitët e Armatës së Bosnjes dhe Hercegovinës në provincat e deklaruara kroate duhej t'i nënshtroheshin HVO-së me vendim të udhëheqjes së kroatëve të Bosnjes. Pasi që Armata e Bosnjës dhe Hercegovinës e refuzoj këtë erdhi deri tek një numër i madh i konflikteve që përfshinin kryerjen e krimeve të luftës dhe shkeljet masive të të drejtave të njeriut në territorin e Bosnjës Qendrore dhe Hercegovinës Perëndimore nga pjesëtarët e HVO dhe Armatës së BiH. Konflikti zyrtarisht ka përfunduar me Marrëveshjen e Uashingtonit<sup>29</sup>, të nënshkruar me 18 mars 1994 nga Kryeministri i BiH Haris Silajdžić, Ministri i Jashtëm Kroat Mate Granić dhe Presidenti i Herceg-Bosnjes Krešimir Zubak.



## ***Vuajtjet në konfliktin boshnjako-kroat në luftën e BiH: Narrativa kroate***

---

### ***Kush i ka urdhëruar vrasjet e kroatëve?***

Kroatët dhe boshnjakët kanë luftuar si aleatë kundër APJ-së dhe forcave serbe deri në vjeshtë të vitit 1992 kur filluan konfliktet boshnjako-kroate, duke rezultuar në një numër të madh viktimash. Më shumë se 1.600 kroat humbën jetën në krime lufte (mënyra se si bashkësia ndërkombëtare përcakton krimet e luftës), dhe midis atyre që humbën jetën në krimet masive 1088 ishin civilë.<sup>30</sup>

Konflikti e arriti kulmin me 16 prill 1993. Ngjarja kulminante njihet si masakra në Ahmići që është shpallur krim lufte - krim kundër njerëzimit. Sulmi kishte për synim pronat myslimane. Shtëpitë dhe hambarët u dogjën dhe shumë njerëz u vranë gjatë procesit. Sipas të dhënave të mbledhura dhe verifikuar nga gjykatat, u vranë 116 boshnjakë, përfshirë të paktën 41 civilë të paarmatosur.

Edhe pse kjo datë është e njohur në mesin e njerëzve që janë më të informuar për luftën, si nga Ballkani ashtu edhe nga bota, kjo nuk ishte e vetmja ngjarje kulminante. Konkretisht, në të njëjtën ditë u zhvillua një betejë në Trusinë (një fshat në komunën Konjic në Hercegovinë) midis Ushtrisë së BiH (njësitit të njohur si “Zulfikar”) dhe HVO. Anëtarët e ARBiH shkuan shtëpi më shtëpi dhe me trupa e civilëve krijuan të ashtuquajturën mburojë të gjallë dhe u drejtuan drejt vendit Brdo križ, ku, me kërcënime për të vrarë civilët, detyruan anëtarët e HVO (6 prej tyre)<sup>31</sup> të dorëzoheshin dhe pastaj i pushkatuan. Pasi thyer rezistencën, ushtarët e Armatës hynë në fshat dhe vranë brutalisht 18 civilë kroatë, përfshirë gra, fëmijë dhe të moshuar, dhe plagosën 4 civilë. Përveç terrorizimit çnjerëzor të civilëve, ushtarët plaçkitën edhe shtëpitë dhe sendet e tjera që u përkisnin kroatëve.

Ajo që konsiderohet dhe theksohet nga një pjesë e shoqërisë kroate si një padrejtësi e tmerrshme është fakti që thelbi i të dy krimeve

është i njëjtë pasi cak ishin pjesëtarët e vetëm një grupi etnik, por krimi në Ahmići u zbulua nga UNPROFOR-i, mediat e huaja dhe vendore e mbuluan mirë kurse autorët u gjykuan para GJNDJ, ndërsa nga ana tjetër, krimi në Trusinë nuk iu dha aq shumë hapësirë apo rëndësi mediatike dhe autorët u gjykuan para gjykatës së BiH, dhe duket se krimi kundër kroatëve është harruar dhe është bërë më pak i rëndësishëm nga media dhe politika.

Krimi i Trusina nuk është një rast i izoluar i vuajtjeve të kroatëve në këtë konflikt. Krimet e luftës u kryen kundër kroatëve në të gjithë BiH, kryesisht në territorin e Hercegovinës dhe Bosnjes Qendrore. Midis shumë viktimave dhe krimeve, dallohen dy. Më 28 korrik 1993, 37 njerëz - 8 civilë dhe 29 rekrutë, janë grumbulluar dhe vrarë gjatë bastisjes nga anëtarët e ARBiH në fshatin Dolani afër Jablanicës, shumica e të cilëve në momentin e futjes në fshat kanë qenë të paarmatosur duke kryer punët bujqësore.<sup>32</sup>

Në Grabovicë, afër Mostarit, më 9 shtator 1993, u vranë 32 civilë kroatë, kryesisht të moshuar, gra dhe fëmijë, të cilët mbetën në fshat pasi ARBiH pushtoi fshatin. Zona më e gjerë e fshatit Grabovica ka qenë nën kontrollin e anëtarëve të Armatës së RBiH që nga 10 maji 1993 dhe në kohën e masakrës, ajo ishte më shumë se 35 km larg nga të gjitha linjat e kontaktit ose konfliktit. 16 trupa të tjerë nuk u gjetën kurrë. Supozohet se janë hedhur në Neretva ose në rezervuarin e HEC-it në Salakovac. Disa nga të vrarët para ekzekutimit u torturuan në mënyrë monstruoze.<sup>33</sup>

Jo rrallë, ekzekutimet e civilëve, anëtarëve të HVO-së dhe të burgosurve të luftës u kryen nga vullnetarët arabë, anëtarët e lëvizjes El-Muxhahedin, të cilët janë të njohur për ekzekutimet e tyre monstruoze dhe festimet e krimeve.<sup>34</sup>

Nën përgjegjësinë komanduese për krimet kundër kroatëve, nuk kanë dhënë përgjegjësi as Kryeministri i RBiH, de fakto entitetit boshnjak të luftës, as Ministrat e Mbrojtjes apo të Brendshëm. Nga dy shefat e Shtabit të Përgjithshëm të Armatës së RBiH, gjenerali Sefer Halilović u lirua në gjykatën e Hagës, ndërsa gjenerali Rasim Delić u dënua me 2 vjet burg.<sup>35</sup>

## ***Vuajtjet në konfliktin boshnjako-kroat në luftën e BiH: Narrativa e Bosnje-Hercegovines***

---

### ***(Ar)Miq***

Konflikti boshnjako-kroat në luftën në BiH shpesh quhet luftë brenda luftës. Boshnjakët i panë kroatët si partner kundër agresorit çetnik dhe idesë së Serbisë së Madhe. Deri në gusht të vitit 1992, Armata e RBiH kreu mobilizim të plotë dhe pati 168.500 trupa, pa forcat e HVO-së dhe MPB-së së BiH, kurse në territorin e kontrolluar nga Armata e RBiH, njësitë e HVO u pranuan si pjesë e forcave të armatosura të BiH. Megjithatë, sipas një oficeri të Armatës së RBiH, HVO ka ndaluar konvojet me armë dhe logjistikë që nga fillimi i luftës, duke sugjeruar se nuk bëhet fjalë për raport partneriteti me palën kroate.

Një seri konfliktesh sporadike, në të cilat boshnjakët dhe kroatët pësuan nga njeri tjetri në fund të prillit 1993, u përshkallëzua në luftë totale me karakter ndërkombëtar. Ngjarjet që i paraprinë konfliktit të përgjithshëm u quajtën “veprime parandaluese”, dhe ndodhën në pjesë të ndryshme të Hercegovinës dhe Bosnjës Qendrore.

Aksionet parandaluese fillojnë në Bosnjën Qendrore, para së gjithash me gjenocidin në fshatin Ahmiqi, i cili ishte i rrethuar nga fshatra me popullatë kroate, ku brenda disa orësh janë vrarë 116 civilë, përfshirë gra, fëmijë dhe të moshuar. Paso i një valë dëbimesh, vrasjesh dhe përdhunimesh të detyruara. Boshnjakët u larguan nga Vitezi drejt Travnikut ose Zenices, duke pohuar se ushtarët kroatë u dhanë atyre tre orë për të lënë qytetin ose të vriteshin.

Brenda disa javësh në prill dhe maj 1993, ndodhi rënia e Srebrenicës, refuzimi serb i Planit Vance-Owen, paaftësia e bashkësisë ndërkombëtare për të zbatuar planin e paqes dhe më në fund shpërthimi i një lufte totale kroato-boshnjake. E gjithë kjo detyroi qeverinë dhe ushtrinë e Bosnjes të përballeshin me rrethana të reja. Paso i një ndryshim i madh politik dhe ushtarak: Armata RBiH filloi



të përgjigjet ndaj sulmeve. Pas raporteve të tmerrshme për kampet e VRS, gjatë verës filluan të arrijnë raportet të tmerrshme të keqtrajtimit dhe torturimit të boshnjakëve në kampet kroate. Më 15 shtator 1993, Këshilli i Sigurimit i OKB lëshoi një deklaratë duke u kërkuar kroatëve të shpërndanin kampet, duke kujtuar ndjenjën e “tmerrit dhe dënimet” e shprehura nga bashkësia ndërkombëtare një vit më parë kur u zbuluan kampet serbe.<sup>36</sup>

Natën e 23 tetorit 1993, pas një bombardimi të vazhdueshëm gjatë gjithë ditës së fshatit Stupni Dol, pjesëtarët e njësive kroate sulmuan fshatin dhe më pas masakruan popullsinë. Krimi kundër civilëve dhe pronave zgjati për ditë të tëra, deri në orët e vona të 3 nëntorit 1993, kur kryetari i bashkisë kroate urdhëroi popullatën kroate që të përgatitej për evakuim dhe të mblidheshin në rrugët e qytetit deri në agim, duke je bërë thirrje përmes një altoparlanti. Derisa lufta egërsohej, qeveria amerikane filloi të ushtrojë presion ndaj Zagrebit, dhe më 3 shkurt 1994, Këshilli i Sigurimit i OKB-së vendosi një afat dy-javor për Kroacinë të tërheqë trupat e ushtrisë së saj të rregullt nga BiH ose të përballet me pasojat. Presioni dha fryt. Gjatë ditëve të ardhshme, delegacionet boshnjake dhe kroate u sollën në Uashington. U nënshkrua marrëveshja për federatën boshnjako-kroate dhe Kroacisë iu premtua ndihmë ushtarake dhe ekonomike si shpërblim.

# ***Vuajtjet në konfliktin boshnjako-kroat në luftën e BiH: Narrativa e përbashkët***

---

## ***Cilat viktima vlejnë më shumë?***

Në kërkimin e arsyes së konfliktit midis kroatëve dhe boshnjakëve, secila palë ka kriteret e veta dhe fajtorët e saj, dhe si rregull i sheh ata vetëm tek tjetri, ndërsa në të njëjtën kohë fsheh ose minimizon krimet e veta. Këtu ndodhin kthesa të pakuptueshme, në të cilat harrohet burimi i të gjitha të këqijave të luftës, agresioni serb kundër Bosnjës dhe Hercegovinës. Kështu, disa politikanë boshnjakë akuzojnë kroatët për agresion dhe gjenocid<sup>37</sup>, duke harruar mizoritë e agresorit serb, pa përmendur dëmet që u shkaktuan kroatëve; për shembull, në Bosnjën dhe Hercegovinën qendrore.

Sa i përket vëmendjes së mediave, në mediat botërore theksohen krimet e kroatëve në Ahmiqi dhe Stupni Dol, ndërsa krimet e boshnjakëve në Borovica afër Vares, Kiselak afër Zhepçes, Trusina, Uzdol, Dolani, Grabovica afër Jabllanica, Konjic dhe Mostar janë më pak të përmendura. E njëjta tendencë, për të mbuluar krimet boshnjake kundër kroatëve dhe duke parë boshnjakët vetëm në rolin e viktimës, vërehet në botën e politikës, si dhe në kujtesën e viktimave. Përfaqësuesit e Kroatëve në BiH, si dhe zyrtarët e Republikës së Kroacisë janë ftuar në mënyrë të përsëritur të vizitojnë vendet ku janë kryer krime kundër boshnjakëve, t'u kërkojnë falje viktimave dhe të pranojnë fajin në kuptimin e pranimit të përgjegjësisë së Republikës së Kroacisë.<sup>38</sup> Në të njëjtën kohë, vendet e vuajtjes së kroatëve në BiH janë lënë pas dore<sup>39</sup> dhe përfaqësuesit politikë të popullit boshnjak nuk janë shfaqur ende në përvjetorët e këtyre ngjarjeve, duke vazhduar kështu “betimin e heshtjes” për këto ngjarje. Më në fund, le të përmendim paditë. Krimet u ndoqën penalisht, por para gjykatave të “peshave të ndryshme”.<sup>40</sup> Kështu, për shembull, krimet në Ahmiqi u gjykuan përpara Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për ish-Jugosllavinë (nën përgjegjësinë komanduese), ndërsa krimet në Trusinë u gjykuan përpara Gjykatës së BiH (ekzekutuesit

e drejtpërdrejtë, jo komandantët). Kjo mund të problematizohet nga i njëjti aspekt i “rolit të viktimës”, por megjithatë krimi u njoh dhe dikush ka dhënë përgjegjësi për të.

Si rezultat i konfliktit kroato-boshnjak, erdhi deri tek eksodi tragjik i popullit kroat nga zonat të cilat ishin ose u vënë nën kontrollin e Armatës së BiH, por edhe anasjelltas.

Numri i të vrarëve dhe të rënëve gjatë luftës në Bosnje dhe Hercegovinë është temë mospajtimi midis palëve ndërluftuese, domethënë institucioneve të ndryshme të përfshira në hetimin e ngjarjeve të luftës në BiH. Shifra me të cilën shumica e studiuesve do të pajtoheshin është rreth 100.000 veta. Fatkeqësisht, shpesh historianë të ndryshëm, studiues privatë, por edhe media marrin shifra që shkojnë përtej këtij numri.<sup>41</sup> Gjithashtu nuk ka pasur konsensus për numrin e personave të zhvendosur dhe të përndjekur.

Pasojat e luftës midis kroatëve dhe boshnjakëve në Bosnje dhe Hercegovinë janë të shumta dhe tragjike për fatin e vendit dhe për të tre popujt në të. Megjithëse procesi i pajtimit midis popullatës ka përparuar, vendet e vuajtjes shpesh përdoren për të arritur qëllimet politike dhe për të mbajtur një gjendje artificiale konflikti në paqe. Për shembull, asnjëherë nuk bëhet fjalë për ngjarje pozitive, siç është rasti në Vitez ku françeskanët e Bosnjës kanë mbrojtur boshnjakët para ekstremistëve të shfrenuar nga rradhës e kombit të tyre, ose në Vareshe ku boshnjakët lokalë ndihmuan fqinjët e tyre kroatë, duke mos përmendur as luftimet e përbashkëta gjatë gjithë luftës në zonën e Bihaçit dhe Bosanska Posavina kundër armiku të përbashkët.



## ***Shkatërrimi i Urës së Vjetër në Mostar: Narrativa Kroate***

---

### ***Kush e shkatërroj urën?***

Në mes të agresionit serbomadh kundër Kroacisë dhe BiH, në vitin 1992 vie deri tek konflikti i hapur i armatosur midis forcave kroate dhe boshnjake, deri atëherë aleatë në luftën mbrojtëse. Kjo për shkak të rritjes së mosbesimit midis dy palëve, si dhe frikës së palës myslimane-boshnjake se HZHB u krijua me qëllim të shpërndarjes së territorit nën kontrollin e popullit kroat në BiH. Gjithashtu, këmbëngulja e palës kroate për t'u vetëorganizuar dhe vepruar nuk kontribuoi në ndërtimin e marrëdhënieve, pavarësisht nga fakti se drejtuesit e HZ HB në mënyrë të përsëritur garantuan integritetin territorial të Republikës së Bosnjes dhe Hercegovinës. Një nga zonat kryesore të konfliktit ishte Mostari, një qytet i vendosur në luginën e lumit Neretva, me popullsi të përzier myslimane-boshnjake dhe kroate. Ndër të tjera, në një moment u shpall edhe kryeqytet i Republikës Kroate Herceg-Bosna të themeluar më herët.

Situata e re e ndau popullsinë mbi baza fetare-kombëtare në brigjet lindore (boshnjake) dhe perëndimore (kroate) të Neretvës, të cilat në një moment mbetën të lidhura vetëm përmes Urës së Vjetër, ndërsa të gjitha urat e tjera të Mostarit mbi Neretvë u shkatërruan ose u dëmtuan ndjeshëm.

Edhe pse palës kroate i zihet për të madhe urbicidi në territorin e qytetit të Mostarit, shkatërrimi i qytetit në Neretva u krye shumë më herët. Gjatë verës së vitit 1992, forcat serbe nën urdhërat e Komandantit të APJ-së, Momčilo Perišić terrorizuan qytetin, duke shkatërruar monumentet kulturore dhe historike, komplekset ekonomike dhe ushtarake. Ura e Vjetër u godit nga forcat serbe në dy raste në qershor dhe tetor 1992, pas kësaj forcat e HVO-së ndërmorën veprime për të riparuar dhe siguruar urën.<sup>42</sup> Pas dëbimit të forcave serbe gjatë fushatës së Agimit të Qershorit, Ura e Vjetër mbetet ura

e vetme në Neretva deri më 9 nëntor 1993, kur u shkatërrua pas disa ditësh granatime (dhe 427 vjet ekzistencë). Shkatërrimi i Urës së Vjetër është filmuar me tre kamera, kurse njëra prej tyre e ka “kapur” një tank nga i cili ishin shkrepuar predhat e lartpërmendura, të cilat dyshohet se shkatërruan urën.

Për shkatërrimin e urës u fajësua pala kroate, përkatësisht njësitë e gjeneralit kroat Praljak, të cilin Gjykata Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë (ICTY) e ka gjykuar për këtë akt. Gjatë konfliktit, Ura e Vjetër ishte nën kontrollin e Ushtrisë së BiH dhe u përdor për të transportuar armë, që padyshim i jep legjitimitet shkatërrimit të mundshme të urës nga HVO.

Ajo që sugjeron që ura nuk është shkatërruar nga pala kroate është: mungesa e urdhrit për shkatërrimin e urës, lirimi i gjeneralit Praljak sipas asaj pike të aktakuzës (29.11.2017.) dhe mënyra e shkatërrimit të urës, e cila dukej se ishte shkatërruar nga eksplozivët e vendosur (që është vërtetuar më vonë nga eksperimente të ndryshme dhe analiza ekspertësh).<sup>43</sup>

Sidoqoftë, shkatërrimi i Urës së Vjetër ka lënë pasojë shumë më të mëdha në ndjenjat dhe “psikën” e njerëzve të Mostarit, të cilët ishin të indinjuar dhe të zemëruar për shkak të shkatërrimit të simbolit të qytetit të tyre, sesa në rrjedhën e mëtejshme të konfliktit midis palës kroate dhe myslimane-boshnjake. Pas përfundimit të luftës, ka filluar rindërtimi i urës, e cila u përfundua në vitin 2004 me mbështetjen e plotë të Republikës së Kroacisë. Kështu, Ura e Vjetër mbetet edhe sot simbol i qytetit, që lidh dy brigjet e Neretvës.

## ***Shkatërrimi i Urës së Vjetër në Mostar: Narrativa e Bosnjes dhe Hercegovinës***

---

### ***Dihet.***

Pyetja: Kush e shkatërroi Urën e Vjetër, na gjen çdo 9.11. kur kujtojmë një nga krimet më të tmerrshme në luftën e kaluar – urbicidin, i cili synonte të ndryshojë rrjedhën e historisë, të çrënjosë përgjithmonë ekzistencën e boshnjakëve në Hercegovinë, të vrasë shpirtin dhe besimin në një shoqëri shumëkombëshe, dhe bashkëjetesën në këto hapësira.

—  
o83  
—

Ura u dëmtua pjesërisht nga e ashtuquajtura Ushtri e Republikës Srpska (VRS) dhe Armata Popullore Jugosllave (APJ), kurse më 9 nëntor 1993 HVO e shkatërroi Urën e Vjetër si pjesë e fushatës së bombardimit dhe terrorizimit të Mostarit. Një ditë më herët, HVO filloi fushatën e shkatërrimit të urës duke shkrepur dhjetëra predha në harqe dhe kulla, e cila përfundoi të nesërmen me shkatërrimin e saj përfundimtar. Ky ishte kulminimi i muajve të tërë të terrorizimit të qytetarëve të Mostarit. Në fillim të gushtit 1993, 25.000 njerëz ishin nën rrethim në anën lindore të Mostarit, me shumë pak ushqim, pa ujë të pijshëm.

Sipas një analize profesionale të bazuar në video regjistrime, shpërthimi mund të jetë shkaktuar nga detonimi i fitilave në ujë, megjithëse konfirmohet se gjatë mëngjesit (9:57) dhe pasdites (15:52), më 8 nëntor 1993, Ura e Vjetër ka qenë cak i goditjeve me predha të ndryshme, dhe sipas së gjitha gjasave edhe të tankeve. Historianët evropianë Holm Sundhaussen<sup>44</sup> dhe Marie-Janine Čalić<sup>45</sup> pohojnë se ura u shkatërrua nga granatimet e HVO-së ose Ushtrisë Kroate (HV), kurse mendim i ngjashëm mbi përgjegjësinë e trupave kroate është shprehur edhe nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë në ish-Jugosllavi në gjykimin e rastit Prlić et al. IT-04-74).<sup>46</sup>

Pas botimit të 36 transkriptimeve të Tugjmanit<sup>47</sup> dhe shtatë gjykimeve<sup>48</sup> para GJNDJ, mund të konkludohet se prishja e urës ishte pjesë e një



fushate agresive të qëllimshme nga Kroacia, e cila, veç të tjerave, ishte reflektuar në urbicidin. Biseda e Tugjmanit me Janko Bobetkon dhe Anto Roson më 6 nëntor 1993, vetëm 4 ditë para rrënimit të Urës së Vjetër, dëshmon për metodat e urbicidit dhe agresionit të Kroacisë kundër Bosnje dhe Hercegovinës. Në një moment, Tugjman i kërkon Rosos të zbatojë “disa elementë të frikësimit” për boshnjakët dhe të zgjedhë të përdorë gjithçka të mundshme pa përdorimin e helmeve të luftës. Vetëm katër ditë më vonë, Ura e Vjetër u rrënuar.

Përndryshe, transkriptet e Franjo Tugjmanit janë pa dyshim dëshmia më e drejtpërdrejtë e agresionit të Kroacisë kundër Bosnjes dhe Hercegovinës dhe ndodhen në gjykatën e Hagës si provë. Krimineli i luftës Slobodan Pralac ka provuar në mënyrë të përsëritur të transferojë përgjegjësinë e shkatërrimit tek ana boshnjake përmes hiperprodhimit të librave kuazi-historikë, por në 2004 ai deklaroi për Slobodna Dalmacija: “Ura e Vjetër ishte një strukturë ushtarake, dhe një strukturë ushtarake gjatë luftës, pavarësisht nga historia e saj dhe vlera kulturore, mund të rrëzohet”.<sup>49</sup>

## ***Shkatërrimi i Urës së Vjetër në Mostar: Narrativa e përbashkët***

---

### *Ura e cila ndan*

Ndërtimi i Urës së Vjetër në Mostar u përfundua në vitin 1566 dhe u ndërtua nga Mjeshtri Mimar Hajrudin me kërkesë të Sulltanit të atëhershëm të Turqisë Sulejmanit të Madhërishtëm.<sup>50</sup> Disa besojnë se qyteti i Mostarit u emërua pikërisht sipas urës, qoftë sipas emrit të tij (ura e vjetër = mostar) ose sipas njerëzve që ruanin urën - mostari. Sidoqoftë, më shumë se dobi funksionale ose (në luftë) ushtarake, ura kishte një vlerë simbolike.

o85

Megjithëse siguria dhe ekzistenca e urës ishte kompromentuar më parë, gjatë Luftës së Dytë Botërore, kur ishte ngarkuar disa herë me eksploziv, në mënyrë që të shkatërrohej në situatë emergjence dhe kështu të parandalohesh që armiku ta përdorte, megjithatë fatin e keq Ura e Vjetër e gjeti gjatë konfliktit kroato-boshnjak. Kështu, në pikën e aktakuzës kundër liderëve kroat të luftës të Bosnjes (gjashtshes), prishja e Urës së Vjetër u përshkrua si “shkatërrim i institucioneve të destinuara për arsim dhe fe”, dhe Dhoma Gjyqësore morri vendim me shumicë votash se më 8 nëntor 1993, një tank i HVO-së gjatë ofansivës gjatë gjithë ditës kishte hapur zjarr mbi Urën e Vjetër, duke bërë që ajo të shembet përfundimisht të nesërmen në mëngjes.<sup>51</sup> Dhoma e Apelit në rastin Prlić dhe të tjerët vendosi që, edhe pse tek shumica e popullsisë së Mostarit, tek kroatët dhe boshnjakët, shkaku i shkatërrimi së urës është kontravers, shkatërrimi ka shkaktuar dëme joproporcionale për popullsinë civile myslimane të Mostarit lindor, por meqenëse është përdorur nga Armata e BiH, ura për HVO-në përfaqësonte një objektiv të ligjshëm ushtarak.<sup>52</sup>

Pas ndërprerjes së armiqësive, në të njëjtin vend u ndërtua një urë e përkohshme, varëse, e ngjashme me atë të vjetrën nga koha para Mimar Hajrudinit. Një dekadë më vonë, në vitin 2004, nga rrënojat e mbetura dhe copat e të njëjtit gur nga Hercegovina, u ndërtua Ura e re

e Vjetër dhe në 2005 u përfshi në listën e UNESCO-s të Trashëgimisë Kulturore Botërore. Rrethi i jetës së Mostarit është mbyllur përsëri.

Shkatërrmi i urës, rrethimi i qytetit dhe terrorizimi i popullatës mbetën tema të freskëta në vitet pas luftës dhe Mostari shpesh përmendet si “qytet çështje”. Arsyeja e këtij qëndrimi është statusi shumë i dobët juridik dhe politik i qytetit në Neretva, me të cilin nuk është e kënaqur asnjëra palë. Mostari është ndarë politikisht në dy pjesë që nga lufta në BiH, boshnjake - lindore dhe kroate - perëndimore. Me statutin e imponuar nga ish Përfaqësuesi i Lartë në BiH Peddy Ashdoën në 2004 janë shfuqizuar gjashtë bashki dhe është krijuar një administratë e përbashkët e qytetit.

Zgjedhjet lokale në Mostar janë mbajtur për herë të fundit në vitin 2008. Aktualisht, nuk ka Këshill Bashkiak, dhe i gjithë pushteti është në duart e kryetarit “të përjetshëm” Ljubo Bešlić. Marrëdhëniet shumë të tensionuara politike kanë kaluar edhe tek marrëdhëniet e popullatës në të dy anët e qytetit. Komunikimi është pothuajse inekzistent, edhe 25 vjet pas shembjes së urës.





### ■ **Formimi i HZHB dhe organizimi ushtarak i kroatëve në BiH**

**18** Në të njëjtën ditë kur HZHB u themelua në Grude, në frontin kroat ra Vukovari, në të cilin APJ dhe paramilitarët serbë më pas kryen shumë vrasje dhe krime lufte.

**19** Gjegjësisht, në atë kohë, ndërsa agresori serbo-malazez po shkatërronte qytetin kroat Ravno afër Trebinjes, në Hercegovinën lindore, nga Sarajeva po vinin mesazhe “kjo nuk është lufta jonë” (A. Izetbegović), dhe ishte e qartë se ishte e nevojshme të kujdesej për mbrojtjen e komuniteteve kroate në BiH (ky organizim bazohej në përpjekjet për të qëndruan si një popull kushtetues dhe sovran në Bosnjë dhe Hercegovinë).

**20** Republika e Kroacisë shpesh akuzohet për konotacione separatiste, megjithëse është një nga vendet e para që e ka njohur BiH.

**21** Vendimi për krijimin e Komunitetit Kroat të Herceg-Bosnjes, 18. 11. 1991. Faktor.ba. *Obilježena godišnjica tzv. HR Herceg-Bosne*. Sarajevo.

• <https://web.archive.org/web/20200208114131/https://faktor.ba/vijest/obiljezena-godisnjica-tzv-hr-hercegbosne/718>  
(Arkivuar më 08.02.2020.)

**22** Index. ICTY: *Milošević dokazivao da je i Ključić bio za podjelu BiH*. Zagreb.

• <https://web.archive.org/web/20200208114726/https://www.index.hr/vijesti/clanak/icty-milosevic-dokazivao-da-je-ikljucic-bio-za-podjelu-bih/148665.aspx>  
(Arkivuar më 08.02.2020.)

**23** Banovina e Kroacisë është rezultat i përpjekjes për të zgjidhur çështjen kroate dhe për të krijuar mundësi për mbijetesën e shtetit jugosllav në rrethanat e rënduara politike europiane në prag të Luftës së Dytë Botërore. Ligjërisht filloi të ekzistojë me miratimin e Dekretit për Banovinën e Kroacisë më 26 gusht 1939. e njohur si zgjidhja e Mačekut për çështjen kroate”, sipas Banovina e Kroacisë, *Hrvatska enciklopedija.hr*. 1999-2009. Ur. Brozović, Dalibor; Kovačec, August; Ravlić, Slaven. Leksikografski zavod Miroslav Krleža. Zagreb.

• <https://web.archive.org/web/20200208115127/https://www.enciklopedija.hr/natuknica.aspx?ID=5743>  
(Arkivuar më 08.02.2020.)

**24** Operacioni Agimi i Qershorit është një operacion i përbashkët i HVO, HV dhe HOS në qershor 1992. Aksioni zgjat nga 7 qershor deri më 26 qershor 1992. Kjo është fitorja e parë ndaj agresorit të Serbisë së Madhe në luftën në Bosnjë dhe Hercegovinë. Operacioni Agimi i Qershorit çliroi Luginën e Lumit Neretva dhe në disa vende forcat e përbashkëta kroate shpërthyen në vijën e sotme të demarkacionit midis Federatës së Bosnje dhe Hercegovinës dhe Republikës Srpska.

**25** Index. *Tko je ubio Blaža Kraljevića?* Zagreb.

• <https://web.archive.org/web/20200208114912/https://www.index.hr/vijesti/clanak/tko-je-ubio-blazakraljevica/987482.aspx>  
(Arkivuar më 08.02.2020.)

**26** “Për qëllimet e këtij ligji, mbrojtës është pjesëtari i Ushtrisë së Republikës së Bosnjës dhe Hercegovinës, Këshillit Kroat të Mbrojtjes dhe policisë së organit kompetent të punëve të brendshme (në tekstin e mëtejshëm: Forcat e Armatosura) të cilët morën pjesë në mbrojtjen e Bosnjes dhe Hercegovinës (fillimi i agresionit kundër komunës Ravno). Nga 18.09.1991 deri më 23.12.1996., pra deri në ndërprerjen e rrezikut imediat të luftës dhe i cili u çmobilizua me një vendim të autoritetit ushtarak kompetent, si dhe personi që ka marrë pjesë në përgatitjen për mbrojtjen dhe në mbrojtjen e Bosnjes dhe Hercegovinës në periudhën para 18.09.1991. Ligji për të Drejtat e Veteranëve dhe Anëtarëve të Familjeve të tyre të FBiH, 2004, Neni 2, paragrafi 1.

**27** Përveç organizimit në njësitë e HVO, disa kroatë të BiH u organizuan brenda HOS, dhe si të tillë duhet të shihen si paraushtarak.

**28** Roli i HVO dhe HZ(R)HB në luftën në BiH po ripërcaktohet nga Aktgjykimi i ICTY në Çështjen Prlić et al., i cili u dha në 29 Nëntor 2017. Gjatë dënimit të gjashtë drejtuesve të paditur politikë dhe ushtarakë të Herceg Bosnes, një nga të dënuarit e mëvonshëm, Slobodan Praljak, bëri vetëvrasje. Kjo ngjarje dhe vendimi, i cili dënoi të gjashtë me shumë vjet burg dhe vërtetoi që kanë kryer numër të madh krimesh, si dhe një ndërmarrje të përbashkët kriminale të udhëhequr nga udhëheqësit e Republikës së Kroacisë dhe Herceg Bosnes, konfirmojnë më tej veprimet agresive të HV dhe HVO kundër Bosnjes dhe Hercegovinës.

**29** MMë tepër për vetë marrëveshjen mund të mësoni në faqet e Institutit të SHBA për Paqe.

• [https://web.archive.org/web/20200208115449/https://www.usip.org/sites/default/files/file/resources/collections/p\\_eace\\_agreements/washagree\\_03011994.pdf](https://web.archive.org/web/20200208115449/https://www.usip.org/sites/default/files/file/resources/collections/p_eace_agreements/washagree_03011994.pdf)  
(Arkivuar më 08.02.2020.)

### ■ *Vuaajtjet në konfliktin boshnjako-kroat në luftën e BiH*

**30** Narod.hr. *Bošnjački ratni zločini nad Hrvatima – zašto pravosuđe BiH o njima šuti?*. Zagreb.

• <https://web.archive.org/web/20200208120052/https://narod.hr/hrvatska/bosnjacki-ratni-zlocini-nad-hrvatima-zastopravosuđe-bih-njima-suti>  
(Arkivuar më 08.02.2020.)

**31** N1 BiH, *Edin Džeko osuđen na 13 godina zatvora za ratne zločine*. Sarajevo.

• <https://web.archive.org/web/20200208120247/http://ba.n1info.com/Vijesti/a29538/Edin-Dzeko-osudjen-na-13-godina-zatvora-za-ratne-zlocine.html>  
(Arkivuar më 08.02.2020.)



**32** Index. 21. *godišnjica zločina nad 39 hrvatskih branitelja i civila u Doljanima kod Jablanice*. Zagreb.

• <https://web.archive.org/web/20200208121038/https://www.index.hr/vijesti/clanak/21-godisnjica-zlocina-nad-39-hrvatskih-branitelja-i-civila-u-Doljanima-kod-Jablanice/762523.aspx>  
(Arkivuar më 08.02.2020.)

**33** Bursać, Dragan. *Mrtva Mladenka iznad Neretve*. Sarajevo.

<https://web.archive.org/web/20200208120925/http://balkans.aljazeera.net/vijesti/mrtva-mladenka-iznad-neretve>  
(Arkivuar më 08.02.2020.)

**34** Duhaček, Gordan. *Zločini Armije BiH nad Hrvatima*. Zagreb.

• <https://web.archive.org/web/20200208121145/https://www.index.hr/vijesti/clanak/zlocini-armije-bih-nad-hrvatimaubijali-i-protjerivali-civile-rusili-crkve-mudzahedini-zarobljenicima-odsijecali-glave/1013948.aspx>  
(Arkivuar më 08.02.2020.)

**35** Jabuka TV. *Haaške presude: Hrvatima 273, Bošnjacima 8,5 godina zatvora*. Zagreb.

• <https://web.archive.org/web/20200208121300/https://www.jabuka.tv/haaske-presude-hrvatima-273-bosnjacima-85-godina-zatvora/>  
(Arkivuar më 08.02.2020.)

**36** Veterani.ba. *Vijeće sigurnosti UN-a od Hrvata zatražilo raspuštanje logora*. Visoko.

• <https://web.archive.org/web/20200208121422/http://veterani.ba/naslovna/2019/09/15-09-1993-vijece-sigurnostiun-a-od-hrvata-zatrazilo-raspustanje-logora/>  
(Arkivuar më 08.02.2020.)

**37** Gjenocidi nuk është përcaktuar nga GJNDJ për asnjë nga krimet e lartpërmendura të kryera gjatë konfliktit boshnjako-kroat.

**38** Ivo Josipović (Presidenti i Kroacisë nga 2010 në 2015) u bëri homazhe viktimave me fjalë shprese se krime të ngjashme nuk do të ndodhnin më. Vizita e tij u mbështet nga Kardinal Puljić dhe Kryeministri Zoran Milanović. Pasardhësja e tij, Kolinda Grabar Kitarović, gjithashtu vizitoi Ahmićin.

**39** Shteti i BiH nuk ka standarde të përgjithshme për përkujtimin e vendeve të vuajtjeve dhe deri më tani ka ngritur dhe mbështetur financiarisht vetëm memoriale kushtuar vendeve ku boshnjakët paraqiten si viktime. Për shembull, në rastin e vuajtjeve të kroatëve në fshatin Trusina, viktimat u nderuan me ndërtimin e një monumenti, të financuar nga popullata, ku përvjetori festohet çdo vit nga familjet, miqtë, përfaqësuesit politikë të kroatëve dhe udhëheqësve fetarë dhe shoqatat e veteranëve.

**40** Këto janë gjykata që kanë një peshë tjetër, kryesisht në interpretim laik. Gjegjësisht, aktgjykimet e gjykatave ndërkombëtare shpesh merren si bazë për debate politike të përditshme, duke shkruar histori të reja të këtyre hapësirave dhe merren me një dozë më të madhe besimi, ndërsa gjykatat lokale perceptohen si më pak të rëndësishme.

**41** Slobodna Dalmacija. *Haaški popis Knjiga smrti u BiH: u ratu 104.732 poginulih*. Split.

• <https://web.archive.org/web/20200208121541/https://slobodnadalmacija.hr/vijesti/regija/haaski-popis-knjiga-smrtiu-bih-u-ratu-104-732-poginulih-96534>  
(Arkivuar më 08.02.2020.)



## ■ Shkatërrimi i Urës së Vjetër në Mostar

**42** Perić, Ratko. 2003. *Na Neretvi ćuprija* Crkva na kamenu. 11. Fq. 161.

**43** Polšak Palatinuš, Vlatka. *Presuda šestorci podgrijala vruće pitanje: Kako i zašto je srušen Stari most?*. Zagreb.

• <https://web.archive.org/web/20200208121719/https://www.tportal.hr/vijesti/clanak/presuda-sestorci-podgrijalavruce-pitanje-kako-i-zasto-je-srusen-stari-most-foto-20171129>  
(Arkivuar më 08.02.2020.)

**44** Sundhaussen, Holm. 2012. *Jugoslawien und seine Nachfolgestaaten 1943-2011 - Eine ungewöhnliche Geschichte des Gewöhnlichen*. Böhlau Verlag Wien - Köln – Weimar. Beč.

**45** Čalić, Marie-Janine. 1996. *Krieg und Frieden in Bosnien Herzegowina*. Suhrkamp Verlag. Frankfurt an Main.

**46** Međunarodni kazneni sud za bivšu Jugoslaviju. 2017. *Sažetak presude Žalbenog vijeća u predmetu Prlić i drugi*. Den Haag .

**47** *Stenogrami o podjeli Bosne*. 2005. Priredio Lucić, Predrag Lucić. Feral Tribune – Dani. Split - Sarajevo.

**48** Bralo, Blaškić, Prlić, Naletilić, Kordić, Aleksovski, Rajić

**49** Behram, Alija. *Svjedoci vremena: 25 godina od rušenja Starog mosta u Mostaru*. Mostar.

• <https://web.archive.org/web/20200208121900/https://www.tacno.net/novosti/svjedoci-vremena-25-godina-odrusenja-starog-mosta-u-mostaru/>  
(Arkivuar më 08.02.2020.)

**50** Gudelj, Jurica. *Najpoznatiji most u BiH*. Banja Luka.

• <https://web.archive.org/web/20200208122147/https://www.nezavisne.com/zivot-stil/nekretnine-vrt/Najpoznatijimost-u-BiH/9058>  
(Arkivuar më 08.02.2020.)

**51** Gjykata Penale Ndërkombëtare e Drejtësisë për ish-Jugosllavinë. 2013. *Përmbledhje e Aktgjykimit të Dhomës Gjyqësore në Prlić et al*. Den Haag.

**52** Gjykata Penale Ndërkombëtare e Drejtësisë për ish-Jugosllavinë. 2017. *Përmbledhje e Aktgjykimit të Dhomës Ankimore në Prlić et al*. Den Haag.

# BOSNJA DHE HERCEGOVINA / MALI I ZI

# 2

BeH / Mali i Zi / Bukovica / 26–29 tetor

093



## ■ Shkatërrimi i Urës së Vjetër në Mostar

42 Perić, Ratko. 2003. *Na Neretvi čuprija* Crkva na kamenu. 11. Fq. 161.

43 Polšak Palatić, Vlatka. *Presuda šestorci podgrijala vruće pitanje: Kako i zašto je srušen Stari most?*. Zagreb.

• <https://web.archive.org/web/20200208121719/https://www.tportal.hr/vijesti/clanak/presuda-sestorci-podgrijalavruce-pitanje-kako-i-zasto-je-srusen-stari-most-foto-20171129> (Arkivuar më 08.02.2020.)

44 Sundhaussen, Holm. 2012. *Jugoslawien und seine Nachfolgestaaten 1943-2011. Eine ungewöhnliche Geschichte des Gewöhnlichen*. Böhlau Verlag Wien - Köln - Weimar. Beč.

45 Čalić, Marie-Jeanne. 1996. *Krieg und Frieden in Bosnien Herzegowina*. Suhrkamp Verlag. Frankfurt am Main.

46 Međunarodni kazneni sud za bivšu Jugoslaviju. 2017. *Sažetak presude Župlenog vijeća u predmetu Prlić i drugi*. Den Haag.

47 *Stenogrami o podjeli Bosne*. 2005. Priredio Lucić, Predrag Lucić. Feral Tribune – Dani. Split - Sarajevo.

48 Bralo, Blaškić, Prlić, Naletilić, Kordić, Aleksovski, Rajić

49 Behram, Alija. *Svjedoci vremena: 25 godina od rušenja Starog mosta u Mostaru*. Mostar.

• <https://web.archive.org/web/20200208121900/https://www.tactio.net/novosti/svjedoci-vremena-25-godina-odrusenja-starog-mosta-u-mostaru/> (Arkivuar më 08.02.2020.)

50 Gudelj, Jurica. *Najpoznatiji most u BiH*. Banja Luka.

• <https://web.archive.org/web/20200208122147/https://www.nezavisne.com/zivot-stil/nakretnine-vrt/Najpoznatijimost-u-BiH/9058> (Arkivuar më 08.02.2020.)

51 Gjykata Penale Ndërkombëtare e Drejtësisë për ish-Jugosllavinë. 2013. *Përmbledhje e Aktgjykimit të Dhomës Gjyqësore në Prlić et al.* Den Haag.

52 Gjykata Penale Ndërkombëtare e Drejtësisë për ish-Jugosllavinë. 2017. *Përmbledhje e Aktgjykimit të Dhomës Ankimore në Prlić et al.* Den Haag.



# BOSNJA DHE HERCEGOVINA / MALI I ZI

---

# 2



—  
093  
—





Në këtë narrativë, u përpoqëm të njiheshim me problemet e konfliktit midis Bosnje-Hercegovinës dhe Malit të Zi në luftërat e viteve 1990. Pjesëmarrja e Malit të Zi në luftërat e viteve 90-të shpesh harrohet sepse përgjegjësia zhvendoset në Serbi dhe Beograd, ku ishte udhëheqja e “RSFJ-së së cunguar”. Para udhëtimeve dhe shkëmbimeve në Sarajevë dhe Bukovica, ne nuk ishim në dijeni të pjesëmarrjes së Malit të Zi dhe krimeve të kryera. Duhet të theksohet se Mali i Zi kishte shtetësi dhe se udhëheqja e saj politike kishte një ndikim në vendimmarrje të “RSFJ-së së cunguar”. Është gjithashtu e rëndësishme të theksohet se njerëzit nga Mali i Zi ishin pjesë e ushtrisë së APJ-së, sipas disa të dhënave afër 20.000, por edhe më vonë një numër i madh i vullnetarëve shkuan në fushat e betejës në BiH me formacione paramilitare.

Çështja e pjesëmarrjes së Malit të Zi është shumë e ndërlikuar sepse edhe sot përgjegjësia e udhëheqjes malazeze në luftërat e viteve 1990 nuk është sqaruar. Është e rëndësishme të theksohet se Mali i Zi ishte dhe mbetet një shtet multietnik në të cilin, për fat të mirë, nuk pati gjakderdhje të madhe në vetvete.

Mësuam për dëbimin e qytetarëve të BiH nga Mali i Zi që u vranë më vonë, por edhe me Bukovicën, për të cilën kemi vetëm një rrëfim të përbashkët, pasi që bëhet fjalë për vuajtjet e qytetarëve malazezë të përkatësisë boshnjake, një pjesë e të cilëve kanë ikur në BiH, por kjo ngjarje ka të bëjë me ngjarjet në Čajniče. Më saktësisht, në atë kohë, shumica e Malit të Zi konsiderohej serbe dhe çdo vuajtje e popullit serb në BiH perceptohej shumë subjektivisht.

Dëbimet në Bukovicë ishin temë e veçantë që ne i mbuluam ato si pjesë të vizitave tona studimore. Bukovica është një zonë e gjërë



malore në pjesën veriore të Malit të Zi, afër Plevljes, në kufi me Bosnjen dhe Hercegovinën, ku ndodhi njëri nga krimet e shumta në historinë e trazuar të ish-Jugosllavisë.

Mbulimi mediatik i ngjarjeve në lidhje me krimet në Bukovicë nuk është i plotësishëm, dhe për këtë arsye midis të rinjve mungonte informacioni për këtë ngjarje. Edicionet e mëparshme të librave shkollorë të historisë për klasën e 4-të të shkollave të mesme e kanë rënditur ngjarjen si pjesë e temës së shpërbërjes së RSFJ-së, ndërsa sot krimi në Bukovicë është lënë plotësisht në harresë.

Në periudhën deri në fillim të viteve 90-të, kishte rreth njëqind familje kryesisht myslimane që jetonin në fshatin Bukovicë. Megjithëse i takon administrativisht Malit të Zi dhe komunës së Plevljes, popullsia ishte në kontakt të vazhdueshëm me Bosnjen dhe Hercegovinën, d.m.th. komunat Foča, Goražde dhe Čajniče, ku banorët e Bukovicës ishin arsimuar, kishin punuar dhe kështu kishin edhe të afërm atje.

Me shpërthimin e konflikteve të armatosura në Bosnje dhe Hercegovinë, ushtria jugosllave ka kryer mobilizimin e malazezëve dhe serbëve në Bukovicë, si dhe në të gjithë Malin e Zi. Për herë të parë, Ushtria Jugosllave hap një komandë në Bukovicë, në fshatin Kovačevići. Anëtarët e formacioneve të armatosura të serbëve të Bosnjes lëvizin lirshëm nga Bosnja dhe Hercegovina në territorin e Malit të Zi. Ajo ushtri dhe anëtarët e ushtrisë jugosllave i trajtojnë myslimanët e Bukovicës si palë armiqësore në luftë. Në fillim të viteve 90-të, një numër i madh i rezervistëve të Ushtrisë Jugosllave, pjesëtarë të formacioneve paramilitare dhe policia malazeze qëndruan në territorin e Bukovicës, të cilit torturonin vendasit, kontrollonin shtëpitë, grabisnin, keqtrajtonin dhe abuzonin me boshnjakët e Bukovicës, nën pretekstin e kërkimit të armëve të paligjshme. Bastisjet e shtëpive myslimane, nën pretekstin e mbajtjes së armëve pa leje, grabitja e parave dhe sendeve me vlerë, rrahja e burrave, kërcënimet për t'i vrarë nëse nuk shpërngulen, dhe vrasjet e herëpashershme i detyrojnë myslimanët të ikin nga Bukovica. Anëtarët e ushtrisë së serbëve të Bosnjës marrin civilët e Bukovicës peng për t'i shkëmbyer me të burgosurit serbë dhe për të marrë informacione mbi pjesëmarrjen e myslimanëve në luftë. Lajmet për rrëmbimet e myslimanëve të Bukovicës u publikuan nga e përjavshmja malazeze "Monitor" disa ditë më vonë, duke theksuar përfshirjen e kësaj ngjarje në planin e politikës së Beogradit për krijimin e një hapësire etnikisht të pastër në territorin e Malit të Zi përgjatë kufirit me BiH.

Sipas regjistrimit të vitit 1992, Bukovica kishte 118 shtëpi dhe rreth 1.500 banorë. Sipas një raporti të Shoqatës së Banorëve të Dëbuar nga Bukovica, gjashtë persona janë vranë kurse dy kanë kryer vetëvrasje pasi janë torturuar. Njëmbëdhjetë njerëz janë rrëmbyer dhe rreth 70 persona janë keqtrajtuar fizikisht në periudhën midis vitit 1992 dhe 1995.<sup>3</sup> Bazuar në të dhënat e mbledhura, më shumë se 800 muslimanë të Bukovicës janë detyruar të largohen nga shtëpitë dhe fshatrat e tyre për shkak të sjelljes së dhunshme të anëtarëve të Ushtrisë Jugosllave dhe dhunës së ushtruar nga ushtria e serbëve të Bosnjës në zonën kufitare të Malit të Zi pranë Bosnjës. Kjo mënyrë e përleshjes së ushtrisë me popullsinë që në fillim shkel rregullat e luftës të përcaktuara me Konventën e Gjenevës.

Momir Bulatović, president i atëhershëm i Malit të Zi, thotë: “Më vjen keq për sulmin terrorist. Vetëm budallenjtë janë të gatshëm për një gjë të tillë”. Bulatović tërhoqi vëmendjen e veçantë për rrezikun nga spekulimet që u shpërdanë pas ngjarjes. Lidhur me akuzat e opozitës për favorizimin e përhapjes së retorikës së Šešelit dhe nxitjes së popullit të Malit të Zi, Bullatović mohoi thashethemet se Šešeli kërcënoi me “hakmarrje të tmerrshme” kundër autorëve.

Vetëm një vrasje është ndjekur penalisht nga autoritetet gjyqësore, ndërsa të tjerat nuk janë përmendur as në gjykimin në gjykatën e lartë në Bijelo Polje.

Në gjykimin në Gjykatën e Lartë në Bijelo Poljes, u vendos që askush nuk ishte fajtor për krimin në Bukovicë. Ky është lirimi i dytë i dhënë nga kjo gjykatë gjatë gjykimit kundër shtatë ish anëtarëve të policisë së Plevljes dhe ushtrisë jugosllave, të cilët u akuzuan nga prokuroria malazeze për krimin në Bukovicë. Gjykata liroi shtatë të pandehurit me shpjegimin - nuk ka prova të mjaftueshme. Pse nuk ka, askush nuk e shpjegoi.

Ne gjithashtu kemi vërejtur se Mali i Zi, si në krimet tjera, i ka paguar dëmet dhe pranuar krimin, por ata që ishin përgjegjës nuk u ndoqën penalisht dhe udhëhësia asnjëherë nuk ka dhënë përgjegjësi, sepse edhe sot të njëjtit njerëz janë në pozita të larta. Pak njerëz dinë për këto krime, përveç publikut profesional dhe aktivistëve social, si dhe familjeve të vetë viktimave, banorëve të Bukovicës dhe banorëve të Plevljes. Autoritetet malazeze mohojnë përgjegjësinë e komandës për këto krime. Sigurisht që ka dëshmi dhe filma dokumentarë si dhe



gjykime që nuk kanë përfunduar në mënyrë adekuate para gjykatave  
vendore, gjë që është shumë e rëndësishme për trajtimin e së kaluarës  
në mënyrë cilësore.



## ***Deportimi nga Mali i Zi: Narrativa e Bosnjes dhe Hercegovinës***

---

### *Gjyelia e refugjatëve*

Në maj të vitit 1992 policia malazeze ka arrestuar në mënyrë të paligjshme të paktën 66 civilë myslimanë dhe serbë nga BiH, kurse sipas shumë burimeve deri në 160, dhe u ka dorëzuar ata forcave të Republikës Srpska në Bosnje dhe Hercegovinë. Këta qytetarë të BiH u larguan në Mal të Zi për të kërkuar mbrojtje nga lufta në vendin e tyre. Në kundërshtim me Kushtetutën e Malit të Zi dhe konventat ndërkombëtare, refugjatët u arrestuan, mbajtën në paraburgim dhe u ekstraduan në Republika Srpska në Bosnje dhe Hercegovinë. Gjyelia e refugjatëve zgjati me muaj. Njerëzit fatkeq u arrestuan përgjatë bregdetit të Malit të Zi nga Ulqini në Herceg Novi, por edhe në brendësi. Shumica u vranë menjëherë me 27 majit të po atij viti, të tjerët u torturuan dhe u vranë në kampe dhe vetëm një numër i vogël mbijetuan. Trupat e disave ende nuk janë gjetur, as nuk dihet saktësisht se ku u vranë. Dy familje tre-anëtarëshe të refugjatëve - Klapuh dhe Avdagić, nga Foča, gjithashtu u vranë në territorin malazez.<sup>53</sup>

Ajo që është e diskutueshme gjatë procesit së marrjes së aktgjykimit janë ekzekutuesit dhe shkalla e përfshirjes së udhëheqjes politike të shtetit të Malit të Zi. Ata që i kanë urdhëruar dhe kryer këto krime ende nuk janë mbajtur përgjegjës individualisht për veprimet e tyre. Arsyeja për këtë është ndoshta që në udhëheqjen shtetërore të Malit të Zi duket se koha ka ndalur në vitet 90-të, të njëjtit njerëz janë në të njëjtat pozita. Kryeministri i atëhershëm, Milo Djukanović, është sot President i Malit të Zi.

Prokuroria e Malit të Zi në disa raste, me kërkesë të familjeve të viktimave, ka filluar një hetim kundër oficerëve të atëhershëm të policisë me dyshimin se kanë kryer veprën e “krimit të luftës kundër civilëve” duke marrë pjesë në dëbimin e refugjatëve boshnjakë. Më 29

Mars 2011, Gjykata e Lartë në Podgoricë liroi të gjithë të akuzuarit. për shkak të “mungesës së provave”.<sup>54</sup>

Në kohën e shkrimit të kësaj narrative, Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut ishte në pritje të përgjigjes së Malit të Zi për padinë lidhur me dëbimin e refugjatëve boshnjakë që më vonë u vranë.<sup>55</sup>

“Mali i Zi i sotëm i reformuar është krenar për reformat e tij demokratike, dhe presidenti i saj publikisht i kërkoi falje Kroacisë për krimet e kryera gjatë viteve ‘91 dhe ‘92 në Dubrovnik dhe në brendësi të tij. Në të njëjtën kohë, Djukanovićit nuk i bie ndërmend të kërkojë falje nga Bosnja dhe Hercegovina, dhe veçanërisht nga familjet e atyre boshnjakëve që janë deportuar tek Radovan Karadžići nga policia e tij malazeze. Këtyre njerëzve që atëherë u kanë humbur të gjitha gjurmët. Politikanët dhe oficerët e policisë që e dinë të vërtetën heshtin”.<sup>56</sup>

## ***Deportimi nga Mali i Zi: Narrativa malazeze***

---

### ***Gabimi i korrigjuar i organeve të sigurisë***

Gjatë majit dhe qershorit të vitit 1992, anëtarët e policisë malazeze morën pjesë në arrestimin, paraburgimin dhe dorëzimin e refugjatëve nga Bosnja dhe Hercegovina tek forcat e Republikës Srpska në territorin e Malit të Zi.

Disa dhjetëra qytetarë të BiH, kryesisht boshnjakë, kërkuan strehim nga tmerret e luftës të Bosnjes dhe Herzegovinës në Mal të Zi, kurse institucionet e tyre i dëbuan dhe ata përfunduan në mënyrë tragjike në kampin në Foča, Bosnje dhe Hercegovinë. Këto incidente ishin gabim i organeve të sigurisë, dhe përkundër të gjitha përpjekjeve, ata që janë përgjegjës për këtë gabim nuk janë sjellur para drejtësisë deri më tani.

Për të treguar synim të mirë dhe bashkëndjesi me viktimat, Qeveria e Malit të Zi ka paguar kompensim për familjet e viktimave në shumën prej 5 milion euro në vitin 2008.<sup>57</sup>

Pjesa më e madhe e publikut nuk ishte e vetëdijshme për këtë krim dhe vetëm më vonë u ngrit çështja dhe përgjegjësia e policisë dhe autoriteteve në Mal të Zi.

Përkundër këtyre incidenteve gjatë luftës, Mali i Zi, sipas Presidentit të saj Gjukanoviq, ishte “një strehë e mirë dhe më shumë se e ngrohtë për të gjithë njerëzit që është dashur të lëshojnë shtëpitë e tyre para stuhisë së luftës. Ka treguar që ishte i bollshëm dhe mjaft i ngrohtë, edhe për serbët që duhej të linin shtëpitë e tyre në Krajina dhe Bosnje dhe për myslimanët që duhej të linin shtëpitë e tyre në Bosnje për të njëjtat arsye” – ka thënë Milo Djukanović, Presidenti i Malit të Zi.<sup>58</sup>





## ***Deportimi nga Mali i Zi: Narrativa e përbashkët***

---

### *Krimi nën tepih*

Në maj dhe qershor 1992, nën akuza për krime lufte, policia malazeze arrestoi në mënyrë të paligjshme dhjetëra refugjatë boshnjakë nga Bosnja dhe Hercegovina, të cilët më pas ju ekstraduan Ushtrisë së Republikës Srpska. Shumica e refugjatëve të arrestuar u sollën në Qendrën e Sigurisë Herceg-Novî, nga ku u transportuan me autobus në kampin e përqendrimet KPD Foçë nën kontrollin e forcave serbe në Bosnje dhe Hercegovinë me 25 dhe 27 maj. Të gjithë boshnjakët e deportuar më 27 maj 1992, me siguri u vranë në të njëjtën ditë, dhe trupat e tyre u hodhën në lumin Drina. Përveç boshnjakëve, në të njëjtën kohë u arrestuan edhe refugjatët serbë, dhe u kthyen në territorin nën kontrollin e ushtrisë së RS nën pretekstin e shërbimit ushtarak.

Sipas të dhënave zyrtare, gjithsej 83 refugjatë nga BiH u arrestuan dhe dëbuan në territorin e Malit të Zi. Numri i saktë i viktimave nuk dihet. Šeki Radončić, një gazetar dhe publicist malazez, deklaroi se bazuar në shumë vite hulumtim, ai erdhi tek të dhënat se bëhet fjalë për 105 boshnjakë, 33 serbë dhe 5 kroatë. Për më tepër, dy familje tre-anëtarëshe të refugjatëve nga Foçë u vranë në territorin e Malit të Zi. Ende nuk janë gjetur mbetjet e të gjitha viktimave. Shtatë prej tyre i kanë mbijetuar torturave të kampit e Foçës në BiH.<sup>59</sup>

Në çështjen Krnojelac para Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për ish-Jugosllavinë, u vërtetua se personat nga stacioni policor Herceg Novi në Mal të Zi u sollën në kampin në Foçë, Bosnje dhe Hercegovinë, kundërligjshëm, pa asnjë bazë ligjore.<sup>60</sup>

Megjithëse autoritetet pretendojnë se aksioni i arrestimit dhe deportimi ka zgjatur vetëm një ditë, të dhënat tregojnë një histori më ndryshe. Aksioni u ndalua vetëm pas 21 ditësh, më 6 qershor 1992,

me ndërhyrjen e Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq. Gjuetia e refugjatëve u zhvillua pothuajse në të gjithë territorin e Malit të Zi. Bastisjet u kryen në rrugë dhe sheshe, shtëpi, taverna dhe dhoma hotelesh.<sup>61</sup>

Dhoma e Gjykatës së Lartë në Podgoricë hodhi poshtë aktakuzën e Prokurorisë Speciale për Krime Luftë dhe në vitin 2011 liroi të gjithë ata që akuzoheshin për veprën penale të Krimeve të Luftës - dëbimin e refugjatëve boshnjakë nga Mali i Zi në Republikën Srpska në vitin 1992. Për deportim janë akuzuar nëntë ish zyrtarë të lartë të policisë dhe ish shefi i policisë malazeze Boško Bojović.

Familjet e viktimave boshnjake kanë hedhur në gjyq shtetin e Malit të Zi në fund të vitit 2004, dhe në një marrëveshje jashtë gjykatës në vitin 2008,<sup>62</sup> Mali i Zi u zotua të paguante 5 milion euro dëmshpërblim , duke njohur përgjegjësinë e Malit të Zi për kryerjen e këtyre krimeve.

Sektori i OJQ-ve dhe aktivistët e shoqërisë civile në Mal të Zi aktualisht mbështesin iniciativën për të ngritur përpara stacionit të policisë në Herceg-Novi ku ishte vendosur qendra e mbledhjes së refugjatëve të dëbuar një monument për viktimat dhe po kërkojnë që procedurat të rihapen, por prokuroria nuk përgjigjet. Në ndërkohë, autoritetet malazeze nuk duan të nxjerrin në pah këto ngjarje në publik dhe besojnë se procesi ka përfunduar me pagimin e kompensimit.

Është interesante që ky krim është më pak i njohur në vetë Bosnje-Hercegovinën. Librat shkollorë të historisë për shkollat fillore dhe të mesme në BiH nuk përmbajnë asnjë informacion mbi këtë krim. Fakti që autoritetet e BiH i kushtojnë shumë pak vëmendje këtij krimi nuk kontribuon në përfundimin e gjyqit. Mbetet vetëm një nga shumë krime të luftës që edhe sot, 23 vjet pas përfundimit të luftës, nuk mund të vijnë në rend të ditës për shkak të atyre të përmasave shumë më të mëdha.

Publiku në Mal të Zi është më pak e njohur me këto deportime të kundërligjshme gjatë kohës së luftës, kurse vetëdijën e publikut për këtë e kanë ngritur organizatat joqeveritare dhe filmi “Karneval” i gazetarit Šeki Radončić i cili për herë të parë tregon dëshmitë e familjeve të viktimave, por edhe të vetë akterëve të arrestimeve.





### ■ *Deportimi nga Mali i Zi*

**53** Koprivica, Veseljko. *Dvije i po decenije od deportacije bosansko-hercegovačkih izbjeglica: Najveći nekažnjeni ratni zločin*. Podgorica.

- <https://www.monitor.co.me/dvije-i-po-decenije-od-deportacije-bosansko-hercegovakih-izbjeglica-najveinekanjeni-ratni-zloin/> (Qasur më 08.02.2020.)

**54** Faktor.ba. *Dvadeset pet godina od deportacije bh. izbjeglica iz Crne Gore: Zločin za koji niko nije odgovarao*. Sarajevo.

- <https://web.archive.org/web/20200208122523/https://www.faktor.ba/vijest/dvadeset-pet-godina-od-deportacije-bhizbjeglica-iz-crne-gore-zlocin-za-koji-niko-nije-odgovarao-249985> (Arkivuar më 08.02.2020.)

**55** Al Jazeera Balkans. *Evropski sud odlučuje o deportacijama Bošnjaka iz Crne Gore*. Sarajevo.

- <https://web.archive.org/web/20200208122913/http://balkans.aljazeera.net/vijesti/evropski-sud-odlucuje-odeportacijama-bosnjaka-iz-crne-gore> (Arkivuar më 08.02.2020.)

**56** Novović, Nataša. *Zločin pod tepihom*. Sarajevo.

- <https://web.archive.org/web/20200208122722/https://www.bhdani.ba/portal/arhiva-67-281/161/t1618.htm> (Archived on 08.02.2020.)

**57** Blic. *Crna Gora plaća preko MILION EVRA za ratne zločine. EU: Nije dovoljno, MORATE BOLJE*. Beograd.

- <https://web.archive.org/web/20200208123259/https://www.blic.rs/vesti/svet/crna-gora-placa-preko-milion-evra-zaratne-zlocine-eu-nije-dovoljno-morate-bolje/eloc38r> (Arkivuar më 08.02.2020.)

**58** Novović, Nataša. *Zločin pod tepihom*. Sarajevo.

- <https://web.archive.org/web/20200208122722/https://www.bhdani.ba/portal/arhiva-67-281/161/t1618.htm> (Arkivuar më 08.02.2020.)

**59** Radončić, Šeki. *Zločin koji mora biti kažnjen*. Sarajevo.

- <https://web.archive.org/web/20200208123710/http://balkans.aljazeera.net/vijesti/zlocin-koji-mora-biti-kaznjen>  
(Arkivuar më 08.02.2020.)

**60** Janković, Srđan; Komnenić, Petar. *Viši sud u Podgorici oslobodio optužene za deportacije*.

- [https://web.archive.org/web/20200208123840/https://www.slobodnaevropa.org/a/visi\\_sud\\_donio\\_oslobadjajucu\\_pre\\_sudu\\_za\\_deportacije/3540713.html](https://web.archive.org/web/20200208123840/https://www.slobodnaevropa.org/a/visi_sud_donio_oslobadjajucu_pre_sudu_za_deportacije/3540713.html)  
(Arkivuar më 08.02.2020.)

**61** Radončić, Šeki. *Zločin koji mora biti kažnjen*. Sarajevo.

- <https://web.archive.org/web/20200208123710/http://balkans.aljazeera.net/vijesti/zlocin-koji-mora-biti-kaznjen>  
(Arkivuar më 08.02.2020.)

**62** Koprivica, Veseljko. *Žrtvama ratnih zločina odšteta, nalogodavcima zločina sloboda. Aljazeera, 02.09.2017*. Sarajevo.

- <http://balkans.aljazeera.net/vijesti/zrtvama-ratnih-zlocina-odsteta-nalogodavcima-zlocina-sloboda>.
- <https://web.archive.org/web/20200208165606/http://balkans.aljazeera.net/vijesti/zrtvama-ratnih-zlocina-odstetanalogodavcima-zlocina-sloboda>  
(Arkivuar më 08.02.2020.)




# BOSNJA DHE HERCEGOVINA / SERBIA

---

# 3

BeH / SER / Prijedor–Banja Luka / 6–9 korrik

109





59 Radončić, Šeki. *Zločin koji mora biti kažnjen*. Sarajevo.

<https://web.archive.org/web/20200208123710/http://balkans.aljazeera.net/vijesti/zlocin-koji-mora-biti-kaznjen>  
(Arhivuar me 08.02.2020.)

60 Jankević, Srdan; Komnenić, Petar. *Viši sud u Podgorici oslobodio optužene za deportacije*.

<https://web.archive.org/web/20200208123840/https://www.slobodnaevropa.org/a/visi-sud-donio-oslobadjaju-pre-sudu-za-deportacije/3540713.html>  
(Arhivuar me 08.02.2020.)

Бен \ РИЈЕДОР-БАНЈА ЛУКА \ -о-корик

61 Radončić, Šeki. *Zločin koji mora biti kažnjen*. Sarajevo.

<https://web.archive.org/web/20200208123710/http://balkans.aljazeera.net/vijesti/zlocin-koji-mora-biti-kaznjen>  
(Arhivuar me 08.02.2020.)

62 Komnenić, Petar. *Žrtvama ratnih zločina odšteta, nalogodavcima zločina sloboda*. *Al Jazeera*, 08.02.2020. Sarajevo.

<http://balkans.aljazeera.net/vijesti/ztvama-ratnih-zlocina-odsteta-nalogodavcima-zlocina-sloboda>  
<https://web.archive.org/web/20200208165606/http://balkans.aljazeera.net/vijesti/ztvama-ratnih-zlocina-odstetanalogodavcima-zlocina-sloboda>  
(Arhivuar me 08.02.2020.)

# BOSNJA DHE HERCEGOVINA / SERBIA

---

# 3







“Nëse e pyesim veten nëse raca njerëzore duhet të shihet si një racë e mirë apo e keqe, duhet të pranoj: nuk kemi asgjë për t'u mburrur”.

*Immanuel Kant*

Pavarësisht se sa dikush ka njohuri për luftën që ka ndodhur në ish-Jugosllavi, një pyetje nuk do të fitoj përgjigjet kurrë - si ka mundësi që një vend të krijoj kaq shumë kaos dhe ndarje, ku njerëzit kanë humbur të gjithë arsyen dhe njerëzimin dhe kanë vrarë fqinjët e tyre. Kjo është një prej disa pyetje në të cilat asnjëra palë nuk ka përgjigje. Sidoqoftë, sado i pakontrolluar dhe i pashpjegueshëm kaosi i luftës, ajo nuk duhet të ndalojë dëshirën e të rinjve për të mësuar sa më shumë që të jetë e mundur në lidhje me të dhe të bien dakord për një gjë - që kjo nuk duhet të ndodhë më. Kjo ishte një nga gjërat që përsëritej shpesh në bisedat e grupit Drina.

Ne, si pjesëmarrës të Grupit Drina, jemi përqendruar në konfliktet e luftës midis Bosnje-Hercegovinës dhe Serbisë. Në mënyrë simbolike, ne e emëruam grupin Drina pas lumit që na lidh, ose në këtë rast na ndanë. Në takimin e parë të përbashkët të grupit, vendosëm se cilat tema kemi dashur t'i diskutojmë dhe cilat vende kemi dashur t'i vizitojmë. Shumica e pjesëmarrësve menjëherë menduan për rrethimin e Sarajevës, një temë për të cilën flitet edhe sot dhe Prijedorin, një temë për të cilën ende nuk flitet sot. Pikërisht për shkak të kësaj, dy nga katër destinacionet ishin Prijedor dhe Sarajeva.

Vizita jonë e parë ishte në Prijedor, krahas Banja Lukës. Prijedor është një vend për të cilin kemi ditur pak para vizitës - në BiH shumë pak flitet për të, kurse në Serbi pothuajse asnjë. Vizita në Prijedor ishte një nga vizitat më emocionuese. Atje vizituam vendet e vuajtjes në Omarska, Trnopolje dhe Keraterm, për të cilat ende është duke u zhvilluar beteja, nëse ato do të quhen kampe përqendrimi ose qendra grumbullimi. Edhe pse, gjatë diskutimit, ne nuk ishim dakord për gjithçka, ramë dakord për faktin se duhet të thuhet më shumë për

Prijedorin. Është për keqardhje që për një ngjarje të tillë çnjerëzore nuk flitet shumë. U larguam nga Prijedori me shumë emocione, por ishte një vizitë që zgjoi dëshirën dhe motivimin tonë për të luftuar kundër nacionalizmit.

Vizita jonë e dytë ishte në Sarajevë, ku folëm vetëm për rrethimin e Sarajevës. Edhe pse kjo temë ishte më e njohur se ajo e Prijedorit, ajo përsëri krijoi një përshtypje të madhe tek ne. Vizita e Muzeut të Fëmijërisë së Luftës dhe shikimi i filmit Trëndafilet e Sarajevës ishin përvojat që na afruan më shumë me atë se si ishte jeta në Sarajevë gjatë rrethimit dhe na kapluan emocionet, sepse fokusi ishte tek fëmijët që mbijetuan, por edhe vdiqën gjatë rrethimit. Rrethimi i Sarajevës është një temë shumë e diskutueshme midis BiH dhe Serbisë sepse të dy vendet e shohin atë në mënyrë të ndryshme. Ndërsa BiH përqendrohet në rrethimin e plotë, me fokus në Markalle, Serbia përqendrohet në dëbimin e serbëve nga Sarajeva. Prandaj, narrativat tona në lidhje me këtë temë janë shkruar ashtu siç janë shkruar, sepse secili shtet përdor argumentet e tij për të përshkruar atë që ka ndodhur, dhe në disa raste, për të justifikuar atë që është bërë gjatë rrethimit.

Vizita e fundit dhe ajo që ka ndikuar më së shumti tek ne, ishte në Trebinje. Shkuam në Trebinje vetëm për një arsye - për të zbuluar sa më shumë që të ishte e mundur rreth rastit të Srdjan Aleksić. Srdjan Aleksić ishte një djalë i ri që u vra pasi i shpëtoi jetën mikut të tij, një myslimani, Alen Glavović. Për shkak të kësaj, Srdjani u rrah nga policia dhe vdiq në spital gjashtë ditë më vonë. Ajo që ne, pjesëmarrësit, ramë dakord, në rastin e Srdjan Aleksić, ishte fakti se akti i tij ishte një akt heroizmi. Por jo të gjithë pajtohen me këtë – derisa shumica e quajnë atë hero, disa e quajnë tradhtar të popullit të tyre, duke u përpjekur të argumentojnë këtë edhe me informacionin se Srdjani ishte një kriminel. Kjo është arsyeja pse tema e Srdjan Aleksićit nuk ka narrativat e veta – kjo është një narrativë, vetëm se njerëzit e shikojnë atë nga këndvështrime të ndryshme. Sidoqoftë, për shkak të rëndësisë së këtij rasti dhe pajtimit, midis nesh, që ai ishte një hero, vendosëm ta përmendim këtu Srdjanin. Srdjani ishte një nga rastet e pakta të njerëzimit në luftë, dhe pa marrë parasysh se sa disa e përçmojnë aktin e tij të heroizmit, shkëndija e tij e dritës do të shkëlqejë përgjithmonë.

Është e rëndësishme të theksohet se, gjatë shkrimit të narrativës së Bosnjës dhe Hercegovinës, është përfshirë ekskluzivisht narrativa



boshnjake, ndërsa narrativa e serbëve nga Republika e Serbisë është përfshirë tërësisht në shkrimin e narrativës së Republikës së Serbisë. Me këtë ne nuk donim të rrezikonim kombet e tjerë në këto shtete, por kemi shkruar në këtë mënyrë sepse jemi përqendruar në ngjarjet që kryesisht kanë përfshirë konfliktet e këtyre dy kombeve të përmendura. Pikërisht për shkak të kësaj, narrativa e BiH është shkruar në gjuhën boshnjake, narrativa e Republikës së Serbisë në gjuhën serbe, ndërsa narrativa e përbashkët është, në mënyrë simbolike, një përzierje e të dy gjuhëve.

E gjithë përvoja e të gjitha vizitave dhe të gjitha informacionet e marra ndryshuan jetën tonë dhe na bënë të vetëdijshëm deri ku shkon nacionalizmi. Sidoqoftë, gjëja më e rëndësishme për ne ishte që bisedat për këto tema nuk u ndalën kur përfunduan vizitat. Vizitat tek ne ngjallën dëshirën për të folur për këto gjëra dhe për të informuar të rinjtë e tjerë për tema për të cilat nuk dinim se duhej të informoheshim më parë. Pikërisht për shkak të kësaj, grupi Drina do të vazhdojë të jetojë edhe pasi të mbarojë i gjithë ky projekt, dhe ne do të vazhdojmë të luftojmë me bishën famëkeqe të quajtur Nacionalizëm.





## ***Rrethimi i Sarajevës: Narrativa e Bosnjes dhe Hercegovinës***

---

### ***Vitet gjatë së cilave vdekja e natyrshme ishte luks***

115

Suada Dilberović ishte viktimja e parë e rrethimit të Sarajevës dhe konsiderohet viktimja e parë e agresionit ndaj BiH. Në mars të viti 1992, erdhi deri tek konflikti midis anëtarëve të Partisë Demokratike Serbe (SDS) dhe policëve të kontrolluar nga qeveria e BiH. Më 5 prill 1992 u zhvilluan demonstrata paqësore, ku qytetarët e Sarajevës kërkuar heqjen e barrikadës dhe tërheqjen e forcave agresore. Anëtarët e SDS qëlluan ndaj protestuesve nga çatia e hotelit Holliday Inn. Pas demonstratave të mbajtura në Marijin Dvor, protestuesit e mbledhur u drejtuan tek ura e atëhershme Vrbanja. Snajperët që ishin pozicionuar në ndërtesën përballë pikës së karburantit hapën zjarr ndaj njerëzve dhe vranë Suada Dilberovićin në urë. Olga Sučić u vra në të njëjtin vend sikurse Suada dhe për shkak të kësaj, në atë urë ekziston një monument për të dyjat si viktimat e para të agresionit në Sarajevë. Qytetarët e Sarajevës së shpejti mbetën pa energji elektrike dhe pastaj pa ujë, ngrohje – gjithçka që mundëson një jetë normale. Shkollat rrallë punonin dhe pastaj u ndalën.<sup>63</sup>

Rrethimi i Sarajevës nga agresorët ka filluar me pushtimin e aeroportit ndërkombëtar nga JNA, natën e 4 prillit 1992, dhe ka përfunduar më 29 shkurt 1996. Ishte një bllokadë pothuajse katër vjeçare e kryeqytetit, e quajtur “Rrethimi i Sarajevës” me 1.425 ditë, një nga më të gjatat në historinë e luftës moderne. Pas “Urës Ajrore të Berlinit”, kjo ishte ura ajrore “më e gjatë” në historinë e aviacionit botëror. Gjatë rrethimit, mesatarisht 329 predha binin çdo ditë në Sarajevë dhe ky qytet ka një rekord specifik. Rekordi i 3.777 granatave të shkrepura mbi Sarajevë brenda një dite u regjistrua më 22 korrik të vitit 1993. Granatat shkaktuan dëme të mëdha, kurse dëmtimi më i madh u shkaktua në ndërtesat civile, kulturore dhe fetare. Njerëzit u vranë, ndërtesat civile, kulturore dhe fetare madje edhe spitalet u shkatërruan. Gjatë rrethimit të Sarajevës, 12.000 njerëz u vranë, 1.500 fëmijë, dhe 50.000 njerëz u

plagosën lehtë dhe rëndë.<sup>64</sup>

120 mortaja dhe 250 tanke të JNA u vendosën në kodrat përreth Sarajevës, të cilat më vonë ranë në duart e Ushtrisë së RS. Qëllimi i rrethimit ishte të urisë dhe demoralizojë popullsinë në mënyrat më mizore.<sup>65</sup> Duke pasur parasysh gjerësinë e temës së dhënë, vendosëm të paraqesim narrativat mbizotëruese të dy rasteve specifike që ndodhën gjatë rrethimit të Sarajevës. Këto janë dy masakrat nga tregu Markalle në qendër të Sarajevës dhe vrasja e civilëve serbë në Kazani. Masakra e Markalles përfaqëson dy granatime që ndodhën mbi tregun Markalle në qendër të Sarajevës, kryeqytetit të Bosnje dhe Hercegovinës. Granatimi i parë ndodhi më 5 shkurt 1994 midis 12:10 dhe 12:15, dhe i dyti me 28 gusht 1995 në ora 11:00.<sup>66</sup> Atë ditë, më 5.2.1994., një shpërthim i fuqishëm jehojë në Sarajevë. U dëgjuan sirenat, thirrjet për ndihmë, të qarat, rënkimet... Një predhë mortajash e kalibrit 120 mm e shkrepur nga pozicioni i Ushtrisë së RS ra në tregun e qytetit të mbushur me njerëz. Pas disa minutash, granata vrau 68 baballarë, nëna, vëllezër, motra, fëmijë dhe plagosi 142 persona të tjerë.<sup>67</sup>

“Markale 2”, granatimi i dytë, ka ndodhur, siç u përmend më lart, më 28 gusht të vitit 1995, rreth orës 11 të mëngjesit. Pesë granata u shkrepën, duke vrarë 37 njerëz dhe plagosur 90 të tjerë. Pas pak, u përcaktua që të pesë granatat ishin shkrepur nga Ushtria e Republikës Srpska, pas së cilës në të vërtetë filloi Operacioni “Forca e Qëllimshme” (fushata ajrore e NATO-s për të çaktivizuar arsenalin ushtarak të serbëve të Bosnjës në luftën në Bosnje dhe Hercegovinë).<sup>68</sup>

Sot, Sheshi i Fëmijëve në Sarajevë dëshmon për të gjitha këto, si dhe prindërit që humbën fëmijët e tyre në vorbullën e luftës. Deri më tani, Stanislav Galić dhe Dragomir Milošević janë dënuar për rrethimin e Sarajevës, ndërsa zyrtarët e parë politikë dhe ushtarakë të asaj kohe të Republikës Srpska, Radovan Karadžić, u dënuan me 40 vjet burg dhe Ratko Mladić me burgim të përjetshëm.<sup>69</sup>

Ngjarjet e luftës në vendin Kazani janë ende objekt diskutimesh të ndryshme dhe ende nuk janë përcaktuar të gjitha faktet rreth asaj që ndodhi në këtë pjesë të zonës së përgjegjësisë së Brigadës së 10-të Malore të Ushtrisë së Republikës së BiH. Numri i viktimave nuk është përcaktuar kurrë zyrtarisht dhe deri më tani mbetjet e rreth tridhjetë personave janë tërhequr nga gropa e Kazanit. Kazani janë në Trebeviç afër Sarajevës.



Data kryesore për qëndrimin e publikut ndaj çështjes së krimeve të kryera kundër jo-boshnjakëve në Sarajevën e rrethuar dhe të bllokuar është 26 tetori i vitit 1993. Gjegjësisht, atë ditë, Presidenca, Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ushtria e RBiH organizuan të ashtuquajturin aksion “Trebeviç”. Bakir Izetbegović, djali i presidentit të atëhershëm të Presidencës së Republikës së Bosnjes dhe Hercegovinës Alija Izetbegović, thotë se babai i tij “ndaloj atë që po bënin disa njerëz në brigadat rebele të Sarajevës”. “Ne ishim e vetmja palë që e bëri këtë. Nëse nuk do ta kishim bërë, kjo do të ndodhte në të gjithë RBiH. Ne megjithatë i kemi ndjekur penalisht ata njerëz edhe në luftë, disa procedura nuk kanë përfunduar ende”, ka thënë Bakir Izetbegović.<sup>70</sup>

Memoriali është detyrë morale dhe obligim për të treguar që të gjithë viktimat e pafajshme i trajtojmë në mënyrë të barabartë gjatë rrethimit dhe vrasjes së Sarajevës. Në këtë mënyrë, sipas pohimit të administratës së qytetit, do të hiqej njolla nga ndërgjegjja e qytetarëve të Sarajevës të cilët, edhe në ditët më të vështira për këtë qytet, ndoqën normat më të larta morale të jetës në diversitet dhe tolerancë dhe dënuan çdo krim, madje edhe atë që ndodhi në Kazani.<sup>71</sup> Sidoqoftë, memoriali nuk u ngrit kurrë. Udhëheqja politike boshnjake, e udhëhequr nga anëtari i atëhershëm i presidencës së BiH, Bakir Izetbegović, vendosi lule dhe u bëri nderime civilëve serbë të vrarë në Kazani. Me atë rast, ai ka deklaruar, “Kisha ndjenjën e detyrës të shpreh devotshmërinë time për Kazanin, dhe ngushëllimet e mia për familjet, anëtarët e të cilëve përfunduan këtu në mënyrë të tmerrshme”.<sup>72</sup>



## ***Rrethimi i Sarajevës: Narrativa serbe***

---

### ***Në Sarajevë, serbë nuk ka më***

Lufta në Bosnje dhe Hercegovinë ka filluar me vrasjen e një dasmori serb në Sarajevë (Nikola Gardović para Kishës së Vjetër në Bashçarshi). Incidenti ndodhi në 1 mars 1992, gjatë një martese serbe përpara Kishës së Vjetër në Bashçarshi në Sarajevë, RSFJ, kur një anëtar i Beretave të Gjelbërta, Ramiz Delalić, i njohur si Čelo, qëllloi dhe vrau babanë e dhëndrit, Nikola Gardović dhe plagosi priftin e Kishës Ortodokse Serbe Radenko Miković. Kjo ditë u bë simbol i tragjedisë së serbëve të Sarajevës, të gjithëve që jetuan në Bosnje dhe Hercegovinë.<sup>73</sup>

119

Ky vrasje ndëretnike ndodhi në një atmosferë tensionesh të larta për shkak të mbajtjes së referendumit për pavarësinë e Bosnje-Hercegovinës. Mediat serbe e përmendin si një nga arsyet e fillimit të luftës, pra rrethimit serb të Sarajevës. Askush nuk është marrë ende përgjegjës për vrasjen e Nikola Gardovićit, dhe policia e Federatës së BiH ka deklaruar se vrasja ishte pjesë e luftës midis kriminelëve në Sarajevë.

Është gjithashtu e rëndësishme të theksohet se sipas regjistrimit të popullsisë në vitin 1991, serbët përbënin 30% të popullsisë në Sarajevë. Në fillim të luftës, nje pjesë e serbëve mbetën në Sarajevë, ndërsa nje pjesë u transferua në vendbanimet përreth, nën kontrollin e Ushtrisë së Republikës Srpska. Gjatë luftës, një numër i serbëve të Sarajevës luftuan në radhët e Ushtrisë së BiH, si gjenerali Jovan Divjak. Një numër i madh i serbëve të Sarajevës emigruan gjatë rrethimit të Sarajevës në vitet 1992-96, dhe shumica u larguan pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Dejtonit, në fund të vitit 1995, kur vendbanimet e Sarajevës të banuara nga serbët (Grbavica, Nexhariqi, Ilixha, një pjesë e Dobrinjës, Rajlovac, Vogoshqa, Nahore...) i takuan Federatës së BiH. Radovan Karadžić dhe Momčilo Krajišnik atëherë urdhëruan serbët e Sarajevës që të mos qëndronin në “shtetin e Alisë”,



duke u dhënë atyre udhëzime: “Largohuni dhe zhvendosuni në RS”. Disa serbë nga Sarajeva gjetën strehim në Serbi, kryesisht në qendrat kolektive të pritjes ku jetuan me ndihmën e Kryqit të Kuq. Dëbimi i serbëve nga Sarajeva konsiderohet një nga spastrimet më të mëdha etnike që nga Lufta e Dytë Botërore.

Gjatë luftës në Bosnje dhe Hercegovinë, krimet u manipuluan dhe disa prej tyre u kryen nga vetë ushtria e BiH në mënyrë që të provokonin reagimin e bashkësisë ndërkombëtare. Një shembull i tillë është Markalle. Markalle dhe Porta e Tuzllës u sajuan për të shkaktuar reagime të caktuara ushtarake, kryesisht ndërhyrje të huaja.<sup>74</sup> Një ish anëtar i sigurisë së Alija Izetbegović deklaroi se sulmi në tregun Markalle u organizua nga Izetbegović dhe udhëheqësi fetar musliman Mustafa Cerić. Dëshmitari i mbrojtur GRM-116 në gjyqin e gjeneralit Ratko Mladić deklaroi se sulmi në tregun e Sarajevës Markale në dimrin e vitit 1994 u organizua nga Alija Izetbegović dhe udhëheqësi fetar musliman Mustafa Cerić, dhe u krye nga gjeneralët e të ashtuquajturës Armatë e BiH dhe që kanë bërë gjithçka për të provokuar serbët në Srebrenicë dhe shkaktuar ndërhyrjen ndërkombëtare kundër tyre.<sup>75</sup>

Prokuroria e Hagës gjithashtu e ka pranuar, gjatë ditës së dytë të seancës dëgjimore publike për ankesat kundër dënimit të presidentit të parë të Republikës Srpska, Radovan Karadžić,<sup>76</sup> se muslimanët qëlluan veten gjatë konflikteve të luftës në Sarajevë. Gjatë procesit së tij, Radovan Karadžić deklaroi në mënyrë të qartë se nëse 30.000 deri 40.000 granata do të qëlloheshin nga një pozicion i vetëm, siç pretendon prokuroria, gjithçka do të rrafshohej me tokën. Prandaj, ushtria serbe nuk ka shkrepur granata në Markalle. Si është e mundur që ka pasur 500 njerëz në tregun e zbrazët pa mallëra dhe që nuk është vrarë një shitës i vetëm, por vetëm blerësit? Serbët në Sarajevë vetëm janë mbrojtur duke mbajtur 80.000 ushtarë muslimanë që të mos sulmojnë vendbanimet serbe, dhe Armata e BiH i ekspozoi njerëzit e saj ndaj vuajtjeve të mëdha vetëm për të shtyrë ndërhyrjen e huaj.

Një nga krimet e kryera kundër serbëve në Sarajevën e rrethuar dhe për të cilin është thënë pak, është krimi në Kazani. Numri i saktë i viktimave në këtë vend, në shpatet e Trebeviqit mbi Sarajevë, nuk është përcaktuar kurrë. Deri më tani, janë zhvarrosur mbetjet e 23 viktimave, dhe 15 janë identifikuar. Shumica e viktimave ishin serbë të Sarajevës.

Kazani është emri i një shpelle në malin Trebeviq, e cila ishte nën

kontrollin e Brigadës së 10-të Malore të Armatës së BiH gjatë rrethimit të Sarajevës, pra luftës në Bosnje dhe Hercegovinë, dhe të cilën Mušan Topalović Caco dhe njësia e tij e përdorën si vend për të vrarë dhe si një varr masiv për viktimat e tyre. Caco ishte komandant i Brigadës së 10-të Malore të Korpusit të Parë të Armatës së RBiH, e cila kontrollonte një pjesë të Qytetit të Vjetër rreth vendbanimit Bistrik. Më 26 tetor 1993, është organizuar operacioni Trebeviq kur autoritetet boshnjake u përpoqën të merreshin me kriminelët në radhët e tyre. Njëri prej tyre ishte Caco, dikur në raporte të mira me Alija Izetbegović, arrestimi i të cilit ishte veçanërisht dramatik: nëntë oficerë policie dhe Caco të vdekur, i cili zyrtarisht “u vra gjatë arratisjes”. Katërmëdhjetë anëtarë të Brigadës së 10-të Malore u gjykuan para Gjykatës Ushtarake në Sarajevë një vit më vonë, kryesisht për vrasjen e civilëve serbë në Kazani, dhe u dënuan me burgim nga dhjetë muaj deri në gjashtë vjet.<sup>77</sup>

Kthimi i serbëve në Sarajevë ishte një përpjekje e dështuar, nëse ka patur ndonjëherë një të tillë. Në Sarajevë, si serb, ju mund të mbijetoni vetëm nëse me mençuri heshtni dhe duroni, ose nëse e pranoni mendimin kolektiv musliman për serbët si një popull kriminel dhe merhametli muslimanët si viktimat e vetme. Në atë rast, ju hiqni dorë nga identiteti juaj serb dhe bëheni boshnjak, duke përmbushur kështu ëndrrën e armikut tuaj politik dhe të luftës. Sidoqoftë, fakti i pamohueshëm, i cili do të na kujtojë përgjithmonë atë që u është bërë serbëve në Sarajevë, mbetet ai që nuk ka më serbë në Sarajevë.





## ***Rrethimi i Sarajevës: Narrativa e përbashkët***

---

### ***Njerëzizmi i humbur***

123

Megjithëse Serbia dhe Bosnja dhe Hercegovina (dhe brenda Bosnje dhe Hercegovinës, Republika Srpska dhe Federata) nuk mund të bien dakord për Markallen, fillimin e luftës dhe krimet e tjera kundër popullatës civile, ajo që është e padiskutueshme kur flasim për rrethimin e Sarajevës është se snajperët dhe granatat nuk zgjodhën se kë do të vrisnin. Rrethimi zgjati 1.425 ditë dhe është një nga rrethimet më të gjata të një qyteti në historinë moderne. Gjatë rrethimit, i cili zgjati tre herë më shumë se rrethimi i Stalingradit, janë vrarë 14.011 njerëz, 7.808 prej të cilëve janë vrarë në vitin e parë të luftës, dhe 3.392 në vitin vijues.<sup>78</sup> Midis viktimave ishin 1.601 fëmijë. Rreth 50.000 njerëz u plagosën lehtë dhe rëndë. Rreth 64.470 granata u hodhën mbi Sarajevë, që është mesatarisht 329 granata në ditë.<sup>79</sup>

Sarajeva ishte granatuar nga anëtarët e ushtrisë së Republikës Srpska, por edhe në ato periudha të vështira kishte njerëz që nuk donin të merrnin pjesë në fushatën për të vrarë bashkëqytetarët e tyre. Një nga të tillët ishte gjenerali Jovan Divjak. Ai ka lindur në Beograd, por duke qenë se babai i tij ishte me origjinë nga Krajina e Bosnjes (Bosanska Krupa) ku ka punuar si mësues, Divjak është deklaruar qytetar i Bosnjes, gjë që e ka treguar në disa raste në intervista me mediat vendase dhe të huaja. Ai përfundoi klasën e 12-të të Akademisë Ushtarake në Beograd, kursin për komandant të batalionit, Akademinë e Komandës dhe të Shtabit dhe Shkollën e Luftës. Më vonë ai u diplomua në Shkollën e Shtabit të Ushtrisë Franceze. Ka dhënë mësim në Shkollën Ushtarake në Sarajevë. Lufta e gjeti në detyrën e oficerit në selinë e Mbrojtjes Territoriale të BiH. Ai u bë gjeneral brigadier i Armatës së RBiH dhe Ndihmës Shef i Shtabit të Përgjithshëm të Armatës së Republikës së Bosnjes dhe Hercegovinës. Është mbajtësi i parë i rendit më të lartë francez, Legjionin të Nderit, nga Bosnja dhe Hercegovina. Duke parë që JNA ishte duke armatosur formacionet

paramilitare serbe dhe civilët, ai vendosi t'ja dorëzojë armët nga Kiseljaku Mbrojtjes Territoriale të BiH, në mënyrë që JNA të mos abuzonte me to. Pozita e tij mbi nacionalizmin ishte e njohur:

“Nuk ka dallim midis nacionalistëve –nacionalisti është nationalist. Për mua, nacionalisti është një person pozitiv nëse ai është i përkushtuar të mbrojë të drejtat e popullit të tij, por jo në dëm të një populli tjetër. Këtu bëhet fjalë me nacional-shovinistët të cilët kanë filluar dhe kryer luftëra për të rrezikuar popujt tjerë. Alija Izetbegović nuk e bëri këtë.”

*- maj 2005 për Radion Europa e Lirë duke iu përgjigjur pyetjes së një dëgjuesi: Kush është më i keqi nga tre nacionalistët: Alija, Tudjmani ose Karadžić*

Shumë vite pas përfundimit të luftës në Serbi, dihet shumë pak rreth rrethimit të Sarajevës. Përpjekjet për të rikrijuar lidhje të thyera midis Sarajevës dhe Beogradit janë kryesisht nisma të organizatave të të drejtave të njeriut dhe një numri të vogël të individëve. Për shembull, ne kishim “Ditët e Sarajevës” në Beograd, një ngjarje kulturore shumëditore që është mbajtur në Beograd që nga viti 2007, e organizuar nga Nisma e të Rinjëve për të Drejtat e Njeriut. Ngjarja është inicuar si kujtesë e rrethimit të Sarajevës, rrethimit më të gjatë të një qyteti në historinë moderne të luftës. Festivali ishte një vend për të takuar gjenerata të reja të të rinjve, të cilët do të ndërtonin marrëdhënie të reja midis Beogradit dhe Sarajevës, bazuar në të kuptuarit dhe rishqyrtimin e së kaluarës. Me kalimin e viteve, ngjarja ka pritur qindra artistë nga skena kulturore e Sarajevës. Duhet të përmendim edhe festivalin “Gjysma e rrugës”, një festival letrar ndërkombëtar që bashkon shkrimtarë nga ish-Jugosllavia. Mbahet që nga viti 2006 në Gjimnazin e Uzhices. Studentët e shkollave të mesme janë përgjegjës për përgatitjen e festivalit, dhe koha e mbajtjes së festivalit është mesi i prillit të çdo viti. Festivali u emërua “Gjysma e rrugës” pasi që Uzhica është në gjysmë të rrugës midis Beogradit dhe Sarajevës.

Një nga tregimet për të cilat nuk ka shumë polemika është tregimi i vrasjes së “Romeos dhe Zhulietës” së Sarajevës. Këta 25-vjeçarë u vranë në urën Vrbanja më 18 maj 1993, në përpjekje për të shpëtuar nga çmenduria që kapi vendin e tyre, kurse trupat e tyre kanë mbetur të shtrirë mbi urë për shtatë ditë. Të rinj dhe të dashuruar, megjithëse të kombësive të ndryshme në një kohë kur kjo ishte pothuajse e pamundur, ata po përgatiteshin për kurorëzim dhe arratisje nga

realiteti i padurueshëm. Në atë ditë fatale në orët e pasdites, me shpresën se ata do të arrinin të shpëtonin, një serb dhe një boshnjake nga Sarajeva u bënë Romeo dhe Zhulieta. Boško ra i pari, Admira u zvarrit deri tek ai dhe e përqafoi atë. Ata u takuan në Lojërat Olimpике të Sarajevës dhe miqësia u rrit shpejt në dashuri, e cila vazhdoi edhe kur kryeqyteti i BiH u godit nga granatat.<sup>80</sup>

Një vit pas fillimit të luftës në BiH, ata vendosën të largohen nga qyteti dhe të kërkojnë një jetë më të mirë diku ku dashuria e tyre nuk do të dënohej dhe ku nuk do të duhej të ecin me koka të përkulura për shkak të emrave dhe mbiemrave të tyre. Boško nuk kishte askënd në Sarajevë, përveç dashurisë së tij të shkollës së mesme, Admirës. Pasi ai qëndroi në Sarajevë për shkak të saj, ajo dëshironte të shkonte në Serbi me të. Përmes një miku të ndërsjellë, ranë dakord të largohen nga Sarajeva e rrethuar dhe më 18 maj 1993 u nisën drejt lirisë. Duke besuar se një armëpushim ishte në fuqi, ata nuk e pritën natën, por u larguan në orën 5 të mërkurës, dhe arritën vetëm tek ura Vrbanja, ku plumbi i parë nga një snajper goditi Boshkon, dhe më pas Admiren. E plagosur për vdekje, ajo u zvarrit tek Boško i vdekur, e përqafoi dhe vdiq. Trupat e tyre mbeten të shtrirë në të njëjtin vend për shtatë ditë sepse ishin në “tokën e askujt”, dhe në fund ata u tërhoqën nga anëtarët e Ushtrisë së Republikës Srpska dhe u varrosën në varrezat në Llukavica.

Shumë kanë shkruar poema, artikuj dhe histori për ta... Një nga artikujt më të famshëm ishte ai i Kurt Shork, botuar nga Reuters në 23 maj 1993, i cili më pas bëri gjiron e botës. Rock grupi nga Sarajeva Zabranjeno pušenje krijoi një këngë të quajtur “Boško i Admira”, sikurse edhe Bill Maiden me titullin “Bosko and Admira”. Për Boškon dhe Admiren u bë edhe një dokumentar i drejtuar nga John Zaricki. Romeo dhe Zhulieta e Sarajevës do të mbesin përgjithmonë në kujtimet e sarajevaseve, serbëve, kroatëve, boshnjakëve dhe hercegovinasve, por edhe të të gjithë njerëzve në mbarë botën që kanë dëgjuar historinë e tyre. Vrasësit e tyre nuk janë identifikuar deri më tani.<sup>81</sup>

Në Sarajevë në vitin 1992, në mars dhe prill, u zhvilluan protesta kundër luftës në Bosnje dhe Hercegovinë. Protestat filluan si një reagim ndaj situatës politike në Bosnje dhe Hercegovinë, e cila ishte intensifikuar dita ditës dhe kërcënonte të bëhej konflikt i hapur i armatosur. Arsyeja e drejtpërdrejt e demonstratës ishte bllokada e Sarajevës. Protestuesit u qëlluan nga anëtarët e njësisë paramilitare



serbe nga Hoteli Holiday Inn, i cili ishte selia e Partisë Demokratike Serbe. 5 persona u vranë dhe 30 u plagosën. Midis të vrarëve ishin studentët Suada Dilberović dhe Olga Sučić, të cilat konsiderohen si viktimat e para të Sarajevës të luftës në Bosnje dhe Hercegovinë. Ura Suada dhe Olga në Sarajevë është emëruar sipas tyre.

Në vitin 2017, u nënshkrua një protokoll për zbatimin e një granti për ndërtimin e një memoriali për studenten Suada Dilberović. Po për Olga Sučićin? Si një nga arsyet e këtij veprimi, supozohet se është fakti që Olga Sučić nuk ishte e të njëjtën kombësi si dekanja dhe kryetari i Komunës Qendër dhe ata që emërojnë dekanë dhe drejtorë, kryesues dhe menaxherë të institucioneve publike dhe ndërmarrjeve në këtë qytet.<sup>82</sup>

## **Prijedor: Narrativa e Bosnjes dhe Hercegovinës**

---

### **Kampet e përqendrimit**

“Qytetarë të kombësisë serbe, bashkohuni me ushtrinë dhe policinë tuaj në ndjekjen e këtyre ekstremistëve. Qytetarët tjerë, muslimanët dhe kroatët, duhet të varrin flamuj të bardhë në shtëpitë dhe apartamentet e tyre dhe të vendosin shirita të bardhë në duar. Në të kundërtën do të kenë pasoja të rënda.”<sup>83</sup>

Kështu tingëllonte thirrja më 31 maj 1992 në Radio Prijedor - fillimi i një masakre të pashembullt që rezultoi me vrasjen e 3.173 civilëve të pafajshëm dhe burgosjen e 31.000 njerëzve në kampe.<sup>84</sup>

Prijedor i është një nga qytetet në BiH që ka pësuar ndryshimet më të mëdha sa i përket strukturës etnike të popullsisë para dhe pas luftës. Popullsia e përgjithshme, e cila sipas regjistrimit të popullsisë në vitin 1991 ishte 112.543, sot është zvogëluar me 23.114. Ndryshimet më të mëdha janë në numrin e boshnjakëve - nga 49.351 para luftës në 29.034 aktualisht.<sup>85</sup>

Pas shpalljes së pavarësisë së Sllovenisë dhe Kroacisë në qershor 1991, situata në Komunën e Prijedorit u përkeqësua shumë. Muslimanët dhe kroatët janë larguar nga komuna nga frika dhe pasiguria. Propaganda serbe po bëhej shumë e dukshme. Gazeta komunale “Kozarski Vjesnik” fillon të botojë akuza kundër jo-serbëve.<sup>86</sup> Mediat, të cilat kryenin propagandën serbe, e kryenin atë me qëllim të theksimit se serbët duhet të armatosen dhe të mbrohen për të shmangur situatën që ndodhi gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Shprehje të tilla si “Ustasha”, “Muxhahedin” dhe “Beretat e gjelbërta” u përdorën për të shenjëzuar popullsinë jo-serbe. Në lajmet e mediave në shërbim të Partisë Demokratike Serbe, boshnjakët dhe kroatët u kthyen në armiç dhe përbindësja që duheshin shfarosur. Pas marrjes

së Prijedorit nga serbët, në prill 1992, filloi një fushatë e dëbimit të boshnjakëve nga ai qytet.

Më 31 maj 1992, autoritetet serbe të Bosnjës në Prijedor nxorrën një urdhër përmes radios lokale duke urdhëruar popullsinë jo-serbe që të shënojnë shtëpitë e tyre me flamuj ose çarçaf të bardhë, dhe të vendosin shirita të bardhë në mëngë kur të dilyn nga shtëpitë. Ky ishte fillimi i një fushate shfarosjeje në të cilën u kryen ekzekutime masive, përdhunime, kampe përqendrimi dhe krime të tjera, dhe rezultati përfundimtar ishte largimi i 94% të muslimanëve të Bosnjës (boshnjakëve) dhe katolikëve të Bosnjës (kroatëve) nga komuna e Prijedorit. Kjo ishte hera e parë që nga viti 1939 që anëtarët e një grupi etnik ose fetar ishin shenjëzuar për shfarosje në këtë mënyrë.<sup>87</sup>

Anëtarët e Misionit Monitorues Europian dëshmuar se, edhe në gusht të vitit 1992, gjatë një vizite në fshatrat përreth Prijedorit ku jetonin serbët dhe muslimanët, panë flamuj të bardhë në shtëpitë muslimane që i ndanin nga ato serbe. Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë për ish-Jugosllavinë krahasoi rezultatet e persekutimit vijues të popullatës jo-serbe me gjenocid. Mijëra njerëz u vranë, u arrestuan, u torturuan, u internuan ose u dhunuan dhe Prijedorit si komunitet ndryshoi përgjithmonë. Ngjarjet në Prijedor gjatë luftës mund të krahasohen me gjenocid, sepse gjithçka që u është bërë boshnjakëve në Prijedor që nga viti 1992 tregon qartë qëllimin për t'i shfarosur ata.<sup>88</sup>

Kampi Omarska ishte në funksion nga maji deri në gusht të vitit 1992, në ndërtesën e administratës kanë qenë të vendosura kryesisht gratë. Në katin e parë ishte "Dhoma e Mujës" - dhoma për marrje në pyetje, ku të burgosurit janë rrahur. Në Festën e Shën Pjetrit, ata ndezën një zjarr të madh në kamp dhe i detyruan të burgosurit të bënin valle, dhe pastaj i shtynë në zjarr. Më 17 korrik 1992, 200 persona u dërguan në "Shtëpinë e Bardhë", nga ku u dëgjuan të shtëna me armë. Më vonë, kufomat u ngarkuan në një kamion dhe u larguan. Të paktën 120 persona u dërguan në Kozara në gusht të vitit 1992, ku u vranë. 10-15 njerëz vriteshin në ditë, dhe 3.334 njerëz kaluan nëpër kamp.<sup>89</sup>

Kampi Trnopolje ishte një kamp internimi përmes të cilit kaluan 5.000-7.000 njerëz. Në një rast, 11 burra u dërguan në një fushë misri, ku u vranë. Në gusht 1992, disa nga të burgosurit janë vendosur në autobusë që më pas janë dërguar në Kozarë. Rreth 200 burra janë dërguar në vendin Koriçanske stijene dhe atje janë vranë.<sup>90</sup>



Kampi Keraterm ishte në veprim nga prilli deri në gusht 1992. Ky kamp është i njohur për abuzimin seksual të burrave. Më 24 korrik 1992, ushtarët i kanë çuar të burgosurit në dhomën 3 dhe e kanë lëshuan një gaz të panjohur i cili të burgosurit i ka bërë histerik dhe vënë në panik. Një fole mitrolozi ishte vendosur para derës dhe kur ata kanë depërtuan nëpër derë janë vranë individualisht. Mbi 100 njerëz u vranë në këtë kamp.<sup>91</sup>

Sipas të dhënave të Shoqatës “Izvor”, 3.176 banorë të Prijedorit, kryesisht civilë, janë vranë dhe zhdukur gjatë luftës - kryesisht boshnjakë, por edhe kroatë, romë, shqiptarë dhe serbë. Mes viktimave ishin 258 gra dhe 102 fëmijë. Spastrimi etnik i Prijedorit pas luftës praktikisht u zyrtarizua me Marrëveshjen e Dejtonit, sipas së cilës qyteti i përkiste Republikës Srpska. Deri më tani, autoritetet komunale në Prijedor nuk i kanë dhënë asnjë respekt në asnjë mënyrë viktimave të kësaj fushate gjenocidale për vuajtjet që kanë përjetuar.



## **Prijedor: Narrativa serbe**

---

### *Qendrat e grumbullimit*

Ngjarjet e luftës në ish-Jugosllavi dhe veçanërisht në Bosnje dhe Hercegovinë, në vitet e para të dekadës së fundit të shekullit të 20-të nuk e anashkaluan komunën e atëhershme, ndërsa sot qytetin, e Prijedorit. I vendosur në zemër të Krajinės, ky qytet kishte një histori shumë të trazuar dhe tragjike të trashëguar nga dy luftërat botërore, si dhe një përbërje etnike të popullatës shumë të larmishme. Kështu, sipas regjistrimit të fundit të paraluftës, në Prijedor kishte 11.2470 banorë, nga të cilët 49.454 ishin muslimanë, 47.745 serbë dhe 6.300 kroatë.<sup>92</sup> Në zgjedhjet e para dhe, siç doli të jetë, të vetmet shumëpartiake në Jugosllavinë e dytë të mbajtur në vitin 1990 në Prijedor, në pushtet erdhi Partia muslimane e Veprimit Demokratik, nga e cila u emërua kryetari i komunës, si dhe drejtuesit e Këshillit të Sigurisë Publike Prijedor.<sup>93</sup>

Disa shembuj tregojnë se atmosfera e paraluftës në Prijedor u ndje qysh në vitin 1991. Konkretisht, muslimanët e Prijedorit tashmë refuzonin thirrjet ushtarake, dhe një numër i madh i tyre, në vend që të bashkoheshin me APJ-në, shkuan në Kroaci për stërvitje, pas së cilës u kthyen në shtëpi. Duhet të kihet parasysh që kjo ndodhte në mes të ngjarjeve të (para)luftës në Kroaci. Për më tepër, muslimanët tallin dhe fyejnë pjesëtarët e ushtrisë legale të APJ-së, duke çuar kuaj nëpër rrugë me një shenjë në të cilën shkruhej “Unë jam më i zgjuar se një gjeneral”.<sup>94</sup> Në verën e vitit 1991, kryetari i Këshillit Komunal të SDA Prijedor u përpoq të parandalojë një kolonë të tankeve të APJ-së të shkojnë për të ndarë palët ndërluftuese në Banija të Kroacisë, dhe menjëherë pas kësaj filloi gjurmimi i istikameve rreth Prijedorit në fshatrat muslimane dhe armatosja, që kulmoi në tetor me formimin e Shtabit të Krizave të komunës Prijedor, i cili përbëhej ekskluzivisht nga muslimanët.<sup>95</sup> Në bazë të ngjarjeve të lartpërmendura gjatë vitit 1991, qëndrimi i muslimanëve të Prijedorit dhe udhëheqjes së tyre politike



ndaj ngjarjeve aktuale të asaj kohe është i qartë.

Në prill 1992, Prijedor u prek rëndë nga lufta. Rreth 7.000 refugjatë serbë nga Kroacia erdhën në Prijedor në atë kohë, dhe për të qenë të gatshëm për një konflikt, serbët e Prijedorit filluan të organizohen fshehurazi në ambientet e Qendrës së Komunitetit Çirkin Pole<sup>96</sup> vetëm në prill, gjashtë muaj pas muslimanëve në pushtet dhe në shumicë. Në ditën e parafundit të prillit, Selia e të ashtuquajturës Mbrojtja Territoriale e BiH lëshon një urdhër për të gjitha selitë e niveleve më të ulëta të MT mbi zbatimin e vendimit të të ashtuquajturës Kryesi të BiH në katër pika për sulmin ndaj njësisë të APJ-së që nuk janë tërhequr ende.<sup>97</sup> Në vend të marrjes së një vendimi për të dëbuar forcat ushtarake të rregullta kroate dhe formacionet paramilitare kroate-muslimane, e ashtuquajtura Presidencë vendos të merret me pjesëtarët të mbetjeve të APJ-së, të cilët serbët i shihnin si formën e vetme të sigurisë së tyre. Kështu vjen deri tek aksioni i marrjes së pushtetit, i cili u krye nga 400 pjesëtarë të policisë serbe qysh më 30 prill. Është e rëndësishme të theksohet se aksioni u krye pa asnjë viktimë dhe pjesëtarëve të SJB-së të kombësive të tjera iu dha mundësia të nënshkruanin lojalitetin.<sup>98</sup>

Viktima e parë e luftës në Prijedor është regjistruar me 1 maj, kur persona të panjohur rreth orës 21:30 vranë Radenko Djapen, pjesëtarin e SJB Prijedor.<sup>99</sup> Të afërmit e të vrarit në hakmarrje vrasin katër qytetarë të pafajshëm muslimanë, kurse keto ngjarje HINA (Agjencia Kroate e Lajmeve) dhe HTV (Televizioni Kroat) i përdorin për të bërë atë që shënon luftën në Prijedor –propagandën, duke pretenduar se 70 njerëz ishin vrarë në Prijedor në atë kohë.<sup>100</sup> Një shtab lufte musliman u formua në Hambarine, fshat afër Prijedorit, me 3 maj, dhe bazuar në dokumentacionin e gjetur, shihet se çdo vendbanim musliman kishte formuar togje dhe kompani, dhe një numër i madh i këtyre formacioneve paramilitare ishin të armatosur.<sup>101</sup> Vetëm në Kozarac, kishte 3.599 pjesëtarë të armatosur.<sup>102</sup>

Fillimi zyrtar i luftës në Prijedor daton me 22 maj, kur një automjet i APJ-së u ndal në një pikë kontrolli në fshatin Hambarine rreth orës 18:00, dhe më pas tre rezervistë u vranë dhe dy u plagosën. Të nesërmen, Ushtria e Republikës Srpska kërkon që të dorëzohen sulmuesit por muslimanët nuk u përgjigjen ndaj kësaj thirrje dhe nga kjo ka pasuar konflikti midis ushtrisë dhe rebelëve.<sup>103</sup> Autoritetet e Prijedorit nxorën një shpallje, në të cilin kërkuan që të gjitha armët e paligjshme të dorëzohen në kazermën “Zharko Zgonjanin”, dhe

si shenjë dallimi, është thënë që ata që vijnë për të dorëzuar armët të nxjerrin flamurin e bardhë.<sup>104</sup> Ngjarjet pasuese treguan se shumë banorë nuk i kanë dorëzuar armët, por edhe një histori tjetër të propagandës muslimane të njohur si “shiritat e bardhë” që shënohet çdo vit në 31 maj, ditën e fitores së ushtrisë së Republikës Srpska ndaj rebelëve në Prijedor.<sup>105</sup> Të dielen, më 24 maj, pati një konfrontim në rrugën kryesore Prijedor - Banja Luka në fshatin Kozarac, ku, pas goditjes së tankut të Ushtrisë së Republikës Srpska, erdhi deri tek luftimi midis ushtrisë dhe rebelëve dhe Kozarac u morrë nga ushtria serbe.<sup>106</sup> Në të njëjtën kohë, forcat muslimane sulmuan kazermat në Prijedor nga drejtimi i lagjes Puharska me shumicë muslimane, gjë që flet në favor të sinkronizimit të sulmeve muslimane.<sup>107</sup>

Ngjarja kryesore e luftës në Prijedor ndodhi më 28 maj, kur qyteti i Prijedorit u sulmua me pesë grupe luftarake rreth orës katër të mëngjesit. Pasi formacionet hynë në qytet, filluan luftimet me ushtrinë dhe policinë e rregullt, pati 38 viktima, të vdekur dhe 20 të plagosur.<sup>108</sup> Sa i përket qasjes së kryengritësve kryesisht muslimanë mjaftueshëm flet fakti që grupi që e zuri të ashtuquajturin “Nënkalim i Madh” qëllloi në drejtim të ambulancës dhe plagosi shoferin me 32 plumba, si dhe trajtimi i të burgosurve që mbajtën në qendrën e shkollës së mesme pa ndonjë ndihmë mjekësore për të plagosurit.<sup>109</sup> Sidoqoftë, ushtria dhe policia serbe arritën të zmbrapsin të gjitha sulmet dhe të mbronin qytetin, ndërsa grupet paraushtarake u tërhoqën dhe u vendosën në fshatrat e Prijedorit rreth malit Kurevo, prej nga vepruan deri në 4 nëntor 1993.<sup>110</sup> Mbi mënyrën e “veprimeve” të tyre mund të mësoni duke u njohur me krimet e tmerrshme që ata kryen, si ato në Rizvanoviqi, Kurevo, Ralash, Konçari, Zecovi, Lamovita, Kozarushta, Podragje, Donja Lubija.<sup>111</sup>

Në zonën e Prijedorit janë krijuar tre qendra të grumbullimit, Keraterm, Trnopolje dhe Omarska. Disa mijëra njerëz kanë kaluar nëpër këto vende, kryesisht muslimanë dhe kroatë, shumë prej të cilëve morën pjesë në luftë ose u përfshinë në konflikte, si dhe ata që në to gjetën strehim nga mobilizimi i përgjithshëm, veçanërisht popullata muslimane. Qendrat e grumbullimit Keraterm dhe Omarska u shpërndanë më 21 gusht kurse Trnopolje në nëntor të vitit 1992. Nga këto qendra të grumbullimit, civilët u transportuan në Skender Vakuf, Bugojno, Karlovac dhe Gradishka. Mediat muslimane dhe disa media botërore i kanë shpallur këto qendra kampe përqendrimi dhe, për më tepër, pohojnë se në to ishte kryer gjenocidi. Mbi pajustificueshmërinë e pretendimeve të tilla, përveç aktgjykimit të Hagës, i cili i mohon ato,

ekziston edhe deklarata e Përfaqësuesit të parë të Lartë, ndaj serbëve, sipas rrëfimin e tij, aspak miqësor, Paddy Ashdown, “Ata shkuan atje sepse duhej të shkonin diku. Shtëpitë e tyre u dogjën dhe jeta e tyre ishte në rrezik. Ekstremistët muslimanë bënë presion ndaj burrave për t'u bashkuar me guerilët, kështu që ata duhej të strehoheshin këtu për shkaqe sigurie”.<sup>112</sup>



## **Prijedor:** **Narrativa e përbashkët**

### *Vendi i vuajtjeve*

Republika e BiH përbëhej kryesisht nga serbët, kroatët dhe myslimanët, të cilët, përkundër shumë dallimeve, arritën të jetojnë në paqe shumicën e kohës. Në fund të viteve 80-të dhe në fillim të viteve 90-të, u formuan tre parti, bazuar në përkatësi etnike: HDZ (kroatët), SDA (muslimanët) dhe SDS (serbët). Pas zgjedhjeve në vitin 1990, këto tre parti fituan shumicën. Më 9 janar 1992, u shpall Republika e Popullit Serb të Bosnjes dhe Hercegovinës, me seli në Banja Llukë.

135

Me rritjen e tensioneve politike përkeqësohet edhe situata ekonomike në Prijedor. Një prej rezultateve ishte edhe mungesa e ushqimit, ilaçeve dhe benzinës. Më 17 janar 1992, Kuvendi i Popullit Serb të Komunës së Prijedorit votoi njëzëri për t'u bashkuar me ARK-në, duke aprovuar “bashkimin e territoreve serbe të Komunës së Prijedorit me Rajonin Autonom të Krajnës së Bosnjes”. Në prill të vitit 1992, pas zgjedhjeve në Prijedor, shumica e përfaqësuesve në organet komunale ishin serbë. Në fund të prillit 1992, në komunë ishin ngritur disa stacione sekrete policore serbe dhe më shumë se 1.500 burra të armatosur ishin gati të merrnin pjesë në marrjen e Prijedorit. Deklarata e marrjes së tij, e përgatitur nga SDS, u lexua në Radio Prijedor një ditë pas marrjes dhe u përsërit gjatë gjithë ditës.

Natën e 29 dhe 30 prillit 1992, marrja e pushtetit u zhvillua “pa u shkreput asnjë plumb”. Punonjësit e sigurisë publike dhe të policisë rezervë u mblodhën në Çirkin Pole.<sup>113</sup> Vetëm serbët ishin të pranishëm, dhe disa prej tyre mbanin uniforma ushtarake.<sup>114</sup> Ata që nuk pranuan të marrin pjesë duhej të dorëzonin kartat e tyre të identitetit dhe armët dhe të largoheshin.<sup>115</sup> Njerëzve iu dha detyra të merrnin pushtetin në komunë dhe u ndanë në pesë grupe.<sup>116</sup> Më në fund, herët në mëngjes më 30 Prill 1992, SDS mori pushtetin në Prijedor.<sup>117</sup> Autoritetet qendrore janë zëvendësuar nga SDS ose stafi besnik i SDS. Banorët e Prijedorit

kanë vënë re një prani të fortë ushtarake në qytet dhe pikat e kontrollit u ngritën në të gjithë qytetin brenda natës. Flamujt serb u ngritën nëpër qytet dhe në ndërtesat e institucioneve.<sup>118</sup>

Në periudhën pas marrjes së Prijedorit, shumë jo-serbë u pushuan nga puna. Më 31 maj 1992, autoritetet e serbëve të Bosnjës në Prijedor nxorën një urdhër përmes radios lokale duke urdhëruar popullsinë jo-serbe që të shënojë shtëpitë e tyre me flamuj ose fleta të bardha dhe të vendosin shirita të bardhë në mëngë kur të dilnin nga shtëpitë e tyre. Thirrja për “shenjëzim” dhe fushata propagandistike në fillim të luftës në Prijedor kontribuan në polarizimin e popullatës së kësaj komune në baza kombëtare, krijuan një atmosferë frike, por gjithashtu hodhën themelet për krime konkrete dhe akte çnjerëzore.<sup>119</sup>

Ekzistojnë dy këndvështrime të vendeve të vuajtjes në Prijedor. Nga ana e narrativës boshnjake, vendet e vuajtjes quheshin kampe përqendrimi - konkretisht kampet Omarska, Trnopolje dhe Keraterm, ndërsa nga ana e narrativës serbe, këto vende vuajtjesh quhen “qendra grumbullimi”. Sidoqoftë, është fakt që njerëzit u zhdukën në këto vende, sido që ato të quheshin në narrativa.

Më 6 gusht 1992, gazetarët e mediave britanike ITN dhe “Guardian” zbuluan para publikut ekzistencën e një kampi për civilët jo-serbë pranë Prijedorit në veriperëndim të Bosnjës dhe Hercegovinës.<sup>120</sup> Fotografitë e të burgosurve të rraskapitur bënë xhiron e botës në vetëm disa ditë. Këto pamje ishin gjithashtu një nga arsyet kryesore për krijimin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për ish-Jugosllavinë. Sipas Librit të të Vdekurve të Bosnjës, 4.868 qytetarë të Prijedorit u vranë gjatë luftës në Bosnje dhe Hercegovinë, nga të cilët 3.819 ishin civilë. Në mesin e viktimave ishin 3.515 boshnjakë, 186 kroatë, 78 serbë dhe 40 civilë të kombësive të tjera.<sup>121</sup>

Sot, Prijedor i është ende një temë kontraverse. Nga njëra anë, vazhdon lufta për njohjen e kampeve dhe shënjimin e vendeve të vuajtjes, kryesisht përmes organizatave të shoqërisë civile (siç është organizata Kvart), ndërsa nga ana tjetër, rezistenca e RS ndaj njohjes së kampit është më e fortë se kurrë. Shumica e popullsisë në Prijedor është serbe. Ndërtimi i një monumenti në qytet në kujtim të viktimave të Prijedorit nuk lejohet, kurse qasjen në vendet e kryerjes së krimit e bllokojnë shumë njerëz, duke përfshirë “Acelor-Mittal”, një kompani që sot është në pronësi të vendndodhjes së kampit famëkeq Omarska. Gjithashtu, propozimet për të ngritur një memorial për fëmijët e vrarë

në Prijedor gjatë luftës, si dhe një monument për të shënuar kampin e Trnopolës dhe viktimat e këtij kampi, janë kundërshtuar në disa raste. Sidoqoftë, në Prijedor, shoqata të ndryshme janë shumë aktive në fushën e tregimit të së kaluarës. Ka shoqata të të arrestuarve, shoqata të të mbijetuarve, shoqata të të kthyerve dhe shoqata të aktivistëve civilë, të cilët së bashku, me emra dhe mbiemra të ndryshëm, po luftojnë për drejtësi universale. Në Prijedor një pjesë e qytetarëve ka qëllim të qartë të bashkëpunoj me njëritjetrin dhe të të zgjidh problemet në mënyrën më konstruktive për komunitetin.<sup>122</sup>







### ■ Rrethimi i Sarajevës

**63** Stojmenović, Rosana. *Najduža opsada u povijesti: U Sarajevu poginulo 14.000 ljudi*. Zagreb.

- <https://web.archive.org/web/20200208165855/https://www.24sata.hr/news/najduza-opsada-u-povijesti-u-sarajevupoginulo-14-000-ljudi-518841>

(Arkivuar më 08. 02.2020.)

- Historija.ba. *Suada Dilberović i Olga Sučić- prve žrtve agresije na BiH*.

- <http://www.historija.ba/d/125-suada-dilberovic-i-olga-sucic-prve-zrtve-agresije-na-bih/>

(Arkivuar më 24.09.2019.)

**64** Historija.ba. *Opsada Sarajeva*.

- <https://web.archive.org/web/20200208170314/http://www.historija.ba/d/408-pocela-opsada-sarajeva/>

(Arkivuar më 08.02.2020.)

**65** Radio Sarajevo. *Najgrozomorniji rekord / Na današnji dan 1993. na Sarajevo je palo 3.777 granata*. Sarajevo.

- <https://web.archive.org/web/20200208165934/https://www.radiosarajevo.ba/vijesti/bosna-i-hercegovina/nadanasnji-dan-1993-na-sarajevo-je-palo-3777-granata/269316>

(Arkivuar më 08.02.2020.)

**66** UN. *UN Report: Serbs Responsible for 1995 Sarajevo Markale Massacre*.

- <https://web.archive.org/web/20200208171316/https://srebrenica-genocide.blogspot.com/2005/12/un-report-serbsresponsible-for-1995.html>

(Arkivuar më 08.02.2020.)

**67** Face HD TV. *21 godinu poslije - Pijaca Markale, simbol prkosa i borbe*. Sarajevo.

- <https://web.archive.org/web/20200208171510/https://www.youtube.com/watch?v=qiMD497Phoo&feature=youtu.be>

(Arkivuar më 08.02.2020.)

**68** UN. *UN Report: Serbs Responsible for 1995 Sarajevo Markale Massacre*.

- <https://web.archive.org/web/20200208171316/https://srebrenica-genocide.blogspot.com/2005/12/un-report-serbsresponsible-for-1995.html>

(Arkivuar më 08.02.2020.)

- 69** N1 Hrvatska. *1425 dana opsade, 390 granata dnevno i 11.000 stradalih*. Zagreb.  
 • <https://web.archive.org/web/20200208171104/http://hr.n1info.com/Regija/a115455/Sarajevo-1.425-dana-opsade390-granata-dnevno-i-11.000-stradalih.html>  
 (Arkivuar më 08.02.2020.)
- 70** Mondo.ba. *Izetbegović i delegacija SDA posjetili Kazane*.  
 • <https://web.archive.org/web/20200208170914/https://mondo.ba/Info/Politika/a663687/Izetbegovic-i-delegacijaSDA-posjetili-Kazane.html>  
 (Arkivuar më 08.02.2020.)
- 71** N1 BiH. *Kazani, mrlja na herojskoj odbrani Sarajeva*. Sarajevo.  
 • <https://web.archive.org/web/20200208173943/http://ba.n1info.com/Vijesti/a100162/Kazani-mrlja-u-herojskojodbrani-Sarajeva.html>  
 (Arkivuar më 08.02.2020.)
- 72** Radio Sarajevo. *Bakir Izetbegović odao počast civilnim žrtvama na Kazanima*. Sarajevo.  
 • <https://web.archive.org/web/20200208173951/https://www.radiosarajevo.ba/vijesti/lokalne-teme/bakir-izetbegovicodao-pocast-civilnim-zrtvama-na-kazanima/228814>  
 (Arkivuar më 08.02.2020.)
- 73** Kurir. *Pre tačno 26 godina ubijen je stari svat na Baščaršiji: Ovaj događaj bio je okidač za početak rata u Sarajevu*. Beograd.  
 • <https://web.archive.org/web/20200208174240/https://www.kurir.rs/region/bosna-hercegovina/3004687/pre-tacno-26-godina-ubijen-je-stari-svat-na-bascarsiji-ovaj-dogadjaj-bio-je-okidac-za-pocetakrata-u-sarajevu>  
 (Arkivuar më 08.02.2020.)
- 74** Tportal. *'Markale i Tuzlanska kapija su namješteni, za Srebrenicu tražim komisiju'*. Zagreb.  
 • <https://web.archive.org/web/20200208174518/https://www.tportal.hr/vijesti/clanak/markale-i-tuzlanska-kapija-sunamjesteni-za-srebrenicu-trazim-komisiju-20161212>  
 (Arkivuar më 08.02.2020.)
- 75** Ish anëtar i sigurimit të Alija Izetbegović deklaroi se sulmi në tregun Markale u organizua nga Izetbegović dhe udhëheqësi fetar islamik Mustafa Cerić . Mondo.rs. *Izetbegović organizovao napad na Markale*  
 • <https://web.archive.org/web/20200208174713/https://mondo.rs/Info/EX-YU/a857401/Alija-Izetbegovic-naredionapad-na-Markale.html>  
 (Arkivuar më 08.02.2020.)
- 76** Novosti.rs. *Hag priznao: Muslimani gadali sebe*, Beograd.  
 • <https://web.archive.org/web/20200208174930/https://www.novosti.rs/vesti/naslovna/dosije/aktuelno.292.html:724-082-Hag-priznao-Muslimani-gadjali-sebe>  
 (Arkivuar më 08.02.2020.)
- 77** Moll, Nicolas. 2015. *Između sjećanja, poricanja i zaborava - o kulturi sjećanja u BiH 20 godina nakon rata*. Friedrich Ebert Stiftung. Sarajevo.
- 78** Numri i viktimave në rrethimin e Sarajevës nga prilli 1992 deri në dhjetor 1995 . Tabeau, Eva; Bijak, Jakov; Lončarić, Neda. 2013. *Studim mbi shkallën e vdekshmërisë bazuar në tetë burime kryesore të të dhënave*. Departamenti Demografik, Prokuroria e ICTY. Den Haag.



**79** Marković, Tomislav. *Opsada Sarajeva: Četvrt veka laži, ćutanja i poricanja*. Mostar.  
• <https://web.archive.org/web/20200208175201/https://www.tacno.net/beograd/opsada-sarajeva-cetvrt-veka-lazicutanja-i-poricanja/>  
(Arkivuar më 08.02.2020.)

**80** *Najtužnija priča o velikoj ljubavi: Boško i Admira*.  
• <http://istinitotrebinje.com/najtuznija-prica-o-velikoj-ljubavi-boskoadmira/>  
(Arkivuar më 25.9.2019.)

**81** *Na današnji dan pre 24 godine poginuli su "sarajevski Romeo i Julija", Srbin Boško Brkić i muslimanka Admira Ismić*. Mondo.  
• <https://web.archive.org/web/20200208181154/https://mondo.rs/Info/EX-YU/a1104923/Bosko-i-AdmiraSrbin-i-muslimanka-umrli-zagrljeni.html>.  
(Arkivuar më 08.02.2020.)

**82** Perviz, Izet. *Ne razdvajajte Olgu i Suadu*. Sarajevo.  
• <https://web.archive.org/web/20200208180727/http://balkans.aljazeera.net/blog/ne-razdvajajte-olgu-i-suadu>  
(Arkivuar më 08.02.2020.)

## ■ Prijedor

**83** Boračić-Mršo, Selma. *Bijele trake: Sjećanje i opomena savjesti*.  
• <https://web.archive.org/web/20200208180656/https://www.slobodnaevropa.org/a/dan-bijelih-traka/29259524.html>  
(Arkivuar më 08.02.2020.)

**84** Documenta. *Prijedor dvadeset i dvije godine poslije - Bijele trake*. Zagreb.  
• <https://web.archive.org/web/20200208180144/https://www.documenta.hr/en/prijedor-dvadeset-i-dvije-godineposlije-bijele-trake.html>  
(Arkivuar më 08.02.2020.)

**85** Stjepanović, Nemanja. *Brisanje sećanja na ubijenu decu Prijedora*. Beograd.  
• <https://web.archive.org/web/20200208180115/http://www.hlc-rdc.org/?p=32078>  
(Arkivuar më 08.02.2020.)

**86** Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë për ish Jugosllavinë. 2003. *Aktgjykimi i dhomës gjyqësore në çështjen Stakić*. Den Haag.

**87** Bosnjaci.net. 31. Maj - Svjetski dan bijelih traka.  
• <http://web.archive.org/web/20200208210309/http://www.bosnjaci.net/prilog.php?pid=45842>  
(Arkivuar më 08.02.2020.)

**88** Radio Feral. *Sjećanje na genocid u Prijedoru: Poziv Kalesijcima da 31. maja obilježe Dan bijelih traka*. Kalesija.  
• <https://web.archive.org/web/20200208213400/https://radio-feral.ba/bih/sjecanje-na-genocid-u-prijedoru-pozivkalesijcima-da-31-maja-obiljeze-dan-bijelih-traka>  
(Arkivuar më 08.02.2020.)

**89** Historija.info. *Koncentracioni logor Omarska – Prijedor*.  
<https://web.archive.org/save/http://historija.info/2019/05/24/koncentracioni-logor-omarska-prijedor/> (Arkivuar më 08.02.2020.)

**90** Historija.ba. *Otkriven logor Trnopolje.*

- <https://web.archive.org/web/20200208210713/http://www.historija.ba/d/367-otkriven-logor-trnopolje/>  
(Arkivuar më 08.02.2020.)

**91** Faktor.ba. *Obilježena 26. godišnjica od zločina: Kroz logor "Keraterm" prošlo više od 3.000 ljudi.* Sarajevo.

- <https://web.archive.org/web/20200208212927/https://faktor.ba/vijest/obiljeena-26-godinjica-od-zloina-kroz-logorkeraterm-prolo-vie-od-3-000-ljudi-304771>  
(Arkivuar më 08.02.2020.)

**92** Në dispozicion në:

- <https://web.archive.org/web/20200208214444/https://pod2.stat.gov.rs/ObjavljenePublikacije/G1991/pdf/G19914026.pdf>  
(Arkivuar më 08.02.2020.)

**93** Radaković, Boris. *Prilog istraživanju građanskog rata u Prijedoru 1992.*

- [https://web.archive.org/web/20200208214053/http://srbiubih.com/prilog-istrazivanju-gradjanskog-rata-u-prijedoru1992/?lang=lat%23\\_ftn5](https://web.archive.org/web/20200208214053/http://srbiubih.com/prilog-istrazivanju-gradjanskog-rata-u-prijedoru1992/?lang=lat%23_ftn5)  
(Arkivuar më 08.02.2020.)

**94-111** Ibid.

**112** Radaković, Boris. *Jer me se tiče 03: Nije bilo genocida u Prijedoru.*

- <https://web.archive.org/web/20200208214630/https://www.frontal.rs/jer-me-se-tice-03-nije-bilo-genocida-uprijedoru/>  
(Arkivuar më 08.02.2020.)

**113** Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë për ish Jugosllavinë - 31. 07.2003. *Aktgjykimi i Milomir Stakićit.* IT-97-24-T. Den Haag. Fq. 68-84.

**114-118** Ibid.

**119** Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë për ish Jugosllavinë. 2003. *Aktgjykimi i Milomir Stakićit.* IT-97-24-T. Den Haag. Fq. 128.

**120** The Guardian. *Shame of Camp Omarska.* London.

- <https://web.archive.org/web/20200208215740/https://www.theguardian.com/itn/article/0,,191240,00.html>  
(Arkivuar më 08.02.2020.)

**121** Tokača, Mirsad. 2012. *Bosanska knjiga mrtvih: Ljudski gubici u Bosni i Hercegovini 1991-1995.* Istraživačko dokumentacioni centar Sarajevo. Sarajevo.

**122** Purić, Amir. *Prijedor: zajednička borba građanskih aktivista i povratnika za univerzalnu pravdu.*

- <https://web.archive.org/web/20200208215039/https://www.dw.com/bs/prijedor-zajedni%C4%8Dka-borbagra%C4%91anskih-aktivista-i-povratnika-za-univerzalnu-pravdu/a-44957527>  
(Arkivuar më 08.02.2020.)



# KROACIA / SERBIA

# 4

KRO / SER / Vukovar / 15–18 korrik

145



**90** Historija.ba. *Otkriven logor Trnopolje.*

• <https://web.archive.org/web/20200208210713/http://www.historija.ba/d/367-otkriven-logor-trnopolje/>  
(Arkivuar më 08.02.2020.)

**91** Faktor.ba. *Obilježena 26. godišnjica od zločina: Kroz logor "Keraterm" prošlo više od 3.000 ljudi.* Sarajevo.

• <https://web.archive.org/web/20200208212927/https://faktor.ba/vijest/obiljeena-26-godinjica-od-zloina-kroz-logorkeraterm-prolo-vie-od-3-000-ljudi-304771>  
(Arkivuar më 08.02.2020.)

**92** Në dispozicion në:

• <https://web.archive.org/web/20200208214444/https://pod2.stat.gov.rs/ObjavljenePublikacije/G1991/pdf/G19914026.pdf>  
(Arkivuar më 08.02.2020.)

**93** Radaković, Boris. *Prilog istraživanju građanskog rata u Prijedoru 1992.*

• [https://web.archive.org/web/20200208214053/http://srbiubih.com/prilog-istrazivanju-gradjanskog-rata-u-prijedoru1992/?lang=lat%23\\_ftn5](https://web.archive.org/web/20200208214053/http://srbiubih.com/prilog-istrazivanju-gradjanskog-rata-u-prijedoru1992/?lang=lat%23_ftn5)  
(Arkivuar më 08.02.2020.)

**94-111** Ibid.

**112** Radaković, Boris. *Jer me se tiče 03: Nije bilo genocida u Prijedoru.*

• <https://web.archive.org/web/20200208214630/https://www.frontal.rs/jer-me-se-tice-03-nije-bilo-genocida-uprijedoru/>  
(Arkivuar më 08.02.2020.)

**113** Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë për ish Jugosllavinë - 31. 07.2003. *Aktgjykimi i Milomir Stakićit.* IT-97-24-T. Den Haag. Fq. 68-84.

**114-118** Ibid.

**119** Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë për ish Jugosllavinë. 2003. *Aktgjykimi i Milomir Stakićit.* IT-97-24-T. Den Haag. Fq. 128.

**120** The Guardian. *Shame of Camp Omarska.* London.

• <https://web.archive.org/web/20200208215740/https://www.theguardian.com/itn/article/0,,191240,00.html>  
(Arkivuar më 08.02.2020.)

**121** Tokača, Mirsad. 2012. *Bosanska knjiga mrtvih: Ljudski gubici u Bosni i Hercegovini 1991-1995.* Istraživačko dokumentacioni centar Sarajevo. Sarajevo.

**122** Purić, Amir. *Prijedor: zajednička borba građanskih aktivista i povratnika za univerzalnu pravdu.*

• <https://web.archive.org/web/20200208215039/https://www.dw.com/bs/prijedor-zajedni%C4%8Dka-borbagra%C4%91anskih-aktivista-i-povratnika-za-univerzalnu-pravdu/a-44957527>  
(Arkivuar më 08.02.2020.)

# KROACIA / SERBIA



—  
145  
—







Grupi ynë, i formuar në konferencën e parë në Beograd në fund të marsit 2018, u emërua Tesla.<sup>123</sup> Vendors për këtë emër sepse shërben si një lloj simbol i mosmarrëveshjeve midis Kroacisë dhe Serbisë dhe në një botë më të mirë mund të ishte diçka që na lidh.

Nikola Tesla sigurisht nuk është pika e vetme e mosmarrëveshjeve midis vendeve tona. Kështu, në punën tonë, kemi trajtuar mosmarrëveshjet në lidhje me ngjarjet thelbësore në luftën e viteve 90-të. Dy ngjarjet në të cilat u përqëndruam ishin Beteja e Vukovarit dhe Operacioni “Stuhia” (“Oluja”). Fakti është që të dy vendet kanë narrativat e tyre për këto ngjarje dhe i promovojnë ato në dobi të atyre në pushtet dhe thellojnë përçarjet midis popujve. Ne zgjodhëm Vukovarin pasi shënoi fillimin e luftës në Kroaci dhe pësoi më shumë dëme. Operacioni “Stuhia” ishte një zgjedhje logjike pasi shënoi fundin e luftës dhe është temë që shkakton më së tepërmi kundërthënie, veçanërisht për sa i përket Tribunalit Ndërkombëtar të Drejtësisë për ish-Jugosllavinë.

Si pjesë e hulumtimit të këtyre ngjarjeve, vizituam Vukovarin (korrik 2018) dhe Kninin (gusht 2018). Përmes procesit të krijimit të këtyre rrëfimeve, kuptuam se këto tema nuk janë vetëm e kaluara, por edhe e tashmja. Kështu që planifikuam udhëtimin për në Knin në kohën kur do të shmangnim festimin e “Stuhisë” dhe kështu bezditë e mundshme. Kjo është arsyeja pse duam që narrativat tona të kontribuojnë në krijimin e një dialogu midis Kroacisë dhe Serbisë, dhe të sigurojë motivimin për zgjidhjen e çështjeve të nxehta për historinë dhe të ardhmen tonë të përbashkët.

Shënim: dëshirojmë të theksojmë se kur flasim për narrativën “serbe” ose “kroate”, bëhet fjalë për narrativën e cili është prezente në masën

më të madhe brenda shteteve dhe mediave; në të njëjtën kohë, nuk duam të lëmë pas dore perceptimin e pakicave të të dy vendeve.

## **Vukovari:** **Narrativa kroate**

---

### *Qyteti hero*

Beteja e Vukovarit u zhvilluar për 87 ditë, në mes gushtit dhe nëntorit 1991. Ishte konflikti i parë serioz midis palës serbe dhe kroate që nga shpallja e pavarësisë së Kroacisë në korrik të vitit 1991. Palët në konflikt ishin Armata Popullore Jugosllave (APJ) dhe njësitë paramilitare serbe, nga njëra anë, dhe Trupat e Gardës Kombëtare dhe Ushtria Kroate, nga ana tjetër. Gjatë një periudhe prej 87 ditësh, qyteti i Vukovar u shkatërrua pothuajse plotësisht dhe pësoi dëme të mëdha materiale. Spitali i Vukovarit, i cili është ende një nga simbolet e Luftës Atdhetare, ishte vendi i vuajtjeve më të mëdha të popullsisë. Pak para përfundimit të betejës, në nëntor 1991, rreth 400 civilë kroatë u nxorrën nga spitali. Nga ai numër, 260 u dërguan në fermën Ovçara afër Vukovarit, ku u vranë brutalisht nga njësitë paramilitare serbe. Kështu përfundoi beteja për Vukovarin.

Duke analizuar librat e ndryshëm kroatë për klasën e 8-të të shkollës fillore, vërehet e njëjta formë - fillon me një përshkrim të ngjarjeve të 2 majit 1991 në Borovo Selo, vrasjen e 12 oficerëve të policisë dhe Josip Joviçit dhe më pas paraqesin agresionin serb në verën e vitit 1991 dhe përfundon me rënien e Vukovarit dhe një përshkrim të ngjarjeve në Ovçara. Për autorët e librit shkollor, Vukovari është simbol i rezistencës ndaj agresionit serbomadh, secili përmban fotografi thuajse identike të qytetit të shkatërruar ose të kullës së ujit, imazhe të refugjatëve kroatë që largohen nga qyteti, kurse përmenden edhe, në mënyrë thuajse identike, mbrojtësit i guximshëm kroatë që i rezistuan sulmeve të APJ-së për një kohë të gjatë dhe vdiqen duke mbrojtur shtetin kroat.<sup>124</sup> Tekstet shkollore për klasën e 4-të të shkollës së mesme kanë një histori thuajse identike. Teksti shkollor i botuar nga Meridijani në vitin 2004 është i vetmi me një nëntitull të plotë kushtuar Vukovarit, ku rrjedha e betejës së Vukovar është përshkruar në detaje, por Vukovarit gjithmonë mbetet viktimë e “agresionit serbomadh”.<sup>125</sup>



Figura më e rëndësishme e pavarësisë kroate dhe politikani më i famshëm kroat i viteve 90-të ishte Franjo Tugjman. Nga seria e fjalimeve të tij politike për Vukovarin, duhet të veçohet fjalimi nga Spliti, më 26 gusht 1995. Në një moment, Tugjman pyet njerëzit e mbledhur: “Çfarë tjetër duhet t’ju premtoj?” Të gjithë fillojnë të brohorasin: “Vukovar, Vukovar, Vukovar!”, pas kësaj Tugjman shton: “Kuptohet, para së gjithash Vukovari, ai simbol i rezistencës kroate në mbrojtje të shtetit të krijuar të pavarur kroat, Vukovari dhe Sllavonia e pasur lindore dhe Baranja, sepse Kroacia ishte dhe do të mbetet një vend i Danubit”.<sup>126</sup> Qytetarët janë të bindur që Vukovari ka qenë gjithmonë qytet kroat dhe se është i okupuar dhe që Tugjmani dhe udhëheqja politike kroate do t’ja kthejnë atë popullit të vetë. Në një fjalim tjetër, dhënë nga Tugjmani në Vukovar në vitin 1997, retorika ishte zbutur: “E ardhmja jonë në Vukovar, në këtë simbol të vuajtjes kroate, rezistencës kroate, aspiratave kroate për liri, dëshirës kroate për t’u kthyer në kufijtë e saj lindor, në Danub për të cilin këndohet në himnin kroat, kjo është simboli jonë, vendosmëria jonë, që ne me të vërtetë duam paqe, pajtim, që duam të krijojmë besim për një jetë të qëndrueshme, në mënyrë që në të ardhmen të mos lejojmë kurrë më atë që na ndodhi”.<sup>127</sup> Vukovari mbetet një qytet kroat, i cili ishte i pushtuar për katër vjet, dhe tani më në fund i takon popullit kroat që thjesht dëshiron paqen.



Gjatë betejës dhe pas rënies, mediat kroate ishin përplot me tituj për Vukovarin, qytetin hero, viktimat dhe të plagosurit. Përmes titujve “Vukovari i plagosur”, mediat krijuan në masë të madhe dhe konfirmuan të drejtën kroate për Vukovarin.<sup>128</sup> Njëkohësisht, disa kroatë fajësojnë autoritetet kroate për rrënien e Vukovarit dhe i akuzojnë ata se ishin të gatshëm të sakrifikonin qytetin për hir të pavarësisë së Kroacisë.<sup>129</sup>



Deklarata e Luftës Atdhetare u miratua në vitin 2000 nga Kuvendi shtetëror kroat. Pjesa interesante është kjo në vijim: “Republika e Kroacisë zhvilloi një luftë të drejtë dhe legjitime, mbrojtëse dhe çlirimtare, jo agresive dhe pushtuese kundër kujtdo, në të cilën mbrojti territorin e vetë nga agresioni serbomadhbrenda kufijve të njohur ndërkombëtarisht”.<sup>130</sup> Në këtë mënyrë, një institucion zyrtar i Republikës së Kroacisë konfirmoi agresionin serbomadhbrenda si dhe faktin që Kroacia po zhvillonte vetëm një luftë mbrojtëse dhe këtë përmes një dokumenti zyrtar.

## **Vukovari: Narrativa serbe**

---

### *Stalingradi kroat*

Beteja për Vukovarin dhe veprimet e luftës që ndodhën atje u përdorën për të arritur qëllimet politike të qeverisë së atëhershme. Raportimi i mediave në vitin 1991 tregoi se me krijimin e një shteti të pavarur kroat, përsëri u krijuar shteti i ustashëve, i cili dëshironte dhe po përgatiste një gjenocid të ri kundër serbëve.

Gjatë analizës së Vukovarit, është vërejtur se në librin shkollor “Historia” të botuar nga Fresco, përmendet se për Vukovarin janë zhvilluar beteja të ashpra ndërsa Ovçara nuk përmendet fare.<sup>131</sup> Në tekstin “Historia” të publikuar nga Enti për Tekste dhe Mjete Shkollore, theksohet që “aspirata e Kroacisë për pavarësi dhe shtetësi u përhap përtej kufijve të saj”, ndërsa betejat për Vukovar, Ovçarë dhe Shkabërnja thjesht numërohen në fund të faqeve të librave shkollor ku ceken ngjarjet e vitit 1991, pa shpjegime dhe kontekst shtesë.<sup>132</sup> Përfundimi është që në tekstet shkollore serbe të historisë për Vukovarin nuk shkruhet mjaft dhe manipulohen përmbajtjet.

Deklaratat e politikanëve e kanë përcjellë këtë qasje, kurse disa individë të caktuar, siç është Dr. Vojislav Šešel, kanë qenë më të qartë në shprehjen e pikëpamjeve të tyre. Në shtator të vitit 1991, ai tha, “kroatët mund të shkojnë, por ata nuk mund të marrin me vete asnjë territor serb”.<sup>133</sup>

Gjatë betejës për Vukovar, mediat serbe, si televizive ashtu edhe e shtypura, publikuan lajme të ndryshme që tregonin synimet e kroatëve për të shfarosur serbët nga ajo zonë. Më 20 nëntor 1991, Ditari i Radios dhe Televizionit serb transmetoi lajmin për 40 fëmijë serbë të masakruar në bodrumin e një kopshti fëmijësh në periferi të Vukovarit në vendin Borovo Selo. Lajmi tronditi dhe acaroi publikun vendas dhe të huaj, dhe pasi u kontrollua nga ekspertë, lajmi u mohua pas 24

orësh.<sup>134</sup> Mediat e shkruara më të lexuara, siç janë Veçernje novosti dhe Politika, u përpoqën të ngrisin vetëdijen e qytetarëve të Serbisë për vuajtjet e ushtarëve të APJ-së dhe krimet kundër popullatës serbe duke raportuar për luftën gjatë betejës për Vukovar. Disa prej titujve janë “Vukovari i çliruar”, “Ushtria dhe mbrojtja territoriale pastrojnë fortesat e fundit të ustashave në qendër të qytetit”, “Qeveria Kroate kërcënon me masakrimin e dhjetëra mijëra njerëzve”, “Ustashat shtiren si të sëmurë”, “Krimet para syve të botës”, “Dje ra Stalingradi kroat”, dhe të ngjashme.<sup>135</sup>

Përveç viktimave kroate në Vukovar, të cilat vështirë se përmenden në Serbi, dihet që krime u kryen edhe kundër popullatës serbe në verën e vitit 1991, para fillimit të konfliktit. Bëhet fjalë për vrasjet, torturat dhe shkatërrimin e pasurisë së dhjetëra qytetarëve të Vukovarit me kombësi serbe. Askush nuk ka dhënë përgjegjësi për ato krime kurse janë ngritur disa kallëzime penale kundër Tomislav Merčepit, komandant i Gardës Kombëtare në Vukovar. Sidoqoftë, kundër tij nuk është ngritur asnjë akuzë dhe deri më tani nuk ka pasur drejtësi për viktimat.<sup>136</sup>

Brenda diskursit publik serb, beteja për Vukovar nuk është aq e pranishme. Vukovari përmendet si një shembull i vuajtjeve serbe, si në vitet 90-të ashtu edhe sot. Edhe sot, banorët serbë trajtohen si qytetarë të klasit të dytë, në masën që u mohohet e drejta ligjore për mbishkrime në alfabetin e tyre.



## **Vukovari:** **Narrativa e përbashkët**

### *Sinonim i ndarjes*

153

Krijimi i një baze për ndërtimin e një narrativi të përbashkët të luftës në Vukovar është një veprim i rëndësishëm për atë që përcakton më qartë domethënien reale të fakteve historike dhe rolin e tyre në ndërtimin e mëtejshëm të identitetit kombëtar, përkatësisht në masën që lejon hedhjen e themeleve më të qëndrueshme kombëtare për të ardhmen. Kultura e kujtesës e cila shkon në favor të qëllimit të ndërtimit dhe ruajtjes së identitetit kombëtar në vendet e ish-Jugosllavisë është në një pozitë të palakmueshme, që për pasojë ka një qëndrim arbitrar ndaj fakteve historike dhe instrumentalizim e të dhënave historike për hir të synimeve dhe interesave aktuale politike. Një atmosferë e tillë e bën të vështirë arritjen e një narrative që nuk do të ishte e ndarë dhe qëllimi i të cilës do të drejtohej drejt një kuptimi të përgjegjshëm të së kaluarës dhe punës së përbashkët në marrëdhëniet që ofrojnë mundësi më të mëdha të bashkëpunimit.

Narrativa e përbashkët e luftës në Vukovar kërkon një përcaktim të saktë të distancës kohore të ngjarjeve me qëllim të ndarjes të së kaluarës nga e tashmja dhe vendosjen e një qëndrimi më korrekt ndaj të kaluarës kombëtare që do të mundësonte ekzistencën e vlerave morale më të përshtatshme për zhvillim kombëtar dhe personal. Një narrative e tillë për Vukovarin nisët nga fakti se beteja për Vukovarin paraqet një nga konfliktet dhe vuajtjet më të mëdha të dy palëve kundërshtarë gjatë shpërbërjes së Jugosllavisë. Palët në konflikt ishin Armata Popullore Jugosllave (JNA) dhe njësitë paramilitare serbe, nga njëra anë, dhe Garda Kombëtare dhe Trupat e Ushtrisë Kroate, nga ana tjetër. Konflikti zgjati nga 24 gusht deri më 20 nëntor 1991 dhe shkaktoi të dy palët i gjejnë tek kërcënimet dhe tensionet e shkaktuara nga aspiratat në rritje të nacionalizmit dhe interesat e kundërshtarëve. Të dy palët e perceptojnë veten si viktimë të qëllimeve të motivuara nacionaliste të kundërshtarëve që përbëjnë një kërcënim absolut për

qytetarët e tyre. Viktimizimi nga të dy palët funksionon si mjet për të justifikuar përgjegjësitë dhe për të hequr fajin, dhe nën presionin e kësaj e vërteta është shtrembëruar plotësisht dhe përsëri provokohen tensionet në nivel etnik, gjë që ndërlikon më tej pasojat e luftës dhe rrethanat aktuale të të dy vendeve.

Narrativi serb e përcakton sulmin e Armatës Popullore Jugosllave ndaj Vukovarit si një veprim të ligjshëm, duke iu referuar faktit se Armata Popullore Jugosllave ishte formacioni i vetëm ushtarak i ligjshëm në shërbim të mbrojtjes së Jugosllavisë, i cila kishte detyrim moral të mbroj qytetarët e saj. Narrativa kroate e konsideron rrethimin e Armatës Popullore Jugosllave plotësisht të paligjshme sipas deklaratës së pavarësisë së Republikës së Kroacisë në vitin 1991. Trajtimi i shpalljes së pavarësisë së Republikës së Kroacisë si një veprim i ligjshëm është i pranishëm në narrativin kroat, ndërsa narrativi serb merr një pozicion krejt tjetër. Në atë mënyrë, të dy palët i trajtojnë lëvizjet e kundërshtarit si jolegjitime dhe kombëtarisht kërcënuese. Sidoqoftë, ne nuk kemi aktgjykime për krimet kroate kundër serbëve në Vukovar dhe nga ana tjetër, pala kroate i konsideron aktgjykimet për krimet dhe vuajtjet e luftës në Vukovar si të paplota, duke konsideruar që pala serbe nuk e ka pranuar sa duhet fajin e vetë.

---

154

---

Interpretimet e tilla të polarizuara të ngjarjeve çojnë në keqkuptim të plotë reciprok dhe neglizhencë të shkatërrimit shoqëror si pasojë e luftës. Fakti është që Vukovari u shkatërrua dhe marrëdhëniet fqinjësore të bashkëqytetarëve të kombësive të ndryshme u rrënuen plotësisht, duke e lënë të gjallë traumën e luftës përmes kujtimit të vuajtjeve dhe të vdekurve pa një mbështetje të madhe dhe sistematike në marrjen e një qëndrimi më të dobishëm ndaj së kaluarës. Narrativi i përbashkët, në përputhje me rrethanat, kërkon përgjegjshmëri dhe trajtim të krimeve sipas ligjit pa përjashtim për të dy palët.

Sot, Vukovari është dëshmi se nuk ka një narrativë të përbashkët, ashtu siç nuk ka interes për ta krijuar atë. Kuptimi rrënjësor i ndryshëm i ngjarjeve në Vukovar gjatë luftës reflektohet më së shumti në arsim, i cili ndahet sipas përkatësisë etnike. Shkollat kroate mësojnë dhe promovojnë narrativen kroate të qytetit hero nga njëra anë, ndërsa shkollat serbe mësojnë narrativen serbe të qytetit të humbur, duke thelluar konfliktin ekzistues. Në bazë të shembullit të iniciativës norvegjeze për krijimin e një shkolle ndërkombëtare, për të cilën Norvegjia dhuroi 1.3 milion euro, dhe e cila u bojkotua nga qeverisja e Vukovarit nga të dy palët,<sup>137</sup> përfundojmë se asnjëra palë

nuk është e gatshme të shkojë përtej bindjeve të veta për këtë ngjarje edhe pse në këtë proces pësojnë të pafajshmit - në këtë rast fëmijët. Të njëjtin përfundim mund të nxjerrim nga çdo përpjekje e mëparshme integruese në atë zonë, siç është vendosja e tableva dygjuhëshe latine dhe çirilike në institucionet e Vukovarit,<sup>138</sup> gjë që rezultoi me zemërimin e veteranëve kroatë dhe mungesën e reagimit nga udhëheqja politike. Për të kuptuar pse është kjo kështu, duhet të kuptojmë se interesi më i madh që partia qeverisëse ka për Vukovarin është fuqia e tij ideologjike, domethënë mundësia e drejtimit të gishtit tek fajtorët në të dy anët e këtij konflikti.

Grupi i të rinjve që kanë punuar në këtë tregim beson që Vukovari është ende një instrument politik, për palën kroate provë heroizmi dhe paprekshmërie të viktimës kroate, për palën serbe dëshmi e nacionalizmit kroat dhe ustashizimit, dhe se asnjë nga narrativat nuk kontribon në asgjë përveç në forcimin e nacionalizmit nga të dy palët. E vërteta e parë e përbashkët është se viktimat e viteve 1990 janë të njëjta me viktimat sot dhe ato janë vetë qytetarët e Vukovarit, pa marrë parasysh kombësinë e tyre.





## ***Oluja:*** ***Narrativa kroate***

---

### *Festimi i fitores dhe mirënjohjes për atdheun*

Termi Operacioni “Stuhia” në Kroaci pak kë lë indiferentë. Ajo është mbi të gjitha një simbol i fitores, krenarisë dhe përfundimit të suksesshëm të Luftës Atdhetare. Me operacionet ushtarako-policore “Bljesak” (“Vetëtimja”) dhe “Oluja” (“Stuhia”), ushtria kroate çliroi një pjesë të konsiderueshme të territorit të shtetit kroat, i cili deri në atë kohë ishte nën pushtimin e parastetit të Republikës Serbe të Krajinas (RSK).

157

RSK u formua si rezultat i rebelimit të pjesës së konsiderueshme të popullatës serbe në Kroaci. Ata ju bashkuan politikave të presidentit serb Slobodan Miloseviq, i cili është përpjekur të imponojë dominimin serb mbi republikat e tjera jugosllave që nga vitet 90-të. Në vitin 1990, pasi Bashkimi Demokratik Kroat (HDZ), i udhëhequr nga Franjo Tugjman, fitoi zgjedhjet e para shumëpartiake në Kroaci, udhëheqja serbe vendosi që serbët në Kroaci duhet të marrin kontrollin mbi pjesë të territorit kroat. Kështu, në vitin 1990, u krijua Zona Autonome Serbe (SAO) Krajina me seli në Knin. Që nga viti 1991, Armata Popullore Jugosllave (JNA) ja ka mbajtur hapur anën rebelëve serbë, duke i ndihmuar ata të pushtojnë territorin kroat. Në fund të vitit 1991, në zonat nën kontrollin e APJ-së dhe rebelëve serbë, u formua Republika Srpska Krajina me selinë në Knin. Në shpallje, territori i saj ishte kryesisht “i pastruar etnikisht” nga kroatët. Rebelët serbë do të vazhdojnë të dëbojnë popullsinë e mbetur. Grabitja dhe persekutimi hodhën themelet e RSK-së. Drejtuesi i Gardës Vullnetare Serbe, Željko Ražnatović-Arkan, njëherë tha: “Kuptoni që nëse duhet, ne do të shkojmë deri në Berlin. Kështu që, çdo qytet i tyre do të digjet, madje edhe Zagrebi”,<sup>139</sup> duke konfirmuar qëllimet e agresorit serb. Kroacia, ndërkohë, ka shpallur pavarësinë dhe ka marrë njohje ndërkombëtare. Zona e RSK ishte vendosur nën kontrollin e Forcave Mbrotjtëse të Kombeve të Bashkuara (UNPROFOR). Ato duhej të

mbanin armëpushimin dhe të mundësonin një zgjidhje paqësore të konfliktit midis Kroacisë dhe rebelëve serbë, për çfarë nuk patën sukses as pas shumë vitesh. RSK ka ekzistuar deri në vitin 1995 dhe në këtë kuptim viti i përmendur sigurisht që paraqet një pikë kthesë në mbrojtjen e sovranitetit kroat. Operacioni “Vetëtima” çliroi Sllavoninë Perëndimore, kurse operacioni “Stuhia” Dalmacinë Veriore me Kninin, Likën, Kordunin dhe Banovinën. Sllavonia Lindore, Baranja dhe Srijemi Perëndimor, të cilat u kthyen brenda territorit kroat përmes riintegritimit paqësor në vitin 1998, mbetën jashtë juridiksionit të Kroacisë. Rëndësia e “Stuhisë”, natyrisht, pasqyrohet në faktin se mundësoi përfundimin e luftës katër-vjeçare.

Operacioni “Stuhia” gjithashtu ka shkaktuar polemika të madhe. Sot në Kroaci, ekziston mendimi që popullata serbe u largua vullnetarisht nga zonat e okupuara, dmth territori i RSK, megjithëse Serbia beson se Kroacia kreu “spastrim etnik” përmes aksionit “Stuhia”. Disa autorë kroatë e barazojnë okupimin serb të Srebrenicës me “Stuhinë” dhe pohojnë: “Mladiqi në Srebrenicë, ‘Kalorësit e Stuhisë’ në Krajina: cili është ndryshimi? Në llojin e veprimit nuk ka asnjë ndryshim, për numrat njerëzit do të argumentojnë deri në ditën e gjykimit”.<sup>140</sup>

Në të njëjtën kohë, disa mbrojnë idenë se rebelët serbë nuk janë aspak përgjegjës për luftën në Kroaci dhe se ata nuk donin të futeshin në shtetin e ri serb. Fajtorët kryesorë janë Presidenti serb Milošević dhe Presidenti kroat Tugjman, të cilët zhvilluan “luftë të dakorduar”. Kjo ide mbështetet nga deklarata e Vojislav Shesheli, i cili tha me një rast: “Edhe një gjë...Nëse e humbasim këtë luftë, ne do të qëndrojmë akoma në Beograd. Beogradin nuk do të na pushtojë, por çfarë do të bëni ju? Por çfarë do të bëni ju? Kapiten Dragani shkoi në Australinë e tij me aeroplanin e tij. Kurse ju? Çfarë do të bëni?”,<sup>141</sup> duke sqaruar se rebelët serbë janë viktima të liderëve nacionalistë.

Pohimet e tilla plotësisht injorojnë faktin që rebelët serbë nuk ishin të gatshëm të pranonin bashkëjetesën me kroatët në Kroaci, gjë që mund të konkludohet nga deklarata të tilla si: “Sepse e kam thënë dhe do ta them përsëri...nëse kjo Krajina do të jetë brenda Kroacisë, atëherë unë zhvendosem në Serbi, poshtë...”<sup>142</sup> Kur mirret parasysht largimi i serbëve nga RSK gjatë “Stuhisë”, duhet të kujtojmë se gati 100.000 serbë të Bosnjes pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Paqës të Dejtonit, lanë pjesë të Sarajevës që kishin qenë nën mbikëqyrjen e tyre.<sup>143</sup> Ajo zonë i shkoi Federatës së BiH dhe serbët pastaj u larguan, megjithëse ata nuk u detyruan drejtpërdrejt ta bëjnë këtë nga ndonjë



veprim ushtarak. Ashtu siç ishte e papranueshme që serbët nga RSK të njohin pushtetin kroat, kështu ishte e papranueshme edhe për serbët e Sarajevës të mos jetonin në Republikën Srpska.

A kreu Kroacia “spastrim etnik” të popullatës serbe në aksionet “Vetëtima” dhe “Stuhia”? Është e qartë se rebelët serbë në përgjithësi nuk donin të ishin nën sundimin kroat. Është gjithashtu e qartë që autoritetet e RSK planifikuan të evakuonin popullsinë para “Stuhisë”. Kjo i përshtatej udhëheqjes së atëhershme kroate si një zgjidhje për problemin e serbëve si një faktor që kërcënonte shtetin kroat. Populli kroat beson se nuk kishte “spastrim etnik” në “Stuhi”. Publiku Kroat në përgjithësi nuk vë në dyshim se u kryen krime gjatë “Stuhisë”, por ato interpretohen si incidente të izoluara nga përfaqësues të niveleve të larta politike. Për shembull, parlamenti kroat miratoi një Deklaratë që thotë: “të bashkuar në dënimin e çdo krimi dhe të gjitha krimeve që kanë ndodhur me të vërtetë gjatë dhe pas operacioneve “Vetëtima” dhe “Stuhia”, viktimat të të cilave, për fat të keq – si zakonisht në luftëra – ishin civilët e pafajshëm dhe të pafuqishëm”.<sup>144</sup>

Po kështu, aktet e tilla mund të konsiderohen pasojë e agresionit kundër Kroacisë, që kanë rrënuar marrëdhëniet Kroaci-Serbi, dhe rrjedhimisht të dëshirës për hakmarrje.



## ***Oluja:*** ***Narrativa serbe***

---

### *Oluja – krim i cili vazhdon*

Operacioni “Stuhia” është një aksion i përbashkët i ushtrisë dhe policisë së Republikës së Kroacisë me qëllim dëbimin e popullatës serbe nga territori i Republikës Serbe Krajina, e cila është krijuar në vitin 1991 dhe ka përfshirë pothuajse 20% të territorit ku serbët kanë qenë shumicë për shekuj me radhë. Stuhia përfaqëson “spastrimin më të madh etnik që nga Lufta e Dytë Botërore” për popullin serb, dhe si e tillë quhet një pogrom kundër serbëve. Në këtë mënyrë përshkruhet në librat e përdorur në shkolla, në retorikën e përdorur nga politikanët në fjalimet e tyre, si dhe shkrimet e mediave gjatë dhe pas operacionit “Stuhia”.

Për shembull, teksti shkollor i Entit për Tekstet dhe Mjetet Shkollore thotë se lufta në Kroaci përfundoi me aksionet Vetëtima dhe Stuhia, të cilat u mbështetën nga SHBA-të. Gjithashtu theksohet numri prej 300.000 serbëve të dëbuar nga territori i RSK. Ekziston gjithashtu një foto e kolonës së refugjatëve që lëvizin drejt Serbisë.<sup>145</sup> Në librin shkollor të botuar nga Fresco, lufta në Kroaci filloi me heqjen e popullit serb nga Kushtetuta e re kroate në dhjetor të vitit 1990, dhe thuhet se kjo kishte një ndikim vendimtar në fillimin e konfliktit të armatosur në Kroaci. Arsyeja është frika që popullsia serbe kishte për shkak të Luftës së Dytë Botërore dhe lëvizjes ustashe. Më tej thuhet se në fund të vitit 1990, populli serb në Kroaci “shpalli pavarësinë e territoreve në të cilat ata kishin jetuar me shekuj” dhe u përcaktuan të mbetet pjesë e Jugosllavisë. Plani Z4 përmendet në një fjali dhe në fund përmenden negociatat e dështuara në Gjenevë dhe operacioni “Stuhia”, që kreu spastrimin etnik të planifikuar të serbëve, ku thuhet se kishte mbi 200.000 njerëzve të dëbuar.<sup>146</sup>

Politikani që ishte sigurisht më i ashpëri në deklaratat e tij për Operacionin Stuhia dhe luftën në Kroaci është Vojislav Šešel, kryetar



i Partisë Radikale Serbe, i cili në programin e tij ka “ëndrrën për një Serbi të Madhe”, e cila përfshin, ndër të tjera, territorin e RSK-së. Gjatë tërë luftës në Kroaci ishte i pranishëm në skenën politike të RFJ-së. Përmes deklaratave të tij kundër Republikës së Kroacisë dhe kroatëve (shembulli 1, shembulli 2), si dhe djegia e flamurit shtetëror të Republikës së Kroacisë në tubimet e partisë së tij, fitoj reputacion si dhe aktakuza në Hagë. Ai u la i lirë më vonë.

Edhe 24 vjet më vonë, politikanët në Serbi, dhe mbi të gjitha Presidenti Aleksandar Vučić, një ish bashkëpunëtor i ngushtë i Vojislav Šešelj, e përdorin Operacionin Stuhia në fjalimet e tyre, duke aluduar se Serbia nuk do të lejojë kurrë një “Stuhi” të re, duke iu referuar situatës aktuale në Kosovë.<sup>147</sup>

Media, si arma më e madhe e çdo politikani, veçanërisht gjatë fazës së luftës, luajti një rol të madh në ngritjen e shovinizmit dhe urrejtjes ndaj fqinjëve. RFJ-ja e atëhershme nuk ishte përjashtim dhe mjeti kryesor propagandistik në duart e Slobodan Millosheviqit ishte Radio Televizioni i Serbisë, duke shtuar edhe mediat e shkruara si Večernje Novosti dhe Politika. Sidoqoftë, gjëja interesante është se Operacioni “Stuhia” nuk dukej të ishte aq interesante për mediat në Serbi dhe u duk sikur të gjithë u befasuan kur kolonat e serbëve nga Krajina arritën në Beograd. TANJUG madje nuk i publikoi fare lajmet për rënien e Kninit, kurse RTS këtë lajm e përmendi vetëm në minutën e njëzetë të Ditarit të saj.<sup>148</sup> Sot, “Stuhia” përdoret në media më shumë se në vitet e 90-të. Titujt në gazetat e përditshme si Informer, sidomos rreth 4 gushtit të çdo viti, mbajnë gjallë idenë e vuajtjeve serbe: “ORGJITË USTASHE NË MES TË DUBLINIT! Kroatët festuan “Stuhinë” në Irlandë, bërtitën VRIT SERBIN, POLICIA E KTHEU KOKËN ANASH!”, “USTASHËT FESTOJNË KRIMIN E TYRE: Kreu shtetëror në krye me Kolindën feston pogromin serb!” dhe të ngjashme.<sup>149</sup>

## ***Oluja:*** ***Narrativa e përbashkët***

---

### ***5 gusht: Dita e universeve paralele***

Operacioni Stuhia u krye nga ushtria dhe policia kroate nga 4 deri në 7 gusht 1995 me qëllim të riintegritit të territorit të Republikës Serbe të Krajinas në kufijtë e Republikës së Kroacisë. Kjo ngjarje paraqet gjithashtu përfundimin e luftës në Kroaci, e cila zgjati nga vera e 1991.

Granatimet e të gjitha pikave të rëndësishme të mbrojtjes së forcave serbe, veçanërisht qytetit të Kninit, filluan në 5 të mëngjesit me 4 gusht nga forcat e përbashkëta të ushtrisë dhe policisë së Republikës së Kroacisë. Gjatë katër ditëve të ardhshme, vlerësohet se 200.000, apo të paktën 180.000 serbë, u larguan nga territori i Kroacisë dhe ikën në Republikën Srpska, RFJ dhe vende të tjera.

Komandantët kryesorë të ushtrisë kroate ishin gjeneralët Ante Gotovina dhe Mladen Markač, të cilët u gjykuan përpara Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për ish-Jugosllavinë. Sidoqoftë, ky aktgjykim është ende një nga më kontraversët. Të dy gjeneralët u dënuan me 24 vjet burg në procedurën e shkallës së parë, vetëm për t'u liruar në apel me një shumicë të ngushtë votash të gjyqtarëve (3:2). Ekzistojnë 5 pika kryesore rreth së cilave janë kundërvënë prokuroria dhe mbrojtja, përkatësisht: 1) Qëllimi i Operacionit “Stuhia”, 2) Qëllimi i granatimit, 3) Vrasja e civilëve serbë, 4) Plaçkitja dhe shkatërrimi i pasurisë, 5) Parandalimi i kthimit.<sup>150</sup>

Ne do të përqendrohemi në pikën e parë të aktakuzës mbi qëllimin e Operacionit “Stuhia”, e cila është padyshim më e rëndësishmja sepse përmes saj mund të vëzhgohen narrativat mbizotëruese edhe tek pala kroate edhe serbe. Gjatë procedurës, prokuroria nuk e ka vënë absolutisht në dyshim legjitimitetin dhe të drejtën e Republikës së Kroacisë për të rikthyer një pjesë të territorit brenda kufijve të saj të njohur ndërkombëtarisht përmes veprimit të armatosur, megjithatë,

beson se ky qëllim u arrit përmes një ndërmarrje të përbashkët kriminale.<sup>151</sup> Me një pjesë të këtij qëndrimi të prokurorisë nuk do të pajtohej publiku në Serbi, i cili edhe krijon narrativen mbizotëruese për Operacionin Stuhia: që Republika e Kroacisë kishte të drejtën të rimarrë një pjesë të territorit, sepse narrativi mbizotërues është se territori i Republikës Serbe Krajina ka qenë me shekuj i banuar nga serbët dhe se RSK thjesht u përket atyre. Publiku kroat, nga ana tjetër, nuk do të pajtohej që popullata serbe ishte dëbuar, por se ata u larguan me vullnet të tyre të lirë dhe insiston në të drejtën e patjetërsueshme të Republikës së Kroacisë për të rimarrë kontrollin mbi territorin e saj. Aktgjykimi i formës së prerë në çështjen Gotovina dhe të tjerët, përcaktoj një numër të madh krimesh të kryera kundër civilëve dhe robërve të luftës. Fatkeqësisht, deri më tani ka vetëm një aktgjykim para gjykatave kroate të krimeve të luftës për periudhën e “Stuhisë”, megjithëse viktimat numërohen me qindra.<sup>152</sup>

Aktgjykimi, pas një procedure ankimore në të cilën u përcaktua se nuk kishte ndërmarrje të përbashkët kriminale dhe gjeneralët Gotovina dhe Markač u liruan, vetëm sa i ka forcuar më tej narrativat e të dy palëve. Në Serbi ai që “askush nuk do të mbahet përgjegjës për krimet e kryera kundër serbëve” dhe se “e gjithë bota është kundër Serbisë” dhe në Kroaci se “operacioni ushtarak-polikor ‘Stuhia’ është një fitore e madhe e Republikës së Kroacisë kundër agresorit serb” pavarësisht vrasjeve, plaçkitjeve dhe shkatërrimi të pasurisë ku numrat mbahen në minimumin e plotë. Përkundër kësaj, mediat kroate pranuan aktgjykimin dhe respektuan narrativën se viktimat ekzistonin, por që gjeneralët nuk ishin përgjegjës.<sup>153</sup>

Dallimet drastike në të kuptuarit e “Stuhisë” mund të shihen më së miri në përkujtimin e vetë ditës së saj, 5 gushtit, dhe në retorikën e propaganduar nga politikanët e të dy vendeve dhe faqet e para të gazetave të përditshme në atë kohë. Stuhia është një fenomen që përfaqëson dy esktrême të kundërta - për Kroacinë, 5 gushti festohet nën kujdesin e kreut të shtetit si festë e Ditës së Fitores dhe Mirënjohjes për Atdheun, e shoqëruar me koncerte të Marko Perković Thompsonit. Nga ana tjetër, Serbia përkujton 5 gushtin si një ditë zie dhe përkujtimi për viktimat e Stuhisë.

Ky interpretim i ngjarjeve në dy mënyra krejtësisht të ndryshme, si dhe neglizhenca e palës tjetër, sjell vetëm dëm midis popujve, ngritjen e nacionalizmit, shovinizmit dhe intolerancës, gjë që nuk shkon posaçërisht në dobi të të kthyerve që duhet të kenë frikë nga nxitja



nga të dy palët. Keqkuptimi dhe mos pranimi i fakteve – nga pala serbe që Republika Serbe Krajina ka kryer krime gjatë ekzistencës së saj katërvjeçare dhe nga ana kroate se gjatë dhe pas Operacionit “Stuhia” u vranë disa qindra civilë, disa mijëra shtëpi u dogjën dhe përmes masave të ndryshme administrative dhe burokratike kthimi u bë pothuajse i pamundur – është i dëmshëm dhe i rrezikshëm për çdo shoqëri demokratike që do duhej të shkonte drejt përballjes me të kaluarën dhe pajtimit.





## ■ Vukovari

**123** Nikola Tesla ishte një shkencëtar me origjinë serbe i lindur në Kroaci. Ai lindi në vitin 1856 në Smilan. Është i njohur për shpikjen e rrymës alternative. Ai e kaloi pjesën më të madhe të jetës së tij duke punuar në Shtetet e Bashkuara, ku vdiq në vitin 1943.

**124** Janë përdorur librat e publikuesve Školska knjiga, Alfa dhe Meridijani.

**125** Kolar-Dimitrijević, Mira i dr. 2004. *Povijest 4. Meridijani*. Zagreb. Fq. 234.-236.

**126** Franjo Tuđman. *Jedan od najdomljivijih govora prvog hrvatskog predsjednika dr. Franje Tuđmana*. Zagreb.

• <https://web.archive.org/web/20200208221747/https://hkm.hr/vijesti/domovina/video-jedan-od-najdomljivijihgovora-prvog-hrvatskog-predsjednika-dr-franje-tudmana/>  
(Arkivuar më 08.02.2020.)

**127** Fjalimi i Franjo Tugjmanit në Vukovar në vitin 1997.

**128** *Večernji list*. 04.11.1991. Fq. 17.

**129** Perković Paloš, Andrijana. *Kontroverze obrane i pada Vukovara*. Split.

• <https://web.archive.org/web/20200208222136/http://hu-benedikt.hr/?p=47930>  
(Arkivuar më 08.02.2020.)

**130** Zastupnički dom Hrvatskoga državnog sabora. *Deklaracija o domovinskom ratu*. Narodne novine. Zagreb.

• [https://web.archive.org/web/20200208222857/https://narodnenovine.nn.hr/clanci/sluzbeni/2000\\_10\\_102\\_1987.html](https://web.archive.org/web/20200208222857/https://narodnenovine.nn.hr/clanci/sluzbeni/2000_10_102_1987.html)  
(Arkivuar më 08.02.2020.)

**131** Ljušić, Radoš; Dimić, Ljubodrag. 2011. *Istorija za treći razred gimnazije prirodno-matematičkog smera i četvrti razred gimnazije opšteg i društveno jezičkog smera*. Freska. Beograd. Fq. 287.

**132** Đurić, Đorđe; Pavlović, Momčilo. 2011. *Istorija za treći razred gimnazije prirodno - matematičkog smera i četvrti razred opšteg i društveno - jezičkog smera*. Zavod za udžbenike i nastavna sredstva. Beograd. Fq. 249.



**133** *Slike i reči mržnje - Godina Druga*. 1999. Fondacija Pravo na sliku i reč; Radio B92. .  
• <https://www.youtube.com/watch?v=Vz7c3f6vHG0>  
(Arkivuar më 08.02.2020.)

**134** Excerpt from the film *Vukovar – poslednji rez*  
• <https://www.youtube.com/watch?v=SfQVoqorivk>  
(Qasur më 19.01.2019.)

**135** Galović, Ani. *Pad hrvatskog Staljingrada – ratno huškanje kao profesija ljudske zlobe u Vukovaru 1991*.  
• <https://web.archive.org/web/20200208224054/https://zutecizme.wordpress.com/2018/09/21/pad-hrvatskogstaljingrada-ratno-huskanje-kao-profesija-ljudske-zlobe-u-vukovaru-1991/>  
(Arkivuar më 08.02.2020.)

**136** SNV. *Ratni zločini nad Srbima 1991-1995: Vukovar*. Zagreb.  
• <https://web.archive.org/web/20190412142035/https://snv.hr/sto-radimo/zastita-prava/zrtve-rata-i-ratni-zlocini>  
(Arkivuar më 08.02.2020.)

**137** Dežulović, Boris. *Muzej zdravog razuma*. Zagreb. ,  
• <https://web.archive.org/web/20200208230034/http://hr.n1info.com/Kolumne/Boris-Dezulovic/a342220/KolumnaBorisa-Dezulovica-Muzej-zdravog-razuma.html>  
(Arkivuar më 09.02.2020.)

**138** Milaković, Srđan. *Zakon ulice' spriječio je dvojezičnost u Vukovaru*. Zagreb.  
• <https://web.archive.org/web/20200208225832/https://www.vecernji.hr/vijesti/srdjan-milakovic-vukovar-zakonulice-1214902>  
(Arkivuar më 08.02.2020.)

## ■ Oluja

**139** Vranjican, Pavle. 2003. *Komšije, dokumentarni video film o Domovinskom ratu*. Zagreb.

**140** Šnajder, Slobodan. 2003. *Zločin bez kazne. (prikaz knjige Mirić. Jovan. 2002. Zločin i kazna. Prosvjeta, Zagreb)*.  
Prosvjeta. Zagreb. godina 10 (35). br. 55 (665). Fq. 56-57.

**141** Kryetari i Partisë Radikale Serbe Vojislav Šešelji flet me rebelët serbë në Benkovac në 23 nëntor 1991. Vranjican, Pavle. 2003. *Komšije, dokumentarni video film o Domovinskom ratu*. Zagreb.

**142** Vranjican, Pavle. 2003. *Siniša Martić, četnička skupina ŠILTOVI Glina, dokumentarni video film o Domovinskom ratu*. Zagreb.

**143** Barić, Nikica. 2004. *Je li 1995. godine Hrvatska počinila 'etničko čišćenje' Srba?*. Časopis za suvremenu povijest. Br. 2. Fq. 441-461.

**144** Hrvatski Sabor. *Deklaracija o Oluji*. Zagreb.  
• [http://web.archive.org/web/20200208231549/https://narodnenovine.nn.hr/clanci/sluzbeni/2006\\_07\\_76\\_1787.html](http://web.archive.org/web/20200208231549/https://narodnenovine.nn.hr/clanci/sluzbeni/2006_07_76_1787.html)  
(Arkivuar më 09.02.2020.)

**145** Đurić, Đorđe; Pavlović, Momčilo. 2011. *Istorija za treći razred gimnazije prirodno - matematičkog smera i četvrti razred opšteg i društveno - jezičkog smera*. Zavod za udžbenike i nastavna sredstva. Beograd. p. 250

**146** Ljušić, Rađoš; Dimić, Ljubodrag. 2011. *Istorija za treći razred gimnazije prirodno - matematičkog smera i četvrti razred gimnazije opšteg i društveno jezičkog smera*. Freska. Beograd. Fq. 250.

**147** Dnevnik. *Vučić ne može bez Hrvatske, Srbima na Kosovu poručio: „Nećemo dozvoliti Oluju ni novi Bljesak”*. Zagreb.

- <https://web.archive.org/web/20200208232031/https://dnevnik.hr/vijesti/svijet/aleksandar-vucic-porcio-srbima-nakosovu-necemo-dozvoliti-nikakvu-oluju-ni-novi-bljesak---511619.html>  
(Arkivuar më 09.02.2020.)

**148** Rašuo, Ognjen. *Svijeće za žive i za mrtve: godišnjica Oluje u raljama politike*.

- <https://web.archive.org/web/20200208232258/https://www.vice.com/rs/article/vbv93x/svijece-za-zive-i-za-mrtvegodisnjica-oluje-u-raljama-politike>  
(Arkivuar më 09.02.2020.)

**149** Informer. (FOTO) *USTAŠKO ORGIJANJE USRED DABLINA! Hrvati slavili "Oluju" u Irskoj, urlali UBIJ SRBINA, POLICIJA OKRETALA GLAVU!*.

- <https://web.archive.org/web/20200208232715/http://informer.rs/svet/vesti/392105/fotoustasko-orgijanje-usred-dablina-hrvati-slavili-oluju-irskoj-urlali-ubij-srbina-policija-okretala-glavu>  
(Arkivuar më 09.02.2020.);

*USTAŠE SLAVE ZLOČIN: Državni vrh na čelu s Kolindom proslavlja srpski pogrom!*

- <https://web.archive.org/web/20200208232842/http://informer.rs/vesti/politika/391981/ustase-slave-zlocin-drzavni-vrh-celu-kolindom-proslavlja-srpski-pogrom>  
(Archived on 09.02.2020.)

**150** Srpsko narodno vijeće. *Oluja u Hagu*. Zagreb.

- <https://web.archive.org/web/20200208233308/https://snv.hr/oluja-u-haagu/oluja-hr.html>  
(Arkivuar më 09.02.2020.)

**151** Ibid.

**152** Hrvatski Helsinški odbor. *Vojna operacija Oluja i poslije*. Zagreb.

- <https://web.archive.org/web/20200208233550/https://snv.hr/oluja-u-haagu/media/sg1/sg1-04-vojna-operacijaoluja-hr.pdf>  
(Arkivuar më 09.02.2020.)

**153** Šimičević, Hrvoje. *Generali su nevini, tko je kriv?*. Zagreb.

- <https://web.archive.org/web/20200208233848/http://www.h-alter.org/vijesti/generali-su-nevini-ali-tko-je-kriv>  
(Arkivuar më 09.02.2020.)





# KROACIA / MALI IZI

# 5

KRO / Mali Izi / Morinj - Podgorica / 6-9 korik

73







KRO \ Mali \ XI \ Morinj - Podgorica \ 6 - 9 kolnik

170

KROACIA / MALI I ZI

5



—  
173  
—







Kur filluam të analizojmë marrëdhëniet bilaterale midis Kroacisë dhe Malit të Zi, nuk e dinim se sa e ndërlikuar është me të vërtetë kjo marrëdhënie dhe çfarë fshihet pas saj. Vendorsëm të shkruajmë për temat më të diskutueshme dhe të dhimbshme që kanë të bëjnë me bombardimin e Dubrovnikut, Prevlakën dhe kampin në Morinj sepse këto janë temat kryesore dhe aktuale të së kaluarës sonë të afërt të përbashkët dhe megjithë statusin e tyre kanë mbetur të marginalizuar në diskutimet publike. Secili prej nesh ka sjellë në këtë punim mendimin e vetë të ndikuar nga familja, mjedisi, sistemi arsimor, media dhe publiku. Duke bashkëpunuar në shkrimin e narrativave, opinionet tona ishin të ndryshme, por ne nuk e injoruam këtë ndryshim dhe konflikt pikëpamjesh, dëgjuam dhe menduam në mënyrë kritike. I kemi lejuar vetes të jemi të lëndueshëm, të pyesim veten dhe të shohim se mbase jo gjithçka është ashtu siç duket, siç kemi mësuar dhe menduar se është. Kemi lindur gjatë ose menjëherë pas luftës, nuk kemi kaluar kurrë nëpër të, por ka gjurmë të saj në ne. Udhëtimet studimore na bënë të vetëdijshëm për realitetin e ngjarjeve për të cilat kemi lexuar dhe shkruar. Kështu kemi mundur të shohim dhe të ndiejmë dëmet nga granatat, mbetjet e kampeve dhe të bisedojmë me njerzit që kanë kaluar nëpër diçka që askush nuk duhet të kalojë. Jo, kjo nuk ka ndodhë në ndonjë realitet tjetër paralel ose në një vend të largët të panjohur, ka ndodhë këtu. Ne, brezat e rinj e mbajmë barrën e shoqërisë dhe paragjykimet, madje pa qenë të vetëdijshëm për to. Nuk duam t'i bartim ato dhe nuk duam që fëmijët tanë t'i marrin ato përsipër një ditë. Nga narrativat që merren me të kaluarën shkatërruese ne kemi krijuar diçka, kemi transformuar dallimet tona dhe kemi formuar kuptime të reja të së kaluarës dhe realitetit, komunikim të ri midis brezave të rinj dhe miqësi të reja që kanë ndryshuar mendimin tonë dhe veten tonë. Jo gjithmonë e kemi ditur se ku të kërkojmë burime për diçka për të cilën nuk ishte folur kurrë në

familje dhe në publik, por nuk kemi hequr dorë. Kërkuam të vërtetën, jo një, por të vërteta të ndryshme.

Nuk e kemi patur të lehtë, por bëmë më të mirën për të lexuar sa më shumë dhe për të veçuar ato burime që ishin të rëndësishme për ne, qoftë artikujt e gazetave, punimet shkencore, dokumentet gjyqësore apo videoklipet. Shpresojmë që ja kemi arritur kësaj pasi që narrativat tona janë të shkruara, por jo të përfunduara. Ky projekt ka stimuluar tek ne disa ndryshime të vetëdijes që do të vazhdojnë të marrin formë dita ditës. Duam të vazhdojmë të mendojmë për gjëra që nuk diskutohen në shoqëritë e të gjithë rajonit. Shkrimi i narrativave na ka ndryshuar kështu që për ne ky projekt është tashmë i suksesshëm. Sidoqoftë, ne nuk kemi shkruar letra vetëm për veten tonë. Nëse nga narrativat tona, duke vepruar në mjedis, duke inkurajuar dialogun, mirëkuptimin dhe pranimin, inkurajojmë të paktën një person më shumë të mendojë dhe të shpërthej kufizimet e përcaktuar, misioni ynë është i suksesshëm.



## **Kampi Morinji: Narrativa kroate**

---

### ***Dubrovnikasit vjelin rrush në Mal të Zi***

Morinji ndodhet në zonën nga Kotorri drejt Herceg Novit, thellësisht i futur në gjirin e detit rrëzë një vargu të lartë malor. Është vendbanimi më i madh në bregun perëndimor të Gjirit të Kotorrit dhe Risanit dhe një vendpushim i famshëm turistik nga i cili vijnë një numër i madh detarësh dhe kapitenësh.<sup>154</sup> Morinji paraqet një port mesdhetar shumë të bukur dhe idilik të Gjirit të Kotorrit, por disa njerëzve ju ngrihet gjaku në vena nga ky vend. Përkatësisht, gjatë luftës jo shumë kohë më parë në hapësirat tona, Morinji shërbeu si qendër grumbullimi. Në periudhën nga tetori 1991 deri në gusht 1992, ai u përdor si një Qendër Pritjeje për të burgosurit e luftës nga Qarku Dubrovnik-Neretva.<sup>155</sup> Morinji është ende një temë shumë e dhimbshme në zonën e Dubrovnikut, ndërsa nuk është mjaftueshëm prezent në mediat dhe publikun e gjërë kroat.

Numri i të burgosurve në Morinj ka arritur në 160 persona por është shumë e vështirë të gjesh numrin e saktë dhe listën e të arrestuarve. Të vendosur në kazerna të vogla në kushte çnjerëzore dhe me një trajtim të papërshtatshëm që përfshinte abuzime të përsëritura fizike dhe psikologjike të të burgosurve. Kjo është paraqitur më së miri në librin *Kujtime të të Internuarve të Dubrovnikut 1991-1992*, botuar nga Shoqata Kroate e të Burgosurve të Kampeve Serbe të Përqendrimit.<sup>156</sup> Të dhënat dhe dëshmitë e të burgosurve të kampit flasin për të gjitha tmerret që u ndodhën atyre atje. Shumë të burgosur deklaruan se torturat psikologjike ishin shumë më të forta se sa ato. Në momentet e shfryrjes se epsheve, ushtarët dhe policia i detyruan të burgosurit të vjelin rrush në të thatë,<sup>157</sup> të kullosnin bar, të rraheshin me njëri-tjetrin ndërsa të tjerët shërbenin si një rreth i gjallë, i kanë dërguar në pushkatime të rreme dhe ju kanë detyruar të këndonin këngë anti-kroate.<sup>158</sup> Marko Margaretić, ish i burgosur i Morinjit, thotë se kënga që ai duhej të këndonte çdo herë që hetuesi Boro Gligić ishte në detyrë

edhe sot i tingëllon në kokën: “Le të presin ustashët, gropë e gjerë i pret. Gropë e gjërë i pret, tash e për shumë vjet”.<sup>159</sup> (Ustaše neka, neka, široka vas jama čeka. Široka je jedan metar, a duboka kilometar). I njëjti hetues Gligić u dënua më vonë për pjesëmarrje në abuzimin e të burgosurve. Sipas rrëfimeve të disa të arrestuarve, ai i ka çuar të burgosurit në një dhomë ku janë torturuar dhe u kanë treguar se si dukeshin ustashët tipik.<sup>160</sup> Gjatë ekzistencës së kampit kanë vdekur tre persona: Miho Brailo, Antun Čagalj dhe Nikola Zlovečar. Përveç atyre që humbën jetën gjatë torturave, disa të arrestuar kanë vdekur menjëherë pas lëshimit nga kampi; Nikola Lučić, Pero Djurišić, Krešimir Bošković, Božo Ban, Ivan Ban, Božo Čaglj, Jak Obrad, Jelo Obrad, Miho Kralj dhe Vlaho Brailo.<sup>161</sup>

Republika e Kroacisë, si edhe Mali i Zi, mbetet prapa në aspektin e konfrontimit publik me rolin e kampit të përqendrimit në Morinj. Së pari, shumica e popullatës kroate nuk e di as që ka ekzistuar ndonjëherë një qendër grumbullimi për civilët e Qarkun Dubrovnik-Neretva, veçanërisht që ai ishte i vendosur në Mal të Zi. Duke diskutuar mbi temën e Morinjit me më të afërmit, por edhe me kolegët tanë të fakultetit, zbuluam mungesëm e njohurive për këtë temë. Gjithashtu, institucionet arsimore dhe kulturore kanë dështuar tërësisht në promovimin e çështjes së krimeve kundër civilëve të Dubrovnikut. Brenda të gjithë sistemit arsimor, Lufta Atdhetare trajtohet në mënyrë sporadike në klasat e larta të arsimit fillor dhe të mesëm, por nuk përmendet kampi i Morinjit apo dëshmitë e të burgosurve dhe nuk ka asnjë literaturë referuese për t’u ofruar informacione të tilla të rinjëve të interesuar.<sup>162</sup> Morinji në manualët për mësuesë dhe profesorë, por jo edhe në librat shkollorë, mbetet vetëm një informacion i rastësishëm, pa ndonjë të dhënë më të detajuar, siç për shembull në manualin për mësuesit për Luftën Atdhetare botuar nga “Libri Shkollor” (“Školska knjiga”).<sup>163</sup> Për më tepër, përveç librit të përmendur tashmë në fillim të tekstit, *Kujtimet e të Internuarve të Dubrovnikut*, nuk ka asnjë literaturë që të polemizojë për këtë temë. Mediat shpesh raportojnë për përkujtimet e përvjetorëve të operacioneve ushtarake-policore, të cilat shoqërohen me përshkrime të vendosjes së kurorave në vendet e vuajtjeve të mëdha, politikanët bëjnë thirrje për memoriale për viktimat dhe të zhdukurit, por Morinji nuk përmendet. Publiku kroat nuk është i informuar sa duhet për Morinjin, dhe autoritetet nuk bëjnë përpjekje të mjaftueshme për të shënuar dhe pranuar me dinjitet vuajtjet e të burgosurve. Vetëm në disa portale të internetit është e mundur të gjesht artikuj në lidhje me kompensimin e paguar nga qeveria malazeze për viktimat dhe disa rrëfime të të ndaluarve.

Shumica e artikujve të tillë kalojnë pa u vënë re nga publiku kroat, dhe temat e tilla nuk përfaqësohen sa duhet në media të tjera.

Në detin e krimeve dhe dhimbjeve të shkaktuara gjatë Luftës Atdhetare, duam të falim, por nuk dimë kujt. Mirëpo, është detyrë e jona t'u bëjmë homazhe të gjitha viktimave, pavarësisht nga identiteti etnik dhe numri i tyre, statusi ushtarak apo civil. Çdo jetë e humbur në luftë meriton të kujtohet. Jemi të mendimit që vuajtja e viktimave nuk njeh status, moshë, gjini, kombësi, kufij, profesion ose fe. Gjithashtu besojmë se dhemb të flitet për atë që ka ndodhur. Por ne ende besojmë se do të jetë më e dhimshme nëse heshtim për këtë gjë, nëse harrojmë se kush janë viktimat. Heshtja për konfliktet, përcaktimi e fajit individual, mbyllja e gojës dhe harresa e viktimave çon në konflikte të reja dhe kështu drejt vuajtjeve të reja. Duhet të dimë se çfarë ka ndodhur në mënyrë që diçka e tillë të mos ndodhë më kurrë. A kemi mësuar ndonjë gjë nga këto ngjarje dhe a nuk ja vlen thënia *Historia est Magistra Vitae*?





## **Kampi Morinj: Narrativa malazeze**

---

### *Pushimorja Morinj*

Vendi i famshëm dhe tërheqës turistik Morinj, i pozicionuar në Gjirin e Kotorrit, ku ka objekte elitare turistike pranë bregdetit, fsheh një kompleks të objekteve ushtarake që u kthye në burg në vitet 90 - një qendër grumbullimi për të burgosurit e luftës. Gjatë luftës, kampi u pa si diçka krejt normale, si burg për tradhtarët fashistë që kundërshtuan autoritetin e udhëheqjes së RSFJ-së dhe ushtrinë e APJ-së. Kampi – qendra e gumbullimit justifikohet nga nevoja për të mbledhur të dhëna të inteligjencës nga anëtarët e mundshëm të formacioneve paramilitare të Gardës Kombëtare (ZNG) dhe anëtarëve të Unionit Demokratik Kroat (HDZ). Censura dhe raportimi i mediave që kanë patur synim mashtrimin e publikut pothuajse arritën të justifikojnë kampin dhe ta paraqesin atë si diçka të nevojshme për mbrojtjen e Malit të Zi dhe të RSFJ-së së atëhershme. Sipas gazetarëve në shërbim të propagandës së udhëheqjes së atëhershme, të cilët madje në disa momente përdorën metoda hetuese për të marrë në pyetje të burgosurit e kampit, Morinji paraqitet si një burg i ligjshëm ose qendër grumbullimi, ku, sipas përgjigjeve të detyruara të të arrestuarve, ata trajtoheshin me humanizëm dhe korrektësi.

Pjesa më e madhe e publikut nuk i ka kushtuar vëmendje kampit dhe për këtë arsye nuk ka reaguar. Popullata përreth kampit gjithashtu nuk ka reaguar dhe arsyeja për këtë është se ata ishin pjesëtarë të familjeve të personelit ushtarak, por edhe se kishin frikë pasi në atë kohë nuk lejohej të vihek në dyshim asnjë veprim i ushtrisë dhe policisë. Një pjesë e publikut ende sot e sheh kampin dhe ngjarjet e asaj kohe si të justifikuara dhe ende beson se ekzistonte një kërcënim nga forcat paramilitare fashiste nga Kroacia. Disa besojnë se operacioni duhej të ishte bërë në mënyrë më konsistente dhe se nëse qëllimi do të ishte mbrojtja dhe ruajtja e RSFJ-së, veprimet e ushtrisë ishin të justifikuara, por që duhej të ishte bërë në mënyrë më

të disiplinuar dhe me njerëzizëm. Sigurisht, ekziston edhe pjesa që beson se e gjithë kjo është e justifikuar dhe se është dashur më ashpër të merrnin pjesë në luftë, sepse kroatët, “ustashët” në përgjithësi, janë ende armiq. Sigurisht, njerëzit formojnë mendime dhe qëndrime nën ndikimin e propagandës dhe manipulimeve për ngjarjet që ndodhën. Sidoqoftë, sot pak njerëz dijnë për kampin në Morinj përveç aktivistëve të OJQ-ve dhe publikut profesional.

Deri më tani, Mali i Zi nuk ka zbatuar në mënyrë të duhur procesin e trajtimit të së kaluarës. Në kontekst të kësaj, duhet të merret në konsideratë çështja e kampit në Morinj dhe dënimi për ish-pjesëtarët e APJ-së për krimet në këtë kamp. Prokuroria malazeze duhej ta kishte filluar procesin gjyqësor shumë më herët dhe të sillte më profesionalisht gjatë zbatimit të tij. Dënimi i përgjithshëm për krimet në Morinj duhet të shihet më shumë si pasojë e presionit nga Bashkimi European dhe vendet e rajonit dhe jo si dëshirë e vërtetë e qeverisë aktuale për të procesuar penalisht krimet nga ky kamp. Ngjashëm me rezultatet e këtyre proceseve, janë edhe dënimet në Kroaci për krimet në kampe në territorin e tyre. Çështja është nëse dënimet e tilla pasqyrojnë peshën e veprave, krimeve dhe torturave të kryera ndaj të ndaluarve.

---

182

---

Ndryshimi i programeve politike, prioritetet e politikës së brendshme dhe të jashtme, por edhe presionet e ndryshme nga adresat ndërkombëtare, janë faktorët kryesorë që ndikojnë tek politikanët malazezë të cilët japin deklarata të ndryshme në lidhje me të njëjtat ngjarje në një periudhë të shkurtër kohe. Megjithatë edhe pse zyrtarët e shtetit malazez e kanë pranuar publikisht përgjegjësinë për dëmin nga operacionet e luftës, dhe disa, siç është presidenti i tanishëm Milo Gjukanović, kanë kërkuar edhe zyrtarisht falje nga Kroacia për vuajtjet dhe humbjet materiale që u kanë shkaktuar qytetarët malazezë pjesëtarët e APJ-së, hetime të hollësishme mbi përgjegjësinë komanduese dhe individuale dhe aktgjykime adekuate për krimet e luftës ende nuk ka. Nuk ka arsyetime për krimet dhe prandaj të gjithë ushtruesit e funksioneve shtetërore duhet të jenë të vetëdijshëm për këtë. Një nga problemet më të mëdha që përcjellë shoqërinë tonë, por edhe tërë rajonin, është mohimi i viktimave të kombeve tjera dhe vënja në plan të parë vetëm e viktimave të popullit vetanak.<sup>164</sup>

Librat shkollorë të historisë për shkollë fillore dhe të mesme përmbajnë informacione themelore në lidhje me shpërbërjen e RSFJ-së dhe luftën gjatë viteve 90-të të shekullit të kaluar në ish-Jugosllavi. Është fakt



që këto mësimë trajtohen në fund të Klasës IX fillore dhe klasës IV të shkollës së mesme, kështu që është e dyshimtë nëse ato trajtohen fare dhe sa mirë. Fakt është që në librat e mëparshëm shkollorë të historisë nuk kishte vend për krimet e luftes në kampin Morinj, ndërsa ne nuk kemi informacion mbi librat e fundit.<sup>165</sup> Duhet të theksohet se në vitin 2009 është botuar një libër shkollor për klasën IV të gjimnazit, autorët e së cilit janë profesor Šerbo Rastoder, profesor Dragutin Papović dhe Sait Šabotić. Në atë libër shkollor, çështjet e shpërbërjes së RSFJ-së dhe ngjarjet e luftës janë trajtuar në masë më të madhe dhe në mënyrë tjetër nga ato më parë. Ai libër shkollor është ndaluar nga qeveria e cila është edhe sot aktuale në Mal të Zi me pretekstin se shoqata të caktuara të luftëtarëve e kërkojnë këtë dhe se Mali i Zi nuk ishte një shtet i pavarur në atë kohë, kështu që nuk mund të vendoste nëse do të shkonte në luftë. Thelbi është që libri shkollor është i ndaluar pasi që për herë të parë një libër i historisë merret me çështjen e përgjegjësisë së disa zyrtarëve të lartë të atëhershëm, por edhe të sotëm, të shtetit, për luftën në Dubrovnik, por edhe me çështjen e përgjegjësisë për krime të tjera të luftës.<sup>166</sup>

Shumë njerëz nuk donin të jepnin një përmbledhje për kampin në Morinj qoftë nga padituria ose frika për pasojat që do të pësonin. Duhet të kemi parasysh që Mali i Zi u përball me krime vetëm si një shtet që njohu krimet dhe pagoi kompensimin, por që vetëm disa autorë të drejtpërdrejtë janë ndëshkuar, kurse ata që janë ende në pozita të larta i janë shmangur përgjegjësisë. Sidoqoftë, pjesa më e madhe e publikut malazez e dënon sulmin ndaj Dubrovnikut dhe ngjarjet e viteve 90-të dhe përpiqet ta transferojë fajin për ato ngjarje diku tjetër, tek udhëheqja e RSFJ-së, por harron faktin se kryeministri i atëhershëm malazez Milo Djukanović ishte pjesë e të njëjtit lidërsip, kurse sot është president i Malit të Zi. Kampi Morinj mbetet njollë e zezë e historisë moderne të Malit të Zi, por ne duhet të jemi këmbëngulës në kërkimin e përgjegjësisë nga ata që janë më përgjegjës për krimet e urrejtjes dhe situatën e përgjithshme dhe sot janë në pozita të larta.



## **Kampi Morinji:** **Narrativa e përbashkët**

---

### *Ku shkojnë në pushime ata që janë përgjegjës?*

Morinji, një vend turistik përrallor në një nga pjesët më të bukura të Malit të Zi, i vendosur në Gjirin e Kotorrit. Sot askush nuk do të mendonte që në atë vend, pak më shumë se njëzet vjet më parë, ishte kampi i parë i luftës në ish-RSFJ gjatë luftërave të viteve 90-të. Ky vend i vogël fsheh sekretin e një serie krimesh të kryera nga pjesëtarët e APJ-së kundër popullatës së gjinisë mashkullore, të arrestuar, civilë dhe robër lufte, nga zona e Dubrovnikut. Qendra e grumbullimit ishte e vendosur vetëm disa qindra metra larg ndërtesave të banuara të atëhershme dhe sot nga vendpushimet luksoze. Është absurde që nuk ka shenja në atë lokalitet që përmendin krimet që ndodhën aty, dhe që në të njëjtin vend në plan të parë është projekti i ndërtimit të komplekseve turistike sikur asgjë të mos kishte ndodhur dikur.

Morinji është i (pa)njohur sot sepse nga tetori i vitit 1991 deri në gusht 1992 shërbeu si një kamp për të burgosurit e luftës nga Qarku Dubrovnik-Neretva.<sup>167</sup> Kampi u themelua me 3 tetor 1991, me qëllim të marrjes në pyetje të të ashtuquajturve “ustasha” dhe pjesëtarëve të ZNG-së.<sup>168</sup> Megjithëse të dhënat zyrtare tregojnë se numri më i madh i të burgosurve kroatë kishte status civil, ata u trajtuan nga anëtarët e APJ-së si kërcënimi më i madh për territorin dhe integritetin e Malit të Zi dhe të RSFJ-së.

Ushtarakët përgjegjës për atë zonë ishin ushtarë të rregullt të APJ-së të njësive së 9-të të sektorit detar, zëvendës-admiral i së cilit ishte Miodrag Jokić, i cili deri në atë kohë mbante postin e Ministrit të Mbrojtjes së Serbisë dhe shef i po këtij shtabi ishte Milan Zec.<sup>169</sup> Megjithëse ka të dhëna për strukturën hierarkike të sektorit detar, i cili përfshinte Morinjin dhe kampin e tij, njerëzit më të përgjegjshëm në atë sistem sot nuk japin përgjegjësi për veprimet e tmerrshme kundër të burgosurve të luftës. Puna operationale me të burgosurit në kampin



Morinj ishte përgjegjësi e Drejtorisë së Sigurisë së Sekretariatit Federal të Mbrojtjes Popullore (SSNO). Gjatë periudhës kur ekzistonte Morinji, një nga shefat e Drejtorisë së Sigurisë ishte Aleksandar Vasiljević. Një nga oficerët kryesorë të grupit të marrjes në pyetje në Morinj, Mirsad Krluč, i tha gjykatës se gjenerali Vasiljević u kishte dhënë atyre udhëzime se si dhe çfarë të pyesnin të burgosurit.<sup>170</sup> Këto deklarata dhe dokumente zyrtare konfirmojnë ekzistencën e një hierarkie të qartë, por marina ushtarake në një seancë dëgjimore në vitin 2007 i ka mohuar këto dëshmi dhe ka deklaruar që kampi Morinj ishte nën juridiksionin e shtabit ushtarak në Beograd. Po ashtu, në atë deklaratë, Morinji nuk është përcaktuar si kamp por si Qendër për Pritje/Marrjen në pyetje të të burgosurve, siç kishte thënë njëri prej hetuesve të akuzuar, Zlatko Tarle, i cili u lirua më pas nga të gjitha akuzat nga Gjykata e Lartë në Podgorica në vitin 2012.<sup>171</sup>

Tregimi i të arrestuarit Marko Lučić është një nga shumë histori që tregojnë se pas numrave dhe fakteve gjenden përjetime individuale, fatet njerëzore. Lučić, i cili përfundoi atje me babanë e tij Nikolën, iu nënshtrua torturave speciale për shkak të mbiemrit. Përkatesisht, një nga policët ushtarakë brenda kampit, Špiro Lučić, i rrahu ata deri në alivanosje, pasi konsideronte që ia kishin turpëruar fisin.<sup>172</sup> Babai i Markos vdiq një vit pas lirimit nga kampi. Autopsia vërtetoi se zoti Nikola vdiq si pasojë e rrahjeve të dhunshme në kamp, torturave psikologjike dhe kushteve çnjerëzore të jetesës.<sup>173</sup> Zyrtari i përmendur policor u dënua me 3 vjet e 6 muaj burg me një aktgjykim të shkallës së parë, më 15 maj 2010, me kusht që periudha e kaluar në paraburgim të merrej në konsideratë në kohën e dënimit të tij, dhe me aktgjykimin e formës së prerë u dënua me 3 vjet burg.<sup>174</sup>

Tre persona vdiqën gjatë ekzistencës së kampit. Miho Brailo nga Konavle, i cili në atë kohë ishte vetëm 26 vjeç, u var në burg vetmie në fanellën e tij. Antun Čagalj nga Zvekovica, ishte 78 vjeç dhe ishte operuar për shkak të kancerit të mëlçisë vetëm gjysmë viti para mbylljes së tij në kamp. Vdiq në kamp gjatë një rrahje të rëndë. Dhe rasti i tretë, Nikola Zlovečar, një burrë mbi 80 vjeç i cili për shkak të gjithçkaje që përjetoi atje në atë moshë të thyer, pësoi 3 sulme në zemër dhe vdiq.<sup>175</sup> Kursa ata që i mbijetuan tmerreve të kampit, ende vuajnë pasojat e torturave fizike, por jo më pak të tmerrshme, torturave psikologjike që përjetuan.

Ajo që është ndoshta më e keqe se vetë krimi është pasiviteti dhe indolencia e banorëve lokalë të Morinjit. Të paktë janë banorët e

Morinjit nga ajo periudhë që dëshirojnë të flasin publikisht për kampin. Obrad Pavlović nga Kostanjice, një fshat afër Morinjit, vendosi të ndante përvojën e tij me mediat malazeze; “Ajo që njerëzve që jetojnë atje duhej t’ju bënte të ditur që ishte një kamp është fakti se, veçanërisht në mbrëmje, kishte ulurima, pastaj shtytje për të kënduar këngë dhe pastaj përsëri ulurima”.<sup>176</sup> Vendasit kanë dëgjuar, e kanë ditur dhe nuk kanë reaguar. Vendasit e tjerë që i ka takuar ekuipazhi i TV pohuan se nuk ishte kamp, por një qendër paraburgimi. Ata kinse kanë dëgjuar zhurmë, por kanë menduar se ishin rezervistët, sepse, sipas dijenisë së tyre, nuk kishte ushtri të rregullt aty.<sup>177</sup> Sidoqoftë, duhet kuptuar që shumë kanë mbetur indiferentë nga frika se mund të përfundonin në të njëjtën mënyrë. Informacioni i transmetuar nga media ishte me të vërtetë keqinformim dhe propagandë dhe me propagandën e tyre ata mbështetën dhe justifikuan atë që po ndodhte në Morinj dhe transmetuan deklaratat e marra më forcë nga të arrestuarit, të citët portretizuan pozitivisht situatën në kompleks. Sot në Mal të Zi, ekziston ende një rrymë mendimi që manifestohet në mënyrë sporadike në disa media dhe promovon propagandën e falsifikuar dhe të krijuar në vitet 90-të.

Vetë aktakuza ndaj disa prej autorëve të krimeve në Morinj u ngrit nga Prokuroria e Lartë e Shtetit të Malit të Zi - Departamenti për Luftimin e Krimit të Organizuar, Korrupsionit, Terrorizmit dhe Krimeve të Luftës në Gjykatën e Lartë në Podgoricë, më 15 gusht 2008. Aktakuza kërkonte paraburgimin dhe dënimin për Mladen Govedarica, Zlatko Tarle, Ivo Gojnić, Špiro Lučić, Ivo Menzalin dhe Boro Gligić për trajtim çnjerëzor dhe johuman të të burgosurve të luftës, që është në kundërshtim me Konventën e Gjenevës në lidhje me Mbrojtjen e Personave Civil. Gjykata e Lartë në Podgoricë dha aktgjykimin e shkallës së parë në vitin 2010, më pas vijnë vite të tëra të procedimit. Procedimet përfundimisht mbaruan me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Malit të Zi më 27 shkurt 2014 dhe në atë seancë vendimet e seancës së viti 2013 u aprovuan, duke refuzuar ankesat e Gojnić, Lučić, Menzalin dhe Gligić. Ivo Gojanović u dënua me 2 vjet burg, Boro Gligić dhe Špiro Lučić me 3 vjet burg dhe Ivo Menzalin, aka Kuhar (Kuzhinieri), u dënua me 4 vjet burg.<sup>178</sup> Gjithsej 12 vjet burg (që përfshin kohën e kaluar në paraburgim).

“Prokuroria e Shtetit e Malit të Zi nuk arriti t'i trajtojë krimet në kampin e Morinjit si një sistem të organizuar të keqtrajtimit të të burgosurve dhe të akuzojë personat që ishin mbikqyrës të autorëve të drejtpërdrejtë të një keqtrajtimi të tillë, megjithëse kishte bazë

për një gjë të tillë”.<sup>179</sup> Shumë OJQ ngrenë çështjen e mungesës së përgjegjësisë objektive/komanduese. Si është e mundur që ata që abuzuan me të burgosurit dhe eprorët e tyre ende nuk janë akuzuar të gjithë? Ekziston një numër i madh i njerëzve që besojnë se Gjykata e Apelit e Malit të Zi nuk e ka marrë seriozisht këtë problem, sepse aktgjykimi i formës së prerë është shumë i shkurtër në përmbajtje dhe në pjesën më të madhe i referohet verdiktit të vitit 2013. Megjithëse, duhet të theksohet se Mali i Zi ka treguar vullnet të mirë për të zgjidhur këtë çështje dhe ka ofruar kompensim për dëmet materiale dhe jo-materiale të viktimave. Ende nuk ka njerëz që janë përgjegjës, as në zinxhirin komandues dhe as sipas përgjegjësisë politike.<sup>180</sup>



## ***Bombardimi i Dubrovnikut dhe zonës së Dubrovnikut: Narrativa kroate***

---

### ***Ombrellë për plumba, dërrasa për granata***

Realizimi i planit për krijimin e Serbisë së Madhe të Millosheviqit pas daljes së Republikës së Kroacisë nga RSFJ mund të kryhej vetëm përmes luftës dhe agresionit.<sup>181</sup> Memorandumi dhe kufijtë maksimalistë të Jugosllavisë së re ose Serbosllavisë kaluan përgjatë vijës Virovitica - Karlovac - Gospiq - Karlobag dhe luftimet e pasuksesshme ose qëllimet e paarrtshme ndryshuan strategjinë ushtarake serbe në aneksimin e territoreve të pushtuara.<sup>182</sup> Zbatimi i strategjisë së përmendur ushtarake përfshinte drejtimin e presionit të politikës së Serbisë së Madhe dhe agresionit në pikat fundore të Republikës së Kroacisë - Vukovar dhe Dubrovnik.

Përveç rëndësisë ushtarako-strategjike të Dubrovnikut për realizimin e politikës së Serbisë së Madhe dhe për krijimin e një ure drejt luftimeve të mëtutjeshme, ekziston nevoja strategjike e pushtimit të Dubrovnikut si një porti të përshtatshëm, pushtimi i të cilit argumentohet me të drejtën historike të fituar nga indoktrinimi të publikut serb mbi pronësinë serbe të kulturës së Dubrovnikut. Sipas pohimeve të politikanëve në mitingjet Serbomadhe, siç janë Radovan Karadžić dhe Novak Kilibarda, dubrovnikasit ishin në të vërtetë serbë të konvertuar në katolikë, dhe kështu pretendohet përkatësia serbe e territorit sipas ligjit natyror.<sup>183</sup> Propaganda serbo-malazeze ka justifikuar sulmin ndaj Dubrovnikut duke u thirrur në rrezikimin e pakicës serbe në Dubrovnik, por kjo tezë nuk ka qenë asnjëherë e qëndrueshme.

Agresioni serbo-malazez u plotësua nga plaçkitjet, zjarrvëniet dhe shkatërrimi i të gjithë zonës së Dubrovnikut, midis të cilave veçanërisht u preken Sllano, Çilipi dhe Zvekovica. Idea e situatës në Dubrovnik, plaçkitjet dhe krimet, arriti në sferat e publikut malazez. Për shembull, në televizionin malazez u transmetuan kërkesat për grabitje të sendeve të caktuara. Masakrat e civilëve dhe ushtarëve dhe persekutimet e

kryera nga trupat serbe dhe malazeze nuk ishin vetëm pasojë e luftës, por thelbi i saj ishte në pushtimin e hapësirës së re të jetesës për serbët, në mënyrë që të formohej Krajina Serbe dhe të formësohej Serbia e Madhe. Spastrimet etnike, bombardimet e civilëve dhe terrori u përdorën për të thyer plotësisht territorin e unifikuar të Republikës së Kroacisë dhe si pasojë izoluar pjesët e cenueshme të cilat do të viheshin në kaos ushtarak, ekonomik dhe politik për të rënë më lehtë nën sulmin e agresorëve. Sulmi ndaj Dubrovnikut është e pamundur të justifikohet dhe është një rast që tregon thelbin e brutalitetit dhe mosarsyeshmërisë së agresionit serbo-malazez.

Poljanić, i cili ishte kryetar i Dubrovnikut në vitin 1991, thotë: “Sulmi ndaj Dubrovnikut u bë ekskluzivisht me qëllim të formimit të kufirit të Serbisë së Madhe”. Po ashtu në lidhje me Prevlakën, Poljanić jep një deklaratë: “Ata na akuzuan për të shtëna ndaj ushtrisë në Prevlaka. Ne nuk kemi qëlluar dhe nuk ka patur kush të qëllojë sepse nuk kishim ushtri atje, por ata e bënë këtë me qëllim që të na akuzojnë se po e bëjmë atë dhe kështu të kishin më shumë arsye për t’u nisur dhe në fund me 1.10. filloj”.<sup>184</sup> Djukanović, kryeministri i Malit të Zi, tha se nuk e dinte që Dubrovniku mbrohej nga një numër kaq i vogël njerëzish: Askush nga udhëheqja e atëhershme e shtetit malazez nuk mund ta dinte këtë. Unë mendoj se udhëheqja ushtarake në Beograd kishte më shumë informacion objektiv sesa ne.<sup>185</sup> Djuro Kolić, anëtarë i këshillit të qytetit të Dubrovnikut, besonte që vetë Dubrovniku ishte demilitarizuar në vitin 1971 dhe se që nga ajo kohë asnjë forcë ushtarake nuk kishte qenë e pranishme në zonë.<sup>186</sup> Të gjitha këto deklarata tregojnë se Dubrovniku nuk ishte i rëndësishëm ushtarakisht, dhe për këtë arsye nuk ishte cak legjitim ushtarak.

Portali kombëtar kroat për mësim në distancë “Nikola Tesla” përmban përmbajtje arsimore dixhitale nga lëndë të ndryshme për nxënësit e shkollave fillore. Ndër të tjera janë ede përmbajtjet për lëndët e historisë dhe gjeografisë, por në përmbajtjet për nxënësit e klasës së VIII nuk ka asnjë informacion në lidhje me Luftën e Atdhetare apo luftën në Ballkan gjatë viteve 90-të të shekullit XX. Përmbajtjet që ndjekin mësimet e shekullit XX përfundojnë me kapitullin Kriza Ekonomike si shkak i përhapjes së totalitarizmit.<sup>187</sup> Në librin shkollor për klasën e VII të shkollës fillore nga historia përmendet okupimi i zonës përreth Dubrovnikut. Në disa fjali, paraqitet periudha kohore e rrethimit dhe operacioneve përmes të cilave është zhbllokuar zona. Gjithashtu është pohuar se rrethimi u krye nga forcat e APJ-së dhe anëtarët e mbrojtjes territoriale nga Mali i Zi dhe Hercegovina

lindore.<sup>188</sup> Saktësisht të njëjtat të dhëna janë paraqitur në librin shkollor të historisë për klasën e IV të gjimnazit, duke shtuar se qendra historike e qytetit të Dubrovnikut e mbrojtur nga UNESCO-ja është shkatërruar pothuajse plotësisht.<sup>189</sup>

Sulmi dhe bombardimi i Dubrovnikut gjatë Luftës Atdhetare u krye edhe pse Dubrovniku nuk ishte një cak legjitim ushtarak sipas strategjisë moderne të luftës. Prandaj, ky veprim i ushtrive serbe dhe malazeze vlerësohet, me arsye, si agresion nga publiku kroat. Përgjegjësia qëndron jo vetëm tek ushtarët e njësive që kryenin agresionin, por edhe tek komandantët e tyre, të cilët, në frymën e politikës nacionaliste, iu përveshën mjeteve shtypëse për të ndjekur politikën e terrorizimit, me qëllim të pushtimit dhe arritjes së interesave të paligjshme kombëtare. Dubrovnik u mbrojt me sukses falë mbrojtësve kroatë dhe dubrovnikas. Fotografitë e vuajtjes së Vukovarit dhe Dubrovnikut përshkuan publikun botëror dhe u bë e qartë se kush ishte agresori në këtë luftë. Vrazhdësia e agresionit shtyu para vendimin për njohjen ndërkombëtare të Kroacisë. Megjithë mësimet josistematike të brezave të rinj për konfliktet gjatë Luftës Atdhetare dhe rolin e sulmit ndaj Dubrovnikut në këtë kontekst, publiku kroat është akoma unanim në dënimin e krimeve të kryera mbi zonën e Dubrovnikut dhe rrethinës së saj sikurse edhe në vitin 1991.





## ***Bombardimi i Dubrovnikut dhe okupimi i Dubrovnikut dhe rrethinës së Dubrovnikut: Narrativa malazeze***

---

### *Dubrovniku më i vjetër dhe më i bukur*

Në Mal të Zi, në vitin 1989, vie deri tek i ashtuquajtimi revolucion AB (revolucion i anti-burokratik) dhe ndryshimi i udhëheqjes së atëhershme komuniste. Në rrethana shumë të çuditshme, erdhi deri tek protestat masive të punëtorëve, pothuajse të gjitha fabrikat hynë në grevë për të ndryshuar regjimin e atëhershëm. Sipas punëtorëve që protestuan dhe që i kujtojnë ato ditë, thonë se ka pasur rebelim të papritur, dhe mund të thuhet, të udhëzuar të punëtorëve. Përkatësisht, në çdo fabrikë kishte njerëz që duhej të ngrinin punëtorët në revoltë – “ngrënësit e qingjave” (drejtuesit e atëhershëm organizuan mbledhje dhe drekë në Zhablak me para të shtetit) me parullat “Nuk do të punoj për 1.000 marka” (që ishte rroga mesatare e atëhershme e punëtorëve në fabrika) dolën në rrugë të udhëhequr nga ish-rinia komuniste - Milo Djukanović dhe shpresa të tjera të reja të shtetit (Momir Bulatović, Aco Djukanović, Ivan Brajović dhe të tjerë) të cilët ende mbajnë poste të larta në Mal të Zi.<sup>190</sup> Pas kësaj u zhvilluan zgjedhjet e para parlamentare dhe u krijua qeveria, e cila ishte një ndjekëse besnike e politikës së Slobodan Miloševićit për një kohë të gjatë.

Fillimisht luhej me letrën e antifashizmit dhe regjimet e posakrijuara në Kroaci, Slloveni dhe Bosnjë e Hercegovinë që donin të drejtonin shtete të pavarura u quajtën fashiste. E gjithë fuqia mediatike në ish-RSfJ kishte për qëllim demonizimin e partive kundërshtare. Nuk kishte më jugosllavë dhe vëllezër, ustashët, çetnikët dhe balitë u rishfaqën nga askund pas 55 vjetësh. Falë mediave të bindura, dezinformimi dhe paniku u përhap me shpejtësi rrufeje në të gjitha drejtimet. Retorika luftënxitëse buron nga adresat më të larta të shteteve të atëhershme. Fatkeqësisht, mesazhet e shumta për paqen dhe arsyen nuk kanë mundur të depërtojnë bllokadën mediatike.

Për të hedhur një vështrim më të ngushtë në retorikën e asaj kohe,

duhet të tregojmë disa citate të udhëheqjes politike malazeze:

*"Miloševići është gjëja më e mirë që mund t'i kishte ndodhur Jugosllavisë në këtë kohë, kur forcat më fashiste dhëmpire në Kroaci po përpiqen të shkatërrojnë gjithçka të krijuar nga viti 1945 e deri më tani. Jam krenar që në këto vite mund të jem krah tij për të mbrojtur arritjet e revolucionit".<sup>191</sup>*

*"Ne do të fitojmë luftën e imponuar. Ashtu siç keni fituar kundër kundërshtarëve të tillë gjatë gjithë historisë sonë. Vetëm që këtë herë do t'i mposhtim dhe do t'i japim fund jetës së përbashkët me ta, shpresoj për të gjitha kohërat! Në të njëjtën kohë, Boka do të mbetet aty ku i përket, brenda Republikës së Malit të Zi dhe shpresoj që në atë ndarje dhe formim të një bashkimi të ri shtetëror në të cilin do të jetojmë, kufiri me Kroacinë do të tërhiqet shumë më natyrshëm dhe logjikshëm sesa ai i vënë nga kartografët bolshevik qëllimi i vetëm i të cilëve duket të ketë qenë të lënë kujdestarinë kroate mbi Malin e Zi në një pjesë të Gjirit të Kotorrit".<sup>192</sup>*

*"Askush nuk mund të tundë flamujt e paqes ndërsa populli serb po masakrohet, dhunohet, ndërsa shtëpitë e tyre po digjen dhe pronat e tyre shkatërrohen vetëm pasi janë serbë. Lufta nuk fitohet përmes dezertimit por përmes mobilizimit".<sup>193</sup>*

*"Qeveria kroate dëshironte luftë me çdo kusht, dhe e ka luftën. E kam urrey edhe shahun për shkak të fushës së shahut në flamurit kroat".<sup>194</sup>*

Milo Djukanović, Pobjeda, 1991.

Kjo është vetëm një pjesë në një mori të deklaratave nga pozitat më të larta në Mal të Zi në vitin 1991. Mediat përhapën panik dhe informacione se kishte disa mijëra anëtarë të "Zengave" (ZNG) dhe formacioneve të tjera paramilitare të Republikës së Kroacisë sipër Gjirit të Kotorrit dhe në afërsi të Dubrovnikut, dhe se po përgatiteshin të sulmonin Bokën në çdo moment, ndaj së cilës, sipas deklaratave të politikanëve të atëhershëm malazezë, pushtetarët kroat kishin pretendime. Shumë rezervistë kujtojnë ditët e mobilizimit kur ftoheshin të shkonin vetëm ata që donin, megjithatë, kur autoritetet panë që përgjigja ishte mëse e kënaqshme dhe që propaganda mediatike dha fryte, titujt për dezertorët dhe dënimet e tyre u shfaqën të nesërmen në Pobjeda dhe shumë media tjera për të gjithë ata që nuk pranuan vullnetarisht të shkojnë në fushëbetejë. Pas këtyre



dënimeve dhe presioneve, të cilat ishin një goditje e madhe për shumë malazezë krenarë për traditën ushtarake, mobilizimi pothuajse u dyfishua. Shumë rezervistë me të vërtetë besonin se mbronin atdheun e tyre Jugosllavinë dhe çlironin Kroacinë nga fashistët, megjithëse kishte edhe nga ata që u mishëruan me nacionalizmin serbomadh dhe urrejtjen ndaj “ustashave”, e cila ngadalë po përhapej në media.

Ushtria malazeze, e cila ishte pjesë e JNA-së, ishte e armatosur mirë sepse pothuajse të gjitha armët u tërhoqën nga Sllovenia dhe Kroacia. Edhe pse përparoi shpejt me pak rezistencë, shumë rezervistë tashmë e kuptuan se tregimet ishin të fryra. Urdhërat shpesh ishin konfuze, duke shkuar para dhe mbrapa sikur të mos kishte vullnet për të përparuar dhe për të arritur të paktën qëllimin deklarativ të ruajtjes së Jugosllavisë. Sipas shumë parashikimeve, APJ vetë mund të arrinte lehtësisht dhe shpejt Zagrebin, por nuk kishte asnjë dëshirë apo qëllim për këtë. Ndërsa rezervistët po përparonin, media përhapte dezinformim në Mal të Zi, madje edhe lajmet mbërrinin një javë me vonesë, për shembull, nëse një fshat do pushtohej sot, media do të raportonte se ai u pushtua pas një jave dhe përpiqej të paraqiste rezistencë të madhe. Kishte një rezistencë të vogël që ishte edhe më problematike për ushtarët pasi që disa burra të armatosur në një fshat mund të shkaktonin probleme më të mëdha për rezervistët sesa nëse do të luftonin forcë me forcë, kjo është arsyeja pse shumë fshatra u shkatërruan nga granatimet e tepërta. Shumë pohojnë se ushtarët shpesh vriteshin nga zjarri miqësor dhe se gjithçka ishte sajuar për të ngritur moralin dhe për t'u paraqitur si viktimë të formacioneve kroate. Gjithashtu, duke kujtuar ato ditë, shumë rezervistë thanë se mendonin se ishin uritur qëllimisht për t'i detyruar të plaçkisnin shtëpitë e braktisura. Në këtë mënyrë, për shumë njerëz, kjo luftë e panevojshme u shndërrua në plaçkitje.

Vetë akti i bombardimit të Dubrovnikut tani për shumicën është një marrëzi dhe turp i madh, kurse atëherë vetëm një pakicë e kuptonte se për çfarë bëhej fjalë. Opozita e atëhershme malazeze, më saktë Aleanca Liberale e Malit të Zi (LSCG) dhe lideri i saj Slavko Perović, ende besojnë se sulmi ndaj Dubrovnikut është turpi më i madh në historinë e Malit të Zi.

Nëse do të pyesnit qytetarët sot se çfarë mendojnë për këto ngjarje të pakëndshme, disa prej atyre që mbështesin qeverinë dhe që e mbështetën atë edhe atëherë do të distancoheshin nga ato dhe do të fajësonin qeverinë në Serbi. Ka disa që janë akoma të kapluar

nga nacionalizmi dhe që do të justifikonin këtë akt, ndërsa publiku qytetar dhe sektori i OJQ-ve që nuk është i afërt me qeverinë fajësojnë Qeverinë e atëhershme të Republikës së Malit të Zi (VRCG), si dhe njerëzit që janë akoma në pozita të larta. Njëri prej tyre është padyshim Milo Djukanović, president aktual i Malit të Zi, i cili e ka ndryshuar retorikën e tij disa herë dhe u distancua nga këto veprime sikur të mos ishte i njëjti njeri. As sot njerëzit përgjegjës për këtë çështje nuk janë sjellë para drejtësisë.

## ***Bombardimi i Dubrovnikut dhe okupimi i Dubrovnikut dhe zonës së tij: Narrativa e përbashkët***

---

*Nga Llovqeni thërret zana,  
Dubrovnik na fal këto t'bama*

197

Pavarësia kroate u përshkallëzua me luftë që përhapej si zjarr i egër përgjatë kufijve lindorë të Republikës së Kroacisë. Konfliktet më së shpeshti preknin ato teritore të Kroacisë në të cilat jetonin pjesëtarët e komunitetit etnik serb dhe zonat në të cilat gjendeshin objektet ushtarake. Sidoqoftë, në zonën e qytetit të Dubrovnikut nuk kishte objekte të konsiderueshme ushtarake ose ushtri të organizuara. Më shumë se 13.000 anëtarë të APJ-së, së bashku me rezervistët nga Mali i Zi, sulmuan jugun e Kroacisë nga Prevlaka deri në Luginën e Neretvës, nga toka, deti dhe ajri, saktësisht në orën 6 të mëngjesit, më 1 tetor 1991.<sup>195</sup> Një numër i vogël i trupave kroate dhe njësitet nga Dubrovniku ofruan rezistencë. Derisa njësitet malazeze depërtonin në Konavle, në të njëjtën kohë njësitë e Mbrojtjes Territoriale (TO) nga Hercegovina kanë deportuar deri në bregdet në disa vende në pjesën perëndimore të Rivierës së Dubrovnikut. Qyteti ishte i rrethuar plotësisht dhe zona e pa okupuar shtrihej vetëm 7 deri 8 kilometra larg Dubrovnikut.<sup>196</sup> JNA zë të gjitha pozicionet strategjike rreth Dubrovnikut përveç Sërgjit dhe kontrollon plotësisht detin e Dubrovnikut. Dubrovnikasit gjatë kohës së rrethimit mbijetuan pa ujë dhe energji elektrike.<sup>197</sup> Qyteti i vjetër u bombardua nga qindra granata, shumica e shtëpive brenda bërthamës u dëmtuan dhe hotelet në zonë u shkatërruan plotësisht. Sulmi i fundit, në të njëjtën kohë sulmi më i fortë ndaj Dubrovnikut u krye në 6 dhjetor, kur u vranë 22 njerëz.<sup>198</sup> Sipas disa mediave, 92 civilë, 417 mbrojtës, 11 anëtarë të Mbrojtjes Popullore dhe tre zjarrfikës u vranë në agresionin serbo-malazez, kurse sulmin e kanë kryer trupat e APJ-së dhe MT-së të ushtrisë malazeze të ndihmuara nga forcat speciale të MPB-së së Malit të Zi dhe vullnetarët nga zonat serbe në Hercegovinën lindore.<sup>199</sup>

Si është e mundur që Dubrovniku të bëhet cak ushtarak edhe pse serbët dhe malazezët nuk kanë vendosur themele administrative



dhe historike dhe nuk kishin të drejtë mbi zonën e Dubrovnikut? Si është e mundur që Dubrovniku u sulmua pa ndonjë shkak specifik dhe arsye të justifikuar politiko-ushtarake? Pse u pajtua populli malazez me këtë luftë? Sulmi ndaj Dubrovnikut u krye për shkak të qëllimeve gjeopolitike dhe strategjike të Serbisë me qëllim thyerjen e rezistencës kroate, por edhe për shkak të qëllimeve të Malit të Zi, i cili sipas urdhërave politike të udhëheqjes së RSFJ-së nuk e aprovoi Republikën e rikrijuar të Kroacisë dhe gjithashtu tentoj shpërbërjen e saj. Thyerja e unitetit territorial kroat gjithashtu rezultoi me atë që rryma politike malazeze të avokoj për rindërtimin e Republikës së Dubrovnikut me qëllim të përvetësimit gradual të territorit, plane të cilat Tugjman i kundërshtoi me forcë.<sup>200</sup> Sipas Admiralit Miodrag Jokić, qëllimi i operacionit ushtarak ishte bllokimi i Dubrovnikut dhe pjesë e një strategjie më të gjerë ushtarake, produkt i fundit i së cilës ishte diskreditimi i qeverisë së re kroate.<sup>201</sup> Në rastin e krijimit të Republikës së Kroacisë brenda kufijve të cilin ishin krijuar në vitin 1945, zona e Prevlakës do të mbetej jashtë kontrollit malazez, kurse Prevlaka është një pozitë jashtëzakonisht e rëndësishme që kontrollon hyrjen në Gjirin e Kotorrit. Malit të Zi nuk i ka pëlqyer një zgjidhje e tillë strategjike, e cila rrezikonte disa aspekte të sigurisë së saj kombëtare dhe ishte pa dyshim një nga shtytësit kryesorë për pjesëmarrjen e Malit të Zi në luftë.<sup>202</sup> Arsyeja e nisjes së trupave malazeze nuk ishte e nevojshme, pasi veprimet ushtarake ishin vendosur tashmë në Beograd, por ishte e nevojshme të krijohej një shkas, por edhe atmosferë publike në të cilën njerëzit do të mbështesnin vendimet shumë të diskutueshme të udhëheqjes politike. Stjepan Mesić, Presidenti i Republikës së Kroacisë, në lidhje me pjesëmarrjen e Malit të Zi në sulmin ndaj Dubrovnikut, thotë: “Shumë njerëz në botë, pavarësisht nëse ata jetojnë në vende të vogla apo të mëdha, gjithmonë duan që kufijtë e tyre të zgjerohen. Por në atë situatë euforike, është e sigurt që malazezët gjithashtu ranë viktimë dhe i besuan Miloševićit. Disa ishin thjeshtë, më lejoni të them, qytetarë të pranishëm, vëzhgues të asaj që po ndodhte, kurse disa ishin edhe aktivë. Disa madje morën pjesë në krime”.<sup>203</sup> Mbrojtja e Miloševićit në Hagë u bazua në një nga tezat se Serbia nuk kishte asnjë lidhje me sulmin ndaj Dubrovnikut, gjë që nuk ishte fare konform realitetit.<sup>204</sup>

Kur diskutohet për Luftën, duhet të merren parasysh shumë rrethana që injorohen sot lehtë, siç është disponueshmëria e informacionit në atë kohë. Republika Socialiste Federale e Jugosllavisë (RSFJ) ishte shtet udhëheqja politike e të cilit ka kontrolluar me sukses mediat dhe tërë opinionin publik për dekada dhe ka ndëshkuar rëndë disidentët

arritjet e të cilave ishin gjithashtu të dukshme në vitet 90-të. Fushatat propagandistike të luftës u krijuan mbi frikën e njerëzve të cilën propaganda jugosllave e kishte instaluar - fashizmin. Përveç fashizmit, propaganda krijonte një atmosferë të pasigurisë, një atmosferë frike dhe të ekzistencës së rrezikuar që inkurajonte masat që të dëshironin të mbronin status quo-në që simbolizonte familjen dhe komunitetin e tyre. Fushatat mediatike u shoqëruan me të dhëna të jashtëzakonshme që sigurisht nuk mund të korrespondonin me gjendjen aktuale të gatishmërisë ushtarake dhe organizimin e HV-së dhe dehumanizimin e pjesëtarëve të tyre, dhe kishin një efekt të suksesshëm në thellimin e frikës dhe armiqësisë.<sup>205</sup> Për ata që nuk ju nënshtruan lehtë një propagande të ulët, pretendohet se Mali i Zi ishte sulmuar, lufta ishte imponuar dhe shteti nuk kishte rrugëdalje tjetër.<sup>206</sup> Panoramën, letërkëmbimet dhe lartësimet e sukseseve ushtarake kishin për qëllim rekrutimin e ushtarëve të rinj.<sup>207</sup> Propaganda nuk u ndal pas fillimit të konfliktit, por vazhdoi intensivisht duke ruajtur një pamje të shtrembëruar të situatës në fushëbetejë, e cila bazohet në hetshtjen e dështimeve ushtarake, zjarrit miqësor, shkatërrimit të luftës dhe dhunës, ndarjen e përvojave pozitive të eprorëve, ushtarëve dhe civilëve të Dubrovnikut me synim të krijimit të idesë së luftës së arsyetuar dhe të drejtë, ndarje në akterë pozitivë dhe negativë, duke luajtur në të njëjtën kohë me emocionet e krenarisë historike dhe heroike luftarake të Malit të Zi.<sup>208</sup>

Duhet sqaruar, kur flasim për udhëheqjen politike përgjegjëse për luftën, nuk duhet i gjithë lidhësi politik të barazohet me të. Transkriptet e seancës së 8-të të Parlamentit të Republikës së Malit të Zi, të mbajtur më 20 shtator 1991, përshkruan me shumë kujdes situatën e vërtetë dhe konfliktin e politikanëve mbizotërues me orientim pro-serbë dhe pro-luftës dhe opozitës së tyre, e cila nuk përdor frazat e përcaktuara dhe justifikimet e liderëve pro-serbë, sikurse që i kundërvihet idesë së luftës së imponuar dhe vetë veprimeve të luftës.<sup>209</sup> Në seancë, qeveria malazeze ka justifikuar sulmin në zonën e Dubrovnikut me rrezikimin e drejtpërdrejt të sigurisë kombëtare të Malit të Zi nga Kroacia.<sup>210</sup> Politikanët nuk ishin të pajtimit me njëri-tjetrin se cilat ishin shkaqet e vërtetë për të cilat filluan luftën, por shumica e politikanëve ishin në favor të tij.<sup>211</sup> Bombardimi i Dubrovnikut paraqitet nga qeveria malazeze si një veprim legjitim ushtarak për shkak të aktivitetit të supozuar ushtarak të HV-së në qendër të qytetit.<sup>212</sup> Mashtrimi i publikut mori përmasa të jashtëzakonshme kur zyrtarët e APJ-së siguruan publikun se pala kroate ishte duke djegur goma për të simuluar shkatërrimin

jo-ekzistues të Dubrovnikut sepse “asnjë grimcë e vetme e pluhurit serb nuk ra mbi Dubrovnik”.<sup>213</sup> Një studim i UNESCO-s zbuloi se 68.33% e ndërtesave brenda zonës së vjetër u goditën nga predha gjatë bombardimit të Dubrovnikut.<sup>214</sup>

Një pjesë e inteligjencës, siç është historiani Radovan Samardžić, i cili e etiketoi Dubrovnikun si një “qytet të prostituar”, ose Božidar Vučurević, i cili bën një deklaratë të famshme se “do të ndërtojmë një Dubrovnik edhe më të vjetër dhe më të bukur”, pajtohet me koalicionin mbizotërues serbo-malazez e cila ishte në favor të agresionit kundër Republikës së Kroacisë.<sup>215</sup> Sidoqoftë, një pjesë e inteligjencës dhe artistëve të Malit të Zi luftojnë fuqishëm kundër Luftës dhe agresionit ndaj Dubrovnikut, kurse puna e tyre nuk është ekspozuar në të njëjtat përmasa. Fytyra e përpjekjes kundër luftës është padyshim shkrimtari Jevrem Brković, i cili ka kundërshtuar publikisht sulmin ndaj Dubrovnikut në fund të shtatorit 1991, për këtë arsye autoritetet lëshuan një urdhër arresti për të.<sup>216</sup> Gazeta pro-serbe “Pobjeda”, përveç udhëheqjes së fushatave propagandistike, ka shërbyer edhe për konfrontime me disidentët politikë dhe sigurisht që ishte në krye të gazetave që ishin mjete të agresorëve politikë dhe agjitorëve si Vučurević.<sup>217</sup> Gazetave si “Pobjeda” u janë kundërvënë gazetat liberale të cilat vinin në dyshim arsyetimin dhe imponimin e Luftës dhe gazeta “Monitor” duket theksuar për këtë. Mendimi i shumë figurave publike dhe kulturore që kundërshtuan Luftën ishte shtypur sistematikisht dhe veprimet e tyre pacifiste janë zbehur, kurse ndaj disa aktivistëve veçanërisht të shquar, si Brkovićit dhe redaktorit të Monitorit, janë bërë tentim vrasje.<sup>218</sup> Aktiviteti qytetar, protestat dhe nismat, midis të cilave dalin në pah veprimet studentore dhe Komiteti Qytetar për Paqe, janë marginalizuar dhe përqeshur në media, pavarësisht përgjigjes dhe mbështetjes së madhe të qytetarëve malazez.<sup>219</sup>

Shumica e politikanëve dhe zyrtarëve përgjegjës nuk kanë dhënë përgjegjësi për agresionin në territorin e Dubrovnikut dhe bombardimin e Dubrovnikut. Menjëherë pas Luftës, domosdoshmëria e konfliktit ishte justifikuar siç kishte insistuar admiral Miodrag Jokić në korrektësinë e ngjarjeve të vitit 1991.<sup>220</sup> Por kur karakteri agresiv i veprimit të Malit të Zi u bë i dukshëm, demagogët politikë gjetën një mënyrë për të penguar publikun të kërkojnë përgjegjësinë e udhëheqësve politikë dhe ushtarakë ende në pozita të pushtetit. Jokić është një nga ushtarakët e parë të nivelit të lartë që ka pranuar përgjegjësinë përpara Gjykatës së Hagës për veprimet për të cilat u dënua me shtatë vjet burg.<sup>221</sup> Me të gjithashtu ka filluar procesi



i dekolektivizimit të përgjegjësisë së luftës, i cili në të vërtetë nuk ka mbaruar kurrë.<sup>222</sup> Ideologët politikë, agjituesit dhe zbatuesit e fushatave mediatike nuk janë thirrur për të dhënë llogari, por kanë mbetur anëtarë aktivë të politikës dhe shoqërisë dhe gjasat që ata do të japin ndonjëherë përgjigje janë pothuajse zero.<sup>223</sup>

Pas këtyre pohimeve, përfundimi i përbashkët i kësaj narrative është se duhet të vazhdojmë të kërkojmë përgjegjësinë e udhëheqjes së atëhershme politike të Malit të Zi dhe agjentëve të luftës që janë ende në pushtet sot, por që hipokrizisht mbulojnë të kaluarën dhe heqin dorë nga përgjegjësia për veprimet e tyre me ndihmën e politikës zyrtare kroate.



## ***Përkufizimi në Prevlaka: Narrativa kroate***

---

### ***E ku ndodhet Prevlaka?***

Gadishulli Prevlaka, i emëruar sipas kepit me të njëjtin emër, është pika më jugore e Republikës së Kroacisë. Ndodhet në pjesën jugperëndimore të hyrjes në Gjirin e Kotorrit në kufirin me Malin e Zi. Prevlaka është një nga shumë mosmarrëveshjet kufitare që Republika e Kroacisë ka pothuajse me të gjitha vendet fqinje. Duke parë historinë, Prevlaka është nga shekulli XV e lidhur me Dubrovnikun, d.m.th Republikën e Dubrovnikut, e cila zonën e përmendur e ka blerë në vitin 1419.<sup>224</sup> Kështu është përcaktuar kufiri lindor i Republikës së Dubrovnikut, që përbën bazën për përcaktimin e mëvonshëm të kufijve në këtë zonë. Toponimi Konfin (kufi në gjuhën italiane dhe latine) e ka origjinën nga ajo kohë, gjë që paraqet një pikë domethënëse në përcaktimin e kufirit të ardhshëm në mes të Kroacisë dhe Malit të Zi. Përgjatë të gjitha ndryshimeve të mëvonshme të pushteteve - Francës, Austrisë, Jugosllavisë së parë, Shtetit të Pavarur të Kroacisë dhe Jugosllavisë së dytë, Prevlaka ka qenë e lidhur administrativisht me Dubrovnikun, që është edhe argumenti kryesor i Republikës së Kroacisë në mosmarrëveshjen e sotme. Përkatësia historike e Prevlakas dhe mos vënia në pikëpyetje e sovranitetit kroat deri në Luftën Atdhetare çuan në qëndrimin e pranuar përgjithësisht në Kroaci se Prevlaka ishte tërësisht territor kroat.

Një nga arsytet për këtë është edhe marginalizimi i temës në shoqërinë kroate. Për dallim nga mosmarrëveshja kufitare me Republikën e Sllovenisë, e cila çoi në bllokimin e hyrjes së Kroacisë në Bashkimin Europian, një pjesë e vogël e publikut është në dijeni të çështjes së Prevlakës. Nga 30 persona (të moshave të ndryshme dhe grupeve arsimore) të anketuar për qëllime të shkrimit të narrativës, vetëm



tetë kishin dëgjuar për mosmarrëveshjen dhe madje edhe më pak ishin në gjendje të deklaronin faktet në lidhje me të me siguri. Tekstet shkollore për Luftën Atdhetare i kushtojnë vetëm kapitujt përfundimtarë kësaj teme, të cilat paraqesin shkurtimisht rrjedhën e viteve të luftës, pa ndalesa të mëdha dhe shpjegime edhe për tema më të rëndësishme sesa demarkacioni në Prevlakë. Përmendja dhe informimi për Prevlakë në mediat kroate gjithashtu nuk është i zakonshëm. Gjatë hulumtimit, u gjetën artikuj dhe raporte të shumta të gazetave, kryesisht me tema paqësore, ku politikanët kroatë dhe malazezë kërkuar një zgjidhje paqësore të problemit, duke vlerësuar marrëdhëniet e mira midis dy vendeve. Takimi i ish kryeministrave Milanović dhe Djukanović në vitin 2014 rezultoi me një artikull të gazetës në të cilin mund të lexohet se mosmarrëveshja për kufirin nuk do të zgjidhet kaq shpejt, por që nuk do të ndikojë në kërkimet në Adriatik ose anëtarësimin e Malit të Zi në NATO dhe Bashkimin Europian.<sup>225</sup> Menjëherë pas kësaj, në vitin 2016, Presidentja e Republikës së Kroacisë, Grabar-Kitarović, bëri thirrje për përpjekje për një marrëveshje para se çështja të paraqitet përpara Gjykatës Ndërkombëtare.<sup>226</sup> Sipas disa raporteve të mediave, është e qartë se Mali i Zi ka frikë nga skenari kroato-sllloven, në të cilin Kroacia do të përpiqej të përfitonte në çështjen e Prevlakës duke bllokuar hyrjen e Malit të Zi në Bashkimin Europian.<sup>227</sup>

Momentalisht në fuqi është Protokollin i Përkohshëm midis Qeverisë së Republikës së Kroacisë dhe Qeverisë Federale të Republikës Federale të Jugosllavisë për Regjimin e Përkohshëm përgjatë Kufirit Jugor midis dy vendeve, të nënshkruar më 10 dhjetor të vitit 2002, duke rezultuar me tërheqjen e forcave të OKB-së të cilat kanë qenë të vendosura në Prevlakë që nga viti 1992.<sup>228</sup> Protokollin në tokë favorizon palën kroate dhe e klasifikon tërë territorin si të sajën. Tek kufiri në det, çështja është më ndryshe, ajo devijon në mënyrë të konsiderueshme nga ekuidistanca – pika e demarkacionit të distancës së barabartë me brigjet e të dy vendeve.<sup>229</sup> Për këtë shkak, vetëm në zonën ujore territoriale, Kroacia i lëshon Malit të Zi 52.3 km<sup>2</sup> det deri në njoftimin e mëtutjeshëm në përputhje me rregullin e ekuidistancës. Protokollin në vetvete është në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kroacisë, sepse sipas tij një pjesë e territorit vihet nën autoritet të dyfishtë, duke vendosur kontrolle të përziera kufitare.<sup>230</sup> Është interesant fakti që gjatë hulumtimit nuk kemi arritur të gjejmë tekstin e Protokollit të botuar në internet nga asnjëra palë dhe u detyruam të dërgonim një kërkesë për dërgimin e tij në Ministrinë kroate të Jashtme dhe të Europës.

Rastet e para të shkeljes së Protokolit, shfaqen në vitin 2001, kur Qeveria e Malit të Zi merr vendim për përcaktimin e blloqeve për kërmin dhe prodhim të karbohidrateve në të cilin injoron kufijt e përkohshëm të përcaktuar përmes Protokolit dhe në vend të azimutit 206°, <sup>231</sup> përcaton kufirin përmes azimutit 231° dhe më këtë ujërat territoriale kroate janë zvogëluar për 2020 km<sup>2</sup>, që është më shumë se sa hapësira e Rrethit Dubrovnik-Neretva. <sup>232</sup> Duhet theksuar që as në ato momente ajo nuk bëhet temë e rëndësishme mediatike në jetën publike të Kroacisë. Në vitin 2014, Qeveria e Malit të Zi ndryshon Vendimin e vitit 2011, <sup>233</sup> por vetëm në ujërat territoriale kursa jashtë tyre ende azimuti 231° përbën kufirin. Nga na tjetër, Qeveria e Republikës së Kroacisë në vitin 2014 publikon Konkursin e parë publik për dhënien e lejeve për kërkim dhe eksploatim të karbohidrateve në Adriatik dhe për kufij merr azimutin 206°. Mali i Zi këtë veprim e vlerëson si akt të njëanshëm i cili është në kundërshtim me Protokolin dhe i dërgon notë proteste Sekretariatit të Përgjithshëm të OKB-së. <sup>234</sup>

Çështje e përkufizimit në Prevlakë nuk është mjaft e njohur për publikun kroat dhe shumica e njerëzve nuk ka rast të dëgjoj për këtë në media dhe në mjedisin e vetë ku jeton. Informimi i zvogëluar i publikut mund të sjellë lehtë deri tek hapa të gabuar të politikanëve duke patur parasysh faktin që populli nuk do të reagoj pa marrë parasysh se çfarë hapi ndërmerret. Konsiderojmë që dialogu dhe marrëveshja e dyanshme dhe raportet e mira fqinjësore janë rruga më e mirë për të gjetur zgjidhje në këtë çështje. Në rast të mungesës së marrëveshjes, mbetet që çështja të zgjidhet në gjykata ndërkombëtare. Sido që të zgjidhet çështja e Prevlakës, jemi të mendimit që Republika e Kroacisë është vend mik dhe aleat i Malit të Zi dhe që mund t'i ndihmoj në rrugën e tij europiane.





## **Përkufizimi në Prevlakë: Narrativa malazeze**

---

### *Çështja kobila-terale*

Çështja e Prevlakës – territorit në juglindje të kepit Kobila dhe detit përreth hapet pas përfundimit të luftës në hapësirën e Dubrovnikut në tetor të vitit 1992. Republika e Kroacisë veçse është njohur në atë kohë nga pjesa më e madhe e komunitetit ndërkombëtar dhe është bërë anëtare e Kombeve të Bashkuara forcat e të cilave vijnë në hapësirën e Prevlakas për të mbikqyrur dhe kontrolluar situatën derisa të dy palët të mos gjejnë një zgjidhje përmes marrëveshjes. Janë dashur dhjetë vjet deri tek Protokoll i përkohshëm i cili është në fuqi që gjashtëmbëdhjetë vjet, kurse zgjidhje e çështjes ende nuk është në dukje.

Pravllaka, e cila për shkak të pozitës gjeografike quhet edhe “porta e Bokës”, gjatë viteve të nëntëdhjetë paraqet një pikë të rëndësishme për Malin e Zi. Që nga fillimi i luftës, pushtetit politik malazez e konsideronte Prevlakën territor të tij dhe ku nuk duhej lejuar prezenca e ushtarëve kroat për shkak të vendodhjes së rëndësishme strategjike.<sup>235</sup> Si argument kryesor është dhënë prezenca ushtarake në gadishullin e Pravllakës qysh nga koha e Austro-Hungarisë dhe që asnjë qytetar nuk ka mundur të ketë asnjë qasje në Pravllakë, as atëherë dhe as gjatë kohës së Jugosllavisë së vjetër dhe të re.<sup>236</sup> Juridiksioni i Armatës Popullore Jugosllave vë në dyshim parimet e Komisionit të Badinterit, i cili thotë se kufijtë ndër-republikanë bëhen kufij shtetërorë. Disa politikanë shkuan më tej, duke kërkuar krijimin e kufijve të ri. “Mali i Zi ka mbrojtur dhe vazhdon të mbrojë idenë që kufijtë ekzistues midis republikave jugosllave të mbeten të pandryshuara (...). Nëse Jugosllavia shpërbëhet, dhe tashmë po shpërbëhet, dy republika janë larguar, atëherë korrigjimi i kufijve do të jetë i nevojshëm dhe i pashmangshëm”. – ka deklaruar Nikola Samardžić në seancën e 9-të të Parlamentit të Malit të Zi të mbajtur më 7 tetor 1991.<sup>237</sup> Dihet edhe deklarata e Milo Djukanovićit nga viti 1991

se do të tërhiqen kufij të rinj dhe më logjikë me Kroacinë, të cilët do të spostohen shumë më në veriperëndim se Prevlaka.<sup>238</sup> Si argument, ai gjithashtu i referohet faktit se certifikatat e pronësisë dhe të dhënat kadastrale janë lëshuar në Herceg Novi dhe Kotor.<sup>239</sup>

Ushtari i fundit u largua nga kazemat e APJ-së në Prevlakë më 20 tetor 1992, duke respektuar marrëveshjen Čosić-Tugjman dhe duke ia dorëzuar objektet misionit të Kombeve të Bashkuara.<sup>240</sup> Në fillim të vitit 1996, u formua një mision special i quajtur UNMOP - United Nations Mission of Observers in Prevlaka, i cili mbeti në zonën e Prevlakas deri në vitin 2002.<sup>241</sup> Ndërkohë, një Marrëveshje për normalizimin e marrëdhënieve midis Republikës së Kroacisë dhe Republikës Federale të Jugosllavisë u nënshkrua në Beograd në 23 gusht të vitit 1996, e cila ka përcaktuar që problemet e kufirit të zgjidhen në mënyrë paqësore, me marrëveshje dhe pa kërcënime dhe përdorim të forcës.<sup>242</sup> Përkundër kësaj, forcat e OKB-së refuzojnë të tërhiqen derisa të dy palët të arrijnë një marrëveshje të përbashkët. Ndërkohë, pala jugosllave insiston që Kombet e Bashkuara të mbesin derisa të arrihet një marrëveshje për të shmangur tensionet dhe rrezikuar paqen, ndërsa pala kroate bën presion që Misioni të përfundojë sa më shpejt të jetë e mundur. Marrëveshja u arrit dhjetë vjet pas fillimit të misionit të Kombeve të Bashkuara dhe paqes në Prevlaka, kur të dërguarit e RF Jugosllavisë dhe Republikës së Kroacisë nënshkruan Protokollin midis Qeverisë së Republikës së Kroacisë dhe Qeverisë Federale të Republikës Federale të Jugosllavisë për një regjim të përkohshëm përgjatë kufirit jugor në mes të dy vendeve. Protokollin u nënshkrua në vitin 2002, duke çuar në tërheqjen e forcave të Kombeve të Bashkuara. Marrëveshja merret me juridiksionin mbi territorin e kontestueshëm në Prevlakë dhe çështjen e regjimit të përkohshëm. Protokollin është ende në fuqi.

“Nuk ka asgjë të re në procesin e bisedimeve për kufirin mbi Prevlakë. Të dy palët mbeten të përkushtuara ndaj marrëveshjes që kjo çështje të zgjidhet përpara Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë në Hagë, pa nxitim, por edhe pa ngadalësim – ka thënë Milan Roćen, ministër i atëhershëm i punëve të jashtme të Malit të Zi.<sup>243</sup> Në terma praktikë, demarkacioni i papërfunduar është një problem i madh, si në vitin 2014, kur Mali i Zi dhe Kroacia shpallën tenderë për eksplorim të energjisë së nëndetëshme pranë këtij gadishulli. Profesoresha e së drejtës publike ndërkombëtare në Mal të Zi, Ivana Jelić, e cila është edhe anëtare e komisionit të delimitimit, beson që Kroacia përmes tenderit për vetësoi 1.800 kilometra katrorë të diskutuar, gjë që sipas mendimit të saj është e paligjshme, sepse ajo është një zonë



e diskutueshme.<sup>244</sup> Megjithëse qeveritë e të dy vendeve tregojnë se kjo çështje nuk rëndon marrëdhëniet e tyre, analistët thonë se fillimi i procedurave para Gjykatës Ndërkombëtare për të Drejtën e Detit, e cila është me qendër në Hamburg, është alternativa më e mundshme.<sup>245</sup>

Mosmarrëveshja për Prevlakan midis Malit të Zi dhe Kroacisë ishte një pikë kthese pozitive në marrëdhëniet bilaterale midis dy vendeve, të cilat filluan negociata paqësore dhe serioze menjëherë pas luftës. Të dy vendet kanë arritur të bien dakord për parimet themelore për zgjidhjen e çështjeve të rëndësishme në lidhje me Protokollin e Zgjidhjes së Përkohshme. Sidoqoftë, fakti i keq që mbetet është se 16 vjet pas nënshkrimit të Protokollit, një zgjidhje e përhershme dhe përfundimtare nuk është gjetur. Nuk jemi dakord me qëndrimin se nuk duhet të nxitojmë për të zgjidhur këtë çështje, sepse Prevlaka ka një rëndësi të madhe për Malin e Zi dhe siç është kontrollon hyrjen në Gjirin e Kotorrit dhe çdo vonesë vetëm na dëmton. Është shumë e rëndësishme për Malin e Zi, si një vend kandidat për anëtarësim në Bashkimin Europian, që kjo çështje përfundimisht të mbyllet dhe të përfundojë, në mënyrë që të mos kemi probleme me bllokimin e anëtarësimit nga Kroacia si një shtet anëtar. Edhe pse kemi dëgjuar garanci nga të dyja palët se kjo nuk do të ndodhë, zgjidhja sa më e shpejtë e kësaj mosmarrëveshje do të sjellë dobi të ndërsjellë, në mënyrë që situata të ngjashme të mos përsëriten, pasi cituam shembullin e shpalljes së tenderëve për hulumtime të energjisë nënujore. Kjo ishte në dëm të të dy palëve, sepse përveç shkaktit të mosmarrëveshjeve midis shteteve, kjo gjithashtu refuzon investitorët seriozë. Ne jemi të mendimit që të dy vendet duhet të bëjnë përpjekje serioze dhe tregojnë vullnet të mirë në mënyrë që të arrijnë më në fund një zgjidhje për këtë çështje.





## **Prevlaka:** **Narrativa e përbashkët**

### *Çështja e (pa)zgjidhur*

Gadishulli Prevlaka ndodhet në pjesën jugperëndimore të hyrjes të Gjirit të Kotorrit dhe është zona kufitare midis Kroacisë dhe Malit të Zi. Pas përfundimit të luftës në Kroacinë jugore në vitin 1992, zona detare dhe tokësore e Prevlakas u bë një çështje kufitare midis Republikës së Kroacisë dhe Republikës Federale të Jugosllavisë, të cilën Mali i Zi e trashëgoi pas rikthimit të pavarësisë së tij në vitin 2006.

211

Argumenti kryesor i palës kroate në këtë mosmarrëveshje është lidhja e gadishullit Prevlaka me qytetin e Dubrovnikut, pra me Republikën e Dubrovnikut që nga viti 1419, kur ajo e bleu atë.<sup>246</sup> Prevlaka atëherë u bë kufiri jugor i Republikës së Dubrovnikut, i cili u ruajt deri në rënien e Republikës dhe ardhjen e sundimit francez dhe austriak. Edhe sot e kësaj dite është ruajtur toponimi Konfin, që në latinisht dhe italisht do të thotë “kufi”.<sup>247</sup> Në shekullin XX, zona e Dubrovnikut ndryshoi njësitë administrative dhe autoritetet, por Prevlaka ishte gjithnjë e lidhur me Dubrovnikun, kurse në RSFJ ajo i përkiste Republikës Socialiste të Kroacisë.<sup>248</sup> Në anën tjetër, ekzistojnë dy argumente të paraqitura nga pala malazeze në këtë çështje. Për shkak të vendndodhjes gjeografike strategjike, gadishulli Prevlaka u përdor për qëllime ushtarake gjatë Perandorisë Austro-Hungareze. Ai u përdor për këto qëllime edhe gjatë Luftës së Dytë Botërore, por edhe gjatë RFSJ-së përkatësisht RSFJ-së. Juridiksioni i drejtpërdrejtë i ushtrisë, pra Armatës Popullore Jugosllave, parandalon zbatimin e plotë të parimeve të Komisionit të Badinterit, i cili thotë se kufijtë ndër-republikanë bëhen kufij shtetërorë. Gjithashtu, megjithëse pronësia dhe të dhënat kadastrale nga pala kroate janë në vënë në dyshim, argumenti malazez është se ato janë lëshuar në Herceg Novi dhe Kotor.<sup>249</sup>

Luftimet e para në jug të Kroacisë filluan më 1 tetor 1991, kur Armata Popullore Jugosllave filloi sulmin në zonën nga Lugina e

Neretvës deri në Prevlaka. Përplasjet midis dy palëve zgjatën për një vit, dhe në tetor të vitit 1992 zona e njëjtë çlirohet nga forcat ushtarake kroate. Megjithëse forcat e Armatës Popullore Jugosllave largohen nga kazemat dhe zona e gjerë e Prevlakës, nuk janë forcat ushtarake kroate ato që vijnë në vend të saj, por misioni i Kombeve të Bashkuara.<sup>250</sup> Me rezolutën e fillim vitit 1996 vendoset një mision special i quajtur UNMOP - United Nations Mission of Observers in Prevlaka (Misioni i Vëzhguesve të Kombeve të Bashkuara në Prevlakë),<sup>251</sup> i cili qëndron në Prevlakë deri në vitin 2002. Ndërkohë, pala jugosllave insiston që forcat e Kombeve të Bashkuara të qëndrojnë derisa të arrihet një marrëveshje midis dy palëve për shkak të rrezikut për paqen, ndërsa pala kroate bën presion për t'i dhënë fund Misionit në Prevlakë.<sup>252</sup> Të dy palët arritën një marrëveshje në fund të vitit 2002 dhe të dërguarit e RF Jugosllavisë dhe Republikës së Kroacisë nënshkruan një Protokoll midis Qeverisë së Republikës së Kroacisë dhe Qeverisë Federale të Republikës Federale të Jugosllavisë për një regjim të përkohshëm përgjatë kufirit jugor midis dy vendeve. Marrëveshja u nënshkrua në Konfin më 10 dhjetor të vitit 2002, duke rezultuar në tërheqjen e forcave të OKB-së. Megjithëse konceptualisht i përkohshëm, Protokollin është në fuqi deri më sot.

Me protokoll rregullohet juridiksioni i përkohshëm mbi territorin e zonës së Prevlakës dhe detin përreth. Toponimi Konfin është marrë si pikë demarkacioni, në zonën në veri të tij juridiksionin do ta ushtrojë RF e Jugosllavisë, kurse në zonën në jug-perëndim të tij Republika e Kroacisë. Kufiri në det gjithashtu fillon nga kepi Konfin, nga ku është tërhequr linja drejt pikës në distancë 3 kablllo (rreth 550 metra) nga kepi Oshtro përgjatë vijës kepi Oshtro - kepi Vesllo. Nga kjo pikë, kufiri lëviz drejt detit të hapur, i cili përcjell azimutin prej 206°<sup>253</sup> Kufiri detar në këtë mënyrë nuk ndjek pikën e demarkacionit të distancës së barabartë me brigjet e të dy shteteve - ekuidistancën. Për pasojë gjatë zbatimit të Protokollit Republika e Kroacisë i lë Malit të Zi 52.3 km<sup>2</sup> det.<sup>254</sup> Krijimi i ekuipazhit të përzier policor në patrollimet me anije është theksuar gjithashtu si një tipar i pazakontë i protokollit, i cili çon në pushtet të dyfishtë që është në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kroacisë.<sup>255</sup>

Me krijimin e Malit të Zi të pavarur në vitin 2006, ai shtet ka trashëguar rregullat e Protokollit nga RF e Jugosllavisë. Nga ana malazeze, ekziston frika e bllokimit të anëtarësimit të Malit të Zi në Bashkimin Europian nga Republika e Kroacisë si një shtet anëtar nën kushtëzime për Prevlakën, megjithëse politikanët nga të dy anët sigurojnë që



një skenar i tillë nuk do të materializohet. Rastet e para të shkeljes së dispozitave të Protokollit ndodhën në vitin 2011 kur Qeveria e Malit të Zi morri vendim për eksplorimin dhe prodhimin e hidrokarbureve nga shtrati i detit në të cilin nuk tërhiqet kufiri sipas azimutit 206° dhe me këtë dëmton Republikën e Kroacisë për sa më shumë që 2020 km<sup>2</sup>. Në vitin 2014, Qeveria e Malit të Zi ndryshoi pjesërisht vendimin,<sup>256</sup> por vetëm për ujërat territoriale, ndërsa jashtë tyre ajo vazhdon të veprojë në dëm të Republikës së Kroacisë. Nga ana tjetër, Qeveria e Republikës së Kroacisë gjithashtu ka shpallur tender për eksplorimin dhe shfrytëzimin e hidrokarbureve në Adriatik dhe merr azimutin prej 206° si kufi. Anëtarja e komisionit të demarkacionit, njëkohësisht profesoreshë e së drejtës ndërkombëtare, Ivana Jelić, beson se Republika e Kroacisë ka përvetësuar në mënyrë të paligjshme deri në 1.800 kilometra katrorë det, sepse zona në fjalë është ajo që kontestohet.

Protokolli i Përkohshëm është në vitin e tij të gjashtëmbëdhjetë në fuqi, përkundër theksimit të politikanëve nga të dy palët se është duke u punuar në zgjidhjen e kësaj çështje. Nga ana kroate, një pjesë e madhe e popullsisë nuk ka dijeni për detajet, por edhe për vetë ekzistencën e çështjes së Prevlakës, e cila mund të vinte në rrezik interesat kroate. Publiku malazez është mjaft i ndarë në lidhje me këtë temë nëse e injorojmë mungesën e interesit për çështje politike që gjejmë tek publiku kroat. Ne besojmë se çështja e Prevlakës duhet të zgjidhet sa më shpejt që të jetë e mundur, por kryesisht duke u përpjekur për të arritur marrëveshje, ndërsa gjykata ndërkombëtare do të ishte vetëm hapi i fundit. Pavarësisht gjithçkaje, Kroacia dhe Mali i Zi janë vende miqësore me të njëjtat synime dhe për popullsinë e të dy vendeve, bashkëpunimi mund të çojë vetëm në arritje pozitive.





### ■ *Kampi Morinj*

**154** Qyteti i Morinjit.

- <http://web.archive.org/save/https://www.montenegro.com/grad/morinj>  
(Arkivuar më 09.02.2020.)

**155** *Proces suočavanja sa prošlošću u Crnoj Gori slučaj "Morinj"*. 2014. Ur. Marić, Boris. Centar za građansko obrazovanje. Podgorica. Fq. 11.

**156** Bulić, Zdenko. 2003. *Sjećanja dubrovačkih logoraša 1991.-1992.* Hrvatsko društvo logoraša srpskih koncentracijskih logora - Podružnica Dubrovačko neretvanske županije; Dubrovački muzeji – Muzej suvremene povijesti. Dubrovnik.

**157** Të burgosurit janë detyruar të vjelin rrush të paqenë që përpos mundimit fizik ka patur edhe dimension të keqtrajtimit psikik.

**158** *Proces suočavanja sa prošlošću u Crnoj Gori slučaj "Morinj"*. 2014. Ur. Marić, Boris. Centar za građansko obrazovanje. Podgorica. Fq. 11., 37., 45.

**159** Stojanović, Marko. *Logor Morinj u Boki Kotorskoj*. Podgorica.

- <https://web.archive.org/watch?v=vdgyIVSvvMI>  
(Arkivuar më 09.02.2018.)

**160** Ibid.

**161** *Proces suočavanja sa prošlošću u Crnoj Gori slučaj "Morinj"*. 2014. Ur. Marić, Boris. Centar za građansko obrazovanje. Podgorica. Fq. 17. – 19.

**162** Si shembull mund të marrim tekstin shkollor për klasën e 4-të të gjimnazit Hrvoje; Raguž, Jakša. 2006. *Povijest 4*. Meridijani. Samobor. 2nd edition.

**163** Nazor, Ante; Barić, Nikica. 2015. *Domovinski rat, čitanka priručnik za učitelje povijesti u osnovnim školama i nastavnike povijesti u srednjim školama*. Školska knjiga. Zagreb. Kampi i Morinjit përmendet në tre raste – në faqet numër 19 dhe 21, dhe në faqen numër 96 të manualit.



**164** Falënderojmë historianin Zoran Milić për informacionin e dhënë, Intervista me Zoran Mikić 19 gusht 2018.

**165** Ibid.

**166** Đurić, Novica. *Nova istorija po starom udžbeniku*. Beograd.

- <https://web.archive.org/web/20200209213157/http://www.politika.rs/sr/clanak/121246/Region/Nova-istorija-postarom-udzbenuku>  
(Arkivuar më 09.02.2020.)

**167** Documenta. *Potvrđena presuda za zločine u logoru Morinj/Priopćenje*. Zagreb.

- <https://web.archive.org/web/20200209213601/https://www.documenta.hr/hr/potvr%C4%91ena-presuda-zazlo%C4%8Dine-u-logoru-morinj-priop%C4%87enje.html>  
(Arkivuar më 09.02.2020.)

**168** Jovanović, Vladimir. *Ko je osnovao Morinj?* Podgorica.

- <https://web.archive.org/web/20200209214546/https://www.monitor.co.me/ko-je-osnovao-morinj/>  
(Arkivuar më 09.02.2020.)

**169** *Proces suočavanja sa prošlošću u Crnoj Gori slučaj "Morinj"*. 2014. Ur. Marić, Boris. Centar za građansko obrazovanje. Podgorica. Fq. 28. - 29.

**170** *Proces suočavanja sa prošlošću u Crnoj Gori slučaj "Morinj"*. 2014. Ur. Marić, Boris. Centar za građansko obrazovanje. Podgorica. Fq. 29.

**171** Documenta. *Potvrđena presuda za zločine u logoru Morinj/ Priopćenje*. Zagreb.

- <https://web.archive.org/web/20200209213601/https://www.documenta.hr/hr/potvr%C4%91ena-presuda-zazlo%C4%8Dine-u-logoru-morinj-priop%C4%87enje.html>  
(Arkivuar më 09.02.2020.)

---

216

---

**172** Stojanović, Marko. 2006. *Logor Morinj u Boki Kotorskoj*. Podgorica.

- <https://www.youtube.com/watch?v=vdgylVSvMI/>
- <https://web.archive.org/watch?v=vdgylVSvMI>  
(Arkivuar më 09.02.2018.)

**173** Ibid.

**174** *Proces suočavanja sa prošlošću u Crnoj Gori slučaj "Morinj"*. 2014. Ur. Marić, Boris. Centar za građansko obrazovanje. Podgorica. Fq. 21.-24.

**175** Morinj Case.

- <http://media.cgo-cce.org/2014/12/cgo-cce-proces-suocavanja-sa-prosloscu-u-cg-slucaj-morinj.pdf>  
(Arkivuar më 21.08.2018.)

**176** Vukičević, Jasna. 2017. *Mračna prošlost Morinja*.

- <https://web.archive.org/web/20200209215316/https://www.slobodnaevropa.org/a/morinj-logor-crnagora/28884396.html>  
(Arkivuar më 09.02.2020.)

**177** Stojanović, Marko. 2006. *Logor Morinj u Boki Kotorskoj*. Podgorica.

- <https://web.archive.org/watch?v=vdgylVSvMI> (Arkivuar më 09.02.2018.)

**178** Slučaj Morinj.

- <http://media.cgo-cce.org/2014/12/cgo-cce-proces-suocavanja-sa-prosloscu-u-cg-slucaj-morinj.pdf>  
(Arkivuar më August 21st 2018.)

**179** Akcija za ljudska prava. *Predstavljen Izvještaj "Sudenja za ratne zločine u Crnoj Gori"*. Podgorica.

- <https://web.archive.org/web/20200209220216/http://www.hracion.org/2013/05/20/20052013-predstavljenizvjestaj-sudenja-za-ratne-zlocine-u-crnoj-gori/>  
(Arkivuar më 09.02.2020.)

**180** Vukičević, Jasna. 2017. *Mračna prošlost Morinja*.

- <https://www.slobodnaevropa.org/a/morinj-logor-crnagora/28884396.html/>  
(Arkivuar më 09.02.2020.)

### ■ **Bombardimi i Dubrovnikut dhe okupimi i Dubrovnikut dhe zonës së tij**

**181** Čakširan, Vlatko. 2010. *U obrani svjetla – 15 godina Udruge hrvatskih branitelja Hrvatske elektroprivrede 1990. - 1995.*, Aura d.o.o. Sisak. Fq. 15.

**182** Goldstein, Ivo. 2008. *Hrvatska 1918-2008*. Europapress holding – Novi Liber. Zagreb. Fq. 707.

**183** Ibid, Fq. 711.

**184** Intervista me Petar Poljanićem. Shih: Pavlović, Koča. 2004. *Rat za Mir*, documentary film. Nezavisna Produkcijaska Grupa OBALA. Podgorica, 2004.  
Shih: Testimony by Petar Poljanić in trial against Slobodan Milošević.

**185** Intervista me Milo Đukanović. Shih: Pavlović, Koča. 2004. *Rat za Mir*, dokumentarni film. Nezavisna Produkcijaska Grupa OBALA. Podgorica. 2004.

**186** Pavlović, Koča. 2004. *Rat za Mir - dokumentarni film*. Nezavisna Produkcijaska Grupa OBALA. Podgorica.

**187** CARNET. *Nacionalni program za učenje na daljinu „Nikola Tesla“*. Zagreb.

- <https://web.archive.org/web/20200209221408/https://tesla.carnet.hr/>  
(Arkivuar më 09.02.2020.)

**188** Erdelja, Krešimir; Stojaković, Igor. 2015. *Tragom prošlosti 8*. Školska knjiga. Zagreb. Fq. 220. – 229.

**189** Erdelja, Krešimir; Stojaković, Igor. 2015. *Koraci kroz vrijeme 4*. Školska knjiga. Zagreb. Fq. 276. – 281.

**190** Rakonjac, Snežana. 2009. *Prevrat 89' godine (2. epizoda)*. RTCG. Podgorica.

- <https://www.youtube.com/watch?v=bIS82PbRhbQ>  
(Arkivuar më 09.02.2020.)

**191** *Ko je Milo Đukanović? (kratak klip iz psihopatologije).*

- <https://web.archive.org/web/20200207180704/https://www.youtube.com/watch?v=3aPS-RAuoVU&t=440s>  
(Arkivuar më 07.02.2020.)



**192** Đukanović o Hrvatima: Nametnuti rat sa ustašama ćemo dobiti (1991.).

• <https://youtu.be/Wrs4PpOWQEg>  
(Qasur më 09.02.2020.)

**193** Ko je Milo Đukanović? (kratak klip iz psihopatologije).

• <https://web.archive.org/web/20200207180704/https://www.youtube.com/watch?v=3aPS-RAuoVU&t=440s>  
(Arkivuar më 07.02.2020.)

**194** Ibid.

**195** Hina. 2015. *Prije točno 24 godine započelo bombardiranje Dubrovnika*. Zagreb.

• <https://web.archive.org/web/20200209222619/http://hr.n1info.com/Vijesti/a75966/Prije-tocno-24-godine-zapocelobombardiranje-Dubrovnika.html>  
(Archived on 09.02.2020.)

**196** Goldstein, Ivo. 2008. *Hrvatska 1918-2008*. Europapress holding – Novi Liber. Zagreb. Fq. 711.

**197** Čakširan, Vlatko. 2010. *U obrani svjetla – 15 godina Udruge hrvatskih branitelja Hrvatske elektroprivrede 1990. – 1995*. Aura d.o.o. Sisak. Fq. 21.

**198** Goldstein, Ivo. 2008. *Hrvatska 1918-2008*. Europapress holding – Novi Liber. Zagreb. Fq. 712.

**199** 24 sata. *Video: Ovako je počeo rat u Dubrovniku*. Zagreb.

• <https://web.archive.org/web/20200209223336/https://express.24sata.hr/life/video-ovako-je-poceo-rat-u-dubrovniku7340>  
(Arkivuar më 09.02.2020.)

**200** *Dubrovnik: "rat za mir"*. 2006. Ed. Biserko, Sonja. Helsinški odbor za ljudska prava u Srbiji. Beograd. 9, Fq. 266.

**201** Ibid. Fq. 8.

**202** Ibid. Fq. 266.

**203** Interview with Stjepan Mesić. See: Pavlović, Koča. 2014. *Rat za Mir - dokumentarni film*. Nezavisna Produksijska Grupa OBALA. Podgorica.

**204** *Dubrovnik: "rat za mir"*. 2006. Ed. Biserko, Sonja. Helsinški odbor za ljudska prava u Srbiji. Beograd. Fq. 526. – 531.

**205** Ibid. Fq. 18., 51., 55., 69.

**206** Ibid. Fq. 8., 261.

**207** Ibid. Fq. 40. – 46., 61., 84.

**208** Ibid. Fq. 173. – 177., 267., 421., 440. – 445., 513., 550.

**209** Ibid. Fq. 261., 292., 299. – 302., 306., 331.



**210** Ibid. Fq. 323. – 325.

**211** Ibid. Fq. 368.

**212** Ibid. Fq. 164., 169., 171.

**213** Ibid. Fq. 171., 541.

**214** Ibid. Fq. 521., 522.

**215** Ibid. Fq. 11.

**216** Ibid. Fq. 405.

**217** Ibid. Fq. 54., 406., 417.

**218** Ibid. Fq. 432., 542.

**219** Ibid. Fq. 458. – 463., 466., 516.

**220** Ibid. Fq. 511., 584.

**221** Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë për ish Jugosllavinë. *Të dhënat mbi rasti Miodrag Jokić*. Den Haag.

[http://www.icty.org/x/cases/miodrag\\_jokic/cis/bcs/cis\\_miodrag\\_jokic\\_bcs.pdf](http://www.icty.org/x/cases/miodrag_jokic/cis/bcs/cis_miodrag_jokic_bcs.pdf)  
(Qasur më 09.02.2020.)

**222** Dubrovnik: “rat za mir”. 2006. Ed. Biserko, Sonja. Helsinški odbor za ljudska prava u Srbiji. Beograd. Fq. 511., 512.

**223** Ibid. Fq. 588. – 590., 596., 597.

#### ■ **Përkufizimi në Prevlakë**

**224** Hrvatska enciklopedija.hr. 1999-2009. Ur. Brozović, Dalibor; Kovačec, August; Ravlić, Slaven. Leksikografski zavod Miroslav Krleža. Zagreb.

• <https://web.archive.org/web/20200209230420/https://www.enciklopedija.hr/Natuknica.aspx?ID=45836>  
(Arkivuar më 10.02.2020.)

**225** Hina. MILANOVIĆ I ĐUKANOVIĆ “Pitanje Prevlake neće se uskoro riješiti, no to ne smeta istraživanju Jadrana”. Zagreb.

• <https://www.jutarnji.hr/vijesti/hrvatska/milanovic-i-ukanovic-pitanje-prevlake-nee-se-uskoro-rijesiti-no-to-nesmeta-istrazivanju-jadrana/805945>  
(Qasur më 10.02.2020.)

**226** Dnevnik.hr. Grabar-Kitarović o Prevlaci: Bolje se dogovoriti nego ići na sud. Zagreb.

• <https://web.archive.org/web/20200210114756/https://dnevnik.hr/vijesti/hrvatska/kolinda-grabar-kitarovic-oprevlaci-bolje-se-dogovoriti-nego-ici-na-sud---436137.html>  
(Arkivuar më 10.02.2020.)

**227** Direktno.hr. Pitanje Prevlake može postati jedan od uvjeta za ulazak Crne Gore u EU. Zagreb.

• <https://web.archive.org/web/20200210114956/https://direktno.hr/eu-i-svijet/pitanje-prevlake-moze-postati-jedanod-uvjeta-za-ulazak-crne-gore-u-eu-109558/>  
(Arkivuar më 10.02.2020.)

**228** UN. 1992. *UN Resolution 779*.

• [https://web.archive.org/web/20200210115416/https://undocs.org/S/RES/779\(1992\)](https://web.archive.org/web/20200210115416/https://undocs.org/S/RES/779(1992))  
(Arkivuar më 10.02.2020.)

**229** *Protokoll midis Qeverisë së Republikës së Kroacisë dhe Qeverisë Federale të Republikës Federale të Jugosllavisë mbi Regjimin e Përkohshëm përgjatë Kufirit Jugor midis Dy Shteteve u nënshkrua më 10 dhjetor 2002.*

**230** Pavić, Radovan. 2010. *Raščlamba Protokola u svezi s granicom između Republike Hrvatske i Crne Gore*. Geoadria, Vol. 15 No. 2.

**231** *Hrvatska enciklopedija.hr*. 1999-2009. Ur. Brozović, Dalibor; Kovačec, August; Ravlić, Slaven. Leksikografski zavod Miroslav Krleža. Zagreb.

• <https://web.archive.org/web/20200210120651/https://www.enciklopedija.hr/Natuknica.aspx?ID=4929>  
(Arkivuar më 10.02.2020.)

**232** Barić Punda, Vesna; Filipović, Valerija. 2015. Protokol o privremenom režimu uz južnu granicu (2002.) s potrebnim osvrto na odluke vlada Republike Hrvatske i Crne Gore o istraživanju i eksploataciji ugljikovodika u Jadranu. *Poredbeno pomorsko pravo*, Vol. 54, No. 169.

• [https://web.archive.org/web/20200210120428/https://hrcak.srce.hr/index.php?show=clanak&id\\_clanak\\_jezik=212997](https://web.archive.org/web/20200210120428/https://hrcak.srce.hr/index.php?show=clanak&id_clanak_jezik=212997)  
(Arkivuar më 10.02.2020.)

**233** Ibid.

**234** Vlada Crne Gore. *Crna Gora štiti svoje interese u morskom području u skladu sa međunarodnim aktima*. Podgorica.

• <https://web.archive.org/web/20200210120029/http://www.gov.me/vijesti/143243/Crna-Gora-stiti-svoje-interese-umorskom-podrucju-u-skladu-sa-medunarodnim-aktima.html>  
(Arkivuar më 10.02.2020.)

**235** *Dubrovnik: "rat za mir"*. 2006. Ur. Biserko, Sonja. Helsinški odbor za ljudska prava u Srbiji. Beograd. p. 308

**236** Ibid. Fq. 22.

**237** Ibid. Fq. 376.

**238** Đukanović o Hrvatima: *Nametnuti rat sa ustašama ćemo dobiti (1991.)*.

• <https://youtu.be/Wrs4PpOWQEg>.  
(Qasur më 09.02.2020.)

**239** Kovačević, Živorad. Simić, Predrag. 2004. *Međunarodno pregovaranje*. Diplomatska akademija MSP SCG. Beograd. Fq. 317.

**240** OKB. 1992. *Security Council Resolution 779*.



**241** OKB. 1996. *Security Council Resolution 1038*.

**242** *Agreement on the normalization of relations between the Republic of Croatia and the Federal Republic of Yugoslavia Jugoslavije*. 1996. Belgrade.

**243** RTS. *Slučaj Prevlaka, drugi deo*. Beograd.

<https://web.archive.org/save/http://www.rts.rs/page/stories/sr/story/11/region/611191/slucaj-prevlaka-drugi-deo-.html>  
(Arkivuar më 10.02.2020.)

**244** Vijesti.me. *Jelić: Raspisivanjem tendera Hrvatska izašla iz okvira Protokola o Prevlaci*. Podgorica.

• <https://web.archive.org/web/20200210122251/https://www.vijesti.me/vijesti/politika/jelic-raspisivanjem-tenderahrvatska-izasla-iz-okvira-protokola-o-prevlaci>  
(Arkivuar më 10.02.2020.)

**245** Mićunović, Vojislav. 2009. *Primjena propisa Konvencije Ujedinjenih nacija o pravu mora na razgraničenje suverenosti mora i razvoj pomorstva Crne Gore*. Štamparija Obod. Cetinje.

**246** *Hrvatska enciklopedija.hr*. 1999-2009. Ur. Brozović, Dalibor; Kovačec, August; Ravlić, Slaven. Leksikografski zavod Miroslav Krleža. Zagreb.

• <https://web.archive.org/web/20200209230420/https://www.enciklopedija.hr/Natuknica.aspx?ID=45836>  
(Arkivuar më 10.02.2020.)

**247** Dražen, Živić. 1998. *Rt Oštra u povijesti i politici*. Matica hrvatska. Zagreb. Fq. 141.

• <https://web.archive.org/web/20200210122647/https://hrcak.srce.hr/file/31902>  
(Arkivuar më 10.02.2020.)

**248** Bertić, Ivan. 1987. *Veliki geografski atlas Jugoslavije*. Sveučilišna naklada Libar. Zagreb.

**249** Kovačević, Živorad. Simić, Predrag. 2004. *Međunarodno pregovaranje*. Diplomatska akademija MSP SCG. Beograd. Fq.317

**250** UN. 1992. *Rezoluta e Këshillit të Sigurimit*. 779.

**251** UN. 1996. *Rezoluta e Këshillit të Sigurimit*. 1038.

**252** Kovačević, Živorad. Simić, Predrag. 2004. *Međunarodno pregovaranje*. Diplomatska akademija MSP SCG. Beograd. Fq. 318

**253** *Protokolli midis Qeverisë së Republikës së Kroacisë dhe Qeverisë Federale të Republikës Federale të Jugosllavisë mbi Regjimin e Përkohshëm përgjatë Kufirit Jugor midis dy shteteve*, 2002., Konfin

**254** Barić Punda, Vesna; Filipović, Valerija. 2015. Protokol o privremenom režimu uz južnu granicu (2002.) s potrebnim osvrtnom na odluku vlada Republike Hrvatske i Crne Gore o istraživanju i eksploataciji ugljikovodika u Jadranu., *Poredbeno pomorsko pravo*, Vol. 54, No. 169. 2015.

• [https://web.archive.org/web/20200210120428/https://hrcak.srce.hr/index.php?show=clanak&id\\_clanak\\_jezik=212997](https://web.archive.org/web/20200210120428/https://hrcak.srce.hr/index.php?show=clanak&id_clanak_jezik=212997) (Arkivuar më 10.02.2020.)



**255** Pavić, Radovan. 2010. *Raščlamba „Protokola“ u svezi s granicom između Republike Hrvatske i Crne Gore*. Geoadria, Vol. 15 No. 2.

**256** Qeveria e Malit të Zi. *Crna Gora štiti svoje interese u morskom području u skladu sa međunarodnim aktima*. Podgorica.

- <https://web.archive.org/web/20200210120029/http://www.gov.me/vijesti/143243/Crna-Gora-stiti-svojeinterese-u-morskom-podrucju-u-skladu-sa-medunarodnim-aktima.html>

(Arkivuar më 10.02.2020.)

# KOSOVA / SERBIA



KS / SER/ Pristina / 4-7 tetor

225

**255** Pavić, Radovan. 2010. *Raščlamba „Protokola“ u svezi s granicom između Republike Hrvatske i Crne Gore*. Geoadria, Vol. 15 No. 2.

**256** Qeveria e Malit të Zi. *Crna Gora štiti svoje interese u morskom području u skladu sa međunarodnim aktima*. Podgorica.

• <https://web.archive.org/web/20200210120029/http://www.gov.me/vijesti/143243/Crna-Gora-stiti-svoje-interese-u-morskom-podrucju-u-skladu-sa-medunarodnim-aktima.html>  
(Arhivuar më 10.02.2020.)

KS \ SER\ Pristina \ 4 - 7 tetor



# KOSOVA / SERBIA



—  
225  
—







Gjatë hyrjes në sallën kryesore gjatë pjesës së parë të projektit Past Continues (E shkuara e vazhduar) të dy palët e ekipit tonë kishin pritje të mëdha dhe jo të gjithë ishin optimistë, për të thënë të paktën. Shumë prej nesh nuk kishin takuar kurrë një person të kombësisë së kundërt. Të gjithë jemi formuar dhe kemi mësuar për njëri-tjetrin në mënyrën më negative – prandaj ne në fakt prisnim të takonim “armiqtë tanë më të mëdhenj”.

227

Tensionet midis vendeve tona janë ende të thella dhe pasojat e luftës ende mund të ndjehen. Media dhe politikanët tanë i përdorin vazhdimisht këto tensione etnike për të fituar publicitet dhe për të trembur njerëzit për qëllimet e tyre, veçanërisht duke prekur të rinjtë në atë proces. Një nga qëllimet e projektit ishte krijimi i ekipeve të dy grupeve të ardhura nga dy vende të prekura nga luftërat në vitet 90-të dhe gjatë atyre katër ditëve të para frika në grupin tonë u zëvendësuar nga miqësia.

Emri që kemi zgjedhur për grupin tonë është Boro dhe Ramizi - dy burra që përfaqësojnë simbolin e miqësisë serbo-shqiptare dhe unitetit jugosllav. Ata ishin ushtarë që luftuan së bashku kundër okupimit fashist të Jugosllavisë. Në vitin 1943, u kapën nga armiqtë dhe u vranë. Ata vdiqën në përqafimin të njëri-tjetrit, duke refuzuar të ndaheshin deri në fund. Disa histori thonë se ata kishin një lidhje romantike.

Ekipi ynë ishte në dy udhëtime studimore – për shumicën prej nesh, ishte hera e parë që vizituam Beogradin ose Prishtinën. Vizita e parë u bë në Beograd në qershor të vitit 2018 gjatë Festivalit “Miredita, Dobar dan!”, Një festival i ndërtuar rreth skenës kulturore moderne në Kosovë. Artistët nga Kosova patën rastin të shfaqin para publikut serb artin modern të Kosovës. Secilin vit aktivistët e krahut të



djathtë organizojnë protesta sepse mendojnë se festivali promovon pavarësinë e Kosovës. Vizituam zyrat e Nismës së të Rinjëve për të Drejtat e Njeriut, dëgjuam debate për njohjen ndërkombëtare të Kosovës dhe rëndësinë e kësaj në planin e pranimin të Serbisë në BE, shijuan festivalin dhe takuam njerëz të rinj gjatë tërë kësaj.

Vizita e dytë u bë në Prishtinë. Në anën serbe, kishte pritje të përziera – ndjenja të eksitimit, frikës dhe thirrjeve telefonike të vazhdueshme nga familjet tona të shqetësuara. Por vizita në vetvete doli të ishte një nga përvojat më domethënëse në projektin Past Continues – përvojat ishin gjithçfare, përpos negative. Morrëm shumë informacione të vlefshme për narrativat – vizituam muzetë, qendrat informative, biseduam me ish-presidenten Atifete Jahjaga, sollëm kuti me emrat e personave të zhdukur nga Kosova te presidenti dhe kryeministri, vizituam Graçanicën dhe, mbi të gjitha, thyem të gjitha stereotipet tona dhe dëshmuam që miqësitë serbo-shqiptare në të vërtetë janë të mundshme.

Në këtë kapitull, kur flasim për narrativat e Kosovës, i referohemi diskursit dhe perspektivës mbizotëruese të shqiptarëve të Kosovës. Kur flasim për narrativën serbe, i referohemi diskursit mbizotërues të mediave dhe retorikës së liderëve politikë në shtetin e Serbisë. Popullsia serbe në Kosovë përfaqëson një element të rëndësishme dhe për këtë arsye ajo përfshihet si pjesë e Republikës së Serbisë sepse qëllimi ynë ishte të përfaqësonim konfliktet midis dy grupeve etnike.

## ***Fushata e NATO-së – Operacioni i Forcave Aleate: Narrativa e Kosovës***

---

### ***Çlirimi***

Pas pothuajse një dekade të tërë shtypjeje nga regjimi serb i udhëhequr nga Slobodan Milošević dhe lufta e përgjakshme që mori jetën e mijëra njerëzve, ndërsa gjithashtu shpërnguli më shumë se gjysmë milioni shqiptarë nga Kosova, më 24 mars 1999, Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO) filloi sulmet ajrore mbi bazat dhe pozicionet e ushtrisë serbe në krahinën jugosllave të Kosovës. Sidoqoftë, rrënjët e problemit që sollën tek ndërhyrja e NATO-s janë shumë më të hershme.

229

Në vitin 1974, gjatë udhëheqjes së Josip Broz Titos, si pjesë e Republikës Federale Socialiste të Jugosllavisë, Kosovës iu dha një autonomi më e madhe dhe ajo veproi pak a shumë si një shtet i pavarur. Sidoqoftë, gjatë fundit të viteve 80-të, kur Slobodan Milošević ishte president i Lidhjes së Komunistëve të Serbisë, ai premtoi rivendosjen e sundimit serb në Kosovë.

Autonomia e Kosovës, e dhënë me Kushtetutën e vitit 1974 u hoq dhe shqiptarët u detyruan të largohen nga sfera publike në fillim të viteve 90-të duke u dëbuar nga vendet e tyre të punës. Kjo çoi në ngritje të tensioneve që vërtetuan idenë se shqiptarët nuk mund të jetojnë më nën sistemin politik jugosllav. Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK) u formua dhe filloi të sulmojë policinë serbe në Kosovë. Trupat serbe filluan një ofenzivë në vitin 1997, duke vrarë dhjetëra civilë dhe kjo shkaktoi ofenzivën e UÇK-së e cila vendosi kontrollin mbi gjysmën e territorit. Trupat serbe dëbuan mijëra shqiptarë nga shtëpitë e tyre.

Masakra e Reçakut më 15 janar 1999, ku u vranë 45 civilë shqiptarë,<sup>257</sup> alarmoj komunitetin ndërkombëtar i cili më pas reagoi me përpjekjet për të mbledhur të dy palët në tryezë të bisedimeve në Rambuje. Pasi NATO kishte kërcënuar Miloševićin me fillimin e sulmeve ajrore, dhe



pasi bisedimet e Rambujesë midis serbëve dhe shqiptarëve në vitin 1999 përfunduan me dështim, NATO filloi vendosjen e trupave dhe me sulmet ajrore si përpjekje e fundit që ndaloj spastrimin etnik nga regjimi i Miloševićit dhe solli çlirimin. Fushata zgjati shumë më tepër sesa pritej për shkak të rezistencës së regjimit të Milosheviqit për t'u tërhequr. Gjatë kësaj periudhe, veprimet ushtarake dhe paraushtarake serbe ndaj popullatës shqiptare u intensifikuan, duke rezultuar në një numër masakrash të tmerrshme dhe dëbim masiv të popullatës në drejtim të Shqipërisë dhe Maqedonisë. Fushata e bombardimeve të NATO-s përfundoi më 10 qershor 1999, kur forcat serbe u tërhoqën nga territori i Kosovës dhe u vendos administrata ndërkombëtare për një fazë kalimtare. Trupat e NATO-s u trajtuan si heronj nga popullata e mbetur civile dhe të tjerët që u kthyen gjatë kapitullit të ri të Kosovës së çliruar pas ndërhyrjes.

Sidoqoftë, perspektiva shqiptare për bombardimet e NATO-s ka tendencë të nënvlerësoj një aspekt të rëndësishëm; faktin që gjatë këtij operacioni, “sulmet e NATO-s vranë gjithsej 754 njerëz: 454 civilë dhe 300 anëtarë të forcave të armatosura. 207 civilë ishin të përkatësisë serbe dhe malazeze, 219 ishin shqiptarë, 14 civilë ishin romë dhe 14 ishin të kombësive tjera. Nga radhët e pjesëtarëve të forcave të armatosura, u vranë gjithsej 274 pjesëtarë të VJ/MUP të Serbisë dhe 26 pjesëtarë të UÇK-së”.<sup>258</sup> Për viktimat flitet rrallë në publik, si as në publikime, pasi ato konsiderohen si “dëm kolateral” që eklipsohet nga rezultati më i madh i tërheqjes së forcave serbe.

Në Kosovë, dy dekada më vonë, bombardimet e NATO-s ende konsiderohen si një ngjarje e rëndësishme që ndaloj genocidin dhe terrorin e regjimit serb ndaj shqiptarëve etnikë. Ky diskurs mund të gjendet pothuajse kudo, nga librat shkollorë deri tek deklaratat publike të politikanëve. Përvjetori i bombardimeve të NATO-s ende përkujtohet çdo vit në Kosovë. Politikanët, në përvjetorin e bombardimeve të NATO-s i referohen ndërhyrjes si “humanitare dhe akt solidariteti”, ndërsa nuk harrojnë të shprehin mirënjohjen e tyre për shtetet që e bënë këtë të ndodhte.<sup>259</sup> Në pyetjen nëse ndërhyrja humanitare apo sovranitet i vendit peshon më shumë, nuk ka dyshime tek pala shqiptare. Siç thotë Leon Malazogu në “Të kuptuarit e luftës në Kosovë”, “ndërhyrja domethënëse humanitare nuk kërcënon rendin botëror. Përkundrazi, ajo vërteton parimet themelore për të cilat u krijuan Kombet e Bashkuara”.<sup>260</sup> Shqiptarët në Kosovë vazhdojnë të kenë një qasje pozitive ndaj NATO-s, duke pasur shpresë dhe aspirata që Kosova së shpejti do të bëhet pjesë e aleancës Veri-Atlantike si



një anëtar i barabartë i familjes së madhe. Vetëm 3% e qytetarëve të Kosovës e shohin NATO-n si një kërcënim, ndërsa një shumicë prej 90 përqind e popullsisë e konsiderojnë atë si mbrojtje, siç tregon sondazhi i Gallupit në vitin 2016.<sup>261</sup>





## ***Fushata e NATO-së – Operacioni i Forcave Aleate: Narrativa serbe***

---

### ***Operacion i paligjshëm***

Një nga çështjet më të diskutueshme të historisë së re të Serbisë është sigurisht bombardimi i territorit të ish-Jugosllavisë nga NATO-ja. Bombardimi zgjati nga 24 marsi deri më 10 qershor 1999. Sot ekzistojnë ende shumë pyetje të hapura në publikun serb për këtë ngjarje – pse ishim të bombarduar, çfarë kishte ndodhur më parë, numri i viktimave, nëse kjo ishte një ndërhyrje humanitare apo një veprim kriminal, etj.

233

Megjithëse ka shumë kundërthënie në lidhje me të gjitha aspektet e bombardimit, ekzistojnë narrativa mbizotëruese me të cilat, besojmë, pajtohet shumica e popullatës serbe. Kjo perspektivë është paraqitur në librat shkollorë të historisë për shkollat fillore dhe të mesme, por edhe në librat shkollorë nga, për shembull, sociologjia për Fakultetin Juridik ku thuhet: “Një shembull tipik i migrimeve të detyruara ishte eksodi i serbëve nga Kroacia në vitin 1995 pasi ushtria e Kroacisë sulmoi Republikën Serbe Krajina dhe persekutimi masiv i serbëve nga Kosova dhe Metohia në vitin 1999 pas agresionit të NATO-s kundër Serbisë”.<sup>262</sup> Fjala “agresion” këtu është fjala kryesore për të kuptuar narrativën serbe në lidhje me ndërhyrjen e NATO-s. Shumica e njerëzve në Serbi, nga të paarsimuarit tek ata më të arsimuarit, besojnë se ndërhyrja e NATO-s ishte një agresion dhe një ndërmarrje kriminale që synonte dëbimin e serbëve nga rajoni i Kosovës dhe krijimin e një shteti të pavarur të Kosovës. Në këtë drejtim, hapësira për manipulim me informacione rreth fushatës së NATO-s është shumë e madhe. Nga viti në vit, në çdo përvjetor të bombardimeve, numri i viktimave manipulohet, në mënyrë që fushata e NATO-s të paraqitet si krimi më i keq në historinë serbe. Shembujt që i shoqërojnë këto qasje janë fjalimet e politikanëve serbë në përkujtimet vjetore për viktimat:

“Agresioni i NATO-s kundër Serbisë është një krim i tmerrshëm, një



krim për të cilin askush nuk është ndëshkuar, një krim kundër një kombi të lirë, sovran, një populli që me historinë dhe jetën e tij nuk e ka merituar një krim kaq të tmerrshëm. Ne nuk mund ta harrojmë, as nuk mund ta falim. Nuk e di nëse ndokush që mori pjesë në agresionin e NATO-s kundër popullit serb është ndëshkuar për atë që bënë – jam gati i sigurt që jo. Për sa kohë që askush nuk ndëshkohet, për sa kohë që asnjë njeri nuk pendohet për vdekjen e këtyre njerëzve në spital, përderisa dikush nuk pendohet të paktën për të gjitha këto mijëra vdekje gjatë agresionit të NATO-s në Serbi, ne nuk do të jemi në gjendje të themi se gjithçka është pas nesh. Nuk mund të harrojmë, as nuk mund të falim. Nëntëmbëdhjetë vjet më vonë ende jemi duke e marrë veten nga pasojat e agresionit të NATO-s, ende po rindërtojmë atë që është shkatërruar, ende po përpiqemi të shërojmë plagët, ende po mundohemi t'i harrojmë, por nuk mund t'i harrojmë dhe nuk mund t'i falim”.<sup>263</sup>

Sigurisht, roli i mediave në tërë këtë narrativë është tepër i madh. Qëndrimi ndaj bombardimeve të NATO-s në mediat serbe ndryshon shumë. Media pro-qeveritare, pro-ruse, anti-perëndimore e ushqen këtë retorikë anti-NATO. Një nga mediat më të spikatura pro-qeveritare në Serbi dhe një prej gazetave të përditshme pro-ruse “Informer”, në përvjetorin e bombardimeve në vitin 2018, ka publikuar një artikull me titullin: “NATO ËSHTË E KEQJA MË E MADHE!” Ratko Bulatović, viktimë e bombardimeve i intervistuar në këtë artikull, thotë: “Ata vranë me dashje civilët në Serbi në vitin 1999”.<sup>264</sup>

Gazeta ruse Sputnjik kontribon shumë në perceptimin e viktimizmit serb të bombardimeve kriminale të NATO-s. Kjo agjenci e lajmeve është e njohur për përhapjen e lajmeve të bujshme dhe përhapjen e ndikimit të madh pro-rus në publik, kështu këtë vit në shënimin e fillimit të fushatës së NATO-s, kishte një artikull me titull: “Balanca e tmerrshme: Serbia u vra me 170 bomba atomike të Hiroshimas”.<sup>265</sup> Një nga rastet më të rëndësishme të viktimitave serbe të bombardimi është vdekja e një vajze dy vjeçare, Milica Rakić.<sup>266</sup> Ajo u vra në shtëpinë e saj ndërsa ishte ulur në oturak nga copat e bombës që ra aty pranë. Ajo më vonë u kanonizua si shenjtore nga Kisha Ortodokse Serbe dhe është një simbol i dëmit të shkaktuar nga agresioni.

Gjatë kryerjes së një hulumtimi të vogël, pyetëm njerëzit nga Serbia, të të gjitha moshave, statuseve sociale dhe niveleve të ndryshme të arsimimit, mbi qëndrimin e tyre ndaj bombave të NATO-s. Kur i pyetën se pse ndërhyri NATO në Serbi në vitin 1999, morrëm kryesisht të



njëjtat përgjigje: “Me qëllim që të dëbojnë serbët nga Kosova; të na helmojë me uranium të varfëruar; në mënyrë që të gjithë të sëmuremi nga kanceri”, etj. Kjo narrativë mbizotëruese që ekziston në Serbi vërteton pikëpamjen për ekzistencën e një urrejtjeje globale ndaj Serbisë dhe serbëve si një komb, kurse arsyeja kryesore e bombardimit është armiqësia e përgjithshme e perëndimi kur bëhet fjalë për Serbinë dhe kombin serb. Sidoqoftë, në këtë pyetje pak njerëz u përgjigjën se ndërhyrjes së NATO-s i parapriu një mori krimesh të tmerrshme kundër shqiptarëve të Kosovës në periudhën midis 1998 dhe 1999 në Kosovë. Ky mini hulumtim pasqyron qartë pikëpamjet e qytetarëve për pranimin e Serbisë në NATO, ku statistikat tregojnë se “rreth 84% janë kundër anëtarësimit, 11% do të mbështesnin anëtarësimin, dhe 5% janë të pavendosur”.<sup>267</sup>





## ***Fushata e NATO-së – Operacioni i Forcave Aleate: Narrativi i përbashkët***

### *Fillimi i drejt i mijëvjeçarit të ri*

Bombardimi i NATO-s në vitin 1999 është një nga shembujt kryesorë të pikëpamjeve të ndryshme midis njerëzve në Serbi dhe njerëzve në Kosovë. Përkundër faktit se kanë kaluar dy dekada nga ajo ngjarje, emocionet nga të dy palët janë ende të gjalla. Në Kosovë, bombardimi i NATO-s përfaqëson një veprim çlirimtar që i dha fund mizorive të kryera nga regjimi serb. Versioni i tregimit të NATO-s bën me kujdes dallimin midis “Jugosllavisë” dhe “udhëheqjes jugosllave”. Javier Solana, ish Sekretar i Përgjithshëm i NATO-s, ka deklaruar se “përgjegjësia e qartë për sulmet ajrore qëndron tek Presidenti Milošević i cili nuk ka pranuar të ndalojë veprimin e tij të dhunshëm në Kosovë dhe nuk ka pranuar të negociojë në mirëbesim”.<sup>268</sup> Sulmet ajrore u portretizuan si “veprime të drejtuara kundër politikave të Miloševićit”. Në Serbi, nuk ka dyshim se bombat e NATO-s ishin akt agresioni nga forcat perëndimore. Kjo narrativë u përhap nga tre faktorë kryesorë: mënyra se si u shkrua dhe u mësua historia pas bombardimeve, modeli i raporteve mediatike gjatë bombardimeve, si dhe në ditët e sotme edhe diskursi politik dhe retorika e politikanëve.

Kur bëhet fjalë për mënyrën se si librat shkollorë në Kosovë dhe Serbi portretizojnë ndërhyrjen e NATO-s në vitin 1999, ndryshimi i këndvështrimeve është i dukshëm. Siç tregon botimi “Historia e Kosovës në librat shkollorë të historisë së Kosovës, Shqipërisë, Serbisë, Malit të Zi dhe Maqedonisë”, diferenca mbetet të jetë e rëndësishme. Fjalimet e politikanëve nga të dy palët janë kryesisht në përputhje me librat shkollorë, ndërsa janë të dukshme notat e larta të popullizmit. Media gjithashtu ka luajtur një rol të rëndësishëm në gdhendjen e opinionit publik duke u rikthyer përsëri në histori, kur i përshtatej interesave të caktuara politike. Sidoqoftë, ka disa pika ku të dy palët bien dakord. Njëra prej tyre është fakti që bombardimi i NATO-s i dha fund një kapitulli specifik të historisë dhe hapi një

tjetër. Ai solli përfundimin e konfliktit në Kosovë ndërsa instaloi një administratë ndërkombëtare për të ruajtur “paqen e brishtë”.

Serbia dhe Kosova nuk duhet të mbeten pengje “të së kaluarës”. Sentimenti publik më nuk duhet të manipulohet duke përdorur historinë e NATO-s. Në vend që të flasim për këtë ngjarje, 20 vjet më vonë, le të përqëndrohemi në shkaqet e atyre konflikteve, si dhe në mënyrat e parandalimit të të rejave.

Si hartues të kësaj narrative të përbashkët, mbështesim fuqimisht bashkëpunimin rajonal. Vetëm në kornizë të bashkëpunimit mund të flasim për të kaluarën. Ne rekomandojmë hetim të përbashkët në lidhje me bombardimet e NATO-s. Në Serbi, ka manipulime kur bëhet fjalë për numrin e viktimave të bombardimeve – në çdo përvjetor të fillimit të sulmeve ajrore, politikanët përmendin numër të ndryshëm të viktimave. Për shembull, ekziston një komision i formuar nga qeveria serbe – komision që punon për përcaktimin e numrit të viktimave dhe dëmeve ekologjike. Nga ana tjetër, viktimat shqiptare të Kosovës nga sulmet ajrore të NATO-s nuk përmenden as kur Kosova shënon përvjetorin e çlirimit. Problemi kryesor është se nuk ka absolutisht asnjë bashkëpunim midis qeverive të Serbisë dhe të Kosovës, i cili do të ishte thelbësor në përcaktimin e fakteve në lidhje me këto ngjarje.

## ***Modeli i krimeve ndaj shqiptarëve të Kosovës: Narrativi i Kosovës***

---

### ***Ne jemi viktima!***

Megjithëse përkufizohej si një provincë autonome e Serbisë dhe jo si republikë, në vitin 1974, së bashku me Vojvodinën, Kosova u bë një pjesë kushtetuese e Republikës Socialiste Federale të Jugosllavisë. Pas vdekjes së Josip Broz Titos, Kosova kishte përfaqësuesit e saj në Presidencën kolektive rrotative e cila mori përgjegjësinë. Kosovës iu dha gjithashtu edhe banka e saj qendrore, policia, sistemi arsimor dhe i drejtësisë, asamblea krahinore dhe dega e saj e partisë së Lidhjes së Komunistëve. Gjatë viteve 80-të, pas vdekjes së Titos, nacionalizmi serb filloi të ngjallej, i promovuar nga Slobodan Miloševići, i cili përfundimisht çoi në heqjen e autonomisë dhënë shqiptarëve gjatë viteve 70-të.

Gjatë gjysmës së parë të viteve 90-të, Kosova u bë një shtet policor nën autoritetin e Beogradit. Pasi autoritetet e Beogradit morrën institucionet krahinore, mijëra shqiptarë të Kosovës u pushuan nga institucionet publike dhe ndërmarrjet shoqërore. Forcat serbe të sigurisë kanë shkëlur vazhdimisht të drejtat e njeriut. Dhuna e policisë, arrestimet arbitrare dhe torturat ishin një dukuri e zakonshme. Pasi morrën institucionet krahinore, autoritetet serbe mbyllën shumicën e shkollave në gjuhën shqipe dhe pushuan së paguari profesorët e shkollave të mesme shqiptare. Shqiptarët e Kosovës filluan të krijojnë pa dhunë institucionet e tyre paralele, siç janë arsimi, shëndetësia dhe sistemi i taksave. Një sistem paralel i shkollave private u organizua në bazë të donacioneve dhe taksave. Studentët shqiptarë vijuan mësimet në shtëpi private, ndërmarrje boshe dhe ndërtesa shkollore të braktisura. Qeveria e Miloševićit nuk lejoi zhvillimin e institucioneve paralele në Kosovë dhe policia serbe vazhdoi të futej në institucionet arsimore dhe institucionet e tjera të shqiptarëve të Kosovës. Anëtarët e forcave të sigurisë keqtrajtuuan, ndaluan dhe rrahën mësuesit, studentët dhe administratorët e shkollave shqipe.



Kjo periudhë konsiderohet nga shqiptarët si një periudhë e “regjimit të egër, totalitar, ushtarak-polikor”, nën të cilin popullsia shqiptare vuajti rëndë.<sup>269</sup>

Izolimi kulturor i Kosovës brenda Jugosllavisë dhe varfëria e saj endemike rezultuan me atë që krahina të kishte nivelin më të lartë si të studentëve ashtu edhe të analfabetëve në Jugosllavi. Arsimi universitar nuk ishte garanci e një të ardhme të suksesshme; në vend të trajnimit të studentëve për karriera teknike, universiteti u specializua në arte liberale, në veçanti në albanologji, që vështirë mund të siguronte punë përveç në burokraci apo institucione kulturore lokale, veçanërisht jashtë Kosovës”.<sup>270</sup> Kjo çoi në trazira masive, kur 14 studentë u vranë dhe 4.200 të tjerë u burgosën, siç raportoi New York Times në vitin 1981. Gjatë kësaj dekade, pasi vdiq Tito, pati shumë raste kur shqiptarët e Kosovës që duhej të kryenin shërbimin e detyrueshëm ushtarak vdiqën në rrethana të dyshimta të cilat nuk u sqaruan kurrë. Aktivistët shqiptarë që punuan në diasporë, si Jusuf Gërvalla, u vranë, sipas dyshimeve nga shërbimi sekret jugosllav. Përkrah raporteve të vazhdueshme të mediave që portretizonin shqiptarët e Kosovës si “terroristë” atë dekadë në Jugosllavi mbizotëronte një klimë pasigurie dhe frike.

240

Gjatë fundit të viteve 90të, përleshjet midis UÇK-së dhe forcave të armatosura serbe u bënë të përgjakshme dhe rezultuan në vrasje masive dhe zhdukje të civilëve dhe pjesëtarëve të UÇK-së. Gjatë luftës, 10812 shqiptarë etnikë humbën jetën - 1392 e viktimave ishin fëmijë ndërsa 296 prej tyre ishin nën moshën 15 vjeçare.

Disa nga shembujt më domethënës të krimeve kundër njerëzimit ishin masakra e familjes Berisha nga Suhareka, sulmi mbi Prekaz, masakra në Reçak, helmimi i gati 7.000 nxënësve etj.<sup>271</sup> Sulmi mbi Prekaz, i njohur edhe si Masakra e Prekazit, ishte një operacion i udhëhequr nga Njësia Speciale Antiterroriste e Serbisë më 5 Mars të vitit 1998, me qëllim të kapjes së pjesëtarëve të UÇK-së, të cilët konsideroheshin terroristë nga serbët. Gjatë sulmit, kreu i UÇK-së Adem Jashari dhe vëllai i tij Hamza u vranë, përkrah 60 anëtarëve të familjes së tyre.<sup>272</sup> Sulmi u kritikua nga Amnesty International, duke pohuar se qëllimi ishte të eliminoheshin familjarët e UÇK-së, kurse nga ana tjetër, Serbia pretendoi se kjo ishte pasojë e sulmeve të UÇK-së ndaj pozicioneve të policisë.

Një moment i madh ndryshimi ndodhi më 15 janar 1999, kur 45

shqiptarë u vranë në fshatin Reçak. Megjithëse sulmi ishte provokuar ndoshta nga një pritë e UÇK-së ku u vranë tre policë serb para disa ditësh, forcat qeveritare u përgjigjën duke qëlluar ndaj civilëve, duke torturuar të arrestuarit dhe duke kryer ekzekutime në grup. Masakra në Reçak u dokumentua mirë nga misioni i OSBE-së dhe u dënua menjëherë nga kreu i misionit, diplomati amerikan William Walker. Qeveria Jugosllave tha se shqiptarët ishin luftëtarë të UÇK-së dhe të vranë në luftë dhe kërcënuan se do të dëbonin Walkerin nga vendi, duke e etiketuar atë si përfaqësues dhe mbrojtës të separatizmit dhe terrorizmit. Më 18 janar, kryeprokurorës Louise Arbor të Tribunalit të Hagës iu mohua hyrja në Kosovë, ku ajo planifikonte të hetonte incidentin në Reçak. NATO i rriti kërcënimet për veprim ushtarak nëse sulmet ndaj civilëve nuk ndalen. Në mesin e 45 viktimave, kishte tre gra dhe një fëmijë 12-vjeçar.

Një tjetër krim i tmerrshëm i kryer nga forcat serbe gjatë luftës në Kosovë është masakra në Suharekë. 48 banorë të qytetit të Suharekës të Kosovës u vranë në mars të vitit 1999 nga forcat e policisë serbe. “46 prej tyre ishin anëtarë të familjes Berisha; 14 prej tyre nën 15 vjeç, përfshirë dy foshnje, si dhe një grua shtatzënë dhe një grua të moshuar. Dy gra dhe një fëmijë i mbijetuan masakrës. Disa nga burrat u qëlluan për vdekje ndërsa të mbijetuarit u detyruan të futeshin në një piceri, u mbyllën dhe ju hodhën granata dore. Ata që treguan shenja jete u qëlluan në kokë dhe u transportuan në një varr masiv në Kosovë, ku u hodhën fillimisht. Trupat u rivarrosën më vonë në qendrën e trajnimit policor në Batajnicë pasi u transportuan nga Kosova në përpjekje të forcave serbe për të mbuluar vrasjet”.<sup>273</sup>

“Në Kosovë, gjatë disa ditëve në mars të vitit 1990, më shumë se 4.000 pacientë, më së shumti fëmijë të shkollave, u sëmurën nga simptoma që kishin treguar se mund të ishin helmuar. Sëmundja misterioze, siç quhej, vazhdoi të godiste popullsinë për pjesën tjetër të vitit dhe me siguri më shumë se 8.000 kosovarë e prekën nga kjo sëmundje”.<sup>274</sup> Pala serbe këtë nuk e konsideronte asgjë më shumë se sa një histeri masive.





## **Modeli i krimeve ndaj shqiptarëve të Kosovës: Narrativi i Serbisë**

---

### *Gjeneralët tanë janë heronjtë tanë*

Në çdo luftë ekziston rregulli i mohimit ose minimizimit të krimeve të kryera. Nuk ka asnjë dallim midis viktimës dhe kriminelit të luftës. Kriminelët shpallen heronj kombëtarë dhe viktimat diskriminohen duke minimizuar ose mohuar vuajtjet e tyre. Sipas Fondit për të Drejtën Humanitare “13.535 njerëz humbën jetën në luftën e Kosovës. Sipas raportit të FDH-së viktimat janë: 10.812 shqiptarë, 2.197 serbë, dhe 526 romë, boshnjakë, malazezë dhe viktima të tjera jo-shqiptare”.<sup>275</sup>

243

Opinion i publik serb nuk di ose nuk dëshiron të dijë për këto krime. Nëse dikush i përmend, atëherë ato përmenden nga dy aspekte – të vetmet viktima në luftën e Kosovës ishin serbët që u vranë dhe u dëbuan nga trojet shekullore serbe. Ose – po, ka pasur krim kundër shqiptarëve në Kosovë, por këto janë krime individuale dhe nuk mund të krahasohen me krime kundër serbëve. Ky diskurs mbizotërues mbështetet nga librat shkollorë të historisë dhe media dhe academia në Serbi, ku nuk ka asnjë fjali për krimet e kryera kundër shqiptarëve të Kosovës në luftën e Kosovës nga viti 1998 deri në 1999. Të vetmet që përmenden janë krimet e kryera kundër serbëve dhe dëbimi i serbëve nga Kosova. Kjo perspektivë fillon të ndërtohet që nga shkolla fillore, përmes shkollës së mesme dhe më në fund në universitet dhe të rinjtë e arsimuar largohen nga universiteti me një pamje të njëanshme dhe pa e ditur se çfarë ka ndodhur me të vërtetë në Kosovë gjatë luftës.

Politikanët serbë, veçanërisht në qeveri, por edhe nga partitë e opozitës, heshtin për këtë për shkak se duan të mbajnë votuesit e tyre. Është më e lehtë për ta të mos i përmendin këto tema, pasi e dinë se do të humbasin një pjesën të votuesve të krahut të djathtë dhe me prirje nacionaliste. Për më tepër, shumë më shqetësuese është mbështetja për kriminelët e dënuar të luftës nga politikanët e pushtetit në Serbi. Për shembull, kriminel i dënuar i luftës, gjenerali Vladimir

Lazarević, i cili ka vuajtur dënimin për pjesëmarrje në ndërmarrje të përbashkët kriminale me gjeneralë të tjerë serbë me qëllim të dëbimit të shqiptarëve të Kosovës – mori nderimet më të larta shtetërore dhe mirëseardhje nga udhëheqja serbe sapo mbërrijti në aeroportin e Beogradit pasi vuajti dënimin.

Lazarevići, përveç që u nderua në Serbi me nderimet më të larta shtetërore, mbajti një ligjeratë në Akademinë Ushtarake më 26 tetor të vitit 2017. Ai më pas deklaroi: “Pranova të jap mësim në Akademinë Ushtarake dhe për mua ky është një nder i madh. Unë kurrë nuk jam fshehur, as gjatë agresionit të NATO-s, madje as tani. Dhe kur shoh se nga kush vijnë kritikrat për angazhimin e ish gjeneralëve të VJ-së, gjithçka është e qartë për mua. Qentë lehin, i merr era...”<sup>276</sup>

Ish Ministri i Mbrojtjes, Bratislav Gašić dhe ish Ministri i Drejtësisë Nikola Selaković me krenari e ftuan kriminelin e luftës Vladimir Lazarević për të mbajtur ligjeratën. Pas këtij skandali, shumë zyrtarë të BE-së, si dhe ambasadori amerikan në Serbi, Kyle Scott, kritikuan këtë ngjarje. Ndaj kësaj, kryeministrja serbe Ana Brnabić përgjigjet: “Gjenerali Lazarević nuk është pedagog në Akademinë Ushtarake, ai u ftua të mbaj një ligjeratë. Kujtoj që Lazarevići shkoi vullnetarisht në Hagë, mori gjykimin, vuajti dënimin, dhe tani është ë njeri i lirë”.<sup>277</sup>

—  
244  
—

Përveç zyrtarëve shtetërorë të Serbisë, të cilët mbështesin pa kushte kriminelët e luftës dhe i trajtojnë ata si heronj, media luan rol dominues në ruajtjen e perspektivës që vetëm serbët ishin viktimat dhe se nuk kishte krime të tjera, përpos atyre të kryera kundër tyre. Shumica e mediave në Serbi, me përjashtime individuale, krijojnë imazhin e serbëve si viktimat dhe shqiptarët si agresorë. Shembulli më i mirë i kësaj është krimi i kryer në Reçak. Të gjitha mediat në Serbi paraqesin pikëpamjen se në krimin në Reçak ishin vrarë pjesëtarët e UÇK-së, duke mohuar se kishte krime të kryera kundër civilëve shqiptarë dhe ka artikuj të tillë si: “Walker sajon krimin në Reçak”, “Clarku i NATO-s: E ka pranuar që jemi bombarduar për një krim fiktiv në Reçak”.<sup>278</sup>

Pra, narrativi mbizotërues i krimeve të kryera ndaj shqiptarëve në Kosovë gjatë luftës 1998-1999 është ai i mohimit absolut. Publiku i gjerë nuk di për këto krime. Shumica e njerëzve e dinë vetëm se serbët u dëbuan masivisht nga Kosova dhe se kundër tyre u kryen krime. Kriminelët e luftës që morën pjesë në dëbim dhe kishin përgjegjësi komanduese për krime, në Serbi trajtohen si heronj kombëtarë,

mbajnë ligjërata, janë aktivë në partitë politike etj.







—  
246  
—



## ***Modeli i krimeve ndaj shqiptarëve të Kosovës: Narrativi i përbashkët***

---

### ***Lavdërimi i heronjve të vërtetë, paraqitja e numrave të vërtetë***

Ekziston një hendek i madh midis perspektivës së Kosovës dhe Serbisë për atë që me të vërtetë ka ndodhur në luftën e fundit në Kosovë. Ana serbe e narrativit thjesht mohon që krimet kanë ndodhur. Njerëzit në Serbi mendojnë se janë kryer krime kundër serbëve dhe ndoshta disa raste të krimeve ndaj shqiptarëve të kryera nga formacionet paramilitare serbe. Në Kosovë, ekziston një situatë e ngjashme – kishte vetëm viktima shqiptare.

247

Ekzistojnë dy aktgjykime në lidhje me krimet ndaj shqiptarëve në Kosovë. Para ICTY, gjykimi i parë për Vlastimir Djordjević, dhe i dyti për Milan Milutinović dhe të tjerët.

Kur bëhet fjalë për Vlastimir Djordjević, kjo çështje ka të bëjë me ngjarjet e ndodhura në Kosovë midis 1 janarit dhe 20 qershorit 1999. Gjatë gjithë kësaj periudhe, z. Djordjević ka qenë Ndhmës Ministër i Ministrisë të Punëve të Brendshme të Serbisë (“MPB-së”). Dhoma Gjyqësore nxori Aktgjykimin më 23 shkurt të vitit 2011. Ajo dënoi z. Djordjević sipas pesë akuzave për krime të dëbimit, akte të tjera çnjerëzore (transferim me forcë) dhe përndjekjeve për shkaqe racore si krime kundër njerëzimit, si dhe vrasje si krimi kundër njerëzimit dhe si shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës. Dhoma Gjyqësore zbuloi se z. Djordjević mori pjesë në një ndërmarrje të përbashkët kriminale me qëllim të modifikimit të ekuilibrit etnik në Kosovë për të siguruar kontrollin serb mbi provincën. Ky qëllim u arrit përmes kryerjes së këtyre krimeve. Dhoma Gjyqësore gjithashtu konstatoi se z. Djordjević ndihmoi dhe nxiti këto krime. Dhoma Gjyqësore dënoi z. Djordjević me 27 vjet burg.<sup>279</sup>

Sa i përket gjykimit të Milan Milutinovićit dhe të tjerëve, Aktgjykimi është një dokument i gjatë, që pasqyron madhësinë dhe

kompleksitetin e kësaj çështje. Procedura gjyqësore filloi me 10 korrik 2006 dhe përfundoi me 27 gusht 2008. Gjatë procedimit Dhoma Gjyqësore dëgjoi dëshminë gojore nga gjithsej 235 dëshmitarë dhe pranoi mbi 4.300 dëshmi. Në kohën e krimeve të supozuara, Milan Milutinović ishte President i Republikës së Serbisë; Nikola Šainović ishte Zëvendëskryeministër i Republikës Federale të Jugosllavisë, ose RFJ; Dragoljub Ojdanić ishte Shef i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Jugosllave; Nebojša Pavković ishte Komandant i Armatës së Tretë të VJ; Vladimir Lazarević ishte Komandant i Korpusit të Prishtinës të VJ; dhe Sreten Lukić ishte Shef i Shtabit të Ministrisë së Brendshme të Serbisë për Kosovën, i referuar si Shtabi i MUP-it. Aktakuza pretendon se secili nga të Akuzuarit ka marrë pjesë në ndërmarrjen e përbashkët kriminale, dhe se në këto role ata kanë ushtruar autoritetin e komandës dhe/ose kontroll efektiv mbi forcat e VJ dhe MUP të përfshira në kryerjen e krimeve të pretenduara.

Ata gjithashtu thuhet se kanë planifikuar, nxitur, porositur ose thënë ndryshe i kanë ndihmuar dhe nxitur këto krime. Kohëzgjatja e gjykimit dhe vëllimi i provave, si dhe madhësia e Aktgjykimit, janë në një pjesë të madhe pasojë e numrit dhe natyrës së akuzave të përfshira në Aktakuzë. Të akuzuarit akuzohen nën çdo formë të përgjegjësisë të përcaktuar në Nenet 7(1) dhe 7(3) të Statutit të Gjykatës për rolin e tyre të supozuar në krime që thuhet se janë kryer midis 1 janarit dhe 20 qershorit 1999 në Kosovë nga forcat e Republikës Federale të Jugosllavisë dhe Republikës së Serbisë, të referuara si forcat e RFJ-së dhe të Serbisë. Në mënyrë të veçantë, të Akuzuarit pretendohet se janë përgjegjës për dëbimin, krime kundër njerëzimit (pika 1); transferim të detyrueshëm si “akte të tjera çnjerëzore”, krim kundër njerëzimit (pika 2); vrasje, krim kundër njerëzimit dhe shkelje të ligjeve ose zakoneve të luftës (pika 3 dhe 4); dhe persekutim, krim kundër njerëzimit (pika 5). Sipas Aktakuzës, i Akuzuari mori pjesë, së bashku me të tjerët, në ndërmarrje të përbashkët kriminale për të modifikuar ekuilibrin etnik në Kosovë për të siguruar kontroll të vazhdueshëm të RFJ-së dhe autoriteteve serbe mbi provincën. Prokuroria pohon më tej se qëllimi i ndërmarrjes së përbashkët kriminale duhej të arrihej përmes një fushate të përhapur ose sistematike të terrorit ose dhunës ndaj popullatës shqiptare të Kosovës, përfshirë krimet e ndryshme të specifikuara në secilën prej pikave të Aktakuzës.<sup>280</sup>

Këto gjykime përbëjnë dokumente të rëndësishme në lidhje me krimet kundër shqiptarëve. Fatkeqësisht, të gjithë këta ish zyrtarë pas daljes nga burgu janë mirëpritur në Serbi si heronj. Ne, si hartues të këtij



narrativi, i dënojmë këto akte dhe besojmë se pas tyre, Serbia duhet të përballlet me të vërtetën dhe një herë e përgjithmonë të ndaloj lavdërimin e kriminelëve të saj të luftës.





## ***Krimet kundër serbëve të Kosovës: Narrativa e Kosovës***

---

### ***Zëri i heshtjes***

Fondi për të Drejtën Humanitare me qendër në Serbi dhe Kosovë ka botuar “Libër Kujtimin e Kosovës”<sup>281</sup> - listën e viktimave të luftës nga janari i vitit 1998 deri më 31 dhjetor 2000. Bazuar në këtë listë të publikuar, 10.812 shqiptarë, 2197 serbë dhe 526 persona të kombësive të tjera janë vrarë ose janë zhdukur.

Bazuar në këto statistika, shumica e viktimave serbe gjatë luftës janë regjistruar si luftëtarë. Por, pas përfundimit zyrtar të luftës, numri i viktimave civile serbe është rritur në mënyrë të konsiderueshme. Arsyet e këtyre krimeve kanë të bëjnë me dështimin e NATO-s për të çarmatosur Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) pas përfundimit të luftës që çoi në një valë dhune kundër civilëve. Edhe pse në Kosovë ishin 45.000 trupa të NATO-s pasi lufta mbaroi zyrtarisht, trupat nuk ishin në gjendje të mbronin civilët etnikë serbë, si dhe rivalët politikë shqiptarë të UÇK-së.

UÇK-ja përmendet në disa raporte që lidhen me krimet e luftës gjatë dhe veçanërisht pas përfundimit zyrtar të luftës në Kosovë. Pavarësisht raporteve, Presidenti Hashim Thaçi këmbëngul se UÇK-ja nuk kishte burgosur apo vrarë kurrë rivalët shqiptarë, masakruar civilët serbë ose kryer krime të tjera të luftës.

Raportet nga organizata të ndryshme si Human Rights Watch, Fondi për të Drejtën Humanitare dhe Këshilli i Europës e lidhin UÇK-në me masakra ndaj civilëve, trafikim të organeve dhe shkatërrimin e kishave dhe monumenteve ortodokse serbe. Sipas raportit të përgatitur nga Dick Marty për Këshillin e Europës, UÇK-ja ishte përgjegjëse për zhdukjen përmes forcës të serbëve dhe shqiptarëve pas ndalimit të paligjshëm, ku disa prej tyre iu nënshtruan torturave, si dhe vjeljes së paligjshme të organeve njerëzore.<sup>282</sup> Zyrtarët shqiptarë të Kosovës



i mohuan këto pretendime. Raporte të tjera për krime kundër civilëve serbë nga forcat e UÇK-së përfshijnë masakra të tilla si Masakra e Liqenit të Radoniqit, Masakra e Gjilanit, Masakra e Kleçkës dhe kampi i burgjeve në Llapushnik. Bazuar në këto raporte, në mars të vitit 2005, gjykata e OKB-së e solli para gjyqit në Hagë Kryeministrin e Kosovës Ramush Haradinaj dhe dy ish-pjesëtarë të tjerë të UÇK-së Idriz Balajn dhe Lah Brahimajn, të akuzuar për krime kundër njerëzimit. Haradinaj dhe Balaj u shpallën të pafajshëm ndërsa Brahimaj u shpall fajtor. Ish pjesëtarët e UÇK-së u kthyen në Kosovë të mirëpritur si hero.

Përveç Tribunaleve Ndërkombëtare, në dhjetor 2010 bazuar në raportin e Dick Martyt për Këshillin e Europës "Trajtimi çnjerëzor i njerëzve dhe trafikimi i paligjshëm i organeve njerëzore në Kosovë",<sup>283</sup> EULEX-i vendosi të krijojë një Forcë Speciale (SIFT) për të hetuar dhe ekzaminuar rastet që përfshijnë krime dhe abuzime të tjera të kryera në periudhën 1999-2000 nga anëtarët e UÇK-së. Marrëveshja për krijimin e Gjykatës Speciale u miratua nga Kuvendi i Kosovës në vitin 2015. Presidenti Thaçi hodhi poshtë raportin e Martyt si dezinformatë, megjithatë, anëtarët e parë të UÇK-së janë thirrur nga gjykata në vitin 2019.

Që nga tërheqja e forcave të armatosura serbe, një numër i madh i serbëve etnikë vendosën të largohen nga territori i Kosovës. Rreth 160.000 serbë të Kosovës u larguan nga Kosova pas bombardimeve të NATO-s. Sipas të dhënave zyrtare demografike, popullsia e qytetarëve serbë ka rënë nga 194.190 (në 1991) në 25.532 (në 2011).<sup>284</sup>

Pasi mbaroi lufta, Kosova u nda nga Serbia dhe ishte qeverisur si protektorat i Kombeve të Bashkuara deri në shkurt të vitit 2008 kur Kosova shpalli pavarësinë e saj. Figurat më të fuqishme politike të Kosovës ishin ish udhëheqësit e UÇK-së - presidenti, kryeministri dhe kryetari i Parlamentit. Ata konsiderohen heronj të luftës. Përveç gjyqeve në Tribunalin e Hagës, ku ish pjesëtarët e UÇK-së u deklaruan të pafajshëm, nga Kuvendi i Kosovës u aprovua Gjykata Speciale për të hetuar figurat e UÇK-së përgjegjëse për krime kundër grupeve të tjera etnike dhe kundërshtarëve politikë gjatë dhe pas luftës 1998-1999. Krimet kundër serbëve dhe grupeve të tjera etnike jo shqiptare mohohen në Kosovë. Perceptimi i përgjithshëm i misionit të UÇK-së ishte çlirimi i Kosovës nga forcat paramilitare dhe ushtarake serbe. Shoqëria kosovare është e vetëdijshme se disa individë në UÇK janë akuzuar se e kanë marrë ligjin në duart e tyre, por ata presin që krimet të vlerësohen si individuale nga të dy palët.

## ***Krimet kundër serbëve të Kosovës: Narrativa e Serbisë***

---

### ***Ne jemi viktima!***

Në Serbi, të gjitha pjesët e shoqërisë, përfshirë mediat dhe politikanët besojnë se të gjitha krimet që ndodhën në Kosovë janë kryer nga shqiptarë e Kosovës. Ata mendojnë se policia dhe operacionet ushtarake serbe ekzistonin vetëm për qëllim të mbrojtjes së serbëve dhe mbrojtjes së sovranitetit serb.

Një nga rastet më të diskutueshme të luftës në Kosovë është “Shtëpia e Verdhë”. Është krimi më i tmerrshëm që u ka ndodhur serbëve gjatë luftërave. Shtëpia e Verdhë ishte emri i qendrës së paraburgimit të paligjshëm në veri të Shqipërisë, ku shqiptarët e Kosovës sillnin serbët e rrëmbyer për t’u nxjerrë organet për trafikim. Pretendimet e para në lidhje me trafikun e organeve u botuan nga ish-prokurorja e Tribunalit të Hagës, Carla del Ponte, në librin e saj “Gjuetia: Unë dhe kriminelët e luftës” („The Hunt: Me and the War Criminals“). Sipas saj, kishte 300 viktime serbe, organet e të cilëve u dërguan në Itali dhe në të gjithë Europën. Organizatorët e këtij krimi janë Hashim Thaçi dhe grupi i Drenicës. Ky krim u mbështet nga bashkësia ndërkombëtare, për shembull politikani francez Bernard Kushner, nga misioni i OKB-së për Kosovën, i cili mohoi ekzistencën e “Shtëpisë së Verdhë”.<sup>285</sup>

Shumë krime të tjera përmenden në publikun e gjerë në Serbi. Ato përkujtohen në çdo përvjetor të atyre krimeve. Për shembull, krimi që përdoret shumë shpesh nga mediat dhe politikanët serbë, është krim në Graçkë të Vjetër. Më 23 korrik 1999, pjesëtarët e UÇK-së kryen një nga krimet më të tmerrshme. Ata vranë 14 fermerë serbë në ara. Për këtë krim askush nuk u akuzua apo gjykua. Gjithashtu, një nga krimet më të mëdha ka ndodhur në Kleçkë, ku 22 civilë u rrëmbyen, u qëlluan dhe u dogjën nga pjesëtarët e UÇK-së. Midis vitit 1997 dhe 1998 ata kryen shumë rrëmbime të civilëve. Gjatë sulmit ndaj Rahovec, rrëmbyen dhe robëruan 43 civilë. Ata u torturuan dhe pastaj u

pushkatuan në grup ose individualisht. Më vonë, trupat e tyre u dogjën në furra të gëlçeres për të fshehur krimet.

Kanë kaluar njëzet vjet nga lufta në Kosovë. Ende ka probleme në Gjakovë, të kthyerit serbë kanë shumë probleme. Atyre nuk ju lejohet të kthehen në Kosovë dhe të vizitojnë varret e familjeve të tyre. Ata sulmohen shpesh kur vijnë në Gjakovë. Pikëpamja mbizotëruese në Serbi mbetet e njëjtë, falë mediave dhe çdo qeverie që nga ajo kohë. Nga këndvështrimi serb – shumica e krimeve u kryen nga UÇK-ja, dhe askush nuk u dënua. Por ndoshta ka pasur edhe disa krime kundër shqiptarëve, por ato janë kryer nga formacionet paramilitare për shembull Çakallët. Kur bëhet fjalë për vendimet që dënojnë komandantët e policisë dhe ushtrisë serbe – Serbia mohon legjitimitetin dhe vlefshmërinë e tyre.



## ***Krimet kundër serbëve në Kosovë: Narrativa e përbashkët***

---

### *Nuk ka drejtësi tranzitore pa bashkëpunim*

Krimet kundër serbëve në Kosovë janë temë me këndvështrime shumë të ndryshme mbi atë që ka ndodhur në të vërtetë. Në Serbi, ekziston një narrativë shumë e njohur që të gjitha krimet që ndodhën në Kosovë janë krime kundër serbëve. Një pakicë e njerëzve duan të flasin për anën tjetër të tregimit – krimet kundër shqiptarëve. Në anën tjetër, në Kosovë, theksi vihet tek viktimat shqiptare. Në këtë situatë, është shumë e vështirë të flitet për atë që kishte ndodhur në të vërtetë dhe të krijohet hapësirë për bashkëpunim.

255

Rasti më i diskutueshëm është çështja “Shtëpia e Verdhë”. Ekziston Hetimi i Gjykatës së Hagës. Më 13 janar 2005, Gjykata e Hagës fillon një hetim mbi tregtinë e organeve, bazuar në objektet e gjetura në shtëpinë e verdhë. Hetimi u quajt “Don Kishoti”. Hetuesit e Tribunalit të Hagës gjetën një larmi objektesh në shtëpinë e verdhë, për të cilat ekzistonte dyshimi i arsyeshëm se ishin përdorur për të nxjerrë organet e serbëve dhe jo-shqiptarëve të rrëmbyer. Ndër objektet e gjetura, kishte kuti plastike, shishe boshe me emrat e ilaçeve të përdorura në ndërhyrjet kirurgjikale (tranxen, chlooraphemical, cinarizine, biscopean), dhe mbetje metalike të ngjasonin me instrumentet kirurgjikale.<sup>286</sup>

Sipas hetimit të kryer nga Prokuroria Serbe e Krimeve të Luftës, ndërhyrjet kirurgjikale mbi viktimat e trafikimit të organeve janë kryer në qendrat shëndetësore ose spitalet e përdorura gjatë luftës për trajtimin e ushtarëve të UÇK-së. Për këtë qëllim u përdorën një pjesë e spitalit në kazermën “Bajram Curri”, një qendër shëndetësore në fabrikën e “Coca-Cola”-së në Tiranë, një spital neuropsikiatrik në burgun numër 320 në Burel dhe një shtëpi private Tropojës, e ashtuquajtura shtëpi e verdhë. Përveç këtyre lokacioneve, Prokuroria serbe kishte marrë të dhëna se ekzistonte një burg i paligjshëm në

minierën e Devës që ndodhej në zonën kufitare midis Kosovës dhe Shqipërisë, njëri skaj i tunelit është në Kosovë dhe tjetri në Shqipëri.<sup>287</sup>

Me 12 dhjetor 2010, Dick Marty dorëzoi një raport në Këshillin e Europës, në të cilin Thaçi ishte emëruar drejtues i grupit mafioz përgjegjës për tregtinë e armëve, drogës dhe organeve njerëzore. Si përgjigje, BE dhe EULEX kanë deklaruar se ata e konsiderojnë raportin si shumë serioz dhe kërkojnë prova të mëtjshme. Thaçi i ka mohuar të gjitha akuzat dhe ka ngritur padi kundër Dick Martyt. Më 11 janar 2011, Dr. Jusuf Sonmez, “kirurgu kryesor” në operacionet e heqjes së organeve të Kosovës, u arrestua në Stamboll.

Më 4 mars 2011, EULEX mori vendim për të filluar procedurën penale në bazë të aktakuzave për trafikim të organeve njerëzore në Kosovë. Aktakuzat janë ngritur kundër Lufti Dervishit, Driton Jiltës, Sokol Hajdinit dhe Ilir Reçajt në lidhje me aktivitetet e tyre në Klinikën “Medikus” në Prishtinë. Në mesin e të dyshuarve është edhe ish sekretari i shëndetësisë Reçaj i cili në mënyrë të kundërligjshme ka lëshuar liçencë për Klinikën “Medikus” në Prishtinë për transplantim të organeve njerëzore. Një nga të dyshuarit është Jusuf Sonmez.

Megjithëse ka shumë çështje kontraverse në lidhje me “Shtëpinë e Verdhë”, si hartues të kësaj narrative mendojmë se një pjesë e rëndësishme e mozaikut serbo-shqiptare është krijimi i një bashkëpunim më të mirë. Do të thotë që nëse duam të jetojmë në një shoqëri më të mirë, duhet të flasim më shumë për të kaluarën. Në këtë rast (“Shtëpinë e Verdhë”), besojmë se mënyra e vetme për të zgjidhur konfliktin është të kemi një hetim të përbashkët. Për shembull, një komision i formuar nga qeveritë serbe dhe kosovare dhe shoqëria civile mund të hetojë plotësisht të gjitha faktet e diskutueshme për çështjen “Shtëpia e Verdhë”. Si rezultat i asaj pune të përbashkët, komisioni do të botonte një raport. Në raport, do të kishte fakte të vërtetuara nga komisioni. Bazuar në këto fakte, gjykatat vendore dhe ndërkombëtare mund të inicojnë procedime.



### ■ *Fushata e NATO-s – Operacioni i Forcave Aleate*

**257** Lambeth, Benjamin S. 2001. *NATO's Air War for Kosovo: A Strategic and Operational Assessment*, RAND Corporation. Santa Monica.

- [https://web.archive.org/web/20200210123630/https://www.rand.org/content/dam/rand/pubs/monograph\\_reports/MR1365/MR1365.ch2.pdf](https://web.archive.org/web/20200210123630/https://www.rand.org/content/dam/rand/pubs/monograph_reports/MR1365/MR1365.ch2.pdf)  
(Arkivuar më 10.02.2020.)

**258** Humanitarian Law Center. *754 Victims of NATO bombing*. Belgrade.

- <https://web.archive.org/web/20200210130140/http://www.hlc-rdc.org/?cat=266&lang=de>  
(Arkivuar më 10.02.2020.)

**259** Konushevci, Arton. *Mirënjohje për NATO-n, 13 vjet pas intervenimit*.

- <https://web.archive.org/web/20200210130011/https://www.evropaelire.org/a/24525874.html>  
(Arkivuar më 10.02.2020.)

**260** *Understanding the War in Kosovo*. 2003. Ur. Bieber, Florian. Daskalovski, Zidas Ed. Frank Cass Publishers. London.

**261** Smith, Michael. 2017. *Most NATO Members in Eastern Europe See It as Protection*.

- <https://web.archive.org/web/20200210125636/https://news.gallup.com/poll/203819/nato-members-eastern-europeprotection.aspx>  
(Arkivuar më 10.02.2020.)

**262** Vuković, Danilo S.; Mitrović, Milovan M. 2016. *Osnovi sociologije prava*. Pravni fakultet. Beograd. Fq. 80.

**263** Tanjug. *Vulin: Ne možemo ni da zaboravimo ni da oprostimo*. Beograd.

- [https://web.archive.org/web/20200210124934/https://www.b92.net/info/vesti/index.php?yyyy=2018&mm=03&dd=24&nav\\_category=11&nav\\_id=1373111](https://web.archive.org/web/20200210124934/https://www.b92.net/info/vesti/index.php?yyyy=2018&mm=03&dd=24&nav_category=11&nav_id=1373111)  
(Arkivuar më 10.02.2020.)

**264** Vukčević, B. 2018. *NATO JE NAJVEĆE ZLO! Ratko Bulatović, žrtva bombardovanja kaže: Oni su 1999. NAMERNO UBIJALI CIVILE U SRBIJI!*. Beograd.

- <https://web.archive.org/web/20200210131056/https://informer.rs/vesti/>



drustvo/374685/nato-najvece-zlo-ratkobulatovic-zrtva-bombardovanja-kaze-oni-1999-namerno-ubijali-civile-srbiji  
(Arkivuar më 10.02.2020.)

**265** Kankaraš Trklja, Mila. *Jeziv bilans: Srbija je ubijana sa 170 atomskih bombi Hirošime*. Beograd.

• <https://web.archive.org/web/20200210131403/https://rs-lat.sputniknews.com/analize/201803241115016453-natobombardovanje-srbija/>  
(Arkivuar më 10.02.2020.)

**266** Telegraf. *LITTLE MILICA WOULD HAVE BEEN 20 YEARS OLD NOW: This child killed by NATO bombs is a symbol of Serbia*. Beograd.

• <https://web.archive.org/web/20200210131708/https://www.telegraf.rs/english/2064250-little-milicawould-have-been-20-years-old-now-this-child-killed-by-nato-bombs-is-a-symbol-of-serbia-suffering-video>  
(Arkivuar më 10.02.2020.)

**267** Beta. *Institut za evropske poslove: Za Srbiju u NATO-u 11 odsto građana*. Beograd.

• <https://web.archive.org/web/20200210130506/https://insajder.net/sr/sajt/vazno/3770>  
(Arkivuar më 10.02.2020.)

**268** Press Statement by Dr. Javier Solana, NATO Secretary General following the Commencement of Air Operations. 24.03.1999.

• <https://web.archive.org/web/20200210130733/https://www.nato.int/docu/pr/1999/p99-041e.htm>  
(Arkivuar më 10.02.2020.)

## ■ Modeli i krimeve ndaj shqiptarëve të Kosovës

**269** Youth Initiative for Human Rights. 2017. *A guide to internal dialogue: Chronology of Kosovo 1974-2017*. Belgrade.

• <https://web.archive.org/web/20200210151644/http://www.yihr.rs/wp-content/uploads/2017/10/Chronology-ofKosovo1-1.pdf>  
(Arkivuar më 10.02.2020.)

**270** Mertus, Julie A. 1999. *The 1981 Student Demonstrations. Kosovo: How Myths and Truths Started a War*. University of California Press. Berkeley.

**271** Bailey, Faith. 2018. *20 years later, faith still burn in Prekaz*. Prishtine.

• <https://web.archive.org/web/20200210132601/https://prishtinainsight.com/20-years-later-fires-still-burn-prekazmag/>  
(Arkivuar më 10.02.2020.)

**272** BBC. *The day Serb police massacred my family*. London.

• <https://web.archive.org/web/20200210132713/https://www.bbc.com/news/av/magazine-31795711/the-day-serbpolice-massacred-my-family>  
(Arkivuar më 10.02.2020.)

**273** Ristic, Marija. *Serbia Reopens Batajnica Mass Grave Probe*. Belgrade.

• <https://web.archive.org/web/20200210132944/https://balkaninsight.com/2014/09/29/serbia-re-opens-investigationinto-batajnica-mass-graves/>  
(Arkivuar më 10.02.2020.)

**274** Wassenius, Göran. *Summary of the poisoning.*

- <https://web.archive.org/web/20200210133202/http://denmystiskasjukdomen.se/en/summary-of-the-poisoning/>  
(Arkivuar më 10.02.2020.)

**275** *Kosovo Memory Book 1998 – 2000 research presentation.* Humanitarian Law Center – Humanitarian Law Center Kosovo. Belgrade – Prishtine.

- [http://www.kosovomemorybook.org/?page\\_id=29&lang=de](http://www.kosovomemorybook.org/?page_id=29&lang=de)  
(Arkivuar më 07.02.2020.)

**276** B92. 2017. *“Psi laju, vetar nosi”; General stigao na predavanje.* Belgrade.

- [https://web.archive.org/web/20200210124332/https://www.b92.net/info/vesti/index.php?yyyy=2017&mm=10&dd=26&nav\\_category=12&nav\\_id=1318417](https://web.archive.org/web/20200210124332/https://www.b92.net/info/vesti/index.php?yyyy=2017&mm=10&dd=26&nav_category=12&nav_id=1318417)  
(Arkivuar më 10.02.2020.)

**277** Tanjug. 2017. *Premijerka: Lazarević je odležao kaznu, pozvan je da održi jedno predavanje na Vojnoj akademiji.* Belgrade.

- <https://web.archive.org/web/20200210124014/https://www.blic.rs/vesti/politika/premijerka-lazarevic-jeodlezao-kaznu-pozvan-je-da-odrzi-jedno-predavanje-na-vojnoj/otzc7g2>  
(Arkivuar më 10.02.2020.)

**278** Titujt e gazetave ditore *Večernje novosti* dhe portalit në internet *Republika*.

**279** Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë për ish-Jugosllavinë. 2014. *Gjykimi ndaj Vlastimir Djordjevic*. IT-05-87/1-A. The Hague.

**280** Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë për ish-Jugosllavinë. 2014. *Gjykimi ndaj Šainović dhe të tjerëve*. IT-05-87. The Hague.

### ■ **Krimet kundët serbëve në Kosovë**

**281** *Kosovo Memory Book 1998 – 2000.* Humanitarian Law Center – Humanitarian Law Center Kosovo. Belgrade – Prishtine.

- [www.kosovomemorybook.org](http://www.kosovomemorybook.org)  
(Qasur më 07.02.2020.)

**282** Këshilli i Europës. 2010. *Inhuman treatment of people and illicit trafficking in human organs in Kosovo.*

- [https://web.archive.org/web/20200207175417/http://assembly.coe.int/committeedocs/2010/20101218\\_ajdoc462010provamended.pdf](https://web.archive.org/web/20200207175417/http://assembly.coe.int/committeedocs/2010/20101218_ajdoc462010provamended.pdf)  
(Arkivuar më 07.02.2020.)

**283** Ibid.

**284** Shih më shumë: • <https://web.archive.org/web/20200207174708/https://ask.rks-gov.net/media/1835/demographicchanges-of-the-kosovo-population-1948-2006.pdf>  
(Arkivuar më 07.02.2020.)

**285** Më shumë në: • <https://web.archive.org/web/20200208164652/https://www.youtube.com/watch?v=7Y5cLML7ZcA>  
(Arkivuar më 08.02.2020.)

**286** Human Rights Watch. 2008. *Kosovo/Albania: Investigate Postwar Abductions, Transfers to Albania*.

- <https://web.archive.org/web/20200207174227/https://www.hrw.org/news/2008/05/04/kosovo/albania-investigatepostwar-abductions-transfers-albania> (Arkivuar më 07.02.2020.)

**287** Telesković, Dušan. *Hirurg Kodra: Presađivali smo organe u bolnici „Majka Tereza”*. Belgrade.

- <https://web.archive.org/web/20200207174440/http://www.politika.rs/sr/clanak/161340/Hirurg-Kodra-Presadivalismo-organe-u-bolnici-Majka-Tereza> (Arkivuar më 07.02.2020.).



# PROTESTAT KUNDËR LUFTËS



263

**286** Human Rights Watch. 2008. *Kosovo/Albania: Investigate Postwar Abductions, Transfers to Albania*.

• <https://web.archive.org/web/20200207174227/https://www.hrw.org/news/2008/05/04/kosovo/albania-investigatepostwar-abductions-transfers-albania> (Arkivuar më 07.02.2020.)

**287** Telesković, Dušan. *Hirurg Kodra: Presađivali smo organe u bolnici „Majka Tereza”*. Belgrade.

• <https://web.archive.org/web/20200207174440/http://www.politika.rs/sr/clanak/161340/Hirurg-Kodra-Presađivalismo-organe-u-bolnici-Majka-Tereza> (Arkivuar më 07.02.2020.).



# PROTESTAT KUNDËR LUFTËS



—  
263  
—









Është e përshtatshme që ky libër të përmbajë një kapitull që mbulon temën e protestave kundër luftës që u zhvilluan në të gjithë ish-Jugosllavinë në vitet 1990. Ndërsa pritja jonë origjinale ishte që temat e zgjedhura për të eksploruar narrativat e përbashkëta do të ishin episodet më kontraverse dhe të diskutueshme të konflikteve midis vendeve ose grupeve të ndryshme, ishte zgjedhja e pjesëmarrësve të përfshinin temën e protestave kundër luftës e cila është mbytur në narrativat mbizotëruese nacionaliste të konflikteve të viteve 90-të. Pjesëmarrësit zgjodhën këtë temë për të “kundërpeshuar të gjithë negativitetin dhe dhimbjen” e krijuar në narrativat mbizotëruese.

Ne, autorët dhe koordinatorët e projektit fillimisht nuk arritëm të parashikonim këtë nevojë të ndjerë nga pjesëmarrësit. Sidoqoftë, sugjerimi i tyre ishte jo vetëm bindës, por ishte thellësisht prekës. Është një përpjekje e qartë për të gjetur ato momente, ato pjesë të tregimit të shëmtuar që është historia jonë e përbashkët e paradokohshme, që meritojnë vlerësim nga të gjithë njerëzit qëllimshëm, pavarësisht “anës” së cilës i përkasin. Dhe jo vetëm kaq - pikërisht këto pjesë të historisë sonë mund të shërbejnë si themel për një të ardhme të çliruar nga urrejtja, pa dhunë, pa shkatërrim dhe dëshpërim.

Fakti i thjeshtë që këta të rinj zgjodhën të merren me këto tema është një akt proteste. Është një akt proteste kundër perspektivës dominuese mbi historinë tonë të afërt; një perspektivë ku qëndrimi kundër dhunës nuk shihet si guxim, por si dobësi.

Pse protestat anti-luftë janë një dimension i shtypur i shpërbërjes së Jugosllavisë? Shkurtimisht: sepse ato kërcënojnë narrativat mbizotëruese nacionalistde të dëshirës uniforme për konflikt (në

shumicën e rasteve interpretohen si një vetëmbrojtje legjitime ose luftëra çlirimtare). Siç shpjegon Barkan, “Për shkak se identiteti i grupit formohet nga perspektiva historike, rrëfimet historike kanë një ndikim të qartë dhe të drejtpërdrejtë mbi identitetet kombëtare”.<sup>288</sup> Vetë ekzistenca e veprimtarëve, ngjarjeve dhe lëvizjeve kundër luftës është në kundërshtim të drejtpërdrejtë me proceset e formimit të identiteteve kombëtare të Bosnjë-Hercegovinës, Kroacisë, Kosovës, Malit të Zi dhe Serbisë që po formësoheshin në luftërat e viteve 90-të. Ato tregojnë se shoqëritë tona nuk ishin asnjëherë aq të unifikuara pas të gjitha akteve të ndërmarra nga ish-udhëheqësit tanë. Ata tregojnë se ka pasur gjithmonë, edhe në kohëra të tilla të errëta, një shkëndijë mosmarrëveshjeje, një potencial për demokraci, një copë bindjeje që çdo person ka rëndësi.

Në esenë e Bosnjë-Hercegovinës do të lexoni mbi ironinë e trishtuar të konfliktit duke filluar gjatë demonstratës kundër luftës me të shtënat e para që kanë vrarë protestueset Olga dhe Suada; eseja kroate tregon iniciativa dhe lëvizje të ndryshme që formuan fushatën kundër luftës në Kroaci; eseja e Kosovës ndryshon nga të tjerat për sa kohë që lëvizja e rezistencës paqësore e udhëhequr nga Ibrahim Rugova ishte e lidhur me luftën për çlirim dhe pavarësi nga dominimi i Serbisë; eseja e Malit të Zi shkruan për disa prej rasteve kryesore të aktivizmit kundër luftës dhe protestave paqësore që përfshinin lutjet për falje nga qyteti kroat i Dubrovnikut; së fundmi, eseja serbe mbulon gjerësisht një mori iniciativash kundër luftës, duke filluar nga dezertimi nga ushtria deri tek aktivitetet paqësore të drejtuara nga gratë.

Historitë e paraqitura këtu nuk janë shterruar të gjitha. Historia kurrë nuk do të dokumentojë çdo akt kundërshtimi ose çdo fjalë që prishi unisonin e perceptuar të thirrjeve për luftë. Por e ardhmja do t'i nderojë të gjithë ata nëse arrin të mësojë mësimet që ofrojnë. Kjo është një përpjekje e tillë.



## Protestat kundër luftës në Bosnje dhe Hercegovinë

---

### „Duam dashuri, jo luftë“

Çështja e angazhimeve kundër luftës në (ish)Jugosllavi është neglizhuar në mënyrë të padrejtë në rrjedhën e ngjarjeve të viteve 90-të. Nga perspektiva e sotme, hulumtimet tregojnë disa nga faktorët kryesorë që e formuan, duke filluar nga roli i domosdoshëm i nënave, përmes anti-militarizmit feminist, aktivistëve të huaj, deri tek roli i rëndësishëm i muzikës.<sup>289</sup> Në përgjithësi, librat shkollorë për shkollat fillore, të mesme ose fakultetet nuk e mbulojnë këtë temë. Më tepër informacione mund të mësohen nga deklaratat e pjesëmarrësve ose nga fotot e vetë ngjarjeve. Për shkak të pasqyrimin të dobët mediatik të këtyre ngjarjeve, ne kemi një mungesë burimesh që flasin sot për protestat në shumicën e qyteteve të Bosnjes dhe Hercegovinës dhe për këtë arsye fokusi është në kryeqytetin Sarajevë.

Kur bëhet fjalë për protestat kundër luftës në Bosnjë dhe Hercegovinë, shembulli më i dukshëm janë protestat në Sarajevë, të cilat ishin akti i vetëm i dukshëm i rezistencës ndaj luftës dhe marrëzisë që ajo mbart. Kjo ndoshta nuk është një rastësi, veçanërisht duke marrë parasysh që Sarajeva, në ish-Jugosllavi, ishte sinonim i multikulturalizmit dhe bashkëjetesës. Lëvizja e harruar paqësore në Jugosllavi ndoshta e ka arritur kulmin me rock koncertin në Sallën Olimpikë Zetra të Sarajevës më 28 korrik 1991. Për shkak të motit të keq, koncerti në minutën e fundit u zhvendos në Zetra. Kompanitë e taksive të Sarajevës transportuan mijëra njerëz falas nga vendndodhja e tij origjinale në hapësirë të hapur. Kishte një turmë të paparë prej 30.000 njerëzish në Zetër, ndërsa rreth saj kishte 50.000 njerëz që erdhën për të dëgjuar programin nga jashtë. Koncerti u organizua dhe transmetua nga stacioni televiziv jugosllav Yutel dhe koncerti u emërua “Yutel për Paqe” (“Yutel za Mir”).<sup>290</sup> “Yutel për Paqe” ishte kulmi i protestave të mëparshme paqësore në Jugosllavi që bashkoi aktivistët kundër luftë nga i gjithë vendi me grupet më të njohura jugosllave të rockut

në përpjekje kolektive për të shpëtuar Jugosllavinë nga lufta dhe shkatërrimi.

Në kohën e koncertit të Zetra, lufta 10-ditore në Slloveni sapo kishte mbaruar dhe viktimat e para kishin rënë në konfliktin në Kroaci. Nëntë muaj më vonë, lufta godet Bosnjën dhe Salla Sportive Zetra digjet nga predhat nga pozicionet ushtarake që rrethuan Sarajevën. Në kontekstin e këtyre ngjarjeve katastrofike, turma që këndon për paqen në Jugosllavi në koncertin e Zetra 1991 mund të duket naive dhe e parëndësishme. Sidoqoftë, numri i njerëzve në koncertin kundër luftës dhe prania e intelektualëve dhe yjeve të rokut të shquar Jugosllav tregojnë se “Yutel për Paqe” ishte gjithçka tjetër përveçse ngjarje marginale. Në verën e vitit 2016, ka filluar projekti ZETRA për mbledhjen e kujtimeve të pjesëmarrësve në këtë veprim qytetar dhe shprehjen e vullnetit për paqe siç u pa nga protagonistët e brezave të ndryshëm të luftërave në vitet 90-të, tani të shpërndarë nëpër botë. Projekti Zetra synonte të shënonte këtë ngjarje dhe të informonte njerëzit brenda dhe jashtë vendit për rëndësinë e saj.

Jadranka Pejaković Hlede, e cila si një vajzë 13-vjeçare në vitin 1991 mbledhi 11.586 nënshkrime paqeje me miqtë e saj nga Tuzlla, gjithashtu ndau kujtimet e saj: “11.586 nënshkrimet e mia të paqes ishin një utopi dhe është me të vërtetë qesharake kur kujtoj me çfarë besimi i kam mbledhur, ajo ishte puna ime, çdo ditë nga mëngjesi në mbrëmje, ishte mision. Më kujtohet saktësisht se si nisi ky tregim, çfarë po mendoja edhe ku isha ulur kur vendosa të filloj aksionin. Tregimi shumë shpejt u bë më i madh nga sa prisja. Por nëse asgjë tjetër, ata 11.586 njerëz më lanë me besim në racën njerëzore”.<sup>291</sup> Nenad Pejić, drejtori i TV Sarajevës në atë kohë, përshkruan në kolonën e tij “Si nuk arrita ta ndaloj luftën në Bosnjë” sesi ai dhe kolegët e tij përdorën përpjekjen e fundit për të parandaluar konfliktin.

Në prill të vitit 1992, vetëm disa ditë para fillimit të rrethimit dhe konfliktit, TV Sarajeva vendosi të transmetojë “Marshin e Paqes” që ishte rezultat i një revolte të 40 studentëve kundër luftës dhe u shndërrua në një demonstratë masive në mijëra. Pejić thekson se pas vendimit të TV Sarajevës për të transmetuar protestat, mori një telefonatë direkte nga Radovan Karadžići: “Ju, z. Pejić, po përgatitni një grusht shteti!”, bërtiti ai në telefon. “Ju dëshironi që Bosnja të del nga Jugosllavia! Serbët nuk do ta lejojnë kurrë këtë. Ju po inkurajoni njerëzit kundër Jugosllavisë dhe duhet të ndaloni programin!” Citati i mëparshëm përshkruan reagimin e Karadžićit ndaj përpjekjeve për



të ndaluar luftën. Më 5 prill, numri i protestuesve u rrit në 100.000, u sollën parulla me mesazhe paqeje dhe u kërkua dorëheqja e të gjitha partive në pushtet në parlamentin e atëhershëm. Pasi protestat u rritën, pasoj thirrja e Izetbegovićit: “Z. Pejić, ajo që ju dhe televizioni po përpiqeni të bëni nuk do të ndodhë. Ju dëshironi të mbani BiH në Jugosllavi. Ju inkurajoni njerëzit të dalin në rrugë. Ju po përpiqeni të përmbysnit një qeveri të zgjedhur ligjërisht!”<sup>292</sup> Duke parë reagimet e Radovan Karadžićit dhe Alija Izetbegovićit, përfundimi i pashmangshëm është se paqja nuk kishte prioritet për asnjërin.

Anëtarët e APJ-së të urdhëruar nga SDS qëlluan nga çatia e Holliday Inn në drejtim të protestuesve. Pas protestave në Marijin Dvor, protestuesit e mbledhur u drejtuan për tek Ura e Vrbanjës. Snajperët e pozicionuar hapën zjarr dhe vranë studentet e mjekësisë Suada Dilberović dhe Olga Sučić në urë. Duke biseduar me një dëshmitar në protestat e vitit 1992, zbuluam sa vijon: “Ne shkuam në protesta dhe ishim të bindur se kështu zgjidhet gjithçka, se nuk do të kishte luftë, pse do të kishte një të tillë? Kur Olga dhe Suada ranë, mendova se kjo ishte thjesht një incident. Unë kurrë nuk i pashë prindërit e mi më të hutuar, për një kohë të gjatë më pas nuk mund të kuptonim se çfarë po ndodhte dhe pse po ndodhte. Paradoksi mizor dhe mbase sekuenca logjike e ngjarjeve politike në Bosnje dhe Hercegovinë, çoi tek viktimat e para të konfliktit, ato ranë në një protestë kundër luftës, ku qytetarët luteshin për paqe dhe kërkonin dashuri në vend të luftës. Ata nuk morën dashuri. Ajo që morën ishin të shtënat e snajperëve që vranë Olgën dhe Suadën. Snajperët ishin në shumë mënyra një sinonim i atmosferës në Sarajevë gjatë 4 viteve të ardhshme.

Fotografitë e protestave në Sarajevë janë pjesë e ekspozitës së Milomir Kovačević Strašni që përcolli protestat në vitin 1992. Ekspozita e fotografive u shfaq në vitin 2012 në Galerinë e Arteve të BiH. Kur u pyet se si i përjetoj protestat kundër luftës, ai përgjigjet: “Sikur torturohej nga ndonjë ndjenjë e keqe, të gjithë vepruan dhe donin të jetonin së bashku, duke mos ditur saktësisht se çfarë do të ndodhte me vendin dhe qytetin e tyre. Pak naivë, të rinj dhe të moshuar, punëtorë dhe intelektualë, gra dhe burra u mbledhën, duke inkurajuar dhe ngushëlluar njëri-tjetrin se asgjë e tmerrshme nuk mund të ndodhte dhe që zërat e tyre do të dëgjoheshin... u përpoqa, përmes lenteve të mia, të kapja këtë atmosferë unike të ankthit të përhapur, por edhe shpresat e sinqerta dhe të thella të qytetarëve të të gjitha besimeve të bashkuar në përpjekjen e fundit për t'u dëgjuar dëshira e tyre për të jetuar në paqe”.<sup>293</sup>



Me përjashtim të rastit të TV Sarajevës, të cilin nuk mund ta përcillni të gjithë qytetarët e BiH, protestat kaluan pa u vërejtur atë vit. Duke pasur parasysh natyrën e tubimit, duke qenë spontan dhe i paplanifikuar, shumica e qytetarëve të BiH nuk kishin informacion në lidhje me ngjarjen. I njëjti model ndjek edhe protestat në qytete të tjera të vendit të asaj kohe, atje shumica e të anketuarve sot nuk e dinë që kishte protesta të organizuara në Beograd, Podgoricë, Zagreb, Cetinje, etj.

Sa më shumë që përmes historisë, arsimit ose tregimit të luftes përmenden termat “fitues” dhe “humbës”, kur shohim përtej perceptimit strategjik, në çdo luftë, të gjithë janë në të vërtetë humbës. Çdo luftë lidhet me një numër të madh të njerëzve të humbur, ushtarëve dhe civilëve dhe familjeve të humbura. Pasojat ndihen për shumë vite me radhë, në të gjitha sferat e ndryshme të shoqërisë. Le të shohim dhe mendojmë për një botë pa luftëra, le të përqendrohemi në bisedime dhe diplomaci. Të ndërtojmë dhe vlerësojmë paqen. Të mësojmë nga këta njerëz që dëshironin të parandalonin luftën. Të mendojmë si ata.

## *Përpyekjet kundër luftës në Kroaci*<sup>294</sup>

---

### *Përballë luftës*

Nëse përmendim periudhën e shpërbërjes së Jugosllavisë, asociimet më të zakonshme janë luftërat dhe betejat, ushtarë nga anë të ndryshme, çështja e fajit dhe përgjegjësisë, krimet dhe autorët e tyre. Herë pas here, përmenden edhe qytetarët, por ata mbeten të bllokuar në vizionin e viktimës - si të pafuqishëm ose pasivë, si ata që u rrëmbyen nga shakullima e luftës ose që ishin me fat dhe që i shpëtuan luftës. Në mënyrë që të dalim nga një kornizë e tillë, ne duhet ta zhvendosim fokusin tonë kërkimor pikërisht në sfera përtej luftës dhe vuajtjeve, në jetën e përditshme të qytetarëve në luftë, si dhe dimensionet individuale të asaj jete të përditshme. Duke trajtuar tema të tilla, ne mund të hedhim dritë mbi mënyrat e ndryshme në të cilat njerëzit janë përpjekur të kontribuojnë në krijimin e kushteve për një jetë normale dhe për një të nesërme më të mirë. Një temë e tillë është lindja e shoqërisë civile dhe aktivizmit në vitet 90-të dhe një nga lëvizjet më interesante të aktivistëve në këto rrethana ishin sigurisht lëvizjet dhe iniciativat kundër luftës dhe ato paqësore. Sigurisht, këto lëvizje nuk janë risi të shekullit të 20-të, aq më tepër fundit të tij dhe prishjsë së Jugosllavisë. Idea e promovimit të paqes mund të gjendet në shumë fe dhe filozofi dhe lëvizjet e para informale mund të gjenden që në fillim të shekullit të 19-të. Sidoqoftë, ndikimi në rritje i luftërave mbi civilët dhe shkeljet e papara të të drejtave të njeriut në shekullin e 20-të zhvilluan lëvizjet kundër luftës në gjysmën e dytë të atij shekulli në një formë që është e njohur për ne sot. Kështu, Kroacia ishte gjithashtu e vetëdijshme për iniciativat civile gjatë Jugosllavisë, por në një kuptim më modern ato shfaqen vetëm gjatë liberalizimit të viteve 80-të. Këto ishin kryesisht grupe informale të mbledhura rreth çështjeve të ekologjisë, feminizmit dhe pacifizmit.<sup>295</sup> Nuk është çudi, pra, që kur nacionalizmat dhe konfliktet e para u intensifikuan në fillim të viteve 90-të, iniciativat ekzistuese filluan Fushatën Kundër Luftës.

Para se të vazhdojmë me vetë iniciativën, duhet t'u japim pak hapësirë rrethanave që i shtynë aktivistët të fillojnë ose të bashkohen me lëvizjen. Duke pasur parasysh periudhën e shkurtër kohore (për historianët), dëshmitë e aktivistëve rreth kësaj periudhe nuk janë të vështira për t'u gjetur. Pra, kur aktivistët përshkruajnë atmosferën në vitin 1991, ata përmendin homogenizimin dhe militarizimin nacionalist të përhapur, paligjshmërinë, vrasjet politike, faljet dhe mobilizimin e kriminelëve, dëbimet, prishjen e monumenteve antifashiste, kontrollin e medias, revizionizmin historik, gjuhën publike të urrejtjes, pëshpëritjen e fqinjëve rreth snajperëve që përgjojnë nga rrokaqiejt, civilët që publikisht bartin armë dhe skenave të tjera të shumta, të cilat po bëheshin gjithnjë e më të zakonshme nga dita në ditë.

Duhet të shtojmë ndërkaq se përvojat e atyre që u bashkuan me Fushatën Kundër Luftës janë të ndryshme. Nuk është aspak një grup unik dhe homogjen, përkundrazi - pikërisht Fushata Kundër Luftës është kthyer në një hapësirë grumbullimi për një gamë të tërë njerëzish që kanë vendosur të kundërshtojnë luftën, domethënë - të ndryshëm, “të tjerët”. Por të gjithë kishin besim se lufta duhet të ndalet dhe se nuk ishte një mjet me të cilin mund të arrinim paqen. Në këtë pikë, është gjithashtu e rëndësishme të theksohet ndryshimi midis aktivistëve kundër luftës dhe atyre paqësor, një dallim i cekur nga Bojan Bilić në tekstin e tij, “Ecje në tel të hollë: Artikulimi i Angazhimit Kundër Luftës në Kroaci në fillim të viteve 90-të”.<sup>296</sup> Aktivistët kundër luftës e kundërshtojnë luftën e padrejtë ose të panevojshme, pra luftën në rrethana të caktuara. Nga ana tjetër, për aktivistët paqësor ose pacifistët, lufta nuk është e pranueshme, pavarësisht nga situata, sepse dhuna është e papranueshme në çdo formë. Për shembull, aktivistët kundër luftës mund të mbështesin ndërhyrjen e shpejtë dhe të ashpër ushtarake të huaj që do t'i jepte fund një lufte të gjatë, ndërsa aktivistët e paqes nuk mund të mbështesnin një veprim të tillë, pavarësisht nga rrethanat.

Në këto rrethana, një grup i vogël aktivistësh kundër luftës dhe paqësor nga Zelena akcija Zagreb (Veprimi i Gjelbërt Zagreb) më 4 korrik 1991, filloi një fushatë kundër luftës dhe me atë rast u dërgoi “Thirrje të bregnosurve dhe të gjithë njerëzve të vullnetit të mirë: Të Parandalojmë Luftën!” Në të u paralajmërua për kërcënimin nga “kasaphanja e përgjithshme” në hapësirën tonë dhe theksojnë ndjenjën e frikës së prindërve për jetën e fëmijëve të tyre. Ata thonë se njerëzit në këtë rajon kanë nevojë për jetë dhe se ajo duhet të jetë më e vlefshme se çdo ideologji dhe qëllim politik për të cilin të rinjtë



dërgohen për të vdekur. Në tubimin themelues morën pjesë Dražen Nikolić, Vesna Teršelić, Zoran Oštrić dhe Vladimir Lay. Të nesërmen, Zoran Oštrić kishte shkruar Kartën e ARK-së, të nënshkruar nga 900 persona nga 21 vende dhe mbi 90 organizata nga 20 vende. Numri i organizatave nënshkruese të Kartës gjithashtu pasqyron karakterin e mëvonshëm të Fushatës Kundër Luftës si një rrjet i organizatave civile, shumë prej të cilave kanë mbijetuar deri më sot ose kanë qenë baza për rritjen e organizatave të tjera të sektorit civil.

Nëse shikojmë përmbajtjen e statutit, aty thuhet se konfliktet dikur do të duhet të zgjidhen dhe se kombet e këtyre hapësirave do të duhet të mësojnë të jetojnë së bashku. Ky pozicion vjen nga një nivel kozmopolit, kundër përhapjes së ndarjeve etnike në të gjitha porët e shoqërisë. Artikulon gjithashtu vizionin e një shoqërie për të cilën duhet të përpiqemi - një shoqëri paqeje, demokracie, mirëqenie ekonomike, sociale dhe mjedisore. Duke marrë parasysh që një shoqëri e tillë nuk është krijuar nga lufta dhe dhuna, nënshkruesit e Kartës i hedhin poshtë këto metoda dhe janë të përkushtuar të punojnë së bashku dhe të bashkëpunojnë për zgjidhjen e problemeve, pavarësisht nga ndryshimet në mendimet politike.

---

273

---

Sidoqoftë, edhe pse aktivistët e dinin se kishin nevojë të vepronin, si dhe ishin të sigurt se në cilat vlera donin të bazonin veprimet e tyre, mbeti dilema e rëndësishme se si të veprohet dhe të organizohen veprime specifike në rrethana të luftës, veçanërisht në një vend të sulmuar, me njerëz që duan të mbrojnë shtëpitë e tyre. Problemi thellohet më tej në vjeshtën e vitit 1991, kur u sulmuan Dubrovniku dhe Vukovari. Për këtë arsye, veprimet duhej të ishin më të kujdesshme në mënyrë që të kishin një ndikim më të gjerë shoqëror.

Planet e para të veprimeve më të gjera u hartuan në gusht të vitit 1991 dhe një shënim i takimit mund të gjendet në gazetën e fushatës kundër luftës - ARKzin. Është interesante të përmendet se vetë ARKzin, ku gjetëm informacionin, është një nga platformat për veprim dhe një nga projektet më të suksesshme afatgjata të Fushatës Kundër Luftës. Në botimin o të ARKzin, i cili u botua më 25 shtator 1991, ne mund të gjejmë një raport nga takimi fillestar i “Komitetit për Fushatën Kundër Luftës”. Disa nga veprimet e planifikuara atje ishin: mbledhja e mesazheve të paqes nga figura të shquara vendase dhe të huaja dhe qytetarë që do të ekspozoheshin në Portën e Qytetit të Vjetër, për këto qëllime të quajtur Porta e Paqes, në Zagreb; një telefon kundër luftës që siguronte një makinë automatike me informacione të përgjithshme

mbi opsionet për përfshirje në aktivitete paqeruajtëse dhe një telefon të drejtpërdrejtë të operuar nga një grup vullnetarësh për të siguruar ndihmë për njerëzit e prekur nga konflikti; ndërmjetësimi i grupeve negociuese të parashikuara në bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare, kurse Negociatat e Grave planifikuan bashkëpunimin e feministeve nga Kroacia dhe Serbia; fanzina paqësore, e quajtur më vonë ARKzin, u ngrit nga idea e kundërshtimit të mediave të cilët bojkotonin ose manipulonin informacionet rreth aktivistëve të paqes; dhe kjo ide lidhet dhe është veprimi i fundit për analizën e propagandës së luftës, i cili ishte planifikuar si një veprim i përbashkët kroat dhe serb për të demonstruar manipulim me njerëzit. Në të njëjtin botim të ARKzinit, u botua një tekst i rëndësishëm, “Nëse keni parë një krim lufte...” duke u përpjekur të përcaktojë qartë një krim lufte dhe gjithashtu të sigurojë një formular për mbledhjen e të dhënave mbi krimet e luftës, që tregon se edhe atëherë situata mund të parashikohej në të gjitha zonat e prekura nga lufta. Me kalimin e kohës, aktivitetet u përshtatën me nevojat dhe për këtë arsye duhet të përmendim protestat e ulej gjatë dëbimeve nga banesat, ndihmën ligjore për kundërshtuesit e ndërgjegjshëm (e cila 114 përfundimisht çoi në një organizatë të veçantë të quajtur Union 47<sup>297</sup>), rrjetin e internetit ZaMir dhe shumë projekte dhe veprime të tjera .

Në mënyrë që të japim vetëm një pasqyrë të gjerë (dhe abstrakte) të aktiviteteve të Fushatës Kroate Kundër Luftës, le të ndalemi për një moment në një nga projektet e saj më të suksesshme - Projektin Vullnetar Pakrac. Tashmë duke parë përgjegjësit dhe emrin e projektit, mund të supozojmë shumë - dhe nuk do të gabojmë nëse konkludojmë që ky është një projekt i paqes që përfshin një numër të madh vullnetarësh në Pakrac. Nëse e njohim edhe kontekstin e Pakracit në vitet 90-të, do të kuptojmë se është një projekt që ka shumë potencial.<sup>298</sup>

Sidoqoftë, mund të na mungojnë akoma disa nga informacionet e rëndësishme si p.sh: Projektin Vullnetar Pakrac ishte një projekt partneriteti i Fushatës Kundër Luftës të Kroacisë dhe Zyrës së OKB-së në Vjenë; zgjati nga korriku 1993 deri në vitin 1997, kur projekti u rit në një organizatë të veçantë të shoqërisë civile – Centar za mirovne studije (Qendra për Studime Paqësore); në vitin 1994, partnerë të tjerë u bashkuan me ata fillestar - grupi “Most” (“Ura”) i Qendrës së Veprimi Kundër Luftës nga Beogradi, i cili zgjeroi projektin në anën tjetër të qytetit atëherë të ndarë.



Të gjitha këto informacione duhet të tregojnë pse ky projekt shpesh merret si një shembull i mirë i aktivizmit të mundshëm të paqes. Ishte një përpjekje unike për të ndërtuar paqen në rrethanat e tmerrshme të Pakracit dhe zonës përreth të shkatërruar nga lufta. Partnerët i ndanë qëllimet e tij në ato afatshkurtra - të tilla si sigurimi i kushteve për kthimin e personave të zhvendosur dhe rivendosja e aktiviteteve sociale dhe ekonomike në rajon, si dhe ato afatgjata - të tilla si krijimi i kushteve për paqe, ulja e tensioneve sociale dhe vendosja e marrëdhënieve normale midis komuniteteve kroate dhe serbe (lokale).

Ata planifikuan t'i arrijnë këto qëllime duke ngritur një kamp vullnetar për vullnetarët ndërkombëtarë të cilët erdhën në Pakrac për minimumi tre javë, shumë prej tyre erdhën për shumë më gjatë. Pak para se të mbërrinin në kamp, ata kalonin një kurs të shkurtër dy-ditor në Zagreb. Në Pakrac bënë punë vullnetare duke bërë punë fizike të tilla si rinovimi i ndërtesave, pastrimi i rrënojave, riparimi i dysHEMEVE dhe dritareve në shkolla dhe kisha, mbledhja e misrit, mbledhja e druve për ngrohje, dekorimi i terreneve të lojërave, etj. Ata gjithashtu ishin vullnetarë në aktivitete sociale si kurse të gjuhës angleze, salla lojërash për fëmijë, seminare kukullash, punëtori dramash, zhonglim, programe në radio, takime sportive, ndihmë në kopshte dhe mbremje shoqërore argëtuese në Klubin "Papiga". Këto seri aktiviteteesh demonstrojnë kompleksitetin e projektit, si dhe punën e tij të thelluar për rigjenerimin e komunitetit, sikurse të dimensioneve materiale ashtu edhe atyre sociale. Brenda gjashtë muajve të parë, 79 vullnetarë ndërkombëtarë nga 14 vende bënë punë vullnetare në Pakrac dhe ky numër u rrit në mbi 400 vullnetarë nga mbi 30 vende të ndryshme deri në fund të projektit.

Sipas Mirjana Bilopavlović, një aktiviste nga Pakraci, Projekti Vullnetar i Pakracit ishte përpjekja e parë e paqes në zonën e ish-RSFJ-së, një përpjekje për të vënë në praktikë teorinë në një zonë të prekur nga lufta. Ajo gjithashtu dëshmoi se kur vullnetarët mbërritën, vendasit u rezistuan atyre, duke besuar se ata, si të huaj, nuk kishin të drejtë të ndërhyjnë në problemet lokale. Kjo u shoqërua me mosbesim ndaj motiveve të vullnetarëve, të cilët shpesh perceptoheshin si aventurierë të huaj që vinin për një linjë shtesë në CV-në e tyre. Sidoqoftë, koha ka treguar se ky projekt ka mundur ndërtimin e rrjeteve sociale, bashkimin e familjeve të mbyllura në anët e kundërta të kufirit, ndihmë për ata në nevojë, arsimim për fëmijët dhe më pas popullsinë e gjerë. Ndërtuesit e paqes kanë diskutuar çështjet e ndërtimit të paqes me vendasit, nevojën për veprim dhe komunikim jo të dhunshëm dhe



transformimin e konfliktit. Ata fuqizuan gratë dhe bashkë me to në planin afatgjatë sektorin civil në Pakrac. Ndoshta vlen të përmendet gjithashtu se projekti vetë u bë pjesë e sektorit civil dhe ia kushtoi punën e tij një organizate kushtuar promovimit dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut, promovimit të vlerave jo të dhunshme, drejtësinë sociale, barazinë, pranimin e dallimeve dhe diversitetit. Përkatësisht, vlerave të promovuara nga Projekti Vullnetar Pakrac.

Duhet të përmendet se ky nuk është projekti i vetëm i madh i Fushatës Kroate Kundër Luftës - dhe secili prej tyre meriton një tekst të veçantë.

Kjo lloj pasqyreje mund vetëm të hapë pyetje të reja, por ky është pjesërisht qëllimi i tij. Ndoshta në këtë pikë është e mjaftueshme për të kuptuar se kishte aktivistë që donin të kontribuonin për të mos përdorur armë, të cilët i kushtuan shumë nga jeta ndërtimit të paqes, por edhe sektorit civil në Kroaci, të cilët kanë menduar se çfarë do të ndodh pas luftës. Veprimet e tyre nuk ishin popullore dhe shpesh të padëshirueshme. Ata hasën në keqkuptim nga politika, mediat dhe publiku i gjerë. Prandaj, për të studiuar këtë temë duhet të studiohen mundësitë e organizimit dhe luftimit për ndryshim - nga poshtë, në një sistem kufizues që nuk dëshironte shtrim pyetjesh, devijim dhe ndryshim. Dhe megjithëse aktivistët e Fushatës Kundër Luftës janë vetëm një formë e veprimit të organizuar civil në luftë, veprimet e tyre janë një klithmë nga margjina që fsheh njohuri unike për vitet 90-të, shpesh të neglizhuar dhe të harruar, dhe për këtë arsye të nevojshme për të kuptuar kompleksitetin e kësaj periudhe.

*Nikica Torbica*

## ***Protestat kundër luftës në Kosovë në vitet 90-të***

---

### ***Rezistenca paqësore gjatë luftës***

Përderisa një ngjarje politike solli një tjetër, vitet 90-të dolën të ishin një dekadë shtypjeje për Kosovën, dhe si pasojë dekadë në të shqiptarët e Kosovës demonstroi në rrugë duke kërkuar të drejtat e tyre themelore. Shtypja sistematike e policisë, shkelja e të drejtave të njeriut dhe situata e tensionuar politike që sinjalizoi fillimin e luftes, çoi grupe aktivistësh të fillonin dhe të organizonin protesta kundër luftës. Ka data historike që shënojnë luftën e shqiptarëve të Kosovës për liri dhe pavarësi. Grupe të ndryshme po gjenin mënyra të ndryshme për të treguar refuzimin e tyre ndaj politikës së Jugosllavisë. Ngjarjet si protesta e studentëve në vitet 80-të, greva e minatorëve në fund të viteve 80-të, si dhe grupeve të tjera ishin një sinjal i qartë se shqiptarët e Kosovës po kërkonin haptazi kushte më të mira pune, arsim më të mirë, kujdes shëndetësor më të mirë dhe një jetë të denjë. Këto ngjarje gjatë viteve më vonë do të çonin në nivele të larta të papunësisë (rreth 80% e punëtorëve) për shkak të politikës së Serbisë që do të mbyllte ndërmarrjet ose do të zëvendësonte punëtorët shqiptarë me ata serbë. Kjo rezultoi me një sistem paralel të arsimit, kujdesit shëndetësor dhe gjithçkaje tjetër që është e nevojshme që njerëzit të jetojnë dhe të përparojnë.

“Rezistenca jo e dhunshme dhe organizimi i shoqërisë paralele” dhe “institucionet paralele” si një përgjigje ndaj represionit dhe si mënyrë e zgjidhjes së konfliktit ndëretnik, paraqesin një përvojë shumë specifike, në kontrast me ato që sollën konflikte dhe luftëra në pjesët tjera të Jugosllavisë. Në një periudhë të caktuar, 1990-1997, lëvizja bazë shqiptare u konsiderua nga shumë si një lëvizje unike dhe që mund të shërbejë si model për qetësimin e situatave të konfliktit. Në të vërtetë, përkundër parashikimeve që lufta është e pashmangshme dhe pritjeve që ajo do të ndodhë para atyre në Kroaci dhe Bosnje-Hercegovinë, lëvizja bazë e Kosovës kontribuoi jashtëzakonisht

shumë në shtyrjen e luftës për një periudhë të caktuar”.<sup>299</sup> Rezistenca paqësore e udhëhequr nga Ibrahim Rugova rezultoi e suksesshme edhe për ruajtjen e status quo-së në Kosovë, midis luftës dhe paqes. Marrëveshja e Dejtonit tronditi besimet e shqiptarëve të Kosovës në lidhje me rezistencën paqësore sepse hapi shumë pyetje në lidhje me çështjen e Kosovës. Në ndërkohë, duke qëndruar midis këshillave të Rugovës dhe nevojës për të thyer heshtjen, shumë grupe u organizuan kundër regjimit serb.

Midis grupeve të njerëzve që do të refuzonin paqësisht regjimin serb në vitet 90-të dhe do të kërkonin të drejtat e tyre si njerëz dhe lirinë dhe pavarësinë si komb, ishin studentët dhe gratë. Këto të fundit sot janë më pak të njohura dhe vlerësuara për kontributin e tyre gjatë dhe pas luftës në Kosovë. Kujtesa kolektive e Kosovës pak ose aspak kujton përfshirjen e grave në politikë, iniciativën e tyre për të dokumentuar krimet, për të vendosur paqen mes vetë shqiptarëve, bashkëpunimin e tyre të vazhdueshëm me lëvizjet paqësore në Serbi siç janë “Gratë në të Zeza” dhe kontributin e tyre të përditshëm për të ruajtur sistemi paralel në të gjitha aspektet e tij.

Pas protestave të studentëve në vitin 1981 dhe 1986 kundër politikës dhe dhunës së padrejtë jugosllave/serbe në Kosovë, data e cila gjithashtu mbart rëndësi historike është 1 Tetori 1997. Studentët konsideronin se politika e së ashtuquajturës “rezistencë pasive” e udhëhequr nga LDK (Lidhja Demokratike e Kosovës), partia më e madhe në Kosovë në atë kohë, nuk ishte efektive, veçanërisht duke marrë parasysh faktin se marrëveshjet specifike midis Miloševićit dhe Rugovës të cilat lejonin që studentët shqiptarë të përdorin ndërtesën e Universitetit dhe objektet e tij nuk po implementoheshin, studentët duhej të gjenin mënyra alternative për të njoftuar komunitetin ndërkombëtar për ngjarjet në Kosovë dhe për të fituar të drejtat e tyre. Ato përfaqësojnë veprimet e para të rezistencës jo të dhunshme që nga fillimi i viteve 90-të dhe, sipas fjalëve të studiuesit dhe aktivistit të ndjerë dhe të njohur Howard Clark, ishin “një model i konfrontimit jo të dhunshëm”.<sup>300</sup>

Nga ana tjetër, nuk ishin vetëm protestat e studentëve që thyen shtypjen dhe izolimin dhe fituan njohje ndërkombëtare. Gratë ishin iniciatorët më të mëdha të protestave kundër luftës në Kosovë. Duke luftuar kundër standardeve të dyfishta, shoqërisë patriarkale dhe shtypjes së përgjithshme të regjimit, gratë u përfshinë në lëvizjet studentore dhe më vonë grupet autonome, të cilat përbëheshin vetëm



nga gratë. Organizimi i brendshëm i grave filloi para viteve 90-të, si rezultat i portretizimit të grave shqiptare në mediat jugosllave. "Ato krijuan një stereotip të ri të grave shqiptare," thotë Sevdije Ahmeti, "Ajo nuk është thjesht një myslimane, një grua e mbuluar, por një stereotip të një gruaje si një makinë lindjeje që nuk bën asgjë dhe që është një skllave e pashkolluar e familjes së saj".<sup>301</sup>

Si reagim ndaj kësaj, gratë shqiptare të arsimuara filluan të mblidheshin në fund të viteve 80-të. Idea fillestare e këtyre grave ishte të linin mënjatë përkatësinë politike dhe të merreshin së bashku me çështjet e grave, përveç çështjeve kombëtare. Ky nuk ishte plani përfundimtar. Pasi ranë dakord të mos bashkoheshin me partitë politike dhe të ishin një organizatë e pavarur, megjithatë, shumë aktiviste vendosën të bashkohen me LDK-së, domethënë Organizatën e Grave të LDK-së, e cila më vonë u bë Forumi i Grave i LDK-së. Organizata kishte një numër të madh anëtarësh (rreth 80.000 gra në atë kohë) dhe organizoj ngjarjen e parë me 8 Mars 1990, në të cilën bëri thirrje për paqe dhe pavarësi.

—  
279  
—

"Me 8 Mars 1990, disa qindra gra u mbledhën në Qendrën Rinore Boro dhe Ramizi në Prishtinë, duke përfshirë anëtarët e Organizatës së Grave të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) - partisë politike që çoi në rezistencë jo të dhunshme ndaj shtypjes serbe gjatë viteve 90-të. Në atë kohë, e cila më vonë do të njihej si fillimi i një dekade shtypjeje nën regjimin e Miloševićit, Organizata e Grave e LDK-së shpalli publikisht shkëputjen e saj nga Lidhja e Grave Socialiste Jugosllave".<sup>302</sup> Me kalimin e kohës, OJQ-të e reja dhe grupet informale filluan të dilnin nga grupet e grave me vizion të lirisë dhe pavarësisë, të cilat kontribuan në pluralitetin e këtij sektori. Përmes llojeve të ndryshme të organizatave, gratë dëshironin pavarësinë e Kosovës nga shtypja serbe. Organizata të tilla si: Motrat Qiriazit, Lidhja e Grave Shqiptare, Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve, Legjenda, etj., ishin aktive në organizimin e kurseve të gjuhës për gratë dhe grupe të tjera, dokumentimin e krimeve dhe dhunës ndaj shqiptarëve të Kosovës, veçanërisht dhunës ndaj grave dhe fëmijëve, ato mbështetën gratë, ofruan shërbime shëndetësore, u përfshinë në politikë (shumë prej tyre ishin në pozita ekzekutive), ndanë ekspertizën e tyre, etj.

Mbylljet e shkollës, helmimi i pretenduar i 7.600 studentëve shqiptarë dhe shkeljet e tjera të të drejtave të njeriut nga regjimi serb çuan në një seri demonstratash: demonstrata në vitin 1992 kundër mbylljes së shkollave dhe demonstrata të mëvonshme të organizuara nga Forumi

i Grave i LDK-së kundër vrasjes së padrejtë të studentit të paarmatosur Armando Dacit. “Maturia” dhe “durimi” ishin fjalët më të përdorura të udhëheqësit të LDK-së, Rugovës. Kundër vullnetit të tij dhe kundër vullnetit të LDK-së, i cili përsëriste se Serbia do t'i perceptojë tubimet e mëdha si një provokim dhe një rast për të filluar dhunën, gratë vazhduan të organizonin demonstrata. “Deri më 8 Mars 1998, Rrjeti informal i Grave kishte organizuar 8 nga 13 demonstratat paqësore në përgjigje të dhunës në Drenicë. Këto demonstrata i bënë thirrje Europës dhe Shteteve të Bashkuara për të ndërhyrë dhe për të ndaluar krimet kundër njerëzimit”.<sup>303</sup> Një ngjarje tjetër simbolike që dëshmon për kontributin e grave dhe thirrjen e tyre të vazhdueshme për paqe ndodhi para Qendrës Informative të SHBA-ve (USIS) me më shumë se 2.000 gra. Motoja e tyre ishte “Ëthtë ora 12 për Kosovën”, që do të thoshte se lufta kishte filluar tashmë në Drenicë dhe se nuk kishte më kohë për të menduar, se ishte momenti i fundit për veprim. Rreth njëqind gra u mblodhën të nesërmen para KNKK-së, duke kërkuar që të shkonin në Drenicë për të dërguar ndihmë humanitare dhe mjekësore dhe gjëra të tjera të nevojshme për njerëzit që kishim mbetur atje. “Më vonë atë ditë, 300.000 njerëz nga Prishtina, Vushtria dhe Podujeva dolën në rrugë dhe thirrnin parrulla për paqe, kundër luftës dhe për solidaritet me Drenicën. Të rinjtë, partitë politike dhe sindikatat marshuan në Prishtinë dhe kërkuan t'i jepet fund “terrorit serb”.<sup>304</sup>

Aktivistet u organizuan në të gjitha mënyrat e mundshme, informacioni u dërgua në të gjitha format: përmes mediave, kanaleve të brendshme, telefonave, etj. Situata u përshkallëzua shpejt dhe konfliktet e armatosura u shfaqën në shumë rajone të Kosovës. Në mbremjen e 5 marsit, gratë u mblodhën përsëri para USIS-it me qirinj në kujtim të familjes Jashari, e cila u vra në Prekaz. Pas një tubimi të madh me 8 mars 1998, 15.000 deri në 20.000 gra u mblodhën përpara USIS me letra të bardha në duar dhe qëndruan atje për 15 minuta. Në të njëjtën kohë, në qytete dhe fshatra të tjerë, njerëzit qëndronin me letra të bardha para shtëpive të tyre, duke siguruar mbështetje simbolike për gratë në Prishtinë. Letrat e bardha nënkuptonin se nuk kishte asgjë tjetër për të thënë. Disa ditë më vonë, një delegacion prej 5 grave dërgoi një peticion në OKB për të ndërhyrë në Kosovë dhe dërgoi një “Deklaratë të Protestës së Heshtur”.

Protesta e radhës u mbajt me 10 Mars dhe ishte relativisht e vogël, e ndjekur nga një protestë e madhe në 16 mars, saktësisht 16 ditë pas sulmit në Drenicë dhe bllokimit të saj të plotë. Atë ditë, rreth 12.000 gra filluan të marshonin drejt Drenicës. Ato mbajtën bukë në duart e



tyre, për t'i treguar botës se njerëzit në Drenicë vuanin për bukë, që i vrisnin, masakronin dhe dëbonin nga shtëpitë e tyre. Disa orë më vonë, trupat serbe i ndaluan dhe i detyruan të ktheheshin. Drejtuesit e protestës folën edhe në anglisht dhe serbisht në mënyrë që të gjithë të mund të kuptonin se çfarë po ndodhte në Kosovë. Megjithëse nuk arritën në Drenicë, mesazhi i tyre u arriti shumë larg.

Përpjekjet e dekadës për të parandaluar luftën me paqe dështuan kur më në fund shpërtheu lufta, por vullneti dhe shpresat e studentëve, grave dhe shumë të tjerëve që dëshironin të shihnin një Kosovë të lirë nuk u zhdukën. Sot, ne nuk mund të pretendojmë që aktivizmi i grave dhe viktimkizimi i tyre është shumë i njohur dhe i vlerësuar, por mund të themi se veprimet e tyre janë të rëndësishme për Kosovën dhe se ato ishin mjeti kryesor për luftën në Kosovë për të fituar vëmendjen ndërkombëtare. Dhe në periudhën e pasluftës, kishte shumë lëvizje autonome të grave që siguronin mbështetje për viktimat e dhunës seksuale, familjet që ktheheshin në shtëpitë e tyre të djegura, refugjatët dhe të tjerët në nevojë. Përsëri, në sfond, gratë po ndërtonin Kosovën nga e para!

*Diana Morina*





## Protesta kundër luftës në Mali të Zi

---

### *“Heroizmi i sotëm është të mos shkosh në luftë”*

Lëvizja kundër luftës në Mal të Zi është e lidhur ngushtë me protestat kundër luftës në territorin e Serbisë, të cilat përshkruhen më hollësisht në kapitujt tjerë të këtij botimi, duke marrë parasysh se në atë periudhë të dy republikat formuan Jugosllavinë e “cunguar”. Shtysa për qytetarët malazezë për të dalë në rrugë dhe sheshe ishte politika e nxitjes së luftës dhe dërgimi i qytetarëve të saj në “luftën për paqe”<sup>305</sup> të Presidentit të atëhershëm Momir Bulatović dhe Kryeministrit Milo Djukanović, së bashku me aleatin e luftës, Presidentin e Republikës së Serbisë (më vonë Republika Federale e Jugosllavisë) Slobodan Milošević .

Në fakt, protestat në Mal të Zi ishin kryesisht të organizuara si rezistencë ndaj ndikimit të Slobodan Miloševićit mbi autoritetet malazeze në atë kohë. Por përpara se Bulatović dhe Djukanović të vinin në pushtet, ndodhën protestat e para, të cilat në fakt kontribuan në rënien e Malit të Zi nën ndikimin e plotë të regjimit të Miloševićit. Këto demonstrata njihen si “revolucion i anti-burokratik”, i cili ndryshon rrënjësisht kuptimin e mëparshëm të komunizmit në Jugosllavi - klasa punëtore si fokus kryesor i politikës zëvendësohet nga kombi. Mitingu i parë i këtij lloji u mbajt në Titograd më 20 gusht 1988, në mbështetje të Serbisë dhe kundër “shtypjes së popullit serb nga shqiptarët e Kosovës”. Protesta më e madhe ndodhi më 10 janar 1989, nga punëtorët e fabrikës Radoje Dakić, të udhëhequr nga Pavle Milić, si dhe presidenti i studentëve të Universitetit, Veljko Vlahović, ku rreth 10.000 njerëz u mbledhën në Titograd. Një nga qëllimet e suksesshme të këtyre protestave, të inkurajuar nga mediat nën kontrollin e Miloševićit (si në shembullin e gazetës “Pobjeda”), ishte dorëheqja e udhëheqjes së atëhershme malazeze dhe ardhja e njerëzve të rinj në pushtet, të cilët ishin të lidhur ngushtë me qeverinë e Miloševićit, dhe Lidhja Komuniste e Malit të Zi u transformua duke fituar kontroll të plotë mbi

Ndërsa Momiri dhe Milo dhe aleati i tyre i luftës Slobodan Miloševići dërguan qytetarët e tyre në “luftën për paqe”, u organizuan protesta kundër luftës, si dhe një ofensivë kundër dezertorëve. Më 17 korrik 1991, Komiteti Qytetar për Paqen organizoi një protestë kundër luftës “Stop Fashizmit” në sheshin qendror të qytetit në Titograd. Proklamata shkruante: “Mos hyni në atë konflikt të përgjakshëm vëllavrasës dhe bëni gjithçka që të tjerët të mos e bëjnë këtë”. Për Malin e Zi dhe Jugosllavinë sot, nuk ka asnjë qëllim më të lartë dhe më të rëndësishëm se paqja dhe një jetë e denjë për një popull. Sot është heroizëm të mos shkosh në luftë”.<sup>306</sup>

Rezistenca e vërtetë ndaj ndikimit të Slobodan Miloševićit në atë kohë filloi me protestat në Cetinje me 1 shkurt 1992, të organizuara nga opozita e bashkuar malazeze për një Mal të Zi sovran. Qëllimi ishte që të kërkohet nga organet drejtuese pavarësia e Malit të Zi dhe pavarësia nga Serbia e Miloševićit, si dhe nga përpjekje për shkëputjen e Republikës Srpska. Vasalët e Miloševićit në Malin e Zi ishin në partinë qeverisëse të Partisë Demokratike të Socialistëve (DPS), përfaqësuesit kryesorë të së cilës në atë kohë ishin Momir Bulatović, Branko Kostić (anëtar i ish-Presidencës së ish-RSFI) dhe Milo Djukanović dhe Svetozar Marović. Të mbledhurit kundërshtuan mobilizimin e ushtarëve malazezë për hir të arritjes së qëllimeve ushtarake të Serbisë, pasojat e të cilave çuan në viktima dhe dëbim të boshnjakëve nga vendi. Slavko Perović, president i LSCG, e përfundoi tubimin me fjalët: “Ne duhet të themi me forcë sot, aq fort sa e gjithë bota të na dëgjojë dhe të dërgojmë mesazh - Slobodan Milošević, Mali i Zi nuk është, dhe as nuk mund të jetë, një copë lecke në veshjen e ndyrë të politikës tënde. Fati i Malit të Zi nuk do të vendoset në atmosferën e tymosur të lojërave politike të pokerit”. Gjatë protestës, u dëgjuan edhe thirrje të tilla si “Nga Lovçeni thërret zana, Dubrovnik na fal këto t’bama”, në përgjigje të rrethimit të Dubrovnikut në vitin 1991.

Pasoi një periudhë pa protesta të rëndësishme qytetare ose tubime në Mal të Zi deri më 14 Janar 1998, kur mbështetësit e Presidentit të atëhershëm në largim Momir Bulatović u përpoqën të zëvendësonin Presidentin e ri Milo Gjukanović përmes tubimeve në rrugë, të cilin protestat e tilla, së bashku me Bulatovićin, edhe e sollën në pushtet. Gurët dhe koktejet Molotov fluturonin dhe një granatë dore shpërtheu, për të cilën organizatorët thanë se i kishte rënë një oficeri policie. Podgorica ishte nën re të gazit lotsjellës dhe gjatë natës pasuan



arrestimet e aktivistëve të Momir Bulatovićit.<sup>307</sup>

Përkundër protestave të organizuara kundër luftës, publiku në Mal të Zi ishte i ndarë. Shumica e qytetarëve i konsideronin organizatorët e protestës si tradhtarë kombëtarë, që edhe ishte pasqyrë e shoqërisë së atëhershme patriarkale të Malit të Zi, ku dezertimi konsiderohej vepër frikacakësh. Pavarësisht nga këto protesta të dështuara dhe më vonë ndryshimet e regjimit në këto vende, qytetarët mbeten të uritur për informacion në lidhje me atë që ndodhi me të vërtetë në vitet 90-të. Të rinjtë nga rajoni mësojnë histori të ndryshme për popullin gjenocidal nga ana tjetër dhe viktimat nga ana e tyre, ndërsa nuk janë të vetëdijshëm se këta të rinj janë viktimat më të mëdha të këtyre luftërave. Ne jemi të kufizuar dhe të ndarë nga një mur paragjykimi dhe jemi lënë të ndërtojmë vetë një të ardhme më të mirë.

“Na mbetet të imagjinojmë se si do të dukej nëse njerëzit do të mund të shihnin atëherë që edhe pala tjetër ishte gjithashtu kundër luftërave, se të gjithë ishin thjesht peng për të fuqishmit. Ndoshta vëllau nuk do të shkonte kurrë kundër vëllaut”.<sup>308</sup>



## Protestat kundër luftës në Serbi

---

### *Mos llogarisni në ne*

287

Ndërsa lufta dhe klima militante në Jugosllavi u bënë gjithnjë e më të pranishme në vitet 90-të, lëvizjet kundër luftës dhe ato paqësore u ngritën në mënyrë spontane, por gjithashtu domosdoshmërisht - ato u formuan nga vetë lufta. Ato u paraprinë nga iniciativat qytetare të bazuara pikërisht në politikën e paqes dhe o formuan bazën nga e cila dolën degë të ndryshme të protestave të paqes gjatë vetë luftës, me grupe dhe organizata të ndryshme. Disa prej shembujve janë protestat studentore, protestat në vetë fushën e betejës përmes largimit nga ajo, dezertimi i burrave dhe rezistenca gjithnjë e më e vështirë ndaj mobilizimit të dhunshëm, refuzimi i komandantëve për të marrë pjesë në luftërat civile, protestat e organizatave të shoqërisë civile, protestat e grave dhe protestat masive të të gjitha shtresave të shoqërisë. Bazuar në sa më sipër, të gjitha këto lëvizje mund të ndahen afërsisht në tre faza: të paraluftës ose përgatitore, gjatë luftës dhe të pasluftës.<sup>309</sup>

*Faza e paraluftës* (fundi i viteve 80-të dhe fillimi i viteve 90-të) u shënua nga shenjat e para të luftës në fund të viteve 80-të, dhe gjatë kësaj periudhe u shfaqën iniciativa të ndryshme qytetare, grupe dhe organizata që u përpoqën të neutralizonin lëvizjet nacionaliste-shoviniste dhe populliste që më vonë u treguan shumë më të fuqishme. Ato ndërmorrën iniciativa të pavarura për të parandaluar luftën dhe për të qetësuar marrëdhëniet tashmë të tensionuara midis shteteve të ish-RSFJ-së. Një shembull i një iniciative të tillë është veprimi i vitit 1989 në të cilin më shumë se 3.000 njerëz me shkrim, me kontratë, morrin obligimin për të mos përdorur dhunë ndaj asnjë grupi, kombi apo individi Jugosllav në asnjë rrethanë. Në mars të vitit 1991, Grupet Autonome të Grave të Beogradit dhe Lubjanës dërguan apelin e "Grave për Paqe" kundër politikës së luftës në Jugosllavi dhe në mbi dhjetë qytete të ish-RSFJ-së u mbajtën konferencat për shtyp



nën moton “Stop Fashizmit – Kalim Qytetarisë”. Mediat e pavarura gjithashtu i rezistuan luftës. Gazetarët e mediave të kontrolluara nga regjimi, të tilla si Radio Televizioni i Serbisë, u përpoqën të mbanin gazetarinë në një nivel profesional. Ata që ishin në gjendje ta bënin këtë i kthyen gazetat e tyre në të pavarura, të tilla si, për shembull, gazetat “Borb” dhe “Svetlost”. Kishte edhe nga ata që arritën të krijojnë media të reja të pavarura, të tilla si “Radio B-92”, “Vreme”, “Republika”... Pikërisht modelet e tilla mediatike ishin në favor të demokracisë, paqes, dialogut, respektimit të të drejtave të njeriut, si dhe për raportimin etik dhe të pavarur të mediave. Shpërthimi i konflikteve të para të vogla të armatosura tregoi se një sistem i tillë i veprimit kundër luftës ishte mjaft i efektshëm dhe se të gjitha këto lëvizje të pavarura duhej të përqendroheshin në një veprim më të madh, megjithatë këto grupe ishin baza për krijimin e iniciativave dhe lëvizjeve që përhapën paqen në Serbi në vitet 90-të.

“Fazën e luftës” (periudha e viteve 90-të) karakterizohet tashmë nga fillimi i luftës dhe fundi i mobilizimit në periudhën nga vera e vitit 1991 deri në vjeshtën e vitit 1992. Karakterizohet nga disa lloje të aktiviteteve paqësore me karakter dhe intensitet të ndryshëm:

1. Formimi i grupeve dhe organizatave të paqes
2. Protesta kundër mobilizimit, ushtrisë së APJ-së, mosekzistencës së qëllimit të luftës dhe rebelimi i dezertorëve
3. Veprime qytetare kundër luftës
4. Nismat e grave kundër luftës

288

Formimi i grupeve dhe organizatave të paqes - Protestat e para kundër luftës u organizuan nga grupe civile dhe shoqata në Beograd, nga të cilat u krijuar Qendra për Veprime Kundër Luftës më 15 korrik 1991. Ajo u shfaq si një lëvizje e rezistencës së qytetarëve ndaj luftës për përhapjen e saj të shpejtë. Qendra për Veprime Kundër Luftës kishte qëllimet e veta afatshkurtra dhe afatgjata. Të parat kishin për qëllim përhapjen e propagandës kundër luftë dhe parandalimin e luftës në këtë moment, ndërsa të dytat kishin për qëllim krijimin e shoqërisë civile dhe respektimin e të drejtave të njeriut dhe të pakicave dhe përgjithësisht krijimin e një gjendje të çmilitarizuar në Gadishullin Ballkanik dhe bashkëjetesën paqësore të të gjithë qytetarëve të saj.

Përveç këtyre llojeve të lëvizjeve, protestave u bashkohen edhe qytetarë të orientimeve dhe bindjeve tjera politike - nacionalistët,

për shembull, të cilët nuk e kundërshtuan luftën për arsye morale ose dashuri për bashkatdhetarët, por nga urrejtja për regjimin e Slobodan Miloševićit, me pretekstin e pasurimit të tij dhe gjeneralëve të tij komunistë. Lëvizja Serbe e Rindërtimit (Srpski pokret obnove) e Vuk Draškovićit spikat këtu. Nuk është sqaruar nëse kjo lëvizje është formuar për arsye morale dhe etike, apo nga urrejtja ndaj regjimit të Miloševićit. Vuk Drašković mbështeste dezertimin nga Armata Popullore Jugosllave, por në të njëjtën kohë dërgonte njerëz në fushëbetejë duke formuar njësitë e tij (Garda Serbe). Pavarësisht nga motivimi i këtyre grupeve, iniciativat e paqes fituan gjerësinë e tyre vetëm me shfaqjen e “Protestuesve, paqeruajtësve të Vukut” dhe me protestën kundër mobilizimit, dhe kështu fituan ndikim masiv dhe të rëndësishëm tek faktorët e fuqisë ushtarako-politike.

Protestat kundër mobilizimit, ushtrisë së APJ-së, mosekzistenca e një qëllimi lufte dhe rebelimi i dezertorëve ishin një fenomen masiv. “Sipas një burimi, mobilizimi pati sukses, mesatarisht, vetëm në 47% të rasteve. Rezistenca spontane ndaj mobilizimit dhe largimi nga fronti pothuajse çdo ditë prodhoi revolta të rekrutëve dhe prindërve të tyre në të gjithë Serbinë”.<sup>310</sup> Në fakt, ne mund ta quajmë lirisht atë periudhë midis 1991 dhe 1992<sup>311</sup> fillimin e lëvizjes së paqes, domethënë lëvizjen kundër luftës. Qëndrimet e vetë njerëzve dhe grupeve që ishin pjesë e lëvizjes nuk ishin homogjene - disa protestuan kundër luftës dhe disa kundër “kësaj lloji lufte”. Serbia dhe Jugosllavia u mobilizuan, megjithëse asnjë gjendje lufte nuk u shpall zyrtarisht dhe qëllimet e luftës nuk ishin përcaktuar qartë. Kështu që disponimi u ridrejtu kundër APJ-së, kundër qeverisë aktuale dhe e drejtuar nga opozita, dhe vetëm në fund të fundit ishte me të vërtetë paqësor. Kjo është arsyeja pse këto rebelime dhe lëvizje spontane u shuan shpejt sepse nuk kishin një qëllim të dakorduar dhe vetëm në disa qytete të Vojvodinës u formuan me të vërtetë grupe dhe organizata të paqes.

Që nga vera e vitit 1991, prindërit e ushtarëve dhe rezervistët kanë protestuar në një numër të madh, duke kërkuar armëpushim, kthimin e djemve të tyre nga fronti; përpara Kuvendit të Serbisë, para Shtabit të Përgjithshëm të APJ-së, në Shtëpinë e Gardës, para Qeverisë së Serbisë. Në dhjetor 1991, prindërit e rezervistëve nga Obrenovci, Grocka, protestuan, duke kërkuar kthimin e djemve të tyre nga fronti në Kroaci. Në dhjetor 1991, një protestë e madhe u mbajt në Valevë nga rezervistët që refuzuan të mobilizohen. Prindërit gjithashtu protestuan në Kragujevc në nëntor 1991 dhe kërkuan që djemtë e tyre të ktheheshin nga Kroacia. Në shtator 1991, rezervisti nga Valeva Vladimir



Zivković hipi në një transportues të blinduar të personelit dhe e çoi atë përpara Kuvendit të RSFJ-së.

21 dhjetor 1991 - Si pjesë e fushatës së përhershme militariste të autoriteteve ushtarake dhe civile në Serbi kundër rebelëve kundër luftës nga Kragujevci, në vende publike u vendosen listat e dezertorëve dhe rezervistëve që nuk pranuan të mobilizoheshin. Kjo u interpretua si thirrje për linçim. Trazirat më të mëdha të rezervistëve dhe dezertorëve ishin në Kragujevc (7.000, 2.000 dhe 200 rezervistë secila) dhe Knjazhevc (5.000), kurse trazirat shpërthyen edhe në Nish (nga 400 dhe 450 persona), Arangeloc (67), Topollë (200), Valevë (600), Çaçak, Milanovc i Epërm (700), Smederevë (700). Në Vojvodinë, rebelime kishte në Moravicë të Vjetër (83), Treshnjec. Në vitin 1991 dhe 1992, 140.000 njerëz u mobilizuan me forcë në Serbi, nga të cilët 82.000 në Vojvodinë. 25.000 banorë të Vojvodinës, kryesisht hungarezë, u larguan në Hungari. Rreth 100.000 të rinj ikën për shkak të pushtetit, i cili i shtyente në luftë kurse filluan procedimet penale kundër 10.000 prej tyre.

Veprimet qytetare kundër luftës, përveç veprimeve të organizuara nga organizatat, lëvizjet dhe partitë, u inicuan në mënyrë spontane, nga vetë qytetarët, të motivuar nga zemërimi, dëshira për paqe, pikëllimi për viktimat dhe mungesa e kuptimit dhe qëllimit të luftës. Spontanisht, këto lëvizje u rritën dhe u përhapën, dhe disa zgjatën me vite.

Nga 8 tetori 1991 deri më 8 shkurt 1992, kishte një aksion të përditshëm të ndezjes së qirinjve në Beograd para ndërtesës së Presidencës. Qirinjtë ndizeshin nga ora 20.30 deri në orën 21. Aksioni zgjati pesë muaj me parullat "Solidaritet me të gjithë kundërshtarët e luftës" dhe "Për të gjithë të vrarët në luftë". U ndezën 72.650 qirinj. Aksioni u iniciua nga Nataša Kandić dhe Biljana Jovanović, dhe atyre iu bashkuan shumë qytetarë. Lëvizja kundër luftës në Beograd botoi një libër me epitafë "Varrë për Miroslav Milenkovićin", në kujtim të veprës së guximshme të Miroslav Milenkovićit.<sup>312</sup> U hap një libër zie në të cilin të gjithë ata që ndaleshin në mbrëmje para qirinjve të ndezur në Parkun e Pionierëve mund të shkruanin epitafin e tyre.

Aksioni kundër luftës i ndezjes së qirinjve në Pançevë u mbajt çdo të shtunë nga 12 nëntor 1991 deri në nëntor 1995, kur u nënshkrua Marrëveshja e Dejtonit. Ky veprim u rrit në një simbol të lëvizjes paqësore të Pançevës. Çdo të shtunë, kishte një zonë të çmilitarizuar,



ku shpërndareshin gazetat “Vreme” dhe “Pančevac”.

Më 22 Prill 1992, në Sheshin e Republikës në Beograd nën parullën “Mos llogarisni në ne”, u mbajt një koncert kundër luftës në të cilin morën pjesë më shumë se 55.000 njerëz ku performoi grupi Rimtutituki, i përbërë nga anëtarët e Partibrejkers, Električni orgazam dhe EKV. Ata filluan fushatën e kundër luftës duke regjistruar këngën “Dëgjo këtu” („Slušaj, 'vamo“), dhe gjithashtu interpretuan këtë dhe këngë të tjera në një kamion që kalonte nëpër Beograd.

Më 30 maj 1992, disa qindra artistë të dramës protestuan kundër luftës me një orë heshtje para Teatrit Jugosllav të Dramës dhe shprehën solidaritet me viktimat. Më 13 gusht të të njëjtit vit, u organizua koncerti “Artistët për Paqen” në Shumarice të Kragujevciz, ku artistët si Rade Serbedžija, Gorica Popović, grupi Smak, Atomsko sklonište, Bora Dugić dhe të tjerë, kënduan, recituan dhe folën. Në qershor të vitit 1992, në vendbanimin në Srem, Hrtkovci, pjesëtarët e kombësisë kroate u dëbuan dhe shtëpitë e tyre u dogjën dhe u shkatërruan. Organizatat e shoqërisë civile si “Gratë në të Zeza”, “Rrethi i Beogradit dhe “Lëvizja e Rezistencës Civile” (“Žene u crnom”, “Beogradski krug” dhe “Civilni pokret otpora”), si dhe gazetarë të guximshëm punuan ditë e natë për të kërkuar drejtësi dhe, me këmbënguljen e tyre, kriminelët u arrestuan.

Veprimet e grave kundër luftës ishin veprime të grupeve feministe që në mënyrë të pavarur dhe të bashkuara kundërshtuan politikën e luftës. Këtu përfshijmë edhe ato nëna që nuk lejuan që shteti të abuzojë me dhimbjen dhe vuajtjet e tyre. Gjatë 15 viteve të fundit, këto lëvizje kanë provuar të jenë një nga më të rëndësishmet në kuptimin e kundërshtimit të luftës.

Është interesant kundër-tubimi më 5 shkurt 1991, ku një grup grash deportuan deri tek skena ku u mbajt një tubim i “Lëvizjes së Nënave të ish-Jugosllavisë”, të ashtuquajturat “xhakete gëzofet” që ishin në thelb gratë e gjeneralëve dhe elitave të tjera të luftës dhe madje arritën të “fusnin” transparente. Domethënës është edhe futja e nënave të ushtarëve në Kuvendin e Serbisë gjatë seancës në 2 korrik 1991, ku e ndërprejnë seancën me kërkesë që të gjithë ushtarët të lirohen nga ushtritë dhe konfliktet e armatosura të pushojnë, dhe që ushtarët të thirren në luftë vetëm brenda kufijve të vendit të tyre dhe të dërgohen jashtë tyre vetëm nëse kërcënohet integriteti territorial i vendit. “Gratë në të Zeza”, më 9 tetor 1991, filluan protestën kundër luftës,

e cila u mbajt vazhdimisht çdo të mërkurë gjatë viteve në vijim, deri në nënshkrimin e Marrëveshjes së Dejtonit. Gratë në të zeza dhe në heshtje, duke marrë forma tradicionale patriarkale dhe duke i mbushur ato me përmbajtje feministe-anti-militariste, përkujtuan të gjitha viktimat e luftës, shprehën solidaritet me të gjithë kryengritësit kundër luftës, protestë kundër militarizmit të armëve dhe fjalëve.

Periudha midis luftërave në Kroaci dhe Bosnjë dhe luftës në Kosovë, 1996 dhe 1997, u karakterizua nga një valë e re protestash masive - kundër qeverisë së Slobodan Miloševićit. U zhvilluan si protestat studentore ashtu dhe qytetare, të cilat filluan në Nish pas vjedhjes së zgjedhjeve dhe shpejt u përhapën në Beograd dhe qytete të tjera. Megjithëse kishte rreth 500.000 njerëz në disa raste, Slobodan Miloshević u zëvendësua tek në vitin 2000.

“Faza e pasluftës” karakterizohet nga konsolidimi dhe zgjerimi i grupeve dhe organizatave të paqes. Pasi lufta përfundoi zyrtarisht, qëllimi i këtyre lëvizjeve ishte të ruanin paqen dhe demokracinë, të forconin të drejtat e njeriut dhe të pakicave dhe të ulnin tensionet ndëretnike. Një shembull i një prej organizatave të shoqërisë civile është Nisma Rinore për të Drejtat e Njeriut, e cila punon për të vendosur komunikimin midis të rinjve nga ish Jugosllavia, hulumtimin dhe publikimin e informacionit mbi krimet e luftës dhe drejtësinë tranzitore, si dhe parandalimin e lavdërimit të kriminelëve të luftës<sup>313</sup> dhe politikave luftënxitëse, të gjitha me qëllim të parandalimit të përsëritje të së kaluarës së luftës.

*Filip Vulović*



**288** Barkan, Elazar. 2009. *Truth and Reconciliation in History, Introduction: Historians and Historical Reconciliation*. The American Historical Review 114, no.4. 900.

**289** Aleksov, Bojan. 2013. *Opiranje jugoslavenskim ratovima: k jednoj autoetnografiji*. Polemos, sv.16, 2=32. 125-144

**290** Kern, Harm Rudolf. *The Zetra Project: Remembering the Concert That Tried to Save Yugoslavia*.

- <https://balkanist.net/the-zetra-project-remembering-the-concert-that-tried-to-save-yugoslavia/>  
(Arkivuar më 07.02.2020.)

**291** Stojanovski, Filip. *Sećanje na antiratni pokret u Jugoslaviji početkom 1990-ih*. Amsterdam.

- <https://sr.globalvoices.org/2016/08/secanje-na-antiratni-pokret-u-jugoslaviji-pocetkom-1990-ih/>  
(Arkivuar më 07.02.2020.)

**292** Nenad Pejić, 2012. *How I Failed To Stop The War In Bosnia*. Radio Slobodna Evropa,

- [https://www.rferl.org/a/how\\_i\\_failed\\_to\\_stop\\_the\\_war\\_in\\_bosnia/24537627.html](https://www.rferl.org/a/how_i_failed_to_stop_the_war_in_bosnia/24537627.html)  
(Arkivuar më 07.02.2020.)

**293** Milomir Kovačević, 2012. Da "Željeli smo mir", snimio je Milomir Kovačević Strašni. Konkursiregiona.net;

- <http://konkursiregiona.net/da-zeljeli-smo-mirsnimio-je-milomir-kovacevic-strasni/>  
(Arkivuar më 07.02.2020.)

**294** Materialet burimore: Fondi HR-DOC-02 - Fushata Kroate Kundër Luftës, Literatura bazë: *Luftuam për ajër: Aktivizmi post-jugosllav kundër luftës dhe trashëgimia e tij*. 2015. Ur. Bilić, Bojan. Documenta - Kuća ljudskih prava - Jesenski i Turk. Zagreb. / *Opiranje zlu: (Post)jugoslavenski antiratni angažman*. 2015. Ur. Bilić, Bojan; Janković, Vesna. Documenta - Kuća ljudskih prava - Jesenski i Turk. Zagreb. / *U dosluhu i neposluhu: Pozitivni primjeri izgradnje mira u Hrvatskoj u 90-ima i kasnije*. 2010. Ur. Božićević, Goran. Miramida centar. Grožnjan. / *Neispričana povijest: Antiratna kampanja 1991.-2011*. 2011. Ur. Janković, Vesna; Mokrović, Nikola. Documenta. Zagreb.



**295** Shembulli më i famshëm është *Svarun* - një iniciativë mjedisore dhe paqësore, e krijuar në 1986 kur filloi të punojë për promovimin e ekologjisë, mos-dhunës, barazisë gjinore, spiritualitetit dhe anti-autoritarizmit. Zhvilloi aktivitetet më të gjera në fushatat kundër ndërtimit të një centrali bërthamor në afërsi të Zagrebit. *Zelena akcija Zagreb* e ka zanafillën në *Svarun*, dhe kështu në *Fushatën Kundër Luftës*.

**296** Artikulli u publikua në librin: *Neispričana povijest. Antiratna kampanja 1991.-2011.* 2011. Ur. Janković, Vesna ; Mokrović, Nikola. Documenta - Centar za suočavanje s prošlošću. Zagreb.

**297** Është emëruar sipas nenit 47 të Kushtetutës, i cili garanton të drejtën e kundërshtimit të ndërgjegjes.

**298** Para luftës, Pakraci ishte një vende me popullsi të përzier kroate dhe serbe. Me fillimin e luftës, në territorin e tij ndodhën konflikte të mëdha etnike, të cilat rezultuan në ndarjen e qytetit, humbjen e një numri të madh të jetëve njerëzore dhe shkatërrimin e 76% të banesave, duke e bërë atë një nga qytetet më të shkatërruara gjatë Luftës Atdhetare.

**299** Maliqi, Shkëlzen. Why peaceful resistance movement in Kosova failed.

• <https://web.archive.org/web/20200206230256/https://shkelzenmaliqi.wordpress.com/2000/03/22/why-peacefulresistance-movement-in-kosova-failed/>  
(Arkivuar më 06.02. 2020.)

**300** Krasniqi, Gëzim. *Where is the spirit of 1997? Student protest and their shattered legacy*, Prishtine.

• <https://web.archive.org/web/20200206230356/https://prishtinainsight.com/spirit-1997-student-protests-shatteredlegacy/>  
(Arkivuar më 06.02. 2020.)

**301** Farnsworth, Nicole. 2008. *History is Herstory Too: The History of Women in Civil Society in Kosovo, 1980-2004*. Kosova Gender Studies Center. Prishtine.

**302** Halili, Dafina. *Three Decades of Protest*. Prishtine.

• <https://web.archive.org/web/20200206230518/https://kosovotwopointzero.com/en/three-decades-protest/>  
(Arkivuar më 06.02. 2020.)

**303** Farnsworth, Nicole. 2008. *History is Herstory Too: The History of Women in Civil Society in Kosovo, 1980-2004*. Kosova Gender Studies Center. Prishtine.

**304** Ibid, Fq. 107.

**305** Porulla "Lufta për Paqen" ishte në kopertinën e një prej numrave të gazetës pro-regjimit (Miloševići), prapa së cilës ishte një foto e Dubrovnikut të bombarduar. Lufta për paqe, veçanërisht kur bëhet fjalë për luftërat e viteve 90-të, nuk është asgjë më shumë se ironi, sepse ideja e luftës me një vend në mënyrë që të ruhet paqja dhe të parandalohet lufta në një vend tjetër është e pakuptimtë.

**306** Monitor online. *Zločini koji su se Ukanoviću isplatili*. Podgorica.

• <https://web.archive.org/web/20200206231017/https://www.monitor.co.me/zloini-koji-su-se-ukanoviu-isplatili/> (Arkivuar më 06. 02. 2020.)

**307** Slobodna Evropa. *Kultura protesta tek na početu*. Podgorica.

• <https://web.archive.org/web/20200206231327/https://www.slobodnaevropa.org/a/kultura-protesta-tek-napocetku/25018097.html>  
(Arkivuar më 06. 02. 2020.)

**308** Një nga të pyeturit mbi temën e protestave

**309** Paunović, Žarko. 1995. *Mirovne aktivnosti u Srbiji - Između inicijativa i pokreta*. Institut za filozofiju i društvenu teoriju. Beograd

*Kratka istorija antiratnog otpora u Srbiji 1991 – 1992*. 2013. Ur. Imširović, Ana; Urošević, Miloš

Zajović, Staša. 2006. *Uvek neposlušne. Žene u crnom*. Beograd.

• [https://web.archive.org/web/20200206230626/http://zeneucrnom.org/pdf/uvek\\_neposlusne.pdf](https://web.archive.org/web/20200206230626/http://zeneucrnom.org/pdf/uvek_neposlusne.pdf)  
(Arkivuar më 06.02.2020.)

Stojković, Dragan. 2011. *Antiratne i mirovne ideje u istoriji Srbije*. Matica crnogorska. Podgorica.

• <https://web.archive.org/web/20200206230723/http://www.maticacrnogorska.me/files/45/16%20dragan%20stojkovic.pdf>  
(Arkivuar më 06.02.2020.)

**310** Vesna Pešić, *Jugoslovenska ratna kriza i mirovni pokret, Sociološki pregled*, Beograd, br. 1-4/1992, Fq. 65.-66.

**311** Nga tetori 1991 deri në pranverën e vitit 1992 - Kishte rreth pesëdhjetë rebelime rezerviste në Serbi, me rreth 55.000 pjesëmarrës.

Gusht 1991 - 700 rezervistë nga Smedereva refuzuan të transferoheshin nga Bosnja në Kzaci. Revolta më e madhe e rezervistëve shpërtheu në Kragujevc, 7.000 u mbyllën në kazerma, duke refuzuar ta linin atë.

Shtator 1991 - Ushtria Popullore e Kragujevcit (2.000 anëtarë) u kthye në shtëpi nga Shidi, duke refuzuar të shkonte në Sllavoni. 600 rezervistë nga Valeva u kthyen nga Hercegovina.

Tetor 1991 - Duke ikur nga mobilizimi i dhunshëm, 500 hungarezë u larguan nga Subotica në Hungari. 200 rezervistë u kthyen në Topollë dhe thanë se nuk dëshironin të shkonin në luftë sepse Serbia nuk u sulmua. Revolta e batalonit të Kragujevcit në Livadhet e Pasulanit - reuervistët nga Smedereva, Pllana e Madhe, Topolla, Svilajnci u bashkuan me revoltën. Rezervistët nga Čačaku bllokuan magjistralë e Ibrit. Në Dal, 150 nga 200 ushtarë u larguan nga fronti. Në Nish, 13 oficerë rezervë me 450 ushtarë të tjerë refuzuan të shkonin në front.

10 nëntor 1991 - Kryengritja më e madhe e rezervistëve që nga fillimi i luftës në Knjazhevc, në të cilën morën pjesë rreth 5.000 rezervistë.

12 dhjetor 1991 - Disa rezervistë protestuan kundër mobilizimit të dhunshëm në Kragujevc. Një grup prej 200 rezervistësh nga Kragujevc u kthyen nga fronti në Vukovar.

18 dhjetor 1991 - 700 rezervistë refuzuan të luftonin në Markučica në Sllavoni.



Janar 1992 - 700 rezervistë në Millanoci i Epërm refuzuan të shkonin në Sllavoninë Lindore.

**312** Rezervisti i mobilizuar Miroslav Milenković, i lindur në vitin 1951. Baba i dy fëmijëve, punëtor civil nga Millanoci i Epërm, bëri vetëvrasje nën presionin e gjeneralit të APJ-së për të vendosur nëse do të ishte një “serb i vërtetë” apo një dezertor dhe tradhtar. Ai qëlloi veten në kokë.

**313** Në janar 2017, tetë aktivistë të Nismës së të Rinjve për të Drejtat e Njeriut protestuan kundër kriminelit të dënuar të luftës Veselin Šljivančanin në promovimin e librit të tij, duke ju fryrë bilbilave dhe duke mbajtur një banderolë ku shkruhej “Kriminelët e luftës të mbyllnin gojën për të folur për viktimat”. Në atë protestë, ata u rrahën nga vizitorët dhe në fund u deshën të paguanin një gjobë prej rreth 450 euro për shkeljen e rendit dhe qetësisë publike.



# PËRSHTYPJET E PJESËMARRËSVE



Janar 1992 - 700 rezervistë në Millanoci i Epërm refuzuan të shkonin në Sllavoninë Lindore.

**312** Rezervisti i mobilizuar Miroslav Milenković, i lindur në vitin 1951. Baba i dy fëmijëve, punëtor civil nga Millanoci i Epërm, bëri vetëvrasje nën presionin e gjeneralit të APJ-së për të vendosur nëse do të ishte një “serb i vërtetë” apo një dezertor dhe tradhtar. Ai qëlloi veten në kokë.

**313** Në janar 2017, tetë aktivistë të Nismës së të Rinjve për të Drejtat e Njeriut protestuan kundër kriminelit të dënuar të luftës Veselin Šljivančanin në promovimin e librit të tij, duke ju fryrë bilbilave dhe duke mbajtur një banderolë ku shkruhej “Kriminelët e luftës të mbyllnin gojën për të folur për viktimat”. Në atë protestë, ata u rrahën nga vizitorët dhe në fund u deshën të paguanin një gjobë prej rreth 450 euro për shkeljen e rendit dhe qetësisë publike.



# PËRSHTYPJET E PJESËMARRËSVE

---







## *Mundemi më ndryshe, së bashku*

---

Pavarësisht nga pjesëmarrja e anëtarëve të familjes në luftë, asnjëherë nuk më është përcjellë shpirti dhe barra e urrejtjes. Kjo më ka lejuar të mos shoh kombësinë ose fenë e askujt duke u rritur, dhe edhe sikur të doja, nuk do t'i dija ndryshimet. Pyetja është se çfarë personi do të isha sot nëse nuk do të përfshiheja në aktivizmin e të rinjve në rajon.

Një nga faktorët që ndikon dukshëm në imazhin e rritjes në Ballkan është vendi ku keni kaluar ditët e fëmijërisë. Është e mahnitshme se si disa dhjetëra milje mund të nënkuptojnë ndryshimin midis një shtëpie të ngrohtë dhe mërgimit, jetës ose vdekjes. Historia ime fillon në bregdetin kroat në një kohë kur tingulli i pushkëve dhe topave ishte qetësuar. Viti është 1996, kishte kaluar ca kohë që nga Stuhia dhe Vetëtima (Oluja dhe Bljesak), Dejtoni është nënshkruar dhe lufta po lëvizte deri disa zonave tjera të ish-shtetit.

Kam pasur fatin të rritem larg tmerreve të luftës. Diçka që miqtë e mi disa vjet më të vjetër nuk e kishin, as bashkëmoshatarët e mi dhe as më të rinjtë që u gjetën nën disa granata “të reja” në Prishtinë ose Beograd. Pavarësisht nga pjesëmarrja e anëtarëve të familjes në luftë, shpirti dhe barra e urrejtjes nuk më kaluan kurrë. Kjo më lejoi të mos shikoja kombësinë ose fenë e askujt duke u rritur, dhe edhe sikur të doja, nuk do t'i dija ndryshimet.

Sigurisht, jo të gjithë kishin kaq fat. Duke u rritur në territoret e shkatërruara nga lufta, duke lënë pas rrënoja dhe vdekje, shumë nga bashkëmoshatarët e mi edhe pas tmerreve të luftës, jetuan ndarjet që ajo la pas. Ata, fëmijë të moshës shkollore, as nuk e dinin se çfarë i ndante dhe as nuk e kuptonin atë - ata e dinin vetëm se egzistonin të tjerët.

Dhe unë, atëherë tashmë në Zagreb, i rrethuar nga fëmijë të tjerë të të njëjtit besim dhe kombësi, nuk mund t'i kuptoja as ndarjet e tilla. Megjithatë është e pamundur të rritesh dhe të mbetesh i izoluar nga kjo në një shoqëri me kaq shumë barrë të pazgjidhur nga e kaluara. Së shpejti e gjithë kjo më kap edhe mua, duke e thithur atë nga shoqëria dhe mjedisi, shumë kohë para se t'i vij radha në libra historie. Kam dëgjuar të gjitha llojet e gjërave që kam menduar se i kam kuptuar, ndërsa në fakt nuk i kam kuptuar.

Pyetja është se çfarë personi do të isha sot nëse nuk do të kishte ndodhur ai prilli i vitit 2013 dhe vizita ime e parë në Beograd. Gara e shkollave të mesme në sipërmarrje në Beograd mbledhi rreth njëqind të rinj nga të gjitha pjesët e Bosnjes dhe Herzegovinës, Serbisë, Malit të Zi dhe Kroacisë. Nuk mund të them se nuk kishte të paktën një frikë të vogël mbi atë se si do të më prisnin atje, por ato ndjenjë u zhdukë në momentin që mbërritëm në Beograd.

Për herë të parë, pata mundësinë të dëgjoj histori nga ana tjetër, por gjithsesi nga perspektiva e individëve. Megjithatë, kuptimi i një ane tjetër të historisë, i disa ngjarjeve të tjera që unë kurrë nuk i kisha dëgjuar më parë, më shtynë të filloj të rimendoj bindjet e mia dhe të filloj me konkluzionet e mia. Nga ai moment e tutje, gjërat ndryshojnë.

302

Çdo mik që bëra në ato pak ditë e afroi Sarajevën ose Podgoricën me Zagrebin. Fatkeqësisht, shumë të rinj nuk do ta arrijnë atë pikë të rishikimit dhe pikëpamjes nga një këndvështrim tjetër dhe do të ndjejnë ende frikën që unë gjithashtu ndjeva gjatë vizitës time të parë në Beograd. Kjo frikë është një pengesë për të gjitha palët e përfshira në ngjarjet e viteve 90-të kurse ajo mund të kapërcehet më së miri duke u përballur me të.

I thashë vetës - bëhu gati dhe shko, sigurohu që të jetë vërtet ashtu se si të thonë. Për ta shtrirë këtë ide në mjedisin tonë, me iniciativën e një kolegu nga Beogradi, në fillim të vitit 2015, filluam projektin "A nuk është më mirë kështu". Bëhet fjalë për xhirimin e një filmi dokumentar të shkurtër dhe plotësisht amator që paraqet ndryshimet dhe problemet tona si lidhje midis të rinjve në këtë hapësirë.

Ekipet mbledhen në Zagreb, Sarajevë dhe Beograd me gjithsej rreth dyzet anëtarë dhe ata shpejt rriten në Shoqatën e të Rinjve Ballkanasi me ekipe në të tre qytetet. Ndryshe nga organizatat e tjera që punojnë në terren, mënyrat tona për të bërë gjërat ishin pak më ndryshe. Ne



lëmë mënjanë shkaqet dhe të kaluarën dhe synuam thjesht lidhjen dhe njohjen e njëri-tjetrit. E kaluara është diçka për të cilën të gjithë duan të flasin, por pakkush dëshiron të thellohet në temë dhe të mësojë vërtet diçka, kështu që shumë të rinj ikin nga aktivitetet që përfshijnë tema të tilla. Këta të rinj ishin grupi ynë i synuar.

Ideja e filmit ishte të ndiqte udhëtimin e një grupi të rinjsh me kombësi, fe dhe histori të ndryshme nëpër mjedise të ndryshme në të gjithë Ballkanin. Që nga ai moment, ai kuriozitet i zakonshëm shndërrohet në një projekt serioz me një qëllim ambicioz. Që nga dita e parë kemi hasur në shumë probleme, dhe një nga më të mëdhatë ishte që ne jemi pothuajse të gjithë amatorë në gjithçka me çfarë duhet të merret organizata.

Por hap pas hapi, ne po i afroheshim gjithnjë e më shumë qëllimit. Takim pas takimi, nga qyteti në qytet, ne gjithashtu thyem disa prej paragjykimëve tona. Kanë kaluar shumë vite që nga ajo kohë, por unë ende i konsideroj të gjitha ato qytete si shtëpinë time të dytë. Idea jonë u ndesh me reagime pozitive pothuajse kudo. Dera na u hap nga individë, por edhe nga media, duke na ndihmuar që ta çonim zërin tonë tek një masë më e gjerë.

Kurrë nuk do ta harroj paraqitjen e parë në televizion dhe intervistën e parë. Në Serbi dhe Bosnje dhe Hercegovinë, media të të gjithë kalibrave shkruanin për ne, nga portalet më të vogla rajonale dhe të qyteteve deri tek emra të mëdhenj si “Politika” e Beogradit, programi i mëngjesit i RTS-it dy herë, BHRT e Bosnjes dhe Hercegovinës, N1 dhe të tjerë.

Në Kroaci, situata ishte ndryshe. Mediat e madhe nuk kishin vesh për projektin tonë, por ne ishim interesant për portalet e shumta, gazetatat dhe televizionet rinore. Gazeta Global ka shkruar për ne, kemi qëndruar para kamerave të Televizionit Studentor, ishim mysafirë në Yamm FM, dhe gjithashtu ishin edhe portalet e tilla si Studentski.hr, srednja.hr, x-ica, etj. Aktivitetet tona u mbështetën nga Rrjeti Rajonal i Paqes, anëtar i të cilit ishim.

Xhirimet i filluam në verën e vitit 2016. Historia jonë fillon në Sarajevë, një qytet që vizitova për herë të parë për shkak të shoqërisë nga Ballkanasi. Në kohën e xhirimeve, ai qytet është tashmë i imi, njerëzit e mi janë rreth meje, dhe kamera këtu dhe atje nuk bëri ndonjë ndryshim. Disa ditë në një qytet dhe më pas në një tjetër, e tillë ishte

jeta jonë për dhjetë ditët e ardhshme.

Në atë furgon të vogël të kuq nga i cili mund të dëgjoheshin grupet Zabranjeno pušenje, Prljavci dhe Bajaga, u krijuan disa nga kujtimet e mia më të bukura të asaj periudhe. Nga Sarajeva në Tuzëll dhe më tej në Zagreb, Trogir, Split, Mostar dhe përmes Sarajevës ku ishim në fillim në Beograd dhe finalja në Jagodinë - ne ishim një karvan që shtynte hundët dhe thjerrëzat e saj kudo, duke ndjekur njerëz të famshëm dhe të panjohur në rrugë. Vendosëm profesorë, artistë, kamerierë para thjerrëzave të kamerave, por gjithashtu hulumtuam secilin qytet në mënyrën tonë ashtu që shikuesi të ndjente pulsën e qytetit.

Shfaqja e parë në Beograd mbledhi mbi gjashtëqind njerëz në sallën e Qendrës Rinore. Pastaj erdhën Zagrebi, Sarajeva, Jajce, Umagu, Tuzlla dhe Prijedor. Në secilin prej atyre qyteteve, ne shikonim përsëri filmin që tashmë e dinim përmendësh, por nuk u mërzitëm. Duke parë të gjithë ata njerëz që kthehen para kamerës dhe situatat që kaluam, çdo herë do të kujtoheshim se sa e ka pasuruar jetën tonë ky projekt. Përpjekja që kemi bërë për këtë projekt na u shpërblye përmes përvojës, njohjeve dhe kujtimeve të reja - në të njëjtën kohë ne bëmë diçka për veten tonë, por edhe për shoqërinë.

—  
304  
—

Ne mund të mos kemi qenë në gjendje të ndikojmë në masa të njerëzve, por që nga fillimi kemi shënjestruar individë dhe jemi të lumtur të dimë që ishim ai hapi i parë në zgjerimin e horizonteve për dikë. Pas xhirimit dhe shfaqjes së filmit u ndamë si grup dhe të gjithë vazhduan rrugën, por disa janë akoma këtu midis miqve të mi më të ngushtë.

Pas Ballkanasit, aktivitetet e mia i kam vazhduar në Nismën e të Rinjëve për të Drejtat e Njeriut. Ndryshe nga Ballkanasi, kauza nuk kapërcehet, por përmes bisedës dhe punës në tema të dhimbshme, bëhet një përpjekje për të ndikuar në vetëdijen e individëve dhe komunitetit. Duke vizituar vendet kyçe të kohës së luftës, biseduar me njerëzit që kanë ndjerë tmerret e luftës në lëkurën e tyre, duke marrë pjesë së bashku në përkujtime, me mendimin më të rëndësishëm në mendje - çdo krim është një krim, pavarësisht nga kombësia e viktimës dhe autorit të veprës.

Shpesh dëgjojmë se si duhet të largohemi nga viti '45 dhe '91 dhe se mirremi me tema që janë kancer i të gjitha kombeve ballkanike. Ndarjet në të majtë dhe të djathtë futen në të gjitha porët e shoqërisë kroate.



Duke mbajtur atë barrë, ne sillemi në një rreth duke i bërë më shumë dëm vetes sonë se kujt do tjetër. Por, a është zgjidhja t'i lëmë pas të gjitha siç janë sot dhe të vazhdojmë tutje? Të lëmë fëmijët të mësojnë kaq shumë histori paralele dhe krejtësisht të kundërta? Gjërat e tilla nuk mund të futen nën tapet përgjithmonë dhe herëdo mund të pritët që të ketë një përshkallëzim zemërimi dhe tërbimi që grumbullohet në një komb, për të cilin të tjerët janë fajtorë për të gjithë fatkeqësitë e tij.

Shembulli më i mirë për këtë janë ngjarjet e luftës të viteve 90-të, të cilat praktikisht ndjekin Luftën e Dytë Botërore, duke sjellë nga të vdekurit emrat, flamujt, këngët, por edhe traumat që u shtypën nën historinë e njëanshme të epokës socialiste. Injorimi i historisë për të ndërtuar në dukje paqen në shoqëri na ka bërë që sot të kemi masa që injorojnë faktet më të thjeshta dhe më themelore historike. Ndikimi i mjedisit dhe përvojat personale shpesh të mbuluara nga aksidente dhe frika janë gjithsesi më të forta sesa faktet e sekuencës historike.

Por si është e mundur që historitë tona të jenë kaq të ndryshme? Si është e mundur të manipulojmë viktimat jo në mijëra, por në qindra mijëra jetë njerëzore? Thjesht janë politikanët që sigurojnë jetesën prej saj, historianët në shërbim të qeverisë dhe një popull i torturuar. Që nga fundi i Luftës së Dytë Botërore, fillojnë lojërat e sakrificës dhe gara për atë se kush ishte viktimë më e madhe në mesin e popujve ballkanikë që nga koha e turqve. Shënimi i krimit shndërrohet në një numër që duhet të jetë sa më i madh që të jetë e mundur.

Në të njëjtën kohë, ne kemi një kompleks të pabesueshëm të pafajësisë sonë dhe çdo përmendje e krimeve të palës sonë justifikohet nga një argument - por çfarë na bënë ata? Si mund Vukovari të jetë hakmarrje për Jasenovcin, krimet në "Stuhi" për Vukovarin? Kush është në rradhë për t'u hakmarrë? Historia e pazgjidhur lë çështjen e hakmarrjes që popujt tanë tashmë e kanë ndërë shumë herë të hapur, a dëshirojmë vërtet t'ua lëmë këtë çështje brezave të ardhshëm?

Komisione të përbashkëta, punë kërkimore etike dhe të paanshme dhe më pak "histori kafenesh" janë mënyrat kryesore që çojnë drejt paqes afatgjatë në këtë zonë. Nisma e të Rinjëve për të Drejtat e Njeriut po punon në disa projekte për këtë qëllim. Së bashku me partnerët e saj, u krijua Koalicioni për KOMRA, i cili avokon që nga viti 2006 për krijimin e një koalicioni të pavarur dhe jashtë gjykatës ndërkombëtar me mision për të hetuar faktet e krimeve të luftës dhe të gjitha shkeljet



e tjera të të drejtave të njeriut në të gjithë ish-Jugosllavinë nga viti 1991 deri në 2001.

Ekziston edhe projekti “E Kaluara Vazhdon” (Past Continues) i cili filloi në vitin 2018 dhe mbledhi më shumë se njëqind të rinj nga të gjitha vendet post-jugosllave. Ata u ndanë në grupe nga dy vende dhe zgjodhën çështjet për t'u adresuar. Si shembull, kemi një grup të rinjsh nga Kroacia dhe Serbia të cilët do të shkruajnë për Vukovarin dhe Stuhinë, duke krijuar një narrativë përfundimtare që bazohet në fakte sa më shumë që të jetë e mundur.

Projekti do të rezultojë në botimin e një përmbledhje që do të bashkojë narrativat e të gjitha grupeve dhe do të tregojë se si bashkëpunimi mbi çështje të së kaluarës është i vështirë, por megjithatë i mundur.

Brezat e rinj trashëgojnë barrat e brezave të mëparshëm edhe pse ata kanë lindur pas vetë luftës. Kjo do të ndodhë derisa të kuptojmë vetë se problemi nuk është vetëm tek të tjerët. Në momentin që do të kuptojmë se krimi nuk ka kombësi dhe fe, që kriminelët duhet të dënohen nëse vrasin nën cilindo simbol kombëtar, qoftë një tabelë shahu, një zambak apo një shqiponjë, të rinjtë më në fund do të jenë në gjendje të rriten pa atë barrë. Secili prej shteteve tona ka për detyrë të ndëshkojë kriminelët dhe të punojë për drejtësi për viktimat. Zgjidhja nuk është të heshtet, por as të bëhen grindje midis palëve sikurse tani. Vetëm biseda cilësore e mbështetur nga faktet çon në mirëkuptim, zgjidhje të çështjeve dhe përfundimisht në paqe. Roli i aktivistëve është vendimtar në këtë proces. Puna me tema si tmerret e luftës dhe të drejtat e njeriut mbart barrën e dënimit nga komuniteti. Nuk është e lehtë të merresh me të, por vetëdija që ndihmoni të paktën edhe një individ të vetëm do t'ju shtyjë përpara.

Përvojat që kam mësuar më kanë ndryshuar në një masë të tillë që sot nuk mund ta imagjinoj jetën pa njohuritë, kujtimet dhe njerëzit që kam takuar gjatë këtyre viteve të veprimit. Edhe pse jam duke studiuar për një fushë krejt tjetër dhe investoj shumë më pak kohë dhe përpjekje në aktivizëm sesa disa nga kolegët dhe miqtë e mi, besoj se çdo veprim ka rëndësi. Nëse secili individ do të mendonte për një mënyrë për të ndihmuar komunitetin e tij në një farë mënyre, cilado qoftë ajo fushë, ne do t'i linim brezave të ardhshëm një botë shumë më të bukur.

Ante Perez

*Ky tekst u botua fillimisht në H-Alter si pjesë e projektit “Le të flasim për luftën për të jetuar në paqe” i cili është pjesë e projektit “Aktivizmi i sektorit civil për pajtim në ish-Jugosllavi - Mbështetja për KOMRA” i bashkëfinancuar nga Bashkimi Europian.*

## *Nuk duam të jetojmë jetën tuaj!*

---



Personalisht, unë kam qenë me shumë fat që jam përfshirë në shumë projekte që kanë të bëjnë me aktivizmin e paqes, temat e luftës dhe të pasluftës. Këto projekte dhe këta njerëz, për të cilët nuk do të dëgjoni kurrë në media, i shtojnë të rinjtë të mendojnë në mënyrë të pavarur dhe kritike për atë që ka ndodhur. Ne thjesht duam të bëjmë një jetë normale, duke mos parë kombësinë, fenë, gjininë e dikujt tjetër... Ne thjesht duam të jetojmë paqen. Kurse për paqe duhet të punohet. Mendoj sikur nuk mund më të zgjedhim të veprojmë ose jo. Brezat e mëparshëm e kishin këtë kurse (mos)veprimit e tyre e jetojmë ne sot. Nuk ka më zgjedhje, ka vetëm përgjegjësi.

Si brez i pasluftës, u rrita me histori heroizmi, por edhe të katastrofës së rëndë që goditi territoret e ish-Jugosllavisë. Si fëmijë, pata mundësinë të dëgjoja histori të ndryshme të prindërve të mi për atë që ndodhi në këtë hapësirë në vitet '90.



Praktikisht, siç e përjetoj këtë të paktën sot, jam rritë me tema lufte sepse prindërit e mi ishin gjithmonë shumë të gatshëm t'u përgjigjeshin në të gjitha pyetjeve të mia ose të flisnin me iniciativën e tyre për ngjarje të ndryshme, krime dhe/ose operacione. Në të njëjtën kohë, tema nuk u ngushtua ekskluzivisht në territorin e Republikës së Kroacisë, por ata ishin gjithashtu të gatshëm të flisnin për luftën në BiH, luftën në Kosovë... Duke përfunduar secilin tregim me të njëjtën frazë: “Është e rëndësishme të dini se çfarë ka ndodhur!”

Unë isha me fat sepse prindërit e mi, ndryshe nga sistemi arsimor dhe mediat toksike, gjithmonë u përpoqën të më tregonin një pamje të drejtë, pa marrë parasysh sa e dhimbshme dhe e turpshme ishte dikur. Gjithashtu, gjithmonë më është theksuar se kurrë nuk do të jem në



gjendje të kuptoj vuajtjet dhe urrejtjen e njerëzve të caktuar dhe se nuk ia vlen të përpiqem shumë.

Dhe në të vërtetë, pas një periudhe të gjatë trajtimi të temave të luftës, pa marrë parasysh sa përpiqem ta kuptoj dhe ta afroj atë ndjenjë më pranë vetes, nuk mund të di se çfarë kanë kaluar njerëzit. Është e thjeshtë, nëse nuk e keni kaluar atë gjë, nuk mund ta kuptoni. Megjithatë, të paktën mund të përpiqem të kuptoj vuajtjet e dikujt.

Të mësuarit im për luftën dhe vetë njohuritë e mia kanë ndryshuar, azhurnuar dhe marrë forma të ndryshme gjatë viteve të fundit. Një pjesë e këtij ndryshimi ka të bëjë me studimin që kam regjistruar (shkenca politike), një pjesë me kërkimin e vetë-iniciuar.

Fillova të kërkoja ekskluzivisht për projekte që merren me çështje lufte, sepse isha e interesuar se si bashkëmoshatarët e mi nga vendet e tjera i përjetuan luftërat e viteve 90-të dhe si e shikuan ata situatën në vendin e tyre. Rreth një vit e gjysmë më parë, pashë një ftesë për të gjithë të rinjtë e interesuar në çështjet e luftës dhe që merreshin me të kaluarën për të aplikuar për projektin “Narrativat e përbashkëta - e kaluara vazhdon”, dërguar nga Nisma e të Rinjëve për të Drejtat e Njeriut. Projekti u bë në nivelin rajonal (Kroaci, Serbi, BiH, Mali i Zi dhe Kosovë) dhe synon të shkruajë narrativa të përbashkëta mbi temat e luftës. Unë menjëherë hapa linkun dhe u regjistrova!

Një mijë emocione të ndryshme më kaluan nëpër kokë, por kryesisht një ndjenjë entuziazmi dhe kënaqësie sepse më në fund dikush po na pyet edhe ne të rinjëve për luftën. Më në fund mund të flasim për mënyrën se si e përjetojmë dhe të mësojmë atë që ende nuk dimë. Mbaj mend që një nga detyrat kur aplikoni për projektin ishte dërgimi i një fotografie/imazhi që personalisht na asocion me luftën dhe na duhej të shkruanim pse e zgjodhëm atë dhe si lidhet kjo me luftën.

Menjëherë e kam ditur se cilën fotografi duhej të dërgoja - kullën e ujit nga Vukovari. Në atë moment, kjo ishte mjaft logjike: “Kjo është ajo me të çfarë jam rritur dhe për çfarë duhet të jemi krenarë”. Megjithëse isha e vetëdijshme për krimet dhe vuajtjet e civilëve serbë gjatë çlirimit të Vukovarit, kjo ishte disi asociimi im i parë me luftën. Unë jam lindur dhe rritur në Zagreb, kështu që kurrë nuk kam qenë e ekspozuar drejtpërdrejt ndaj mbetjeve të luftës.

Jeta ime e përditshme në Zagreb nuk është e mbushur me histori





kafenesh për ndërtesa të shkatërruara, granata që bien dhe jetë të shkatërruara të fëmijë. Nuk ka diçka të tillë këtu, të paktën njerëzit nuk flasin për të. Ajo që përmendet më shpesh dhe më shumë është Vukovari, kryesisht nëpër media. Sigurisht, jo gjatë gjithë vitit, por vetëm kur është e nevojshme për përfitime politike.

Për fatin tim të mirë, u pranova në projekt. Konferenca e parë u mbajt në fillim të vitit 2018 në Beograd. Erdhën mbi 150 të rinj nga i gjithë rajoni i ish Jugosllavisë. Të gjithë me prejardhje dhe rrëfime të ndryshme historike me të cilat jemi rritur. Kishte një atmosferë të mrekullueshme, pozitive të të rinjve që erdhën të mësojnë nga njëri-tjetri dhe të punojnë për diçka më të mirë për të ardhmen tonë.

Disa gjëra më goditën jashtëzakonisht shumë. Në një seminar ishim të ndarë sipas vendeve dhe në dyshemenë para nesh ishin fotografitë që të gjithë i dërguam së bashku me formularët e aplikimit. Në atë moment, unë mbeta e hutuar. Të gjitha grupet e tjera kishin disa imazhe të përsëritura, por në përgjithësi përmbajtja ishte e larmishme. Grupi im kishte mbi 70 përqind fotografi të kullave të ujit nga Vukovari. Të gjithë e pamë njëri-tjetrin me miratim dhe mirëkuptim: “Po, kjo është historia jonë!” Disa çaste më vonë, një grup krejtësisht i bashkuar dhe krenar u prish nga pyetja e një grupi të rinjsh nga Serbia: “Si e justifikoni Vukovarin?”

U krijuar një heshtje e plotë. Në një mënyrë normale të të menduarit, besova se duhet të ngrihem në këmbë dhe të kërkojmë falje për atë që ka ndodhur ose të përmendim të gjitha viktimat e vuajtjeve dhe të theksojmë se ne në Kroaci kemi një problem të madh të mos përballesh me të kaluarën dhe mohimit të krimeve. E shpreha mendimin tim brenda grupit. Unë dhe një kolege shprehëm pikëpamje të ngjashme, por nuk u pritëm me miratim. Paso i një panik i përgjithshëm, nacionalizmi filloi të zgjohej, narrativat e gabuara dhe jo të plota me të cilat u rritëm vetëm dolën në sipërfaqe.

Një koleg nga grupi e kërkoj mikrofonin dhe e lexoi vendimin e Betejës për Mbrotjtjen e Vukovarit nga telefoni. Ndërsa lexoi tekstin për mbrotjtjen e Vukovarit, ai shpërtheu me krenari. Situata dukej paksa joreale. Të rinj, të paprekur nga lufta dhe në të njëjtën kohë kaq krenarë dhe plot keqkuptime për të gjitha viktimat e vuajtjeve.

Por paniku vetëm sa u intensifikua; Një koleg tjetër u përgjigj dhe mori mikrofonin: “Duhet ta kuptoni që ajo që ndodhi atje është numerikisht

dhe përse i përket shkallës së katastrofës e pakrahasueshme me atë që ju na bëtë ne...” Me një ngërç në stomak mora mikrofonin dhe u përpoqa të qetësoja kalvarin që u ngrit: “Ne brezat e rinj nuk kemi nevojë të justifikikohemi”. Për fat të mirë, seminari në atë moment përfundoi.

Edhe sot shpesh e kujtoj atë ngjarje dhe nuk mund të shpjegoj se çfarë u ndodhi të rinjve që janë të paprekur nga lufta (dua të them ata që vërtet nuk e përjetuan luftën dhe tmerret që ajo sjell me vete) sa mund të flasin me kaq shumë urrejtje dhe intolerancë në zë.

Për shkak të njerëzve të tillë dhe të ngjashëm, sot kemi atë që kemi - një grup turistësh nga Serbia të rrahur në Braç, rrahjen e serbëve lokalë në një kafene afër Kninit... Jetojmë të kaluarat e gabuara, jo të plota që sot krijojnë urrejtje. E jetojmë këtë sepse nuk flasim për atë që ka ndodhur, ku dhe si. Nuk flasim për fajtorët, nuk flasim për viktimat. Thjesht nuk flasim - e shmangim këtë. Pleqtë pretendojnë se kështu është më lehtë.

Në të njëjtën konferencë në Beograd, mbaj mend ligjëratën e Žarko Puhovskit. Ai tha se shkenca e ka konfirmuar vazhdimisht gjatë historisë se rimëkëmbja e komuniteteve etnike të shembura dhe të ndara është e mundur, ju vetëm duhet të ndiqni një skemë të caktuar që ekziston. Së pari, duhet të ketë një dialog brenda komuniteteve për problemet dhe mundësinë e diskutimit të vazhdueshëm rreth tyre. Biseda pasohet nga një përballje mendimesh dhe diskutimesh. Pastaj vjen kërkim falja, falja dhe vazhdimi i mundshëm i mirëqenies në komunitete.

Duke filluar me individin, është e rëndësishme të falësh. Dhe është me të vërtetë e mundur të falësh, cilado qoftë baza e krimit. Sidoqoftë, profesor Puhovski vuri në dukje problemin që e shohim akoma edhe sot: “Kë duhet të falin viktimat? Kë, kur akoma nuk e dimë ose nuk duam ta dimë kush janë autorët e këtyre krimeve. Kështu humbet edhe gjurma e viktimave”. Dhe vërtet është kështu. Kë ta falim kur mohojmë krimet dhe viktimat? Kush dhe kë ta fal kur nuk duam të flasim për këtë gjë?

Menjëherë pas asaj konference, me rastin e pjesës së dytë të projektit, e cila u zhvillua në Sarajevë, ne vizituam një pasdite vendin Ahmiqi. Kogja e hutuar, por shumë kurioze, shkova në atë udhëtim me pjesëmarrësit e tjerë. Deri atëherë, nuk kisha parë kurrë atë që kishte



ndodhur atje.

Mbërrijmë para xhamisë ku na pret një hoxhë mikpritës dhe i qeshur (fatkeqësisht nuk e mbaj mend më emrin e burrit, por fytyrën dhe fjalët e tij do t'i kujtoj përgjithmonë). Ai na ftoi në një dhomë të vogël që është një lloj muzeu i bërë për të kujtuar atë që ndodhi në Ahmiqi në prill të vitit 1993.

Nikoqiri ynë na udhëhoqi nëpër atë dhomë me tregimin rreth operacionit “48 orë hi dhe gjak”. Unë dridhesha gjithnjë e më shumë nga çdo fjali e tij. E gjithë ajo neveri e kimit është edhe më keq kur njerëzit nuk e dinë se ka ndodhur.

Kur ai mbaroi prezantimin e tij, unë menjëherë e pyeta, me aq shumë dëshirë që përgjigja të ishte po: “A ka ardhur ndonjëherë ndonjë nga kroatët që jetojnë në Ahmiqi ose rrethinë për të parë këtë dhomë, për të dëgjuar të njëjtin tregim dhe për të kërkuar falje për gjithçka?” Hoxha thjesht më shikoi thatë, pak i hutuar nga pyetja ime e nxituar, por në të njëjtën kohë me dhimbje të madhe ai dha një përgjigje të trishtuar – “jo”. Unë vetëm e shikoja mërztishëm dhe heshtja.

---

311

---

Shumë kohë pas kësaj, më ka përndjekur e njëjta ndjenjë që më pushtoi gjatë leksionit të hoxhës - një ndjenjë e pafuqisë së plotë. Duket sikur mijëra “më falni” po qëndrojnë në fytin tënd dhe nuk mund të marrësh frymë prej tyre, dhe thjesht dëshiron të bërtasësh dhe të rregullosh gjithçka që ka ndodhur. Ta rregullosh pasi shikon që njerëzit ende vuajnë, sepse vetëm koha nuk do t'i zgjidhë ato probleme. Askush nuk i zgjidh ato. Për Ahmiqin akoma nuk flitet, ende nuk kemi kërkuar falje publike për Ahmiqin.

Dhe çdo ditë shoh të rinj të fiksuar pas luftës dhe ndonjë heroizmi të pretenduar, thirrjeve “Të gatshëm për atdhe” („Za dom spremni“), nacionalizmit sadist ... E gjithë kjo lulëzon tek të rinjtë që nuk janë as të vetëdijshëm se janë me fat pasi nuk i preku lufta. Dhe çdo ditë tronditem përsëri dhe përsëri nga marrëzia njerëzore dhe inercia e institucioneve themelore të shtetit. A është kaq e vështirë të thuash publikisht gjëra që janë përcaktuar nga gjykatat (madje edhe ato ndërkombëtare) dhe të kërkojë falje për të?

A është më mirë të jetosh në një ballonë brenda së cilës fëmijëve u mësohen gënjeshtra dhe të vërteta jo të plota dhe/ose të reme pa ndonjë pendim? Duket se ata që duhet të parët të zgjidhin këtë



problem preferojnë që brezat e rinj të shkatërrohen të indoktrinuar nga nacionalizmi dhe krenaria pretenduese për arritjet e vendit të tyre, sesa të mësojnë të vërtetën dhe të ndërtojnë paqen për të cilën vujnë këto hapësira dhe këta njerëz. Nëse ata që duhet nuk e bëjnë këtë, ne të rinjtë do të rregullojmë atë që duhet të rregullohet. Sepse flasim për këtë, sepse nuk shmangim temat e luftës dhe nuk kemi frikë të ndërtojmë diçka të re dhe më të mirë së bashku.

Mendoj sikur nuk kemi më mundësi të zgjedhim të veprojmë ose jo. Brezat e mëparshëm e kishin këtë mundësi dhe (mos)veprimin e tyre e jetojmë edhe sot. Nuk ka më mundësi, ka vetëm përgjegjësi. Dhe nuk e di nëse mënyra e duhur është t'i kërkojmë falje individuale dikujt për krime apo jo. Nuk e di se kush duhet të dijë ose të mos dijë diçka, por e di që nuk duhet të heshtim për këtë në mënyrë që të jetojmë në paqe. Nëse jo për brezat tanë, kjo paqe do të sjellë dobi për brezat e ardhshëm. Është e qartë se lufta nuk i solli askujt ndonjë të mirë. Është koha të heqim dorë prej saj dhe të shikojmë drejt paqes.

Situata më duket sot më mirë. Gjegjesisht, disa ditë më parë në konferencën në Vukovar “Tregimet e pathëna: Të rinjtë dhe ballafaqimi me të kaluarën”, kuptova se sa të rinjve u duhet vërtet ajo paqe. Kur prezantuan pikëpamjet dhe përshtypjet personale në lidhje me luftën dhe narrativat me të cilat ata u rritën, nxënësit e shkollës së mesme të Vukovarit u bënë të vetëdijshëm se pse duhet të flitet për këtë.

Këta fëmijë janë kuptimi i gjithçkaje që po bëhet në fushën e ballafaqimit me të kaluarën. Këta njerëz të rinj, të bukur, kanë folur për gjëra që janë mjaft të natyrshme për moshën e tyre; mënyra e kryerjes së aktiviteteve jashtëshkollore, ekskursionet dhe udhëtimet, ndarjet gjatë garave sportive... Gjëra krejtësisht natyrale, por gjëra që atyre u janë pamundësuar pasi ndahen vazhdimisht sipas kombësisë.

Një djalë, Uroš Antić (17), tha se një pjesë e familjes së tij ishte nga Kroacia, ndërsa pjesa tjetër ishte nga Serbia. Ai rrëfeu se si sot familja e tij, e cila u dëbua në masë të madhe nga Dalmacia, e sheh të tërën që ndodhi gjatë luftës dhe si jetojnë në Vukovar sot ata që mbeten. Pastaj foli për diçka kaq banale, por në fakt kaq të rëndësishme për afirmimin e një fëmije të shkollës së mesme – për ekskursionin e maturës:

“Dhe për shkak të faktit që jemi të ndarë në dy ndërrime, unë duhet të shkoj në ekskursion në Suboticë dhe Novi Sad, ndërsa miqtë e mi nga turni kroat mund të shkojnë në Poloni dhe Hungari. Unë nuk

dua të jetoj luftën e dikujt tjetër, unë vetëm dua të rri me miqtë e mi normalisht dhe të jem në gjendje të shkoj në ekskursion me turnin e dytë”.

Atëherë ishte plotësisht e qartë për mua se të gjithë ne që ballafaqohemi me tema lufte dhe zgjidhjet e tyre, në fakt jemi Uroši; nuk duam të jetojmë luftën. Thjesht duam të jetojmë një jetë normale në paqe, duke mos parë kombësinë, fenë, gjininë e dikujt tjetër... Ne thjesht duam të jetojmë paqen. Dhe kjo paqe është e mundur nëse punohet për të.

Personalisht, unë kam qenë me shumë fat që jam përfshirë në shumë projekte që kanë të bëjnë me aktivizmin e paqes, temat e luftës dhe të pasluftës. Këto projekte dhe këta njerëz, për të cilët nuk do të dëgjoni kurrë në media, i shtynë të rinjtë të mendojnë në mënyrë të pavarur dhe kritike për atë që ka ndodhur. Po këta njerëz ma kanë mundur mua, por besoj edhe shumë të rinjëve të tjerë, të përpiqem të punoj për ndryshimin në shoqëri.

Ju kurrë nuk do të lexoni ose dëgjoni për këta njerëz brenda orës së pikut të transmetimit të ngjarjeve më të rëndësishme politike në shoqëri, por do të duhej të dëgjoni. Ju nuk do të dëgjoni sepse ata nuk i bëjnë këto gjëra për hir të publicitetit dhe përfitimeve politike, por sepse ata besojnë se të rinjtë meritojnë paqe. Ata besojnë se të gjithë meritojnë të vërtetën dhe paqen.

Viktorija Stanković

*Ky tekst u botua fillimisht në H-Alter si pjesë e projektit “Të flasim për luftën për të jetuar në paqe” i cili është pjesë e projektit “Aktivizmi i sektorit civil për pajtimin në ish-Jugosllavi - Mbështetje për KOMRA-në” i bashkëfinancuar nga Bashkimi Evropian.*





PËRFUNDIM



ALICE  
INDICATING  
FACTS  
DEFENCE  
TRUTH  
LAW  
RESPONSIBILITY  
GUILT  
JURY

# PËRFUNDIM









Ky libër me narrativa të përbashkëta, i shkruar nga të rinj nga e gjithë ish-Jugosllavia, nuk u bë për të mbledhur pluhur në raftet e OJQ-ve të ndryshme. Procesi i krijimit të tij përshkruhet në kapitullin hyrës - lindja e një metodologjie për hartëzimin e rrëfimeve kontradiktore në lidhje me episodet më të diskutueshme të konflikteve të ndryshme, dekonstruktimit të tyre përmes udhëtimeve studimore, intervistave dhe hulumtimeve, dhe më pas duke ardhur ngadalë në narrativa të përbashkëta. Në secilin nga hapat e procesit kishte një kuptim të qartë se ne po shkonim drejt diçkaje më të madhe - se procesi në vetvete po krijonte një mori xhirimesh deri në pikën ku u bë e vështirë për të mbajtur gjurmët e të gjithave. Ishte një përvojë transformuese në nivel personal - si për organizatorët, ashtu edhe për disa nga pjesëmarrësit; ishte një përvojë transformuese edhe në nivelin tonë kolektiv, grupor - sepse ne filluam një udhëtim të pasigurt me një qëllim të qartë, por pa një hartë ose manual të qartë se si të arrinim atje. Për organizatorët, kjo nënkuptonte pjesëmarrjen në vëzhgimin e pjesëmarrësve dhe vetës së tyre gjatë këtij procesi dhe hartëzimin e metodologjisë së ardhjes tek rrëfimet e zakonshme gjatë punës me të rinjtë në një mjedis pas konfliktit. Tani, duke parë prapa, vijnë deri tek disa përfundime.

Libri “Narrativat e përbashkëta” është një ***mjet për të avokuar për pajtimin***. Ajo u krijua nga të rinj nga brezi i pasluftës. Është e tashmja e tyre që po rrëmbehet nga elitat politike, duke u përqendruar ende në të kaluarën dhe duke thelluar mosbesimin dhe mosmarrëveshjet e krijuara gjatë viteve 90-të midis shteteve tona fqinje dhe midis komuniteteve brenda tyre. Libri i narrativave të përbashkët dëshmon për faktin se njerëzve (të rinjtë), kur u jepet mundësia të takohen dhe diskutojnë për çështje të diskutueshme nga e kaluara, mund ta bëjnë këtë pa kërcënime dhe dhunë. Ai dëshmon gjithashtu për aftësinë e të rinjve për të udhëhequr përpjekjet për të mbrojtur pajtimin, pasi

autorët e librit kanë treguar pjekuri nga e cila largohen shumë nga udhëheqësit aktualë të shteteve tona. Lëvizja studentore gjermane në vitin 1968 ishte e njohur për thyerjen e së kaluarës naziste, shkeljen e paktit të heshtjes dhe refuzimin e krimeve të baballarëve dhe gjyshërve të tyre - a janë vendet e Ballkanit Perëndimor të gatshme për një lëvizje si kjo e të rinjve gjermanë të vitit 1968 që u shkëput me të kaluarën naziste dhe krimet e prindërve të tyre? Ky lloj studimi i së kaluarës i udhëhequr nga një brez i ri që merr dhe përvetëson mësimet e historisë për të përmirësuar të tashmen dhe për të hapur rrugën për një të ardhme më të mirë është diçka që mungon në të gjitha vendet e ish-Jugosllavisë. Të rinjtë po largohen nga vendet e Ballkanit Perëndimor dhe emigracioni po bëhet një nga çështjet kryesore me të cilat përballet e ardhmja e rajonit. Disa studime që hetojnë arsyet pse njerëzit largohen, kanë gjetur lidhje të qarta me të kaluarën që helmon diskursin aktual politik dhe publik. Kjo mund të sugjerojë që mbase ka ardhur koha për të krijuar një lëvizje rinore që kërkon të qetësojë të kaluarën.

Duke marrë parasysh rolin vital të arsimit në ruajtjen ose heqjen e ngarkesës së narrativave të ndryshme historike, duhet të marrim ***parasysh përdorimin potencial të librit me narrativa të përbashkëta në një kontekst edukativ***. Meqenëse libri zbaton multiperspektivitetin në eksplorimin e rrëfimeve të ndryshme për të njëjtat grupe ngjarjesh, një udhëzues krahasues dhe ilustrues se si historia ndërtohet, instrumentalizohet dhe mësohet është e dobishme. Vendet e ish-Jugosllavisë kanë vështirësi të merren me të kaluarën e afërt, që nga Lufta e Dytë Botërore e më tej. Sot, polemikat publike për ustashët dhe partizanët janë të shpeshta, ashtu si diskutimet për episodet e ndryshme nga vitet 90-të, kështu që nuk duhet të jetë për t'u habitur që shumica e librave të historisë në shkollat fillore dhe të mesme mezi prekin Luftën e Dytë Botërore, Jugosllavinë gjatë Titos, ose shpërbërjen e saj. Vitet 90-të Mësuesve të historisë nuk u janë dhënë burime të nevojshme për të ligjeruar historitë e kohëve të fundit, dhe duke kuptuar se sa e ndjeshme është ajo akoma - shumica janë të lumtur ta shmangin këtë temë tërësisht. Libri i narrativave të përbashkëta mund të jetë një mjet i dobishëm mësimor në dy mënyra: (1) si një udhëzues krahasues, ilustrues i rrëfimeve historike, modelit të tyre dhe procesit të kërkimit (historik) - veçanërisht kur lidhet me tema që mbahen mend gjallërisht nga shumë në mjedisin tonë (aeteranët, anëtarët e familjes, fqinjët); ose (2) si metodologji që mund të përsëritet në një projekt në klasë ose detyrat të shtëpisë për hartëzimin e rrëfimeve të ndryshme në lidhje me ngjarjet (lokale) nga historia e kohëve të fundit. Mësimi



i historisë në mënyrë participative, me të rinjtë që marrin rolin e studiuesve, është një shembull i pedagogjisë emancipuese që është i përdorur në shkolla. Metodologjia e rrëfimeve të përbashkëta mund të sigurojë një mënyrë që të rinjtë të interesohen për historinë (e fundit), të hulumtojnë aspektet e ndryshme të saj dhe të shkruajnë raporte mbi ngjarjet e kaluara me ndihmën e mësuesve.

Një mënyrë shtesë për të përdorur metodologjinë e narrativave të përbashkëta është **replikimi i saj diku tjetër**. Bota ka, për fat të keq, plot vende me konflikte të zgjata, polarizim dhe versione të ndryshme të historisë. Për shembull, gjatë zbatimit të projektit, ne morëm shprehje të interesit nga Kolumbia për të eksploruar potencialin e zbatimit të kësaj metodologjie në vendin e tyre. Ne mund të parashikojmë zbatueshmërinë dhe transferueshmërinë e kësaj metode në kontekstin e konflikteve të zgjata, shkallëve të larta të polarizimit mbi ngjarjet historike (të fundit) dhe interpretimin e tyre ose instrumentalizimin politik të historisë. Edhe pse narrativat e përbashkëta kanë marrë parasysh ndjeshmërinë socio-kulturore të rajonit të Ballkanit Perëndimor/ish Jugosllavisë, transferimi i metodës natyrisht varet nga drejtuesit e procesit që do ta bëjnë këtë në kontekste të tjera. Duhet thënë se duhet gjetur një mënyrë për lëvizjen (kulturore) përmes hapësirës së sikletshme në mënyrë që të maksimizohen përfitimet e procesit bashkëpunues të kërkimit, hetimit, ballafaqimit dhe dialogut. Së fundmi, ky proces është frymëzuar nga shembuj nga e gjithë bota, projekte dhe iniciativa nga Izraeli, Shtetet e Bashkuara, Franca dhe Gjermania, Armenia dhe Turqia, për të përmendur disa. Çdo shoqëri dhe çdo kontekst është unik. Sidoqoftë, teknologjia e mohimit, propaganda e detyruar, përdorimi i historisë si një mjet i ndarjes dhe si një bazë për pozicionimin armiqësor ideologjik ndaj “tjetrit” dhe një pamje e bazuar në identitet e historisë janë të gjitha procese të njohura që nuk janë endemike Ballkanike.

*Maja Nenadović dhe Mario Mažić*



# EPILOGU



—  
325  
—







# EPILOGU









Është e vështirë të thuash me fjalë ndjenjën e befasisë kolektive pozitive që ndodhi në fund të takimit të autorëve të mbajtur në janar 2019 në Samobor, Kroaci. Një grup prej 18 pjesëmarrësve më aktivë të projektit u mblodhën për të redaktuar dhe finalizuar tekstet e të gjitha grupeve dypalëshe të punës. Ndoshta është natyra e shumicës së proceseve kolektive që vetëm në fund na lejojnë të pranojmë hapur dyshimet që kemi pasur në lidhje me këtë sipërmarrje që nga fillimi? Sido që të jetë, udhëtimi ynë i narrativave të përbashkëta ishte i veçantë, sepse për shumicën prej nesh ishte një përpjekje thellësisht personale, por edhe kolektive. Na lejoi të përballemi me disa skelete të së kaluarës sonë të pazgjidhur dhe përsëri të sfidojmë supozimet tona.

Për ne, si organizatorë, supozimi më domethënës mos plotësimi i të cilit na bëri të lumtur ishte se doli se ishim gabim me idenë fillestare që të gjitha temat e zgjedhura për narrativat e grupeve dypalëshe të punës do të ishin episodet më të diskutueshme, më të përgjakshme të prishjes së Jugosllavisë. Megjithëse shumë tema të tilla janë të pranishme në libër, u befasuam nga iniciativa e secilit prej grupeve dypalëshe për të eksploruar skenën kulturore dhe protestat kundër luftës në vendet e tyre - një temë që është fshehur kryesisht dhe pothuajse është e harruar në narrativat e viteve 90-të. Fakti që protestat kundër luftës u zhvilluan në secilin nga vendet e ish-Jugosllavisë dhe se kishte artistë (shkrimtarë, aktorë, këngëtarë) që përdorën zërin e tyre kundër luftës është një pjesë e shtypur e historisë sepse ajo kundërshton drejtpërdrejt narrativat mbizotëruese të dëshirës unanime dhe të guximshme për vetëvendosje kombëtare. Ishim të lumtur që një grup të rinjsh në këtë projekt vendosën të përqendroheshin në këto protesta si një mënyrë për të ndriçuar dhe tërhequr vëmendjen për faktin se luftërat nuk ishin të pashmangshme, por një zgjedhje e bërë nga elitat politike në atë kohë.

Emri i plotë i projektit ishte “E kaluara e vazhduar: Narrativat e përbashkëta” për të treguar dy gjëra: fakti negativ që e kaluara është tepër e pranishme në jetën tonë të përditshme sot dhe qëndrimin tonë realist nëse ndërtimi i rrëfimeve të përbashkëta ishte fare një mundësi fare në këtë moment në rajon. Sidoqoftë, ky proces na ka treguar se duhet të ndalojmë dyshimet tona, të kontrollojmë supozimet tona dhe të jemi të hapur për një proces bashkë-krijues, bashkëpunues të angazhimit kolektiv (qytetar) në mënyrë që të bëjmë hapat që pasojnë. Në fund të këtij udhëtimi, u pajtuam me faktin se historia nuk mund të ruhet në sirtarë dhe skeda të organizuar me kujdes. Qëllimi ynë i përgjithshëm ka qenë dhe vazhdon të jetë të gjejmë rrugën nga status quo-ja aktuale e “të kaluarës së vazhduar” në vendet e ish-Jugosllavisë në atë në të cilën kjo e kaluar armiqësore është ndërprerë njëherë e përgjithmonë.

*Maja Nenadović*

# MBI PËRDORIMIN E METODËS SË NARRATIVAVE TË PËBASHKËTA









Projekti Narrativat e Përbashkëta ka zgjuar interesin e publikut edhe para se të botohej teksti i tij i plotë. Procesi i qasjes ndaj së kaluarës dhe i të mësuarit të historisë, i krijuar dhe zbatuar nga Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut në nivel rajonal, ka zgjuar interesimin tek një numër i madh të rinjsh, organizatash të shoqërisë civile, institucioneve akademike dhe shtetërore dhe individësh të interesuar në politikë, kulturë të kujtesës, edukim dhe mësim të historisë.

331

Duke kaluar me pjesëmarrësit e projektit nëpër të gjitha fazat u punës, të cilat kanë përfunduar me shkrimin e narrativave, atyre dominuese dhe atyre të përbashkëta, fakti që projekti po mbaronte nxori në dritë të vërtetën se procesi i krijimit të narrativave të përbashkëta në Ballkanin Perëndimor nuk do të mbaroj.

Po kështu, shpejt u bë e qartë se do të ishte jashtëzakonisht e rëndësishme t'i ofrojmë publikut një pasqyrë mbi atë që është krijuar.

Interesi i lartë i pjesëmarrësve në zbatimin e secilit hap të projektit dhe suksesi i tyre në krijimin e narrativave të përbashkëta për të kaluarën e viteve 90-të, ka dëshmuar, mbi të gjitha, se hapa të tillë janë të mundshëm. Duke pasur parasysh kënaqësinë e pjesëmarrësve me punën që është bërë, vlerësuam se do të ishte e dobishme që ky proces i suksesshëm të kthehej në një mjet didaktik për të mësuar historinë. Kështu, kjo rezultoj me një model ndërdisiplinor të të mësuarit, dialogut dhe qasjes ndaj historisë që përmbledh metodën dhe përvojën e përdorur për të sjellë së bashku të rinjtë me prejardhje të ndryshme etnike ose kombësi tjetër, për të biseduar dhe krijuar qasje ndryshe ndaj temave që ndajnë shoqëritë, pjesë e të cilave janë.

Mjetin apo veglën e krijuar e kemi prezantuar në Panairin e Tretë

Kombëtar të mjeteve dhe metodave të mësimi joformal, të mbajtur në maj 2019 në Sleme (Kroaci), organizuar nga Agjencia për Mobilitet dhe Programe të Bashkimit Europian.

Falë interesit për mjetin tonë didaktik që kontribuon në pajtim, jemi ftuar ta paraqisnim atë në ngjarjen ndërkombëtare Tool Fair XIV - #know-how mbajtur në Rovaniemi (Finlandë) dhe organizuar nga SALTO-YOUTH EuroMed dhe Good Practises Resource Center, Agjencia Kombëtare Finlandeze për Erasmus+ dhe Qyteti i Rovaniemit në nëntor 2019, në të cilën janë tubuar më shumë se 140 ekspertë të rinj në punën me të rinjtë nga 38 vende për të shkëmbyer njohuri mbi metodat dhe mjetet e reja arsimore.

Në bashkëpunim me Friedrich Ebert Stiftung dhe Shtëpinë e Europës në Vukovar, në 2019 dhe 2020 kemi prezantuar projektin e Narrativava të Përbashkëta në konferencat e Tregime të Pathëna (Untold Stories) dhe e Kaluara në Jetën tonë të Përditshme: Qëndrimet e të Rinjve (The Past in Our Everyday Life: Attitudes of Young People.) Prezantimi është bërë në panele diskutime dhe punë në grupe ku është diskutuar mbi marrëdhëniet e të rinjve me të shkuarën. Krahas të rinjve, grupet janë përbërë nga ekspertë dhe aktivistë në fushën e politikës së kujtesës dhe historisë, dhe shumë të rinj nga Kroacia dhe Serbia, qofte si pjesëmarrës të drejtpërdrejt ose përmes platformave virtuale.

Në prag të 25 vjetorit të Operacionit Stuhia (Oluja), Documenta - Qendra për Ballafaqim me të Kaluarën në emër të Rrjetit të Pajtimit KOMRA, ka organizuar në gusht të vitit 2020 debatin të quajtur Stuhia në Kulturën e Kujtimit, ku gjithashtu kemi theksuar përfitimet e përdorimit të modelit tonë për të gjetur interpretime të përbashkëta të historisë. Duke krijuar marrëdhënieve më të mira ndëretnike dhe ndërkombëtare.

Interesin për të dëgjuar përvojën e fituar me projektin Narrativat e Përbashkëta e kanë shprehur edhe disa profesorë të historisë në Fakultetin e Shkencave Humanistike dhe Shkencave Sociale në Zagreb, disa ekspertë akademikë, ekspertiza e të cilëve mbulon fushën e historisë dhe kulturën e kujtesës, por edhe Ambasada Franceze në Kroaci dhe Qyteti i Zagrebit.





